

BIBLIOTEKA
SHTETIT

NJERIU GJIGANT

ROMAN

SKENDER DRINI

814-57

026

SKENDEE DRINI

NJERIU GJIGANT

Roman



SHTËPIA BOTËSE «NAIM FRASHERI»

NË VEND TË PARATHËNIES

Romani «Njeriu gjigant» është një vepër fantastike-shkencore e politike, madje më tepër fantastike-politike se sa shkencore, mbasi autori interesohet më fort për përdorimin e shpikjes shkencore, se sa për vetë shpikjen. Autori ka dashur të japë, fashistizimin e jetës në vendet kapitaliste, orvajtjen e kapitalit për të vënë në shërbim të tij kokët më të mëdha të shkencës. Borgjezia në fazën e sotme, sukseset e shkencës i përdor për të ruajtur dhe mbrojtur sistemin e saj të kalbur, të dënuar historikisht. Këtë ide dhe realitet historik, autori është munduar ta zbërthejë nëpërmjet fatit të jetës dhe të shpikjes së shkencëtarit Batler. Nga ana tjetër ai ka kundërvënë forcat regresive të përfaqësuara nga senatori Xhon Stivens, shkencëtari Maks Veber, peshkopi etj që spekulojnë me arritjet e shkencës, në rastin konkret me hormonet e rritjes që ka zbuluar Batleri. Në ndihmë të profesor Batlerit autori ka vënë forcat përparimtare e revolucionare të përfaqësuara nga Redi, Albano, Pris etj.

Me gjigantët autori do të dënojë nocionin famëkeq të «superfuqisë», mbi të cilin mbështetet sot gjithë ekspansioni politik dhe ushtarak i SH.B.A. dhe B.Sovjetik.

Romani mbyllet me dështimin e Xhon Stivensit, me demaskimin e parodisë së zgjedhjeve dhe me zgjimin politik të Batlerit, i cili e kupton përgjegjësinë politike që merr me studimet e veta se kapitalizmi është armik i njerëzimit dhe i shkencës së tij.

KAPITULLI I

Një taksi qëndroi në krye të rrugës numër trembëdhjetë. Nga porta e pasme doli një burrë i ri, i veshur me pardesy dhe me kapelë feltri në kokë. Streha e saj e gjerrë dhe e kthyer përpara i mbulonte pothuaj gjithë fytyrën. Kapela ishte e vjetër dhe e dalë boje nga përdorimi i gjatë. Nga forma dhe madhësia, ajo nuk dallonte shumë nga «panamaja» e njerëzve të jugut. I tha shoferit ta priste, pastaj u drejtua me të shpejtë për te një vilë me oborr të madh përpara, të rrethuar me kangjella hekuri.

Vjeshta ishte në të dalë. Mbi trotualet dhe mbi pllakat prej betoni të udhëve shtriheshin gjethet e zverdhura të akacieve të veriut dhe plepit kanadez. Ato binin ngadalë me një siguri të tillë që të kujtonte ritmin, me të cilin po e përfshinte vjeshta qytetin, me një zhurmë që i ngjasonte gërvishjes së një letre celofani. Që përtej qytetit vinte zhurma e mbytur e oqeanit dhe dhjetëra zhurma të tjera që përziheshin me të. Sirenat e vaporeve që po i linin lamtumirën portit, e pritnin si me thikë uturimën e ujërave dhe sajnin me të një britmë ngjethëse. E gjithë kjo që një zhurmë mbytëse dhe i ngjante pak a shumë rropamës së trenave ajrorë që trondisnin grataçielet. Megjithatë qyteti kishte çastet e veta të pushimit, ato ishin intervalet, kur dallgët ktheheshin të lodhura në oqean, pasi ishin larguar trenat, pasi që zhdukur në qiellin e zi

plot tymra ndonjë avion zhurmëmadh. Po ato ishin pushime tepër të shkurtëra dhe ndoshta po aq tronditëse sa zhurmat e vërteta. Kontrasti ndikonte për t'i nxjerrë në relief me tërë fuqinë e tyre.

Duke ecur drejt vilës, Stenli mendonte për Norman Batlerin. Ç'drejqin kishte dashur ai që e kishte ngritur laboratorin në këtë anë gjithë zhurmë?

Megjithatë vila «Trinidad» ishte një vend për t'u lakmuar në tërë qytetin, ishte si në oaz mes ndërtesave të larta që i zinin frymën asaj ane. Vila ishte e vetmja njollë e gjelbër në tërë Njuharkun, po të përjash-toje parqet publike me pemët tërë pluhur dhe kutitë e konservave të flakura në të katër anët. Shtypi zilen, pastaj zgjati kokën nga kangjellat. U çudit. Lulishten e kishin lënë pas dore. Trëndafilat e mëdhenj të Holandës qenë harlisur përdhe nga të rriturit jashtë mase. Dafne indika dhe zambakët e bardhë të fjordeve e kishin bërë vendin pyll. Bari i dendur që rritur si fier i lartë nëpër saksitë ku jetonte në miniaturë baobabi i Afrikës. E kish-te kaluar pemën «gjigante» duke i dhënë fund kështu kësaj ironie të klimës.

Stenli vështronte shumë i çuditur dhe kishte harruar që nuk po ia hapnin derën. Siç që i hutuar, zuri të ecte gjatë murit duke çikur kangjellat një nga një me dorë. Kudo e njëjta gjë: braktisje dhe harresë!

Stenli psherëtiu dhe zuri të shqetësohej. E gjithë kjo ishte tepër e çuditshme. Norman Batleri nuk do ta kishte lënë kurrë lulishten në këtë gjendje.

Përtej vinte një oborr i ndarë me shufra hekuri dhe me tel rrezë. Batleri mbante aty kafshët që i duheshin për eksperimente.

Edhe oborri që i shkretë. Stenli zgjati kokën. Vendet ku u hidhnin ushqimin kafshëve qenë krejt të thata dhe dukej qartë që nuk i kishin përdorur prej kohësh.

Ndjeu hapa pas shpinës dhe u kthye përnjëherësh. Një fëmijë nja tetë vjeç e tërhiqte të ëmën drejt vilës.

— Dua zogun Lira dhe pavodat e mëdha! — ngulte

këmbë djali gati duke qarë. — Dua të shoh pavodën e profesorit.

E ëma i hodhi një vështrim tërë frikë Stenlit, pastaj e ktheu me forcë të birin dhe s'e la t'u afrohej kangjellave. Stenli ngriti supet. «Këtu diçka paska ndodhur», mendoi ai. Pastaj iu kujtua që kishte marrë letër në udhë e sipër, në Zvicër, përpara tri ditësh dhe u qetësua. Letra ishte shkruar nga Norman Batleri përpara dy javësh dhe mbante adresën e vilës «Trinidad». Batleri nuk e kishte njoftuar se mund të ndërronte laboratorin. «Po braktisja këtu nuk është punë dy javësh, u shqetësua prapë Stenli, është shumë e gjatë...» I ra edhe një herë ziles dhe priti. Shoferi i taksisë kishte ngritur mbulesën e përparme të maqinës dhe seç po bënte.

Stenli nxori një cigare dhe e ndezi. Gjithfarë mendimesh nisën t'i vërtiteshin nëpër kokë.

Dy veta që kaluan andej iu shmangën trotuarit posa iu afruan vilës dhe zbritën në udhë. Stenlit iu duk se ata e vështruan në një mënyrë të jashtzakonshme.

E mbajti një kohë të gjatë gishtin në butonin e ziles. Nga vila asgjë!

Kishte katërmbëdhjetë muaj që ishte larguar nga Njuharku. Gjithë këtë kohë e kishte kaluar në lindje, në Filipine, në Australi dhe në Zelandën e Re për të mbledhur materiale shkencore që i duheshin për disertacionin. Meqë fusha e studimeve të tij ishte e afërt me kërkimet e Norman Batlerit, materialet e mbledhura u hynin në punë të dyve. Stenli qe asistent i Norman Batlerit. Batleri e kishte marrë posa u diplomua, po në të vërtetë Stenli i kishte ndihmuar profesorit shumë kohë më përpara.

Stenli ishte aq këmbëngulës në punë sa e bëri Batlerin menjëherë për vete. Karakteri i tij përkonte me mendimet që kishte Norman Batleri, që vinte këmbënguljen përpara inteligjencës kur përcaktonte një kërkues. Rasti i Stenlit qe ideal për të vërtetuar këtë, megjithëse te asistenti këmbëngulja dhe inteligjenca shkonin krah për krah. «Duke u nisur nga këmbëngulja e Stenlit, qeshte

Batleri në të rrallë, kushdo që ka pak fantazi, mund ta marrë asistentin tim për një nga ato mushkat proverbiale të papunëve të Avinjonit»¹⁾

Norman Batleri merrej prej dhjetë vjetësh me studimin e gjendrave me sekrecion. Në fillim i hyri kësaj valleje thjesht për të shëruar të sëmurët, pastaj shkoi tepër larg. Udhën ia hapën vetë ato gjendra misterioze, për të cilat gjer atëhere dihej fare pak, ose kishte të dhëna të gabuara. Nga studimi dhe shërimi i sëmundjeve, Batleri kaloi gjer te ndërrimi i vetive të qenieve të gjalla. Aq përpara shkoi, sa në sytë e të tjerëve ai mori pamjen e një magjistari çudibërës. Në oborrin e rrethuar me tel shiheshin pavoda, pula, gjela deti dhe plot kafshë të tjera afro tri herë më të mëdha nga ato të zakonshmet. Padsdrekeve kangjellat e vilës mblihdnin plot kureshtarë që vinin të vështronin çuditë e profesorit. Vështronin dhe tundnin kokën të mahnitur, po asnjërit nuk i shkonte ndër mend që këto mrekulli Batleri i kishte arritur përmes hipofizës, gjendrës misterioze në «shalën e Turkut»²⁾

Stenli Pris sa vinte dhe shqetësohej më shumë. Papritur u kujtua që në aeroport ia kishin mbajtur në duar më shumë se sa duhej pashaportën dhe se një nga nëpunësit nuk ia kishte ndarë sytë çantës së tij të madhe.

Stenli u drodh, u shkëput nga kangjellat dhe vrapoi drejt taksisë. Hapi derën dhe mori çantën. Aty brenda kishte katërmbëdhjetë muaj punë kërkuese dhe mendime si rrjedhim i vëzhgimit nëpër vendet e lindjes, dhe kryesoren «ndikimin e rrezatimit diellor mbi rritjen e organizmit».

1) E përdor A. Dode. Është shprehje mjaft popullore në Francë. Rrjedh që nga koha kur papët e kishin selinë në Avinjon të Francës.

2) Hipofiza është gjendër me sekrecion të brendshëm, ndodhet në «shalën e Turkut». Hipofiza influencon në rritjen e organizmit dhe në procese të tjera.

— Paguani atëhere, mister — i tha shoferi që e pa të dilte me çantën.

— Pritni — ia ktheu Stenli. — Nuk do të qëndroj shumë.

Ai kishte pasur ndër mend vetëm sa ta shihte Norman Batlerin, pastaj të shkonte në shtëpi.

Stenli pyeti një plak që po kalonte nëpër trotuar.

Plaku ngriti supet pa folur.

— Nuk e njihni profesorin Batler, mister?

Prapë ngritje supesh.

Një grua që kaloi po atë çast për çudinë e madhe të asistentit tha se nuk ia kishte dëgjuar kurrë emrin këtij profesori.

— Zonjë! Atëhere me siguri do ta njihni Xhosi Xhozdejin — tha me cinizëm të hapur Stenli. (Xhosi Xhozdej ishte klloun cirku.)

Ju drejtua edhe një polici. Policët në Njuhark janë mbretër pa kurorë.

— Nuk e njoh, — u përgjegj ai pa pikë njerëzie.

E lëshoi veten krejt. E pushtoi një valë e zymtë, e trishtuar. Gjithë gëzimi dhe entuziazmi që kishte ndjerë me të vënë këmbën në tokë, tani qe zhdukur. Vendin e tyre e zuri një farë zbrazësie dhe frike. Ju duk se qyteti kishte ndërruar shumë në ato katërmëdhjetë muaj, iu duk sikur ai vraponte me dëshirë drejt së keqes dhe çnjerëzores. Katërmëdhjetë muaj përpara nuk ishte aq i vrejtur ky qytet, nuk të përgjegjeshin kaq harbutërisht banorët e tij. Kështu mendonte Stenli. Ai vështroi orën dhe desh të shkonte deri në fakultet të pyeste për Batlerin, kur diçka kërciti nga vila. Pastaj dera e brendshme u hap dhe një njeri jashtëzakonisht i shkurtër nxori pak kokën jashtë saj.

— Din! — thirri gjithë gëzim Stenli. — Din!

Shkurtabiqi mulat çapëloi sytë gjithë frikë dhe bëri të hynte prapë brenda. Ai plakush sa një grusht i shërbente si roje vile Norman Batlerit.

— Ç'më fshihesh, mor budalla i mallëkuar? Jam unë, Stenli! — ulëriti tjetri duke parë që shkurtabiqi po e mbyllte derën pak nga pak.

Mulati e mbylli edhe më shumë derën dhe gati humbi pas saj.

— Ç'ka ndodhur, moj pjellë e keqe? — bërtiti Stenli duke harruar që ndodhej në mes të rrugës. — Ku është profesori? — Me të dëgjuar pyetjen e fundit, mulati u zhduk fare.

— Ah! — psherëtiu Stenli dhe kërceu në murin ku mbështeteshin parmakët e hekurt. Ai po matej të hidhej përtej, kur ndjeu një dorë të fuqishme në sup. U kthye dhe mbeti si i mpirë. Dy burra të shëndoshë qëndronin përpara tij. Pa nga rruga. Ngjitur me taksinë e tij kishin ndaluar një «Bens» i madh, i zi.

— Ç'dëshironi? — pyeti Stenli i tronditur.

— Zbrisni!

Stenli u hodh poshtë.

Njëri nga ata të dy ktheu jakën e përdesysë, Shërbimi sekret i shtetit!

— Ky është keqkuptim — kundërshtoi Stenli. — Unë nuk desha për të... Unë jam...

Ai mendoi se mos e kishin marrë për ndonjë hajdut.

— Nuk ka asnjë keqkuptim, mister. Ju njohim fare mirë. Ju jeni Stenli Pris.

— Dhe atëhere? — pyeti i dëshpëruar Stenli.

— Atëhere ju lutemi të vini me ne — tha njëri nga ata.

Stenlit iu kujtua menjëherë se ku e kishte parë atë fytyrë. Ai ishte nëpunësi i doganës që kishte mbajtur diçka më gjatë pashaportën e tij. Me sa dukej ata e paske-shin ndjekur. Stenli shtrëngoi më shumë dorezën e çantës, po pas pak kjo iu duk qesharake dhe e lëshoi. Gjer tani ata të dy ishin sjellë shumë mirë me të.

— Të paguaj taksinë, atëhere — foli Stenli dhe psherëtiu.

— Është paguar! — ia kthyen ata me një gojë.

Çudia e asistentit sa vinte e shtohej. Po ai nuk e zgjati më shumë. I hapën derën e maqinës dhe hyri

brenda. Ktheu kokën nga taksia. Shoferi i saj vështronte gjithë inat nga «Bensi», po nuk ia mbajti të lëvizte. Me sa dukej nuk e kishin paguar. Stenli u zemërua dhe desh të thoshte diçka. Po atë çast diçka tjetër e turbulloi. Pranë shoferit të «Bensit» qëndronte një i tretë. Ai vështronte drejt përpara pa e kthyer kokën nga Stenli. I pa fytyrën në pasqyrë dhe u drodh. Ai ishte Maks Veberi, një shkencëtar me zë, i lidhur me qarqet e Jarta të Njuharkut. Stenli e kishte takuar dy a tri herë nëpër konferenca shkencore, po s'kishte miqësi me të.

— Mister Veber! — i thirri ai megjithatë. — Mister Veber! — Ai që rrinte pranë shoferit nuk e ktheu fare kokën. Pamja e fytyrës së tij në pasqyrë ishte e qetë. Stenli u lëshua i mërziur pas poltronës. Maqina zuri të çante me shpejtësi udhët plot lëvizje të Njuharkut.

KAPITULLI II

Vetëm kur zbardhi e kuptoi se kishte punuar gjithë natën. Megjithëse laborator i ndriçohej shumë mirë nga llambat e argonit, drita e diellit ua doli atyre.

I pari e ngriti kokën nga mikroskopi Norman Batleri. Ai ndjeu në gojë shijen e keqe të gjithë atyre purove «Marlboro» që kishte pirë. U kollit nja dy herë vrazhdë, u shtriq si ai që posa zgjohet dhe shtypi një buton në anë të tryezës së punës. Pastaj u kthye me gjithë poltronën e vet rotulluese dhe pa asistentin pas dhomës me xham.

Maks Veberi nuk e kishte lënë ende punën.

Batleri fërgëllloi nga kënaqësia. Ky qe një fërgëllim prej njeriu të shkencës që ka kaluar gjysmën e jetës në laborator dhe që kërkon ta gjejë pasionin e kërkuesit edhe të tjerët.

Shkencëtari është njeri. Edhe ai ka baticën dhe zbacicën e tij. Më të rrallë ka edhe çastet e pendimit për atë

jetë murgu; i duket se miliona e miliona njerëz të tjerë jetojnë më mirë se ai. Prandaj do një ballsam, do një dëshmi të fortë që edhe ai ka jetuar, që edhe ajo jetë është po aq e bukur dhe e madhe sa e atyre që e shijojnë nën diell dhe nën shi. Po a nuk janë dëshmi e fortë për këte brezat e rinj të kërkuesve që ulen përpara epruvetave dhe mikroskopeve? Jetën e shkencës e vлека për ta jetuar, atëhere...

Batleri i kishte shumë të rralla këto shpërthime, po ama i kishte.

Nuk ia kishte ndarë sytë Veberit. «Nuk i lë gjë mangut Stenlit, mendoj profesori, mbase dhe ia kalon». Po pastaj u vrejt. Asistenti po punonte për llogari të vet. Kohën e punës në shërbim të Batlerit e kishte mbarur qëkur. Dhjetë orë punë!

Batlerit i qe dukur sikur ato dhjetë orë kishin kaluar si vetëtimë. (Kështu i dukej edhe kur punonte me Stenlin, sado që ky i fundit nuk e ndante punën e tij nga puna e Batlerit).

Batleri nuk kishte pse të ankohej nga asistenti i ri. Në kontratë shkruhej që Maks Veberi mund të bënte kërkime për llogari të vet, pasi të kishte plotësuar detyrimin ndaj Norman Batlerit. Profesori e dinte se Veberi kishte interesat e tij. Nëse kishte pranuar të punonte edhe për të, pikërisht ato interesa e kishin shtyrë. Megjithatë s'kishte përse të ankohej për asistentin e ri. Ai tregonte po atë durim dhe këmbëngulje, sikur punonte për vete, sikur ndihmonte Norman Batlerin. Tri ditët e para të javës, dhjetë orë në shërbim të tij. Të enjten Batleri nuk punonte. Ditët e tjera mbante leksione në fakultet. Maks Veberi mund ta përdorte laboratorin edhe kur s'ishte profesori aty. Dhe ky i fundit e dinte mirë që vetëm falë atij laboratorit të pajisur më mirë se asnjë tjetër në Njuhark, kishte pranuar Veberi ato tridhjetë orë pune dërmuese në tri ditë. Veberi e kishte thënë edhe vetë këtë. Apo kishte edhe arsye të tjera? Po për këto, hëpërhë Batleri kishte vetëm dyshime. Në fillim Maks Veberi kishte kërkuar të ishte diçka më i lirë. Profesori kishte ngulur këmbë. Për

asgjë në botë nuk do ta ndryshonte atë regjim pune që kishte ndjekur me Stenlin.

Batleri pra nuk kishte pse të qahej nga asistenti i ri, megjithatë atë mëngjez sikur u pendua që e la Stenlin të ikte. Cili që ndryshimi në mes atyre të dyve? Ato dy muaj që po punonte me Veberin i kishin zgjuar Batlerit një kërkesë të re. Kur që Stenli, nuk kishte menduar kurrë që një shkencëtar, përveç ndihmës, ka nevojë edhe për një shok pune, për një mik. Dukej që Stenli e kryente edhe këtë rol në një farë mënyre të pakuptueshme, me një mënyrë krejt të tijën. Po Veberi? Hëpërhë ai ishte i ri. Po edhe ai kishte diçka interesante. Nuk i kalonte kurrë caqet e marrëdhënieve të Stenlit me Batlerin. Ai sikur i kishte njohur mirë ato caqe dhe dëshironte të rrinte brenda tyre.

Batleri ngrysi sërish vetullat. Nuk i erdhi mirë që po merrej me të tilla arësytetime. Kishte pasur mjaft asistentë në jetën e vet, po për asnjërin nuk kishte menduar gjë tjetër veç punës dhe kërkimit. Çkishte me Maksin? Nuk e ndjente shpinën aq ngrohtë tani që te mikroskopi elektronik pas krahëve të tij rrinte një tjetër në vend të Stenlit? Ishte për t'u çuditur.

Kur punonin veç e veç, qëllonte që edhe me Stenlin të mos ndërronin dy fjalë për dhjetë orë rresht. Qëllonte të mos i vinte vesh siç duhej Stenlit edhe kur ai hapte ndonjë bisedë rreth ngjarjeve të kohës dhe asistenti nxehej me vete. Megjithatë Batleri ndjehej shumë i qetë me Stenlin, shumë i sigurtë. Nuk i kishte vajtur mendja kurrë te arësytimi gati femënor i «shpinës së ngrohtë» siç po bente tani. Kështu e quajti Batleri pak më vonë këtë: arësytim femëjesh nga të kolegjit «Morrison». Po nuk ishte krejt kështu. Ai harronte që kjo shprehje nuk ishte e re për të. Disa vjet mjaftuan për t'ia shlyer nga kujtesa sa ngrohtë e ndjente shpinën kur në bisht të avionit të tij fluturonin shokët në vend të «Stukasve» dhe «Foke-Vulfëve»¹⁾. Megjithatë luftën ai e kishte bërë në ajër më

1) Aeroplanë luftimi të përdorur nga nazistët në luftën e dytë botërore.

shumë dhe po nga ajri e kishte parë luftën dhe nazizmin. Në kohën kur nuk kishte nisur ende ajo dhe në Vilhelmshtrase parakalonin kryqet e thyera me pishtarë të ndezur, Norman Batleri rrudhte buzët kur ndonjë i profetizonte fatkeqësira pa numër dhe as që e merrte me mend ç'mund të ndodhte. Po ja që lufta shpërtheu atëhere kur nuk e priste. Batleri bëri vetëm dy vitet e fundit të luftës më shumë në ajër se në tokë. Kishte ngritur një sallë shëtitëse operacioni mbi një «Hurrikan» të vjetër, të arnuar nga plumbat. Me të ai u ra fushave të luftës kryq e tërthor, që nga Ardenet, në Afrikën e Veriut, që nga Siquilia gjer në prapavijat e armikut. Batleri shëronte të plagosur, u nxirrte predhat nga mushkëritë, i shihte t'i vdisnin ndër duar për mungesë transfuzioni, shihte flakën dhe vdekjen rreth e rrotull (e kishte parë dhe rreth vetes kaq herë), dhe nuk ishte në gjendje të kuptonte si mund të pillte bota luftën dhe nazizmin. Miliona njerëz që nuk gërmonin aq thellë sa ai, i kishin krejt të qarta këto gjëra, Batleri jo. Ai vinte mbi tryezë arësyeën e shëndoshë dhe mbetej i zhgënjyer. Arësyeja e shëndoshë nuk e pranonte as luftën, as nazizmin. Nga pikëpamja ai që demokrat i lindur, sado që s'kishte marrë mundimin asnjëherë ta mësonte demokracinë nëpër libra. Atë ai e kishte thithur si të thuash në eter, siç mund të thithet një aromë e këndshme. Për të arritur këtu e kishte ndihmuar karakteri i tij i drejtë. Demokracia e Batlerit binte erë Furrie dhe Ovens, sado që ai as që e dinte kush ishin këta zotërinj. «Është një demokrat instinktiv», thoshin disa, që ia njihnin pak a shumë bindjet. Po kishte të tjerë që mendonin ndryshe dhe më origjinali ndër ta e kishte quajtur Batlerin, «naivi i çmendur, i përkëdhelur nga fati».

Megjithatë lufta e shkundi Batlerin. Me të mbaruar ajo, ai u kthye shumë më i ndryshuar në atdhe. Mjafton të sjellësh ndër mend ç'bëri Batleri, për të shpëtuar zezaken Pater. Atë kohë ai besonte në forcën e shoqërisë së bashkuar dhe që një ndër krerët që luftuan për të shpëtuar Xheni Paterin. Shpëtimi i Paterit do të ishte edhe i

Norman Batlerit! Po kjo s'qe e mundur. Ai u mbyll në laborator dhe i shkurttoi në maksimum lidhjet me botën. Tani pas kaq vjetësh i kishte lindur edhe një herë ideja gati feminare e shpinës së ngrohtë. Pse? Mos shihte Batleri «Stukas» dhe «Mesershmüt» në bisht të avionit të tij?

E gjithë kjo rridhte ngaqë Batleri e kishte kuptuar më në fund ç'donte Maks Veberi nga ai. Donte atë prodhimin misterioz të hipofizës, donte hormonet e rritjes.

Dera e laboratorit u hap. Sipër saj tingëlloi zilja dhe brenda u fut mulati Din. Servisi prej porcelani morri përpjesëtime të habitshme në krahasim me trupin e tij prej xhuxhi. Servisi i dridhej pak në duar.

Batlerit iu duk se ishte vonuar dhe ngrysi vetullat. (Vetullat e tij qenë të zeza dhe pa asnjë thinjë. Studentët thoshin që vetullat e Batlerit nxjerrin një paund lesh).

Mulati la mbi tryezë gotën me limonadë për Batlerin dhe kafënë e Maks Veberit. Norman Batleri nuk e ndërronte prej vitesh dietën e mëngjezit: një gotë të madhe me ujë ku shtrydhnin një limon të tërë.

Dini u tërhoq.

— Nëse ka letra për mua sillmi — tha Batleri.

Ai ua kishte ndaluar t'i çonin korespondencën kur punonte. Zakonisht letrat i shihte vetëm kur pushonte.

Zuri të pinte limonadën. E gëlltiste me ëndje të madhe duke e shijuar gllënjë pas gllënjë. Kështu i ikte shija e keqe e purove dhe lodhja e një nate pa gjumë. «Gjatë tridhjetë vjet pune në laborator vetëm një gjë kam zbuluar unë, Anabell, bënte shaka me të mbesën, vetëm këtë gotë me limon të shtrydhur».

Vështroi Maksin. Asistenti vazhdonte të punonte me kokën ulur. I shihte gjysmën e fytyrës. Ajo tregonte një qetësi dhe vëmendje për ta pasur lakmi. Syrin e mëngjër e mbante të mbyllur, tjetrin të puthitur pas okularit.

Përqëndrimi i asistentit e bëri nervoz. «Duket se po plakem, mendoi, nuk mund të punoj si ky...» Po përnjëherësh iu kujtua avantazhi që kishte ndaj Veberit dhe buzëqeshi. Kjo qe një buzëqeshje zanati, gati e egër dhe

egoiste. Veberit i duheshin pothuaj dhjetë vjet punë për të arritur te hormonet e rritjes.

Batleri ngrysi vetullat sërish. Tani që ai kishte zbuluar çdo gjë, nuk ndjente pikë kënaqësie. Kjo ndodh në shkencë dhe në jetë. E kërkon me ngulm diçka, i kushton gjithë jetën dhe, kur e ke gjetur, gëzimi është i shkurtër. Po pikërisht këtu është madhështia e njeriut. Ai është i pakënaqur, se nuk i mjafton ajo që ka bërë e do të bëjë më tepër, të shkojë më larg, pa mbarim. Po Batlerin nuk e shqetësonte kjo. Ai i druhej zbulimit të vet, i druhej fuqisë së hormoneve të rritjes. Në duart të këqija, ato mund të bëheshin mjet i së keqes... Jeta ka treguar që gjithë zbulimet e mëdha kanë qenë si thikë me dy presa. Ato janë përdorur edhe për njeriun, edhe kundër tij. Dyshimet që kishte si dhe ardhja e Veberit e bënë të ndërpriste punën. Le që ai tani s'kishte ç'të zbulonte më. Kishte kohë që hipofiza s'ishte më një mister për të.

Hoqi bluzën e bardhë dhe doli në lulishte. Vesa shkëlqente mbi lulet dhe barin e njomë. Ajo e tregonte qartë pluhurin e blozës mbi trandafilët e bardhë dhe mbi zëmbakë. Vesa e kishte mbledhur pluhurin si toptha të vegjël mbi gjethe e lule. Ajri mbante erë blozë nga uzinat që kishin punuar gjithë natën. «Smok», pëshpëriti Batleri dhe fryu hundët në shami.

Zuri të vërtitej nëpër lulishte. I kujtoi edhe një herë ato që kishte menduar në laborator dhe u drodh. Hipofiza, hormonet e rritjes, gjigantizmi... Hormonet në duart e shkencëtarëve pa skrupuj... Nuk do të ndalnin përpara asgjëje ata, gjer në krijimin e njerëzve përbindsha... Njeriu përbindsh që bredh udhëve me çomangë me gjemba në dorë... Njeriu përbindsh në duart e manjatëve të politikës... Përbindshi është fuqi. Fuqia u duhet manjatëve. Hormonet e rritjes... Përbindshit... Përse mund të hyjë në punë përbindshi sot? Njerëzit mund të jenë të tillë edhe me përmasat e zakonshme. Hipofiza! Gjendra misterioze në «shalën e turkut». Gjithë ato vite kërkimi dhe tani... Stenli është larg. Veberi atje brenda. Veberi në


laborator. Veberi ëndërron përbindshit me çomange me gjemba. Pse e la Stenlin të ikte? Përbindshit që ulërijnë nëpër udhët e Njuharkut dhe shkelin qytetërimin me këmbë...

Në rrugë përtej kangjellave vërshonte lumi i pandërprerë i maqinave. Diku larg ulërinte një sirenë fabrike. Ja, ajo duhet të ulërinte, vetëm ajo duhet të ishte e përbindshme. Le të ulërinte, le të ulërinte...

Batleri pa fytyrën e vet të parruar në hurdhën e peshqve. Imazhi dridhej sipas dredhjeve të ujit. Qe një fytyrë e qetë pesëdhjetëvjeçari «të rrethuar me dafina.» Ajo fytyrë e kishte jetën të siguar.

Batleri u drodh. Pa një emblemë të qepur nën xhepin e sipërm të xhaketës. Një goxha emblemë. Si djallin e kishte veshur sot këtë kostum që s'e përdorte prej dhjetë vjetësh. Emblema «Klubi i drejtësisë». Njuharkezët vdesin për klube, për emblema. Pa emblemë Njuharkezit i duket vetja sikur shëtiti lakuriq mes bulevardit një ditë të diel. Pra ajo është një lloj veshjeje për të, si palltoja, si xhaketa që i shërben për ta paraqitur në botë. Batleri nuk mund të ndahej nga grigja, e kishte qepur edhe ai në xhaketë. «Klubi i drejtësisë», një balancë gati mesjetare. Drejtësia dhe mesjeta... Ekstremit puqen në erën tonë... «Klubi i drejtësisë» dhe procesi kundër Xheni Paterit¹⁾... A do të hynte ai sot në ndonjë «klub drejtësie»? Ka vite që ka hequr dorë nga kjo dobësi. «Dobësi» në gjuhën e sotme të Batlerit do të thotë «humbje besimi». Xheni Pateri në morg. Xheni Pateri në sallën e autopsisë. Xheni Pateri kavie eksperimenti për Norman Batlerin. Bisturi hyn diku edhe në zemrën e Batlerit, nuk përshkon vetëm Xhenin. Nga karrigja elektrike drejt e përpara Batlerit. Zezakja ka marrë formën e karriges ashtu e ngrirë nga korrenti. Shoqëria përfiton nga kriminelët vetëm pas vdekjes... Batleri përpara Paterit. Jo, nuk mund të çante atë trup, ai kishte luftuar që ta mbronte. Dy vjet kishte luftuar për ta shpëtuar. Për këtë qëllim

1) Emri është i trilluar, po fakti real. Ndodhi në shtetet e jugut të SH.B.A.



qe formuar edhe «Klubi i drejtësisë». Dhe Xheni Pateri shpëtoi. Shpëtoi nga konvejeri i kutive të konservave. Dyqind etiketa në minutë! Duart përzihen, ngatërrohen... Vënë etiketa edhe kur të përshëndetin, kur të përkëdhelin, kur mbështeten në hekurat e tramvajit... Dyqind etiketa në minutë! Duart përzihen, ngatërrohen. Harrojnë që i përkasin Xheni Paterit. Duart i përkasin padronit.

Xheni Pateri nuk ka faj! Nuk e vrau ajo magistrin e madh. Gjetiu ta kërkojnë vrasësin! Pse i tërheq vetëm ngjyra e zezë? E zeza dhe e kuqja? ¹⁾

«Klubi i drejtësisë» i bie fanfarës me tërë fuqitë. Po mbetet një zë në shkretëtirë. S'ka si të jetë ndryshe, gjersa është vetëm fanfarë... Në Njuhark nuk mund të jetohej duke i rënë fanfarës. Në fillim ikin ata që i kanë vënë për herë të parë instrumentat në buzë... Pastaj me radhë... Fanfara prishet. Prishet edhe «Klubi i drejtësisë». Dihej kjo! S'mund të bësh drejtësi me trompë e saksofon! Po me se? «Me të shtëna», mendonin disa, po jo Batleri! Ai u largua i fundit nga fanfara, brodhi dhe u përpoq sa mend u bë për ta mëshiruar. Pastaj erdhi batica dhe ai hoqi dorë nga drejtësia dhe nga lufta. Ai u përpoq ta shpjegonte disfatën me shkencën: «Nuk mund të bëhet asgjë në këtë botë gjersa s'ka dy mendje të njëllorja, dy tru të njëllorjtë!» Qe një bindje që rridhte nga bisturi që hapte kafkat, po qe dhe një nënshtrim. Batleri u mbyll në laborator. U përpoq të harronte Njuharkun, «Klubin e drejtësisë», zhaketën me balancën nën xhep. Kohën që i tepëronte nga kërkimi e kalonte me Tacitin, Lukrecin dhe bashkëkohësit e tyre. Nuk i lexonte me ndonjë besim të madh as ata. Dhe koha e tyre s'kishte nxjerrë tru të njëllorjtë, megjithatë ajo qe më e lehtë për ta kuptuar. Po koha e Njuharkut? Një kaleidoskop... Ai i solli ndër mend të gjitha këto, sepse e dinte që do t'i duhej të mbante edhe një herë qëndrim në jetë si në rastin e Xheni Paterit. Veberi kërkonte hormonet e rritjes. Batleri tani e kishte edhe më keq se përpara dhjetë vjetësh. Tani ishte po-

1) Aluzion për zezakët dhe komunistët

thuaj vetëm, tani as fanfarës nuk të linin t'i bije në Nju-hark.

Profesori ngriti kokën. Nga kati i dytë i vilës vinte një melodi e gëzuar. Grilat ishin të mbyllura, po brenda në dhomë kishte dritë. «Anabella qënka zgjuar», tha Batleri me vete.

Zajet e lulishtes u prishën nga një hap i sigurt dhe i fortë. Po vinte Veberi.

Batleri u kthye përgjysëm nga ai.

— Keni shëndet të mirë, mister Veber — i tha. — Tek kërcisnin zajet, pata përshtypjen se po vjen një graduat i posadalë nga Vest-Pointi.¹⁾

— Një kohë kam shërbyer në ushtri, — u përgjegj Veberi. Po ai u pendua menjëherë për budallallëkun që bëri. Pse t'ia tregonte ai jetën e vet Batlerit? Ata ndërrojnë, a nuk ndërronin dy fjalë në ditë.

— Veber!.. Nuk duhet të jetë njuharkez ky mbiemri juaj, mister Maks.

Asistenti e vështroi me dyshim. Ç'i kishte hipur kështu sot këtij plaku kokëngjeshur?

— Nuk është njuharkez, — u përgjegj Veberi dhe desh të largohej.

— As edhe i kombësisë sonë — nguli këmbë tjetri. Veberi mohoi me kokë dhe u largua.

Batleri e ndoqi një copë herë me sy, pastaj u fut në të ndarën ku mbante shpendët. I hapi dyert e kafazëve. Që andej vërshuan dy gjela deti afro dy herë më të mëdhenj nga racat më të mira që njihen, ndonjë gjysmë dyzine pulash «Leghorn», po me përmasa të tilla, si dhe një pavodë madhështore. Pavoda hapi krahët dhe zgjati bishtin. Bishti i saj i shkëlqyer doli pas rrzës së telave dhe sajoi andej gjithë ngjyrat e ylberit. Zogun Lira nuk e lëshoi. Atë e ushqente mbasi mbyllte pavodën. Ato të dyja s'jetonin dot në paqe. Kur grindeshin, Batleri pëshpëriste: «Lufta për sundim nis nga kafshët!» Ky ari laborator, që kishte nocione të varfëra në sociologji, nganjëherë qëllonte në shenjë.

1) Akademi ushtarake në SHBA.

Zhurma në udhë kishte pushuar diçka. Kalonin vetëm vetura të ngeshme dhe maqina që zbraznin mallra nëpër supermerkatet anës trotuarëve. Njuharku e kishte zbrazur barkun e vet vigan. Shitësit e gazetave të mëngjezit qenë ulur grumbuj-grumbuj gjatë trotuarit dhe loznin me zaret. Ishin fëmijë dhe të rritur. Zaret nuk kanë moshë në Njuhark.

Në katin e dytë të vilës vazhdonte xhazi. Dëgjohej zëri i Amstrongut. Batlerit iu kujtua që e mbesa i qe lutur mbrëmë ta çonte në opera. Kishte harruar.

Maks Veberi nuk e kishte pirë ende kafënë. Ajo ishte ftohur qëkur dhe tani me siguri do të ishte bërë një lëng i zi pa shije. Veberi bariste poshtë e lart nëpër laborator. Ai u kujtua për kafënë vetëm kur hyri profesor Batler. E gëlltiti me një frymë pa shprehur asnjë shenjë kënaqësie.

Batleri u ul në poltronin e vet.

— Po të doni, mund të pushoni në sallon, mister Veber — tha ai papritmas.

— Falem nderit, profesor, po dua të vete në shtëpi.

— Këto ditë dua të operoj Dinin — vazhdoi Batleri. — Nuk ka të holla për ta bërë gjetiu operacionin. Do t'ju lutesha të më ndihmonit në anestezi.

— Mulatin tuaj?

Batleri pohoi me kokë.

— Ç'ka?

— Tumorr në zorrën e trashë. Po të mos ia heqim, do t'ia hajë kokën.

Heshtën disa çaste. Të dy përpiqeshin të mos e vështronin njëri-tjetrin në sy. Kjo ishte gjë e zakonshme për të dy.

— Në mos gabo hem, mulati juaj ja ka shitur trupin institutit «Norton»?

— Po, pas vdekjes, për pesëdhjetë mijë dollarë. Çuditem nga e paski marrë vesh ju?

Batleri u kthye dhe ia nguli sytë Maksit. Veberi duhet t'i kishte kaluar të dyzetat, por nuk tregonte më shumë se 35-36 vjeç. Batleri sikur e shihte për herë të parë.

Iu duk jashtëzakonisht i pashëm. Flokëverdhë me lëkurën e fytyrës të njomë dhe pa asnjë rrudhë, me ca sy të kaltër dhe të bukur, ai i ngjante Çarl Stefensit në filmin «Shpresat në Nebraska». Megjithatë sytë e tij ishin disi të ftohtë. Kishte diçka të pakapshme në to. Sytë e tij sikur të shpëtonin nga duart.

— Instituti «Norton», ai që ju financon ju, mister Batler, — i dredhoi pyetjes Veberi. — Megjithatë pesëdhjetëmijë dollarë janë një vrimë në ujë.

Asistenti qëndronte këmbë mbi këmbë dhe kishte ndezur një puro. Po, meqë nuk pinte duhan, e mbante puron në dorë si ndonjë fëmijë që llastohet.

— Siç duhet ta keni marrë vesh, për anët financiare të kërkimeve të mia interesohet Anabella.

Kjo që një përgjegje për ta prerë shkurt hovin e Maks Veberit. Pastaj Batleri i kishte inat bisedat për para.

— E di! — Veberi nxori një shtëllungë të madhe tymi, e ndoqi me sy si u ngjit lart, pastaj vazhdoi: — Po pesëdhjetëmijë dollarë nuk janë gjë po të marrësh parasysh me ç'fonde luan instituti «Norton». E lexuat sa i dhuronte institutit korporata e mishit? Plot tre milion të thata!

Batleri pohoi me kokë pa e vështruar.

Ai vështronte tani diku në një pikë, në një qoshe të murit. Qoshja që e zezë, e ndotur. Batleri nuk po kuptonte ç'që ajo njollë e zezë. Ai që i papërqëndruar. E gjithë kjo ishte ngaqë ai priste të shpërthente Maksi. Kështu do të ishte më mirë, do të përcaktohej qëndrimi mes njëri-tjetrit.

Veberi e shuajti mirë e mirë puron, pastaj u kthye nga profesori. Me ç'dukej ai do ta vazhdonte bisedën.

— Ju, mister Batler, as që ia keni nevojën «Nortonit», as edhe mecenatëve të tjerë. Mjafton t'u jepni trusteve që rritin shpendë zbulimet tuaja dhe do të jeni i fortë dhe i pavarur. Paraja të jep supremaci. Kur ke para, diçka je, pastaj lëre dobinë që mund të sjellë.

— Nuk e kuptoj supremacinë — i vrejti vetullat Batleri. — Në çdo rrethanë për mua njerëzit janë njëlloj. Nuk e kuptoj dhe as që ekziston.

Veberi u zemërua. Ai u ngrit në këmbë dhe u afrua pranë Batlerit.

— Më falni, — tha — po atëhere unë mund të heq kur të dua dy vija barazimi mes mulatit dhe profesorit të famshëm Batler.

— Të hiqni, posi! Në kushte të njëjta me të miat, mulati Din, nuk do t'i linte gjë mangut Norman Batlerit.

— Kurrë! — gati ulëriti Veberi. — Kurrë, mister Batler! Vetë jeta juaj e hedh poshtë këtë. Keni pasur me mijëra studentë nëpër duar. Të gjithë ata pak a shumë kanë punuar në kushte të njëjtoja. Sa prej tyre u dëgjuan? Sa bënë emër në shkencë? Tre-katër veta.

Batleri nuk diti çfarë të thoshte. Le që ai dhe nuk po ia vinte veshin si duhet. Më shumë ndiqte një njollë në mur. I dukej sikur lëvizte, sikur zgjatej dhe mblidhej top, si ndonjë polib. Po kaq ngadalë, sa mezi dallohej. Dje ajo njollë nuk kishte qenë aty.

Batleri ndiqte dhe Veberin. Veberin dhe njollën. Ata të dy gjer atëhere po ecnin paralel, me po atë shpejtësi. Batleri iu kthye asistentit. Atë çast kishte një fytyrë energjike dhe s'i tregonte aspak të pesëdhjetë vjetët e tij.

— A nuk më thoni pse erdhët të punoni me mua, Veber? Ju jeni aq i zoti, sa nuk keni nevojë për ndihmën e askujt!

— Kam kohë që e pres këtë pyetje dhe do t'ju përgjegjem — tha tjetri. — Kur erdha këtu, unë kisha një plan të përcaktuar mirë. Po, me të shkelur në laborator, e kuptova që kisha gabuar. Ju kujtohet? Ju më shtrënguat dorën dhe më treguat udhëzimet që m'i kishit pregatitur me shkrim në laboratorin tim. Ato kërkime nuk kishin asnjë lidhje me ato që më interesonin mua, as edhe me ato që ishit marrë ju. Unë kërkjoja hormonet e rritjes, ju më ngarkonit t'i vihesha pankreasit. E pashë që nuk do të nxirrja gjë nga ju. Më falni, mister Batler! Po nuk ju vë faj. Është e drejta juaj t'i mbani për vete ato që keni zbuluar. Edhe unë kështu do të kisha vepruar. Do t'ua jepja të tjerëve vetëm për një shifër astronomike.

«Të paktën flet hapur mendoj Batleri. Po ajo djall njolle? Më duket po lëviz. Njolla ngadalë, Veberi po e shton shpejtësinë...»

— Dhe pse qëndruat, kur ishte kështu?

— Spektotroni juaj është i vetmi në Njuhark. Koka më të mëdha se imja do të vinin këtu vetëm për hir të tij, ju e dini këtë. Po pata edhe arësye të tjera. Në fillim m'u ndez gjaku dhe m'u mbush mendja t'i vihesh po asaj pune që isha i bindur se e keni zbuluar ju. Kështu vendosa, sidomos kur u binda që ju mund të mos i publikonit zbulimet tuaja. Pata një ide, sipas saj duhej t'i kisha në dorë pa shumë vështirësi hormonet e rritjes. Po ajo dështoi. E shoh që nuk është punë muajsh. Së fundi qëndrova se shpresoja që një ditë do të gjenim një gjuhë të përbashkët. Kam plane të mëdha në kokë, ato zënë fill nga hormonet e rritjes...

— Dhe pse ju duhen hormonet e rritjes? Të krijoni raca të reja kafshësh, apo t'i përdorni në mjekësi? Çfarë sëmundjesh shpresoni të kuroni me to?

Veberi tundi kokën me forcë.

— As njëra, as tjetra — tha. — Nuk më intereson as tregëtia, as ana mjekësore, si të thuash. Hormonet e rritjes unë dua t'i shtrij në një fushë shumë më të largët nga ajo që mund të keni parashikuar ju.

— Ju lutem... — e nxiti padashur Batleri asistentin.

— Më mirë e lëmë për një herë tjetër — ndryshoi papritur Maks Veberi dhe vështroi orën. — Shkoi vonë dhe mua më presin.

Batleri ndjeu një shtrëngim në fyt. Mos që një taktikë e menduar gjatë nga Veberi?! Pritje në ankth, apo matje pulsi?! Sidoqoftë ai duhej të ishte shumë i zgjuar. Batleri nuk kishte dyshuar se Maksi nuk do t'i hapej atë ditë. Po ja si ndodhi.

Dini solli postën. Dy letrat e para ishin oferta trustesh të fuqishme që merreshin me rritjen e shpendëve. Pastaj një telegram i Stenlit nga Kalkuta dhe një ftesë për një mbrëmje. Ftesën e la mbi tryezë pa e hapur.

— Nesër do të të shtrojmë këtu, Din — i foli mulatit. — Do të ta heqim atë tumorin bashkë me mister Veberin.

Xhuxhi bëri një hap të vogël prapa dhe vështroi asistentin gjithë frikë. Batleri kishte vënë re që Dini trembej nga Veberi. Ai qeshi. Mulati u zhduk pas derës pa thënë

asgjë. Batlerit iu kujtua ftesa. Vinte nga senatori Xhon Stivens. E vërtiti nëpër duar shumë i çuditur. Nuk e kishite zakon të shkonte nëpër ballo dhe as të ftonte njeri. Si rrjedhim, as atë s'e ftonin.

I hodhi një sy kalendarit. Më pesëmbëdhjetë nëntor binte e diel. Po ç'i duhej, kur nuk do të shkonte? E lëshoi ftesën mbi tryezë dhe mori telegramin e Stenlit. Vetëm përshëndetje nga Kalkuta.

Asistenti hoqi bluzën dhe u mat të dilte.

— Mos e dini cili është një farë senatori Xhon... Xhon... Stivens? — pyeti Batleri.

Maksi e vështroi me ngulm.

— Është për t'u çuditur, profesor. — shfryu Maks Veberi duke harruar çdo rregull të mirësjelljes. — Si nuk e njihni? Xhon Stivensi është president nderi i institutit «Norton» dhe financuesi juaj kryesor! Xhon Stivens Makhorn...

— Makhorn? Kështu po! Por nuk e dija që qe senator. Megjithatë nuk kuptoj ç'do kjo ftesë tek unë.

— Me sa kuptoj unë, kjo do të jetë një mbremje për inteligjencën. Senatori është amfitrion¹⁾. i madh. Dhe nga ana tjetër i pëlqen ta rrethojnë njerëzit e shquar. Ju pa asnjë dyshim jeni një nga ata...

Batleri s'e la të vazhdonte.

— Megjithatë nuk kuptoj asgjë — tha.

Maks Veberi rrudhi supet. Ndenji disa caste në këmbë pa ditur çfarë të thoshte, pastaj doli jashtë.

«Nuk do të shkoj!» tha Batleri me vete.

E flaku ftesën në koshin e letrave, pastaj i ra ziles.

— U ngrit mis Anabella, Din?

— Ende jo, mister Batler.

— Kur të zbresë në sallon, më lajmëro, se dua të ha mëngjezin me të.

— Si urdhëron, mister Batler.

Megjithatë ai nuk po luante vendit.

1) Zot shtëpie. Këtu është përdorur në kuptimin e njeriut bujar, mikpritës.

— Ç'ka ndodhur, Din?

— Unë... mister Batler... Unë dua të më operoni ju!
Jo të më operojë Mister Veberi...

— Pse?

Dini nuk u përgjegj.

— Mos u shqetëso. Do të të operoj unë.

Batleri u shtri në poltronë. E mbështeti kokën mirë pas shpinës së poltronës. Sytë i shkuan te qoshja e murit. Ishte aq i lodhur, sa përtonte të ngrihej dhe të shihte çfarë kishte aty. Tani njolla në mur nuk lëvizte më. Megjithatë ajo bënte kontrast të fortë me bardhësinë madhështore të laboratorit.

Batleri i mbylli sytë dhe nuk mendoi më për asgjë.

KAPITULLI III

Me të dalë nga vila, Maksi, ndaloi një taksi. I dha shoferit adresën e Xhon Stivensit, pastaj u mbështet në poltronin e pasmë. Vështroi pasqyrën përballë dhe ndërroi vend. Nuk donte që ta shihte shoferi symbyllur. Dyzet minuta udhë nuk ishin kushedi çfarë, megjithatë Maksi e kishte zakon të merrte një sy gjumë kur udhëtonte vetëm. Po në të vërtetë ai nuk flinte. Kotej dhe i lëshonte fre mendimit dhe fantazisë, që si kërkues i kishte të guximshme. Po sot fytyra e tij nuk shprehte atë qetësinë e zakonshme që kishte kur ëndërronte symbyllur. Tani ajo i shëmbëllente më shumë një maske të egër pagane, më mirë të thuash një gjysmëmaske, sepse pjesën tjetër të fytyrës ia fshihnin perdet e ulura të veturës me errësimin që krijonin. Mendonte për Batlerin. Asgjë nuk po mundej të vendoste rreth tij. Nuk dyshonte që ai i kishte përfunduar eksperimentet (Këtë e dëshmonte një oborr i tërë me ato kafshë të çuditshme).

Veberi nuk kuptonte pse ishte aq i mbyllur Batleri, pse nuk bënte fare zë rreth zbulimeve të tij. Mos kërkonte t'ua rriste vlerën atyre? Veberi nuk e besonte këtë. Ai i kishte parë me sytë e tij me sa mospërfillje i vështronte Batleri ofertat e trusteve të mëdha. Po ç'kishte ndër mend të bënte atëhere? Mos priste Stenlin? Me të ardhur Stenli, atij i duhej të largohej... Po të niseshe nga oborri i shpendëve, çështja e veçimit të hormoneve të rritjes ishte e përfunduar. Po në mjekësi? Po te njerëzit? Kuptohej që Batleri nuk qe nisur të krijonte raca të reja shpendësh. I ofronin miliona dhe ai nuk çante kokën. Kishte diçka që e shtynte të mos i pranonte milionat, sado që nuk jepej pas parasë. Në fund të fundit milionat janë miliona, dhe ato mund t'i hyjnë në punë si biznesmenit, si një ariu laborator. Gjithë atë kohë që kishte punuar në laborator nuk kishte arritur ta kuptonte profesorin. Si mund ta kuptonte kur ai nuk qëndronte të ndërronte dy fjalë me të? Ishte një njeri i tillë, mbi të cilin nuk mund të ndiçkoje shumë. Zakonisht ai ndikonte mbi të tjerët. Maks Veberi çuditej nga ai shpërthimi i sotëm i Batlerit. E kishte pyetur për emrin, për hapin ushtarak, për qëllimet e tij... Dhe të gjitha këto në një kohë kur Veberi s'e priste. Tre muaj në laborator kishin qenë tre muaj zhgënjimesh. Gjithë detyra e Veberit në ata tre muaj kishte qenë të vështronte pankreasin në spektotron dhe të mbante shënime. Nganjëherë kjo punë e rrëmbente, e bënte për vete dhe atij i zgjohesh për disa kohë shpirti i kërkuesit dhe i vihej seriozisht punës. Pastaj kujtohej që Batleri atë punë mund t'ia kishte ngarkuar vetëm për ta hequr qafe dhe entuziazmi i binte përnjëherësh. Megjithatë dhjetë orë rresht nuk e ngrinte kokën nga spektotroni. Kjo ishte më shumë edukatë pune se sa dëshirë për punë. Batleri ia linte detyrat me shkrim dhe po me shkrim i merrte përfundimet. Profesori e programonte kërkimin gjer në hollësitë më të vogla. Kjo në vështrim të parë të krijonte përshtypjen e tutelës, dhe s'ka si të ishte ndryshe, po puqej me edukatën që kishte marrë Maks Veberi. Rregulli gjer në imtësitë më të parëndësishme, ndonjëherë gati qesharake, ishte tipari dallues i natyrës së tij.

Maksi zuri të bindej që Batleri nuk kishte besim tek ai. Nëntë muaj ai kishte qëndruar pa asnjë asistent. Asistenti as tani nuk i hynte në punë.

Futi dorën në xhepin e brendshëm të veturës me shpresë se mos gjente çamçakëz. Taksitë e Njuharkut mbanin lloj-lloj vogëlimash të tilla për të tërhequr klientët. Nuk kishte.

Shoferi e pa nga pasqyra që nxori dorën bosh dhe tundi kokën.

— Gjithë pasdrekën shëtita një plakë çeke nëpër qytet, mister. M'i përplau gjithë ç'kisha. Edhe në kishë mbllaçitej.

— Sigurisht që do të të ketë ecur me të, mik i dashur...

— Ç'thoni, sër? Edhe një udhëtim me të dhe do të detyrohesh ta lija maqinën në garazh. Tridhjetë cent çamçakëz! Djalli e merr vesh stomakun e asaj plake!

Veberi largoi perdet. Grataçielet e larta kishin mbetur pas. Kishin hyrë në një udhë të drejtë me vila anash. Këtu zotëronte një qetësi e çuditshme dhe nuk shihej asnjëri të ecte në këmbë. Edhe veturat kalonin pa zhurmë, ndërroheshin me njëra-tjetrën pa u ndier.

Taksia e Veberit, megjithëse ishte një maqinë e re, regëtinte për qamet në mes të asaj heshtjeje. Përreth kalonin pa pushim vetura të pasurish, të ulëta, të gjera, vetura pa zhurmë. Benzoli që harxhonin ato ishte qind për qind i pastër dhe motorët të prodhuar jashtë serisë.

Sa herë kalonte këtej, Veberi ndjente sikur e shtrëngonte diçka në fyt. Qetësia dhe bukuria e atyre anëve ishin një botë, të cilën ai e ëndërronte dhe njëkohësisht ia kishte frikën. Në një largësi vetëm dyzet minuta prej Njuharkut të çoroditur, pushteti i parasë kishte krijuar në këto anë një qytet më vete. Vilat në të dyja anët e udhës përziënin në një kaos të vërtetë kombinimesh gjithë stilet e njohura dhe të panjohura të arkitekturës. Vilat e kësaj ane të Njuharkut i bënë po atë konkurrencë njëra-tjetrës, që i bënë zotërit e tyre shoqi-shoqit në bursë dhe në tregëti. Gjithë mania dhe vëmendja e arkitektëve sikur ishte përqëndruar të ngrinte modernen mbi lashtësinë, primiti-

ven mbi erën kozmike, të mishëronte në fortësinë e hekurit dhe betonit mistikën e kohës antike, të lartësonte me një kupolë gotike ankthin e jetës moderne, apo të shprehte me ca kolona dhe zbukurime baroke sa e ndërlikuar është jeta në Njuhark. Ja një godinë që djalli e merr vesh se ç'është! Më shumë ngjan si një observator astronomik, se sa si vilë banimi. Asnjë mur i saj nuk bie pingul, po oval dhe hark i plotë. Banorët e vilës i kanë krijuar kështu vetes përshtypjen se banojnë në një anije, në një sputnik, po në asnjë mënyrë në një ndërtesë standart. Këta lloj banorësh po shumëzohen në rrethet e Njuharkut. Ata janë një protestë kundër këndit të drejtë. «Nëntëdhjetëgradëshi është fatkeqësia jonë,» thonë njuharkezët.

Ata jetojnë me simbole. Vilat e kryejnë këtë detyrë disa herë me vërtetësi.

Banasa e Xhon Stivensit bënte përjashtim. Nga ajo nuk merrej vesh si duhet të ishte i zoti. Qe një vilë e zakonshme e stilit italian. Përpara kishte një lulishte të vogël, prapa një pyll të vërtetë.

Shoferi frenoi përpara portës prej bronci. Maksimi bëri me kokë të shkonte përpara. Porta u hap automatikisht dhe maqina hyri brenda. Veberi i hodhi shoferit një gjysmë dollar dhe doli. Një shërbëtor me livrë i mori pardesynë, ndërsa një tjetër e udhëhoqi lart. Në sallon Maksi ndjeu të qeshurën e senatorit dhe krismën e bilave.

«Djall, o punë! mendoi Veberi. Duhet të pres ndonjë gjysmë ore gjersa të mbarojë lojën ai trashalug!»

Muret e sallonit të katit të parë ishin të mbushura me quadro piktorësh të mëdhenj. Pjesa më e madhe e tyre ishin origjinale. Një Van Gog, dy peisazhe të Pusenit, një kuadër origjinal i një veneciani të panjohur që çmohej shumë, pastaj me radhë Rafaeli me një kopje të darkës së famshme, Murillo, Millsi, Gogeni me një portret që të mahniste nga drita, male të kaltëra nga Rokuell Kenti, fragmente duarsh të Pikasos, nervoze, të stërmëdha.

Veberi qëndroi përpara një kuadri të vogël. Po t'ia shihje fytyrën atë çast, ajo i qe bërë gati e egër. Ishte «Rini në vjeshtë» një peizazh i një piktori gjerman. Për-

para luftës ajo tablô ndodhej në galerinë e arteve në Këln. Nuk dihej si i kishte rënë në dorë Xhon Stivensit.

Me të ngjitur shkallët, çdo shenjë egërsie që zhdukur nga fytyra e Maksit. (Ai bëri përpjekje të mëdha për këtë. Shumë që betuar të mos ia hidhte sytë tablosë, megjithatë nuk që e mundur të kalonte pa e parë).

Senatori ishte shtrirë me barkun rrafsh mbi bilardo dhe luante stekën. Ngaqë nuk arrinte siç duhet, mbështetej vetëm në një rën këmbë. Tjetrën e luante në erë poshtë e lart, si ata fëmijët çamarrokë.

Veberi i pa këpucën e vogël, pa pikë shije dhe i erdhi për të qeshur. Pastaj ai pa kokën e rrumbullakët dhe të shogët të senatorit. Në sfondin e gjelbër të bilardos ajo kishte shkëlqimin e bilave. Tutje, përballë Xhon Stivensit, rrinte në këmbë Erihu, peshkopi i Njuharkut. Ai po pinte diçka në një gotë të gjatë.

«Ujin e mallëkuar mineral!» pëshpëriti me vete Maksi. Ua kishte nevojën që të dyve, po i urrente që të dy, si domos peshkopin. Nuk mund t'ia shihte atë fytyrë të njomë, çuditërisht të njomë, që në gjashtëdhjetë vjet jetë nuk kishte vënë asnjë rrudhë. Nuk mund t'ia shihte atë jakë që të verbonte nga bardhësia, që e puthiste bukur pas rëdimit të së zezë, nuk mund t'ia shihte duart, që në çdo çast merrnin një pozë shenjtorie, nuk mund t'ia shihte ujin mineral. E pinte gjithmonë të një marke dhe, kur shkonte gjëkund, e merrte një arkë në veturë. E urrente edhe senatorin, si një i huaj që ka gjetur strehë nën hijen e tij, po që ia ndjen thundrën orë e çast pranë kokës. Po për të urrejtja pleksej me një adhurim që e bënte herë-herë Veberin të skuqej për dobësinë e vet. Senatori e mahniste me gjithë atë energji, me aftësinë e tij për t'i bërë ballë çdo vështirësie. Kur e gjente në kabinetin e punës, Maksi e ndjente veten sa një grusht. Dridhej nga nervat duke parë si manovronte Xhon Stivensin me shtatë telefonat e tryezës së tij. Çdo gjë qartë, rreptë dhe me përpikmëri. Përpara Maks Veberit vërtitej gjithë globi. Dhe ironia ishte se nga tryeza e këtij senatori trashalug globi humbte proporcionet e vërteta gjeografike. Mbi atë tryezë vinin pompaset e Argjentinës, Xhakarta, Korporatat e Nju-

harkut, minierat e Alaskës, dëgjohej si rridhte nafta në ishujt Bahreim dhe si fluturonin avionët në Tripoli. Xhon Stivensi bënte marrëveshje, lidhte kontrata, caktonte çmime. Merrte masa për tepricat e grurit në Kanada, udhëzonte si të shtypej një grevë, binte në ujdi me sindikatat, në Peru. Telefonat kërcisnin pa ndërprerje: Ju lutem mister Stivens! Po, mister Stivens!

Përgjegjet ishin gati lutje të përulura.

Xhon Stivensi punonte me një energji që të çudiste. Ai nuk kishte as laps, as letër në dorë. Punonte me mend.

Veberi e ndjente veten shumë keq në këto çaste. Ndjente gati një dhembje fizike. E gjithë kjo rridhte nga etja për fuqi që kishte vetë Veberi. Xhon Stivensi e kishte fuqinë, Maks Veberi jo!

Përpara bilardos dhe në sallonin e tij, Stivensi qe një rondokop dosido, po përpara atyre shtatë telefonave që kërcisnin parreshtur ai ishte një shembull i përsosur.

E vunë re që të dy. Peshkopi ngriti lehtë gotën me ujë mineral. Senatori bëri karambolin e fundit dhe u kthye nga Maks:

— Teutonikus! Fluturoi shpirti i shenjtë! E lashë dy jarde prapa, si ndonjë karavidhe Ostende!

Maksi vuri buzën në gaz me pahir. Senatori erdhi gjithë gjallëri pranë tij dhe i shtrëngoi dorën.

Peshkopi i vari turinjtë. Kur i varte turinjtë, ai i ngjante një adoleshenti që i kanë hequr disa shpulla.

— Ç'lajme më sjell, teutonikus? Do të vijë ai ariu yt në ballon time?

Maksi e ndjente veten të poshtëruar në çdo hap që bënte Xhon Stivensi. Senatori nuk kërkonte ta poshtëronte me qëllim Maksin, po ai këtë mënyrë të sjelluri e kishte në natyrën e tij. Nuk ka dyshim që ajo tregonte tërthorazi sigurinë dhe superioritetin e tij ndaj të tjerëve. «Dolce stil» quante ai me intimitet dhe jo pa ironi këtë mënyrë të sjelluri. Veberi ndjente vetëm hidhësinë e «Dolce stil» megjithatë nuk mund të vihej kundër. Tjetri kishte fuqinë në dorë. Dhe Veberi vetëm një gjëje i besonte dhe i përulej në këtë botë, fuqisë: Përulja ndaj Stivensit ishte e përkohshme, sa të anonte fuqia në dorë të tij..

— Besoj se nuk do të vijë, mister Stivens — tha Veberi. Tjetri qeshi. Kur qeshte, atij i buhaviteshin kapakët e syve e ngjante me një bablok leshko dhe pa të keq.

— Teutonikus! — iu kanos me gisht senatori. — Ka njëzet vjet që nuk ma kanë kthyer fjalën as luanët e jo më një ari gjysmë matuf si ai.

Shoga e shkëlqyer e senatorit lëvizte poshtë e lart. Tani ai kishte fituar gjithë gjallërinë e mëparshme. Veberi kafshonte buzët. I vinte zor nga peshkopi. Po ai harronte që pikërisht kur ishte Erih Mihelsoni, senatori kishte qejf të nxirrte prapashtesa latine.

— E kuptova që nuk do të vijë, sër. Ai është...

Peshkopi qe afruar. Ai qe ulur në kolltuk pa e lëshuar nga dora gotën, me ujë mineral.

— Gjithsejt dy herë e kam parë në kishë atë Batlerin tuaj. Herën e parë kur i vdiq e shoqja dhe të dytën nuk e di me ç'rast. Më kujtohet që e ngushëllova me disa fjalë nga dhiata e vjetër. Dhe si m'u përgjegj ai? «Hirësi, këtu plotësova një dëshirë të së ndjerës!» Me një fjalë — vazhdoi peshkopi «po të qe për mua, nuk do të kisha ardhur». Kështu e kuptova unë atë kohë Batlerin dhe besoj që e kuptova mirë.

— Padre santus! — Senatori qeshi me duart e ngritura drejt qiellit. — Kisha e shenjtë nuk ka ndrequr dot gjë në njëzet shekuj sa të besoj se do të ndreqë tani. Na lërë ta rrahim me Maksin këtë punë. Vetëm ne i përkasim tokës.

Peshkopi as që u tund. Ai kishte afruar gotën dhe pas saj Maksi vuri re si e zmadhonte kristali buzëqeshjen e tij dredharake. Asnjëherë nuk e kishte vështruar me kaq vëmendje peshkopin. Jo, nuk mund të hahej me të as për sqimë, as për elegancë. Redingota e Erihut i ngjante më shumë një fraku të vërtetë se sa një rrobeje të kishës. Pastaj ai zotëronte atë siguri që Veberi e humbte në disa rrethana të caktuara. Shkurt, Erih Mihelsoni dinte të ishte edhe banor i Njuharkut, edhe njeri i perëndisë. Senatori i ktheu shpinën peshkopit, gjysmë serioz, gjysmë me tallje, u ngrit dhe i futi krahun Maksit. Asistenti i Veberit u detyrua të përshkonte gjithë sallonin me hapat e shpejtë të

senatorit. Krahu i dhembte, kaq ja shtrëngonte tjetri. Xhon Stivensi qëndroi përpara një kuadri dhe foli pa ia ndarë sytë pikturës:

— Ariu yt duhet të vijë patjetër tek unë. Të premtoj që këtu do të gjejë një xhungël siç duhet. Thua që nuk do të vijë? Që nuk do të arrijmë të merremi vesh me të? Çdo gjë mund të ndodhë, Maks, po, po ta shkundim ca Batlerin, besoj se do të bëhet qengj i butë. Ai tani e ndjen veten të sigurt. E mbytën me oferta dhe honorare. Po, pa t'ia presim ca këto, pa ta sjellim pak në vete! As që i shkon mendja që e kemi në dorë... Pritni një çast, teutonikus... — Ai hyri me vrap në kabinetin e tij. Telefonat zunë të tingëllonin. Një orgji e vërtetë...

Veberi nuk po ia hiqte sytë tablosë. Ishte «Uria» e ekspresionistit Emerih Sidëll. Dukej vetëm goja e një koke të fshehur në errësirë, një copë gjuhë në gojën gjysmë të hapur, pastaj dhëmbët. Dhëmbët nuk kanë çfarë të përtypin. Buzët sensuale sikur dridhen dhe presin diçka. Dridhjet shuhen sa më shumë futet ajo kokë në errësirë. Megjithatë buzët të lënë të kuptosh ç'vjen pas tyre në errësirë.

Për Veberin ajo qe një pikturë e përsosur. Ai çmendej pas abstraksionistëve dhe i vinte gjithmonë në avantgardë të pikturës.

Në tablo nuk kuptohej ç'lloj urie ndjente goja e Emerih Sidllit. «Uri mistike» thoshte Erih Mihelsoni që harronte afro njëmijë kishat e Njuharkut me dyzet e pesë mijë priftërinjtë. «Uri seksi», kishte thënë senatori me Veberin, pa u shkuar nëpër mend që në Njuhark kishte afro një milion të papunë. Po as peshkopi, as ata të dy nuk ishin të sigurt ç'kishte dashur të shprehte Emerih Sidlli.

Senatori doli nga studioja e tij duke fërkuar duart.

— Tani do të na ecë — tha. — Të shohim.

I futi krahun prapë dhe, tek ktheheshin, i tregoi një trupore në qoshe të sallonit. Ishte truporja e vetë senatorit e gdhendur në mermer në madhësinë e trupit të tij. Të çudisnin vetëm krahët, ato ishin në një pozë jo fort të bukur.

— E ke parë këtë? Dje ma sollën. Më kushtoi tridhje-

tëmi një dollarë. E vlen? Martin Parkeri, skulptori më i mirë i Njuharkut... Është shtrenjtë, po artistëve u mbyllet goja vetëm me para. Nejse... Të kthehemi te Batleri. Për mua ka po aq rëndësi hyrja e tij në shoqërinë tonë, sa edhe zbulimi i sekretit që ruan. Ai duhet të bëhet yni, Maks. Kupton? Yni. Hormonet e rritjes janë zbulimi i parë i tij, ai ruan rezerva të tjera. Pastaj edhe vetëm si figurë ai do të na shërbente mjaft. Nganjëherë ai projekti ynë, pardon, ju-aji në radhë të parë — e korrigjoi veten senatori — më duket i çmendur. Po, kur rri e mendoj që ju vetë ia dolët përmes një rruge tjetër, nuk më duket i porealizueshëm. Në botë nuk ka gjë që nuk arrihet! Dhe, sa për Batlerin... Mendoj se ka ardhur koha të luajmë me letra të hapura.

Maksi u drodh. Gjakftohtësia dhe fuqia e Xhon Stivensit e çarmatosnin. E dinte që, po të vinte kandidaturën, senatori mund të bëhej president. E dinte edhe mendimin e senatorit për këtë punë. Ajo ishte një sentencë me pak fjalë: «Më mirë opozitë dhe të japësh goditje, se sa në pushtet dhe të presësh goditje!» Pastaj si opozitë ia kishin nevojën, mbështeteshin tek ai. President mund të bëhej kur të donte....

Vajtën pranë peshkopit. Ky kishte nderur puron dhe ishte shtrirë në kolltukun me sfungjer. Ai e duroi me kënaqësi vështrimin tërë ngulm të të zotit të shtëpisë.

— Për besë, Erih, — tha senatori me një farë çudie — ka njëzet vjet që s'kam mundur të prehem kështu kaq qetë si ti. Duhet të lëshohesh në pëqi të kishës për të kuptuar ç'është jeta.

U bëri shenjë me dorë të dyve dhe u zhduk nëpër shkallë. Maksi mbeti keq, megjithëse ia dinte huqet.

— Ulu, i dashur, — tha peshkopi. — Miku ynë duhet të ketë hipur në avion tani. S'besoj të bëjë më pak se dy mijë kilometra udhë sot. Ka telashe në Çisko.

Veberi i hodhi një vështrim pyetës.

— Ata e formuan rishtas partinë. U ndanë një pjesë nga udhëheqja e vjetër që na bindej për bukuri. Më përpara ishte një parti sa për sy e faqe...

— Kush janë, «ata»?

— Ata, të kuqtë! Qendrën e kanë ngritur në Çisko dhe

kanë hapur degë gjithandej. Në Njuhark kanë zënë të nxjerrin edhe një gazetë: «Dhë star of Njuhark». Nuk e paske parë? Ky fraksion i të kuqve përbëhet nga anarkistë të vërtetë. Kështu thotë gazeta e tyre.

Veberi tha se nuk e kishte parë gazetën. Pastaj ai pyeti se ç'donte Stivensi në Çisko.

— Xhon Stivensi është ai që e ka shkatërruar këtë parti dy herë me radhë brenda njëzet vjetëve. Megjithëse në opozitë qeveria e ka lutur të merret sërish me situatën e re. Ky fraksion i të kuqve nuk do të merret me fjalë, po me revolucion. Ata nuk kanë pranuar asnjë marrëveshje dhe është e pamundur të bisedosh. Xhoni buzëqesh dhe s'ka ndër mend të marrë asnjë masë ndaj tyre.

— Pse?

— E di si më thotë: «Erih, ju s'merrni vesh nga politika. Njeriu fiton më shumë nga frika e rreme se sa nga shtypja e vërtetë. Spërkatuni me ujë të bekuar, Erih dhe ma lini mua politikën. Mua më shërbejnë forcat e kundërta, mund të nxjerr nga ato përfitime që s'di t'i nxjerrë qeveria». Ai është aq i marrë sa edhe të fyen pa pikë turpi — vazhdoi Erih Mihelsoni.

— Kur është kështu, ç'do në Çisko atëhere? — pyeti Veberi pa ua vënë veshin ankimeve të peshkopit.

— Me ç'duket ai nuhat, lidh nyjet, thur plane. Po unë nuk marr vesh asgjë. Sa kohë do t'i lërë të bredhin lirisht? Në Kongres dhe në gjirin e qeverisë ka kundërshtime. Ca kanë arritur gjer atje sa të thonë që Xhoni e bën këtë për të fituar kapital politik. Ç'nuk thonë! Megjithatë hëpër-hë Xhoni ynë e ka në dorë gjendjen. Po mos u çudit, po doli ndonjë kokëkrisur që t'i rrasë në burg të gjithë të kuqtë pa çarë kokën për Xhoin.

Maksi hodhi pak uiski në një gotë të madhe dhe zuri ta pinte mengadalë.

— Xhoni gabohet, Veber — tha ai papritur. — Kjo nuk është një botë ku njeriu mund të gëzohet dhe të bëjë qejf. Bombat kërcasin nëpër qytet dhe flakët e shtëpive që digjen e kalojnë kapitolin. Natën përpiqen në gjumë, digjem dhe gjithë kohën vështroj njerëz të therur që për-

pëlitën në agoni. E dini, Veber? Ata nuk do të kursejnë as njerëzit e zotit!

— Nuk do t'i kursejnë! — tha tjetri me qëllim.

— Xhoni as që do t'ia dijë për këto, i quan vogëlma të zhvillimit. Ama, kur të ngrihen dyzet milionë rreckamanë, do t'i mpihet edhe atij palca e kurrizit.

— Ç'ju paska hipur sot kështu? — tha Veberi i mër-zitur. — Mbajeni veten!

— Nuk do të kursejnë as shkencëtarët. Mjafton të kesh një kravatë të pastër dhe një kostum siç duhet për të të hedhur lakun.

— S'ju kam parë ndonjëherë kështu — tha Veberi.

— Nuk keni frikë ju?

Maksi ngrii supet pa ditur çfarë të thoshte.

— Keni që ç'ke me të! Përndryshe nuk do ta mbanit «Valterin» automatik në xhep. Ai që s'ka frikë sot në Nju-hark është i çmendur. Po përpara se të na presin kokën, duhet t'ua presim ne. Xhoni ushqen iluzione. Këtu ndahen rrugët tona...

— Lëreni senatorin — e ndërpreu Veberi i mër-zitur sa s'ka. — Asnjë iluzion nuk ushqen ai. Po të ushqente iluzione, nuk do të interesohej aq fort për zbulimet e shkencës. për kërkimet tona.

Sa tha këto fjalë u pendua. E shau me mend peshkopin që nga stërgjyshërit, po atë që e nxori s'e kthente më prapa.

Nuk druhej nga Erih Mihelsoni. Peshkopi dinte pothuaj çdo gjë, vetëm e mër-zisnin pyetjet, të cilave ishte i detyruar t'u përgjigjej.

Peshkopi u gjallërua përnjëherësh.

— Ç'kemi nga ishulli? — pyeti. — Në shtypin e majtë po pëshkrëritet diçka. Po ata duket nuk dinë gjë me saktësi. Më afër së vërtetës është «The star of newhark». Në dy shkrime të fundit ata bëjnë thirrje për vigjilencë të masave kundër shkencëtarëve të kapitalit. O perëndi, gjithnjë këto shprehje përdorin. I kanë si kallëpe. Të çmendin...

Veberi preferonte të dëgjonte një orë të tërë vetëm të mos jepte asnjë përgjegje. Kishte frikë mos e fyente, se do

të qe ngritur me kohë. E shpëtuan disa zëra që erdhën nga poshtë:

— Ku është Mecenati?

— Ku është Agripa?

— Letigat, skllevër! T'i biem pas!

Peshkopi kërcëu në këmbë.

— Të ikim! — tha me një frymë. — Banda e artit! Jam më i siguruar përpara Tom Hejvudit që ka qenë dymbëdhjetë herë në Sing-Sing,¹⁾ se përpara tyre.

Maksi njohu piktorin Samuel, një poet të dështuar nga Ajdadaho, Nils O'Brajenium me prejardhje të dyfish-te islandodaneze, Xhonin e vogël që këndonte në kafenë të e udhës trembëdhjetë, si dhe një aktore të teatrit kombëtar. Të gjithë kishin pirë dhe mezi qëndronin në këmbë. I fundit ngjiti shkallët Martin Parkeri që kishte bërë njëfarë emri me një statujë të parkeve antike. Të gjithë ishin të dehur me përjashtim të Martinit. Piktori Samuel u ndal përpara Maksit dhe e qelbi me një erë që zinte fill nga konjaku dhe mbaronte te koktejt «Bakardi». Maksit, që ishte i pastër dhe i përkorë si ndonjë afishe e shoqëri-ve të pastrimit, i erdhi për të vjellë. Ai nuk ia ndante sytë rrobave të përdorura të Martin Parkerit. Skulptori ishte i varfër, njihej vetëm në një rreth të ngushtë.

Piktori Samuel e kishte më shumë me peshkopin.

— Një tedeum, hirësi — u ngërdhesh ai. — Për kishën, për mecenën tonë, për ne dhe Njuharkun. Një tedeum...

— Na lini të kalojmë! — thirri Maksi.

— Prisni! Ku shkoni? — u hodh Xhoni i vogël. — Bota po shembet. Do të shkëlni mbi gërmadha.

— Mirë bën që po shembet. Është vjetëruar shumë — e pasoi poeti i dështuar nga Ajdadaho.

Veberi dhe peshkopi u vështruan sy në sy.

— Po t'ju shihte kështu zonja Stivens...

— Na e mbushe mendjen, hirësi! Zonja Stivens? Ha, ha, ha! Sa herë e kemi sjellë për krahësh. Njëherë e lamë edhe te shkallët...

1) Emri i një burgu të famshëm

— Mbylle ti, Samuel! — bërtiti Martin Parkeri.

Ndërkaq Xhoni i vogël kishte ngritur kapakun e pianofortes. Mahogani shkëlqeu, refleksi përshkoi fytyrën e Erih Mihelsonit dhe humbi diku.

— Ujqit e Lejkvudit.

Të dehur me xhin tapë.

Bredhin në Njuhark.

Këndoi Xhoni i vogël. Pastaj kapaku prej mahogani ra fare papritur e i drodhi njerëzit dhe akordet. Piktori Samuel nuk kishte ndër mend t'i ndahej peshkopit.

— Ju të zinj të jeni shtuar si kërpudhat në Njuhark — po i thoshte. Erihu desh ta largonte, po tjetri nuk u tund.

— Pa dhunë, hirësi! Urtë e butë siç predikuat të dielën.

Kishte mbetur vetëm piktori, pjesa tjetër po zbriste shkallët me zhurmë.

— Samuel i thirrën ata. — Samuel, or djall i qytetëruar! Lëre qengjin e kishës.

I dehuri u shkoi pas, por te kreu i shkallëve qëndroi edhe një herë.

— Dhjetë dollarë për një nudo, hirësi. Vetëm për një seancë. Ama nudo... Më të paturpshmen në botë! Një trup mistik... I bardhë... I brishtë... Të fut në ngasje, Pesë dollarë në orë merr Xheni që ka pozuar për Pikason. Një trup pa mëkate.

Maks Veberi u hyri në mes.

— Ah, shkencëtari! I lexuat gazetata? Ju do të përmbysni botën!

— Samuel, Samuel, or djall! Lëre qengjin e kishës...

Peshkopi u drodh. Ai u shemb në kolltuk dhe kërkoi me sy gotën me ujë mineral. Si ai, si Veberi ishin shumë të tronditur. Veberit i kishin mbetur në mend fjalët e fundit të të dehurit. Mos kishin shkruar gjë tjetër gazetata?

— Ç'thua, Maks? — e theu heshtjen peshkopi. — A nuk meritojnë t'i mbyll brenda disa ditë? — Me këtë pyetje ai sikur donte të rivendoste autoritetin e tij.

— Nuk e di! — u përgjegj Maksi. — E dua artin, po i urrej njerëzit e tij.

— Ata janë të dehur, gjithmonë të dehur, sikur kanë lindur kështu. Nuk dinë ç'duan, nuk dinë ç'bëjnë. As ne s'dimë ç'kërkojmë, Maks!

«Lavdi zotit unë e di!» pëshpëriti me vete Veberi.

— Abyssus abyssum invocat... 1)

Maksi nuk donte ta zgjaste, prandaj nuk i dha përgjegje.

— Animus meminisse horret 2) — psherëtiu njeriu i zotit duke zbritur nga shkallët.

Ai e kishte mendjen ende te njerëzit e artit.

Veberi hipi në maqinën e tij.

— Do të vete në shtëpi — i tha peshkopit. — Vdiqa për gjumë.

— Nuk më the ç'bëhet në ishullin e «Kananarave» — pyeti për të dytën herë peshkopi.

Maksi vështroi me frikë nga shoferi. Harroi që tjetri foli latinisht.

— Po numërojmë në vend. Katër muaj që nuk po bëjmë asnjë hap përtej asaj që arritëm.

— Prandaj i jeni vërsulur Batlerit?

— Po, siç duhet t'ju ketë thënë senatori Xhon...

— Xhoni s'thotë kurrë gjë, i dashur. Ai të lë të kup-tosh vetë.

— Idem!

— Dhe nga Batleri?

— Asgjë!

— Aula est timida?

Asistenti mohoi.

— Mos është njeri me parime?

— Nuk di çfarë të them — u përgjegj Veberi. — Këfo dhietë vjetët e fundit atë e rrethon misteri. Përpara se të filloja punën, lexova dosjen e tij. Ka qenë një nga ithfarët e ziarrtë të Xheni Paterit këtu e dhjetë vjet të shkuar. Ju kujtohet «Klubi i drejtësisë»? Batleri ka qenë një nga themeluesit. Në rini ka vuajtur mos më keq. Ndiqte

1) Humnera thërret humnerën (lat.)

2) Shpirti im dridhet nga tmërri duke sjellë ndër mend këto kujtime! (latin).

universitetin dhe mbante valixhet në hotelin «Korint». Ka qenë dy herë me nga dy muaj në burg për rrahje. Një kohë gjithë shpirtin e kishte te paraja. Dhe fitoi shumë, po i prishi të tëra për Xheni Faterin. Vitet e urisë duhet t'i kenë rënduar në shpirt. Megjithatë nuk e kam dëgjuar kurrë të flasë për para. Nuk interesohet për gratë, megjithatë kam vënë re se nga zhduket një herë apo dy herë në muaj. Thonë që ato ditë e kalon kokën në një lagje të varfër nga perëndimi. Sidoqoftë në dosjen e tij shkruhet se nuk interesohet për femrat...

— Çudi! Gjithë ai ari... — shfryu peshkopi.

— Kjo pikë e fundit e bëri senatorin të hiqte dorë nga ndihma që mund të na jepte Berta Snou...

Peshkopi fërgëllloi.

— Berta Snou është seksomane — tha. — Ajo e bën edhe gurin të lëshojë lëng...

— Nuk e di çfarë kërkon Batleri nga jeta. Nganjëherë më duket madje sikur s'kërkon asgjë. Po a është e mundur që një krijesë me arësye të mos kërkojë, të mos ketë dëshira? Kjo është kontradiktore. Atë sikur e vesh një maskë olimpike qetësie. Po nën të më duket sikur lëvrin krimb i një lloj humanizmi që më kot përpiqem ta zbuloj...

— Mos keni fjetur këto ditë me Berta Snoun, i dashur?

Mirë ia bëri! Ai po llapte shumë. Dhe me kë? Më Erihun, me një njeri, për të cilin s'kishte pikë respekti.

Veberi ktheu kokën në një anë dhe vështroi jashtë. Kështu desh t'ia paguante sfidën peshkopit. Ç'fliste ai dhe ku i rrihte mendja Erih Mihelsonit!

Maksi e mblodhi veten menjëherë. Nuk ishte mirë për të ta prishte me peshkopin. Ai kishte lidhje të fuqishme në Njuhark.

— Batleri hesht. Sot kam pasur bisedën e parë me të pak a shumë të gjatë. Jam i bindur që ai e di tani çfarë duam ne. Dhe prandaj është mbështjellë në koracë. Po aq më mirë. Tani do t'i lozim letrat hapur. Ndoshta duhej përdorur edhe Berta Snou...

Fjalët e fundit i shtoi me qëllim për të zgjuar Erihun.

— Tani e kuqtoj që ke fjetur me të — tha peshkopi i përtëritur. — Thuaj të drejtën, biri im...

Maksi kishte një parim që i kishte sjellë dobi në jetë, bënte lëshime të vogla për hir të fitoreve të mëdha.

I buzëqeshi peshkopit.

— Me Batlerin duhej të kishim përdorur edhe udhën e nëndheshme — vazhdoi Maksi duke i dredhuar prapë Erih Mihelsonit.

— Vila e Batlerit kontrollohet tetë herë në natë, i dashur! Ti e di që herën e fundit Batleri mend i zuri me presh në duar...

Veberi mbajti frymën. Nuk dinte asgjë për këtë. «Për Xhon Stivensin, nuk derka as budalla. Paska edhe ai të lëshentat e tij. Kujdes, Maks! I tha vetes asistenti i Batlerit.

— Ajo Berta Snou...

Maksit i hipën xhindet. I vinte ta pështynte në surrat peshkopin. Vetura qëndroi. Se ku ishte blokuar rruga dhe vargu i makinave kishte ngecur në vend.

— Të lajmërojmë për helikopterin, hirësi? — pyeti shoferi.

— Jo! — tha peshkopi. — Hape televizorin!

Ishin lajmet. «Prokurori i Njuharkut do të lëshojë së shpejti një urdhër arrestimi kundër Bill Nostringut lidhur me zjarret e parmbremshme në Njuhark. Prokurori mendon që ai është shtytësi i zezakëve...»

— Të zinj? — pyeti Veberi duke e pasur mendjen te zjarret.

— Të zinj e të bardhë! E dëgjove? Ai prokurori Smith dashka të arrestojë Nostringun. Kot sa bëhet qesharak dhe lëshon deklarata. Xhon Stivensi nuk do ta lejojë t'i prekë as qimet e flokëve... Për ato arsye që biseduam pak përpara. Ke dëgjuar për Bill Nostringun?

— Anarkistin?

— Dora vetë.

Udha u hap. Maqinat zunë të lëviznin. Në fillim me ngadalë, pastaj më shpejt.

Peshkopi u përkul nga shoferi:

— Djathtas, Xho! Do ta shpiem mister Veberin në shtëpi.

Maqina ndaloi përpara një banese të zymtë.

— Nuk ju ka vajtur mendja të ndërroni banesë, i dashur? Po, ju kuptoj, ju kuptoj! Shkencëtari nuk ua var këtyre vogëlimave...

— Gjer tani të ardhurat e mia kanë qenë mjaft modeste — u përgjegj Veberi duke e mbajtur veten me zorr. — Tani edhe mund ta ndërroj.

— Salve!

— Ç'ti them Berta Snout? — nuk iu durua Veberit!

— *Le të vijë të paktën të rritet!* — u përgjegj tani duke mbyllur sytë.

• • •

Sa hapi portën, i doli përpara një grua. Veberit i ra në sy menjëherë përparësja e saj e përdorur dhe peshqiri, me të cilin po fshinte duart e lagura. Sa herë e shihte kësh-tu, i shkante mendja të shërbëtorët me livre të Xhon Stivensit dhe pasanikëve të tjerë të Njuharkut. Ai e ndjente pabarazinë që në takimin me shërbëtorët. Megjithatë Veberi mundehej t'i mbushte ndryshe boshllëqet. Gjithë shkëlqimin e shërbëtorëve të Xhon Stivensit dhe të tjerëve nuk do t'i ndërronte me besnikërinë e fraulein Evës. Më shumë se një shërbëto-re, ajo ishte një simbol i familjeve të kombit të tij. Pa një njeri të tillë, një familje si e Veberit do të ishte e mangët. Pak a shumë i ngjiste «Leporelës» së Cvajgut. Vetëm një «Leporelë» pa dashuri. Ajo donte vetëm rregullin dhe ritet e shtëpisë. Asgjë tjetër. Të paktën kështu ishte tani.

Veberi pa fytyrën e saj të shpëlarë me flokët bjondë që kishin nisur të thinjeshin, pastaj e vështoi në sy. Ishte mësuar të lexonte në sytë e saj mbarësitë dhe prapësitë e familjes.

— Është ngritur babai, fraulein!

— Është ngritur, herr Veber!

— Ç'thotë? Si ka fjetur mbrëmë?

— Thotë se ka fjetur mirë, herr Veber.

I ngjiti shkallët me një frymë dhe qëndroi përpara dhomës së të atit. Tek ngjitej, provoi po atë ndjenjën e pa-

këndshme që provonte sa herë hynte në këtë shtëpi ku gjithë punët i bënte vetëm një grua. Ju kujtua peshkopi dhe pakënaqësia iu shtua. Duhet të ndërronte shtëpi. Tani fitonte mjaft.

Maksi trokiti edhe një herë në derë. Lehtë dhe me shumë kujdes. Mbajti vesh. Nga brenda asnjë zë. E shtyu derën pa pritur t'i thoshin të hynte. I ati qëndronte symbyllur në poltronën me rrota.

— Ç'më shqetësoni? — foli vrazhdë ai. — Kush ju fha të hyni?

— U shqetësova, baba — foli Maksi me përdëllim. — Nuk ndieva zë...

— U shqetësove, u shqetësove... — Plaku zuri të grindej. Pastaj paralitiku i hapi sytë. I ngjante të birit pikë për pikë. Ishte po aq i pashëm si ai, po me një hije shumë më të rëndë. Mund ta merrje për një emblemë autoriteti. Kockat e nofullave i mbante të shtrënguara. Ato tregonin vullnet dhe fuqi. Megjithatë ai ishte një trup i ndarë më dysh, gjysma e vlekur, gjysma me gjallëri të tepëruar. Po t'ua hiqje sytë rrotave të poltronës, nuk mund ta kuptoje që ishte i paralizuar.

— Baba! — tha Veberi. — I dashur baba...

I sëmuri u ngrys. Nofulla e tij u shtrëngua edhe më shumë. Ai e urdhëroi të heshte me një lëvizje të dorës.

— I more ilacet, baba?

— Po! — bëri plaku me kokë.

— Duhet ta përcërisim radioterapinë. Me një mënyrë tjetër kurimi...

— Mjaft! — tha i sëmuri pa ia varur Veberit. Ai kapalliti sytë dy a tri herë dhe një nënqeshje ironike iu duk në buzë. Pastaj napolitur i bëri një ovetje të birit që qe në sfidë për gjithë përkujdesjet dhe mundimet që hiqte dhe kishte hequr Veberi me të prej dy vjetësh. Përpara se t'i binte paraliza, ai njeri s'kishte qenë kurrë i sëmurë. s'kishte ditur as ç'është një migrenë apo një dhembje stomaku. Të tjerët që vuanin i shihte me mospërfillje dhe nuk qe aspak i mëshirshëm ndaj tyre. Nëse vuanin, vetë e kishin fajin, kishin qenë të parregullt në jetë. Rregulli për Kurt Veberin ishte çdo gjë. Po tani që u shtri vetë i sëmuri

rë... Tani donte që më mirë të mos i flisnin për atë që e kishte gjetur.

Ai e kishte pyetur për Norman Batlerin.

— Batleri vazhdon të qëndrojë në kapsulë, baba. Është vechur me një kist më të fortë se të stafilokokut. Po do t'ia gjejmë të çarën...

— Në kohën time ishte ndryshe — e ndërpreu më zemërim Kurt Veberi. — Në kohën time...

Ai vazhdoi të fliste gjatë. Po të njëjtën gjë përsëriste, pa u lodhur e pa u mërzitur: «Iks shkencëtar, pedagog, shkrimtar, deputet... Plotoni i ekzekutimit përpara... Doni të bashkëpunoni menjëherë dhe pa dredha me ne, herr Patcke, herr Moltke, herr Ditrih, herr Stucker, apo preferoni plumbin? Dhe herr Patcke, Moltke, Ditrih dhe Stucker nuk janë aq të marrë sa të duan plumbin. Në kohën time vendimet merreshin brenda minutës. Me dorë të hekurt... Këta njuharkëzët janë kërmij të flashkët, Maks... Mos rri shumë me njuharkëzët!»

Ato që tha paralitiku përputheshin pikë për pikë me ato që po sillte ndër mend Maksi.

Plaku e përqëndroi vështrimin në një anë të dhomës. Qëndroi pak ashtu, pastaj i luajti rrotat e poltronës në atë drejtim. Në mur varej një uniformë gjenerali divizioni. Kapela, xhaketat me spaleta të arta, pantallonat qillota dhe çizmet fringo të reja, ishin vënë në një mënyrë të tillë që të dukej sikur kishte të bëje me një oficer të gjallë.

Maks Veberi nuk përshëndeste me dorë të shtrirë përpara kur hynte në këtë dhomë. Po kishte shumë të tjerë që e bënin atë punë që nga praku. Kë përshëndesnin ata? Uniformën apo Kurt Veberin? Maksi kafshonte buzën dhe i duronte. Ai do të dëshironte që të mos ishte uniforma aty, që nderimi t'i takonte vetëm të atit. Edhe tani ruante për plakun po atë ndjenjë që kishte provuar kur e kishte parë në ballë të dyzëtmijë helmetave prej çeliku.

Në të dyja anët e uniformës ishin dy portrete të varura në mur. Fric Veberi dhe Hans Veberi vështronin që andej me arrogancë. Ndjenjën e kryelartësisë së tyre nuk e zbutnin as dy shiritat e zinj në qoshtet e kornizave.

— Në mes tyre duhej të isha edhe unë — psherëtiu paralitiku. Herë të tjera ligjërata e tij kishte qenë më e gjatë. Atë e vazhdoi Maks i gati në formë automati: «Trimat vdiqën të gjithë... Ne s'bëmë dot gjë për atdheun tonë të gjorë... Ne u katandisëm popull pa atdhe... Po mos u ngutni, zotërinj! Ne shpeshherë na e prenë kokën. Dhe ç'ndodhi? Na mbinë dy të tjera...»

Kjo ishte një ligjëratë gati rituale dhe vetë Maks kishte nevojë për të.

Paralitik i erdh i rishtaz në pozicionin e parë.

— Më vërë në shtrat — i tha Maksit.

I biri e ngriti pezull me shumë kujdes. Megjithatë këmbët e plakut u varën poshtë si dy drurë. Po ai nuk nxori zë. Maks i rregulloi mirë e mirë jastëkun.

— Tani dua të fle — tha paralitiku dhe i mbylli sytë.

Maks i largua në majë të gishtërinjve.

KAPITULLI IV

Veberi ia kishte frikën Polit atë ditë. Kishte një fytyrë, një fytyrë... Poli i kishte përplasur pjatat me gjellë pas dritareve me hekura të trasha. Pastaj u qe afruar atyre dhe u kishte dhënë një të shkundur...

— Ku e zgjodhën atë ditë për ta nxjerrë jashtë?

Veberi nuk ia ndante sytë kamionçinës së mbyllur që kishte përpara. Kishin arritur në zonën më të dendur të Njuharkut. Gjer aty kishin udhëtuar shpejt, tani lëviznin me pëllëmbë. Vargu i pafund i maqinave sikur s'bente çap përpara. Këtë përshtypje e krijonte edhe vetë arkitektura e dy anëve të rrugës numër trembëdhjetë, ndërtesat me blocqe masive, reklamat e ngjashme, vitrinat si binjake Siami. Më shumë se kushdo, dritat dhe reklamat i jepnin një tipar të përbashkët dhe të mërziqshëm atij krahu të qytetit. Ai vështroi orën dhe u shqetësua. Po të mos shpejtohej qarkullimi, do të vonoheshin me gjithë mend. Pastaj

ai Poli... Po sikur t'i jepte një të shtyrë derës së kamionçinës dhe ta bënte copë?!

Buzë trotuarëve u ndezën fenerët e gjelbër, pikërisht atëhere kur ai shpresonte të shpejtohej qarkullimi. Maqinat mbetën në vend. Kushedi ç'kishte ndodhur përpara hotelit «Uolldorf». Aty ishte e pamundur të mos ndodhte ndonjë përplasje. Maksi i ra sediljes me grusht nga inati. Befas ai u ngrit me rrëmbim nga ndenjësja dhe përpoqi kokën pas mbulesës së veturës. Dera e kamionçinës qe hapur e shtyrë si nga forca e ndonjë tajfuni, ganxhat e saj ishin këputur në çast dhe ajo ra poshtë në udhë me një rapëllimë të mbytur. Që brenda u hodh jashtë një alamet njeriu me një trup të tillë, që vështirë të ta marrë mendja.

— Po ikën! — Klithi Maksi i tmerruar. — Oh, ç'kastastrofë!

Për një çast mbeti si një qyqar i shkretë, i dërmuar nga grushti i fatit.

Pas Polit nga kamionçina u hodhën edhe tre-katër veta të tjerë dhe zunë të vështronin nga iku. Ishin tepër qesharakë në krahasim me të, sado që Veberi i kishte zgjedhur ndër më trupmëdhenjtë e Njuharkut. Turma ku u përzje Poli ishte e vogël në krahasim me të, madje edhe ndërtesat dhe objektet e mëdha përreth sikur e humbisnin atë madhështinë e mëparshme.

Gratë nxorën klithma të forta lemerie nga shkallët e hotelit «Uolldorf». Një alamet njeriu vraponte si i çmendur nëpër trotuarin pyll me njerëz. Vraponte dhe dukej si ndonjë kafshë e zhdukur parahistorike. Këmbët e tij të trasha sikur godisnin me tokmak pllakat e trotuareve. Përpara tij hapej një korridor i gjerë që i ngjante atij të detit të kuq në mitologji. Njerëzit thërrisnin, shtyheshin, binin të lemerisur nën rrotat e maqinave. Më mirë në udhë se përpara tij... S'dihej si u hap ajo udhë përpara njeriut apo përbindshit që vraponte, s'dihet ku u rrasën njerëzit për t'i lëshuar rrugë atij. Vetëm një gjë shihej. ai e kishte rrugën të hapur përpara vetes, një rrugë që çahet si nga një magji e keqe. Fytyrën e kishte edhe më të tmerrshme se trupin. Një kokë e rrumbullakët, çuditërisht e madhe, që i ngjiste një sferë të zezë nga flokët e shkurtër, të prerë

kare. Flockët i rrinin lart si perçja e derrit të egër. Pastaj sytë... Oh, sytë! I djalhti nuk i dukej fare. Nuk kishte as vetulla, as qerpikë, as gropën e syrit. Ia kishte zënë një si palë lëkure që i varej nga koka. Në vend të të majtit shihej vetëm një vrimë sa një saçme, brenda së cilës shkrepse me të keq drita verbuese e reklamave. Sytë ia kishte zënë të ngjallurit. Ai vraponte dhe me dorën e djathtë mundahej të hapte syrin e djathtë, mundahej të largonte masën e mishit dhe të dhjamit që i vareshin si hejbe poshtë vetullave.

Një pështjellim të tillë nuk mbante mend njeri në Njuhark. Mitralozi i Xhim Teklejt të çmendur që korri kot së koti dyzet veta po në atë rrugë nga tarraca e konviktit nuk bëri gjëmë më të madhe. Tmerri që i njëjtë, por ndoshta ky i sotmi që edhe më i madh, që një tmerr pa krisma, një tmerr i ftohtë që të rrëqethte trupin. Tmerri që kishte shkaktuar Xhim Teklejt ishte shuar sa heshtën krismat e mitralozit. Në fund të fundit ai shkaktoi një frikë njerëzore. Ky tjetri ishte krejt ndryshe, i përkiste së panjohurës. Ishte e panjohura që shfaqej dhe zhdukej si një vegim. Ashtu u shfaq dhe u zhduk ai gjigant i frikshëm. Mizëria e njerëzve që haqej kur vraponte ai dhe e mbyllte udhën pasi kishte kaluar, e bënte misterin edhe më të përgjithshëm.

— Përbindshi...

— Monstri.

— Krijesë nga Marsi. Oh, perëndi!..

— Mos është fundi ky?

— Ja, erdhi dita. E thonë librat... Do të dalë **monstër** nga deti...

Atë e kishin parë vetëm pak sekonda. Kjo i linte shteg fantazisë më të shfrenuar dhe trillimeve më të çuditshme. Po pjesën e pasme të kokës dhe shpinën e tij që dilte mbi turmën e panë për një kohë më të gjatë. Ajo i siguronte që ata nuk ëndërronin, që vërtet andej kaloi njeriu përbindsh.

Kur u hodh gjiganti nga kamionçina. Veberi mbeti si i paralizuar disa çaste, po pastaj e mblodhi veten menjëherë. S'dihet si u gjendën të dy ballë për ballë. Të dy në një boshllëk njerëzish, aq të vogël dhe përnjëherësh aq të

madh. Kështu iu duk Veberit, të cilit s'i kishte mbetur pikë gjaku në fytyrë. Ai ngjante atë çast me një bouburrec të mjerë përpara Polit dhe s'priste asnjë ndihmë nga turma e topitur dhe e frikësuar.

— Ndal! Ku vete, Pol? — mezi thirri Veberi.

Turma përreth nxori një psherëtimë lehtësimi. Pra qenka njeri, pra qenka një krijesë tokësore... Po megjithatë... Gjiganti u step. Vrima e majtë e syrit të tij vështroi me të keq nga Veberi. Zgjati dorën dhe e largoi tutje si ndonjë fiçe kahte Maksin, pastaj nxori një klithmë që u përzje me dihatien e tij të rëndë. Gjiganti ia dha vrapit edhe më fort. Atëhere turma u ngjesh rreth Veberit si një masë betoni. Keni parë si bie në paqe deti pas tajfunit, një ishull pas ndonjë uragani mizor? Ashtu u step për disa çaste ai çofë vend rrotull hotelit «Uollsdorf». Batica që shumë e shkurtër dhe kuptohet ç'shpërthime pati pas saj. Përbindshi kishte ikur, mbetej Veberi. Dhe me të mund të flitej pa frikë.

— E njihni?

— Kush jeni ju?

— Ç'ishte ai përbindsh?

— Oh, perëndi! Kushedi sa vajza ka mbytur...

— Flisni, ju thonë!..

— Ju e thirrët me emër, flisni!

As që mund të bëhej fjalë për respekt dhe dinjitet njerëzor. Veberi s'i mendonte këto në ato çaste. Jakën e këmishës dhe mëngët e xhaketës së tij i tërhiqnin andej-ketëj me tërbim. Veberit i mbetej vetëm të shpëtonte kokën. Në ato tërheqje dhe kanosje kishte një kërcënim të vërtetë, të cilit Veberi ia pati frikën. Ajo skenë të kuitonte mesjetën e plotë, ndjekjen e shtrigave dhe heretikëve dhe njëkohësisht frikën mistike ndaj tyre. Veberi përpëlitej pa pikë gjaku në fytyrë. E urrente turmën, turma i zinte frymën, turma e bënte të mos e ndjente veten kryelartë dhe aristokrat siç ndjehej vetëm. Po tani pështirosja ia kishte lënë vendin frikës. Kërkonte vetëm të shpëtonte nga ato duar të forta që e shtynin, e tërhiqnin, që po e shtrëngonin si darë nga të gjitha anët. Ishte një masë larama-

ne njerëzish, një detar gjysmë i dehur, një grua e ngjallur që bërtiste më shumë se të gjithë, pensionistë që kishin humbur kapelat e s'pyesnin fare për to, dy oficerë të marinës që e shtrëngonin sa mundnin dhe plotë të tjerë. Këta i kishte më pranë Veberi. Dikush e qëlloi me grusht pas shpinës. Veberi u vërtit andej, po e shtrëngonin në fytyrë me gjithë krahun. Grushti dhe ajo e shtrënguar sikur e sollën në vete dhe i treguan në ç'rrezik ndodhej. U shkëput me një kërcim të fuqishëm nga ai që e kishte shtrënguar. Se nga mbiu ai polic që e shtrëngoi ashtu.

— Do të përgjigjeni për këtë — tha Veberi me zemërim. — Unë jam vëllai i kryetarit të bashkisë dhe kryemjek në spitalin «Urtonen»! Ç'doni të dini? Ai që iku është një l'çmendur që është rritur pa masë nga një dëmtim i kolonës vertebrale. Ne po e dërgonim në një klinikë për t'i bërë ca kura.

Polici kërkoi ndjesë me një ndjenjë përulësie të shplarë. Turma i hapi udhë Veberit. I ndihmoi edhe polici me grushte dhe me bërryla. Me t'u larguar Veberi, kureshtja e turmës u shua si zjarr kashte. Kjo ishte kureshtja e zakonshme e njuharkezëve, për të cilët çudia më absolute është zero me atë që do të dëgjojnë nesër.

Maksi u takua me shoferin e kamionçinës e i tregoi grushtin. Në çast ia behën fotoreporterët. Maksi uli kokën. Drita verbuese e aparateve përfshiu turmën që kishte zënë të largohej. Maksi u hodh në veturën e tij. Udhë hapur. Në xhamin e veturës u puthitën dhjetëra fytyra. Po tani më që vonë. Vetura u lëkund dhe u vu në udhë. Veberi zgjati dorën me rrëmbim nga receptori i radio-telefonit. I duroi të sharat e Xhon Stivensit me gjakftohtësi. «Mos ke lajmëruar policinë? Jo! E vetmja punë me mend që pa- ske bërë!».

Veberi psherëtiu.

«Mos bëre ndonjë deklaratë kur të rrethuan?»

Maksi seç i ngatërroi.

«Po i nis pas ata të legjionit. Policia është e zonja vetëm për të ngatërruar punë. Ndërroja targën veturës dhe më prit pranë «Uollsdorfit». Për pesë minuta jam aty».

Veberi nxori një psherëtimë të dytë lehtësimi.

Gjiganti gulçonte. Pështjellimi dhe rrëmuja e shoqëronin hap pas hapi. Qe kapitur dhe mezi i bënin këmbët. Udhë hapej përpara tij si me magnet, megjithatë do të dilte diçka ta pengonte. Dyqind hapa përtej «Uollsdorfit» u kthye në të majtë. Atje e pat më vështirë. Trotuari nuk çahet aty, se njerëzit s'e kishin parë. Kur e vunë re, ai u kthye rishtas nga kishte ardhur dhe mori drejt vilës «Trinidad». Po, me t'iu afruar asaj, e rrethoi një mori veturash. Fenerët e tyre e verbuan dhe ai mbuloi sytë me duar, i përkulur më dysh si një krijesë që vuan. Atë çast ishte për t'u mëshiruar dhe jo për ta pasur frikë.

E solli në vete krisma e dyerve të maqinave. Nga ato zbriten legjionarët me shkopinj metalikë në duar. Gjiganti njohu Veberin në një rën prej veturave dhe kuisi si një qen i plagosur. U mbështet me shpinë pas derës metalike, pastaj e tërhoqi me forcë pas vetes dhe e shkuli nga vendi. E ngriti pezull derën, pastaj e flaku me fuqi drejt atyre që po i afroreshin. Ajo ra mbi mbulesën e një veture dhe e bëri petë. Poli u fut me vrap në parkun e «Trinidadit».

Norman Batleri e pa pas xhamit të laboratorit dhe ngriu. Pa një kokë që rrotullohej djathtas dhe majtas me dëshpërim, një si kokë bishe që pret ta ushqejnë. Shkencëtarit i rrëshqiti epruveta nga duart dhe u bë thërrime në parketin e laboratorit. Batleri ndjeu një shtrëngim në gjoks. Nuk mund të thuhet se ndjeu frikë, as që u çudit. Gjithë emocioni i tij rodhi nga e papritura. Ai gjigant atje ishte një përjashtim i natyrës apo dora e ndonjë Batleri tjetër? Kjo i shtrëngoi gjoksin shkencëtarit. Me t'u zhdukur përshtypja e parë, Batleri e kundroi gjigantin vetëm ashtu siç mund të vështrojë një shkencëtar. Sytë e tij nuk i bënë përshtypje. Batleri llogariste qartë. Ata sy që për këdo ishin misterit vetë, për të ishin rrjedhim i adepozicionit ¹⁾.

Gjiganti u zhduk. Me zhdukjen e tij u shpërndanë edhe gjithë dyshimet e Batlerit për dorën e shkencës në këtë mes. Ai ishte shkurt një përjashtim i natyrës. S'me-

1) Të ngjallurit.

rrej askush tjetër me kërkimin e hormoneve të rritjes. Veberi?.. Veberi ishte tepër larg hormoneve.

Batlerin e rrëmbeu një gëzim foshnjarak. Sytë i mban-te të mbërthyer në hekurin transversal të dritares ku kishte arritur koka e gjigantit. Kërkoj metrin dhe mati lar-të-inë. Dy e shtatëdhjetë e pesë centimetra! Batleri pshe-rëtiu. Nuk u besoi syve dhe e mati edhe një herë. Po ajo masë, nuk e luante as topi. Batleri doli jashtë në korrido-rin e vilës ashtu i humbur siç qe, me bluzën e bardhë për-sipër dhe me metrin në duar. Nga hutimi po tërhiqte me vete një tub llastiku që sillte oksigjen në laborator dhe që s'dihej si ishte ngatërruar nëpër sallë. Jashtë nuk pa as-gjë. Në një nga kolltukët e verandës pa Dinin të mbledhur grusht nga frika. Mulati dridhej dhe të jepte përshtypjen e një kafshe të lagur që po vdes nga të ftohtët. Përpigjej të fliste dhe s'i dilte asnjë tingull nga gryka. Edhe ai kishte parë...

Batleri i dha dy-tri të goditura në faqe. Dini erdhi në vete dhe pastaj vazhdoi të dridhej.

Vila u mbush me njerëz. Shkencëtari i pa vëngër shko-pinjtë e tyre metalikë. Jo, ai nuk e kishte parë atë lloj gjiganti që kërkonin ata. Ç'i duhej atij se çfarë qe? I çmendur apo i burgosur?

U kthye dhe u mor me Dinin. Po mendien e kishte tek ai. «Djali, o punë! Sikur ta vësh pranë Dinit? Ç'kontrast i mrekullueshëm do të ishte! Kontrastet pjellin disa herë zhvillimin e vrullshëm të shkencës dhe gjithmonë ndryshimet në...»

Ai desh të shtonte «rë rendin shoqëror». por nuk e vazhdoi. Jeta shoqërore s'i interesonte dhe aq. Me këtë je-të ai lidhej vetëm sa për të dhënë leksione në universitet. Endokrinologji... Në auditor prej tij buronte vetëm shkenc-a, për tjetër gjë nuk e kishte. Studentët ishin mësuar me të, e dinin që s'ishte e mundur t'ia ndryshoje mendjen. Nuk vinte nënshkrime mbi ndonjë apel, nuk shkonte nëpër mbledhje jashtë atyre të profesionit, nuk ngrihej kundër ndonjë padrejtësie. Mbaronte leksionin dhe turrej poshtë shkallëve ku e priste vetura. Batleri nuk kishte as niq, as armiq. Një njeri i tillë sipas arabëve është për t'i qarë ha-

llin. 1) Kishte vetëm admirues. Dhe këta të fundit e ndanin Batlerin njeri nga Batleri shkencëtar. Dy mbiemrat e studentëve «Ariu» dhe «Njeriu pa jetë» nuk i takonin Batlerit shkencëtar, po Batlerit njeri. Si njeri atij nuk ia varte askush, nuk e respektonte askush. Dhe më e çuditshmja ishte se ai ishte i kënaqur. Ai kishte arritur gjer në përfundimet absurde ku puna dhe profesioni zëvendësonin karakterin dhe personalitetin e njeriut. I thoshte Stenlit në orë të mira: «Çuditëm kur thonë se Nortoni është njeri i mirë, apo Stenli dhe Batleri janë djem siç duhet, në vend që të thonë se Nortoni është kirurg i zoti, Stenli një shkencëtar siç duhet dhe Batleri një fizikant që premtan...»

— Oh, mister Batler! — klithi Dini që erdhi në vete më në fund. — Ç'ishte ai tmerr, mister Batler?

Shkencëtari qeshi dhe u fut në laborator. U ul në poltronë dhe mbylli sytë. Një përbindsh iu fanit në mugëtim. Ai kishte vënë përpara qytetin me një vravashkë të ndezur në dorë dhe po i vinte flakën.

U ngrit me rrëmbim në këmbë i inatosur me vetëveten. «Po bëhem si fëmijë mendoi, po ia kaloj Uellsit në fantazi. Askush nuk mendon një gjë të tillë, askush nuk kërkon një gjë të tillë nga unë. Duket se po plakem...»

* * *

Maksi nuk doli fare nga vetura. Ai u ngjesh mirë e mirë në fund të saj që të mos e shihnin nga vila. Si ai, si Xhon Stivensi, merrnin e jepnin me ata që ndiqnin Poin.

I kishin ulur perdet e maqinës dhe kishin ndezur një dritë të gjelbër. Vetura ishte bërë tym nga purot e senatorit. Maksit po i zihet fryma, po s'guxonte të thoshte të hapnin xhamet. Senatori ishte shumë i zemëruar.

«E kaloi vilën!» erdhi njoftimi nga ndjekësit.

«Po e kapërcen udhën trembëdhjetë.»

«Na humbi nga sytë...»

— Do t'ju var të gjithë! — klithi Xhon Stivensi.

1) Proverb arab, pak a shumë i njëjtë me sa shkruhet lart.

Senatori u kthye papritmas nga Veberi dhe i buzëqeshi.

— Dëgjo, teutonikus! A nuk mund të na shërbejë ky rast për të matur pulsën e qytetit?

Veberi u lehtësua përnjëherësh. Harroi që Stivensi e kishte thirrur me atë mbiemër poshtërues. Mjaft që senatori të mos e merrte inat.

— Herët a vonë kjo do të ndodhte — vazhdoi senatori.

— Megjithatë... — Veberi u kujtua se s'duhej ta zemëronte Xhon Stivensin dhe heshti.

— Kot e vajton të vdekurin, teutonikus! — u tall senatori.

«U ndal përpara barit «Feniks», erdhi njoftimi tjetër nga ndjekësit.

— Ndalojeni për gjithë djajtë! Nuk duhet të futet aty! — bërtiti Stivensi.

Ai largoi kufjet nga veshi. Në valët e radios se si ishte përzier një bisedë amatorësh. Atë e dëgjoji edhe Veberi.

Senatori tundi kokën. Kur vuri kufjen, nuk e dëgjoji më.

«E la «Feniksin». Po drejtohet nga ura e Torentit... Kllajf Bokerin që deshi të pengonte e rrëzoi gjysmë të vdekur përdhe...»

«Ja Polifemi që po hipën mbi parmakët e urës. Kërkon të mbytet...»

— Ndalojeni për gjithë skëterrën! — Ulëriti senatori.

«Stiv Çarltoni e goditi në kokë. Po i bien edhe të tjetrët... Po lëkundet... U rrëzua.»

«E kemi lidhur. Dy veturat tona u përplasën keq. Po e ngrejnë Polifemin...»

— O perëndi ç'farë idioti! Kush pyet për veturat e prishura tani? — shfryu senatori.

Ai afroi mikrofonin pranë gojës dhe e pyeti a ishte bërë trazirë e madhe andej.

«Aspak! iu përgjegjën. Çdo gjë shkoi fare në rregull»

— Mercenarë të qelbur! Gënjeshtarë pa turp! — shfryu prapë Stivensi duke u kthyer nga Veberi. — Gënjej-

në pa pikën e turpit! Andej do të jetë lemerisur dynjaja. Apo kalojnë pak njerëz nga ura e Torentit!

Stivensi dha pastaj një sinjal tjetër me radio që Veberi nuk e mori vesh.

— Lajmërova atë «Pelikanin» — shpjegoi senatori.

Pelikan për Xhon Stivensin ishte presidenti. Ai nuk kishte një thërrime respekti për atë që qeveriste vendin..

— Mos duhet ta bëjmë edhe një herë këtë udhë, mister Stivens?

— Nuk besoj. Po të dojë, «Pelikani» mund të fluturojë gjer në ishullin e Kanarinave. Veç Polifemit mund të shohë edhe të tjerët.

— Veç presidentit a e di njeri tjetër ç'bëhet në ishull?

— Jo, nuk besoj. Megjithatë nuk dihet. Pelikanët kanë gjithë atë gjuhë...

— Sigurimi i brendshëm duhet ta dijë. Diçka kanë nuhatur edhe gazetatat...

— Mos çaj kokën për ta, Veber.

Senatori e shuajti dritën e brendshme dhe ktheu maqinën.

— Ç'qe kjo e ikur, Maks? — pyeti ai papritur.

— Krizë!

— Krizë?

— Po! Thirrja e të parëve... E keni lexuar Londonin?

Ai është vjetëruar shumë, po diçka prej tij jeton. Polin po e grin malli për jetën e përparshme, për të afërmit. Në rrethana të tilla njeriu ose bëhet melankolik, ose tërbohet. E pashë që kur u nisëm se do të kishim telashe me të.

— «Thirrja e të parëve» duhet asgjësuar, teutonikus...

— Hëpërhë nuk dua t'i prek inteligjencën...

— Ndjenja e të afërmve është ndjenjë primitive, teutonikus...

— Thjesht primitive. mister Xhon — foli me zë të akullt Maks Veberi dhe një e dredhur i përshkoi trupin duke kujtuar të atin. E donte gati me përgjërime. Për të Kurt Veberi ishte edhe baba, edhe shok armësh. Po i tha ashtu senatorit, ngaqë donte të tregojë i modës.

— Nuk mund ta fsheh, teutonikus, që, megjithëse jam njeri tepër i fortë, ju më bëni të dridhem nganjëherë. Pak

përpara, kur m'u përgjegjët, pata përshtypjen se po më mbështillej një kordon i ftohtë rreth qafës.

— Ju admiroj si njeri të singertë, mister Xhon...

— Ju a i doni të afërmit, Veber?

Maqina çante me shpejtësi nëpër udhët e Njuharkut. Dritat e reklamave dhe kriptonet mbi trotuare herë ndriçonin fytyrën e Veberit, herë të Stivensit. Ata që të dy i urrenin ato çaste drite, që të dy kërkonin të mbateshin për vete në errësirë dhe të shihnin tjetrin në dritë. Errësirë, dritë, errësirë, dritë! Errësirë...

Këtë çast e kapi Veberi.

— Nuk mund të kundërshtoj atë që thashë përpara, mister Xhon. Pastaj s'di ç'të them. Nuk më kanë mbetur të afërm. I përlau lufta.

— Shkojmë te unë, — tha senatori — pas gjithë këtij çrregullimi kemi nevojë të hedhim ndonjë gotë.

Veberi pranoi.

— Dhëntë zoti të mos e gjejmë Erihun aty, teutonikus!

— Jo. Stivensi s'kishte ndonjë gjë kundër peshkopit, madje e kishte mik të ngushtë, por, kur i shkrepaj të ngrinte ndonjë gotë (Stivensi pinte rrallë), nuk e duronte ujin e tij mineral. Veberi s'e kishte parë të pinte asnjëherë tjetër gjë. Thoshin që pinte në shtëpi. Ujin mineral e pinte për veshkën. Megjithatë ai s'ishte ankuar kurrë.

Senatori e pyeti kryeshërbëtorin për të shoqen.

— Mis Karola është në mbledhjen e shoqërisë së mbrojtjes së Dingove¹⁾ të Australisë, mister Xhon. Tha se nuk do të vijë para orës dymbëdhjetë.

Senatori i shkeli syrin Veberit. «Jemi rehat atëhere», deshi të thoshte.

U ulën në kolltukët e butë. Kryeshërbëtori erdhi dhe ua mbushi gotat.

— Na sill edhe nga ajo torta me çokollatë! — e urdhëroi senatori. — Uiskin e marr me këtë tortë, i dashur — iu kthye ai Veberit.

— Nesër do t'i bëj një vizitë Batlerit, ç'thua?

Maksi u kthye nga ai.

1) Racë qensh.

Xhoni kishte ndezur llullën dhe nxirrte shtëllunga tymi nga goja. Dukej i qetë dhe i kënaqur nga vetja. Kur e shihte kështu, Veberi i ruhej më shumë. Në ato çaste atij i pillte mendja gjërat më të çuditshme.

— Mos u çudit, teutonikus! Nesër në mëngjez do t'i vete Batlerit...

— E kuptoj. Unë nuk duhet të shkoj në mëngjez në laborator.

— Pikërisht!

Stivensi i mbushi rishtas gotën Maksit dhe e trokiti me të.

— Për suksesin tonë, Veber!

Tingëlloi telefoni nga studioja. Senatori nuk e prishi terezinë. Tingëlloi për së dyti. Vetëm në tingëllimin e tretë u ngrit. Mori e dha një copë herë pas derës me xhama të studios. Veberi shihte siluetën e tij si lëvizte me gjallëri. Xhoni fliste në telefon sikur ta kishte bashkëbiseduesin përpara syve. Doli nga kabineti dhe u ul. E ngriti për njëherë gjysmën e gotës me uiski. Nuk e kishte më atë qetësinë dhe vetëkënaqësinë e përparshme. Vendin e tyre tani e kishte zënë një gjallëri e jashtëzakonshme, një vrull i brendshëm, një përpëlitje që s'tregohet. Ai e kishte harruar Veberin. Merrte vendime, bënte llogari, lëvizte në kolltuk sic lëvizin tifozët e regbisë nënër stadiume.

— Është fjala për një ndërmarrje të re, — u kujtua të thoshte ai.

Krvekamerieri doli në sallon me nxitim.

— Erdhi Ralfi! — tha ai me një frymë.

Ralfi ishte i biri i Xhon Stivensit. Kishte tre viet në Indonezi dhe gjatë kësaj kohe s'kishte ardhur asnjëherë.

— Ralfi, the?! Qetësohu, merr frymë mirë!

Kryeshërbëtori mbeti. Në zërin e Stivensit dallohej hapur një notë e hollë ironie.

Veberi ia nguli sytë dialoshit që doli në sallon. Nuk i ngjiste senatorit. Qe shëndetlig, me një pamje dhe me një të ecur nervoz.

Xhon Stivensi i ra supit.

— Qenke mirë, Ralf. Si ia çon? Ky është mister Veberi.

Veberi e humbi torruan. Ralfit i dukeshin kockat e fytyrës. I kishin thënë që i biri i senatorit kishte pasur një kohë shqetësime nervore. Ai sikur e ndjeu kur djali i shtrëngoï dorën.

— Pa na thuaj, Ralf, ke bërë para?

Djaloshi ende nuk ishte ulur. Të tre qëndronin në këmbë.

— S'ka dyshim që s'ka nxjerrë gjë! Paratë bëhen vetëm këtu, te ne.

— Baba...

— E di, e di, pavarësia jote...

Veberi s'dinte ç'të bënte. Ai djalosh thatim dukej më i huaj se vetë Veberi në atë shtëpi.

— Eh, rinia!... — tha senatori. — Po, ulu, Ralf.

— Erdha sa t'ju shoh. Nisem në ora dhjetë...

Veberi vështroi orën. Donte dhe njëzet e pesë minuta të vinte dhjetë.

— Ja, një minutë, sa të marr pak në telefon...

Xhon Stivensi u fut në kabinetin e tij. Veberi e humbi keq.

Ralfi i mbante sytë te kabineti i të atit. Gjuri i djath-të i dridhej pak. Veberi nuk ia ndante sytë atij gjuri. Sa më shumë vonohej Xhon Stivensi, aq më shumë i dridhej. Veberi vështroi përsëri orën. Plot njëzet minuta. Taka e këpucës së Ralfit tani rrihte shkoqur parketin.

Number one! 1) — pëshpëriti Ralf Stivensi me një zë prej të sëmuri. Këmba e tij rrihte më fort parketin. Kështu disa sekonda, pastaj ai u ngrit dhe iku pa i folur njeriu.

KAPITULLI V

Batleri doli nga banjoja dhe zuri të vishej. Sa herë që ndjente lodhje dhe dhembje koke, bënte dush me ujë të ftohtë dhe fërkohej mirë e mirë me një peshqir me fije

1) Nëmër një. (Angl.) Shprehje mes milionarëve që tregon luftën e tmerrshme për të qenë kudo i pari, i vetmi, i paarritshmi në biznes.

sintetike. Rrallëherë vishej kaq me nge si atë pasdreke. Madje ai u mendua një kohë të gjatë për të zgjedhur kravatën që i shkonte më mirë.

Kishte takuar Xhon Stivensin atë ditë...

Batleri vërejti me një farë turbullimi që fytyra e vet po i qëndronte mirë kohës, ajo që e freskët dhe e çelur. Ajo sikur i kujtonte atë ditë, vetëm atë ditë. një farë boshllëku që mundahej të mos e vinte re. vetminë. Buzëqeshi. Ju kujtua Perkinsi shkurtabiq i institutit të rrezatimeve. Perkinsi që martuar dy javë përpara me një asistenten e tij që mund të ishte dy herë e bija. «Edhe në qoftë se unë nuk do të jem burri i saj me gjithë kuptimin e fjalës, të paktën do të jem adhuruesi i saj. Kemi nevojë të adhurojmë diçka, Batler. Shkencën? Gjer në grykë e kemi...» i kishte thënë. Ishte zemër njeriu Perkinsi i institutit të rrezatimeve, ishte i sinqertë.

Batleri i që përgjegjur si harbut dhe e kishte lënduar në sedër. Nuk e kuntonte këtë lloj adhurimi, nuk mund të kuptonte asgjë që s'ishte materiale.

I hodhi edhe një herë sytë pasqyrës. U mendua të merrte pamjen e zakonshme. pa asnjë shprehje. Nga filozofët e vjetër kishte lexuar që një fytyrë pa shprehje është apogjeu që mund të arrijë njeriu. Është maja nga ai sundon çdo pasion njerëzor. Batleri asket? Kjo është për të qeshur. Qe materialist gjer në palcë. Po fytyra pa asnjë shprehje? Prej vitesh ishte kështu, prej vitesh as gëzohej, as hidhërohej. Vetëm punonte. Dhe s'mendonte ç'mund t'u jente të tjerëve puna e tij.

Tingëlloi videofoni, dy zile përnjëherësh, e dhomës së gjumit dhe e laboratorit. Batleri ngriti receptorin pa vështruar ekranin e vogël.

- Mirë dita! — thirri me gëzim një zë çapkën.
- Mirë dita, Anabell!
- Si duket plakushi im i dashur?
- Mirë, Anabell!
- Ç'ka plakushi im i dashur që nuk më vështron?
- Asgjë, Anabell...
- Po këto përgjegje të shkurtëra?
-

— Do më shoqërojë sot plakushi im i dashur?

— Nuk mundem, Anabell...

— Përse?

— Pas pak do të operoj Dinin.

— Po vështromë pra, vështromë! — rrahu këmbën vajza.

Batleri uli sytë mbi ekran. Anabella i tundi kokën dhe e përqeshi me gjithë shpirt. Pastaj ajo mori papritmas një pamje jashtëzakonisht serioze.

— Këtë javë duhet të shkojmë në varrezat, i dashur.

— Mirë — tha Batleri. Anabella e kishte fjalën për shoqen.

— Po të ketë diçka nga Stenli...

Batleri e la receptorin i pakënaqur.

«Jeta dhe vdekja... një humnerë... Atë mund ta kapërcesh me një hap ose të mos ia arrish për shumë kohë. Kjo humnerë që zmadhohet për disa dhe zvogëlohet për të tjerët është njëfarë rregullatori i jetës...»

Batleri nuk mendoi më. Ai filozofonte me rast, tepër rrallë. Filozofia nuk ishte punë e tij, megjithëse, kur shtrihet në shtrat, hapte Platonin.

Ai u ul në poltronë dhe sytë i vajtën te një letër e hapur. Një adresë gruaje nga Milanoja. Sinjora Kozeli, «një shtëpiake me jetë të siguar, që besonte në zotin dhe jo në diallin si Batleri», e bënte horr «për ato marifetet e tij djallëzore me kafshët e bekuara». Batleri, sipas saj, «kishte përgjakur krijesat e pafajshme të zotit dhe s'kishte shpëtim tjetër për të veç ferrit. Zoti...»

E flaku tutje letrën. Një kohë edhe këtu i kishin thyer xhamat e laboratorit, ndonjëherë dhe e kishin kërcënuar me grushte udhës. Se si i vajti mendja te qeliza e gjallë që u prodhuan artificialisht dhe psherëtiu i lehtësuar. Ku do të fshihej sinjora Kozeli, po ta kuptonte ç'do të thoshte kjo? «Ku do të mbytet feja? Pyeti ai veten. Ne krijuam jetën e gjallë...»

Letrat e tjera i kishte parë në mëngjez. Ishin nga truste dhe korporata të ndryshme. Ato nuk interesoheshin më për shpërc'et e tij. Dhe më e keqja nga të gjitha, një letër nga rektori. «Mister Batleri është i lutur të mos paraqitet

më për leksione, pasi ai vend do t'i jepet një profesori tjetër».

Batleri veshi bluzën e bardhë dhe u fut në laborator. Ndoshta ishte hera e fundit që do të punonte aty. Kishte takuar Xhon Stivensin atë pasdreke...

* * *

Më shumë se një shekull përpara në portin perëndimor të Njuharkut kishte zbritur Filip Batleri, gjyshi i Normanit.

Ai kishte sjellë me vete nga qyteti Leiden pesë gojë për të ushqyer edhe ëndrrën e çmendur për të bërë pasuri. Që një njeri i shkathët dhe për ca kohë i eci me spekulimet, kur po ndaheshin tokat e perëndimit. Po më pas falimentoi dhe u katandis shitës gazetash në udhët e Njuharkut. Njuharku i asaj kohe ishte një qytet i shplarë, me ndërtesa njëkatëshe. Ishte vendi ku zbarkonin emigrantët, ku një njeri mund ta shihje vetëm kur arrinte, se të nesërmen ia mbathte nga perëndimi. Tek ndodhej sot udha trembëdhjetë, kalonte aso kohe një nyje e shkurtër hekurudhore që lidhte qytetin me portin. Vagonat i tërhiqnin kafshët. Ato i fshikulloi Filip Batleri për dyzet cent në ditë.

Fred Batleri, i ati i Normanit, punoi gjithë jetën si mekanik lokomotivash. Kishte kaluar cuditërisht shpejt koha e vagonave me kuaj. Kishte një dëshirë të çmendur ai Fred Batleri, donte t'i jepte shkollë djalit të vetëm. «Ose prift, ose njeri i ditur. Ky ka një natyrë... Asnjë nga Batlerët nuk ka cenë si ky».

Normani çau përpara gjer në vitin e tretë të universitetit. S'i kishte vaitur mendja të bëhej as prift, as njeri i ditur. Donte të mësonte thjesht mjekësi. Megjithatë dashuria për shkencën i digjej përbrenda si një llambë Bunsen që nxjerr një flakë të padukshme, por bën punë të madhe.

Batleri kishte bërë armiq në universitet. Këta zinin fill që nga dekani dhe mbaronin te portieri. Ai ishte kap-

ter dhe bir kapteri me prejardhje nga të konfederatës, që Batleri harronte ta përsëhëndeste gjithmonë. Armiqësia e tij e vërtetë me të tjerët nisi kur filluan praktikat në kirurgji. Ai i kishte ndërhyrë disa herë gjatë operacionit Ser Donalt Mokraftit, asit të kirurgëve të Njuharkut. Dekani e kishte nxjerrë nga salla, po Mokrafti i kishte telefonuar në mbrëmje në konvikt dhe e kishte lavdëruar.

Të mëdhenjve të Njuharkut nuk u vjen aspak mirë kur u jep një këshillë, apo kur u ndërhyjnë, vetëm se njuharkëzët e dëgjuar kanë meritën e padiskutueshme që e mbajnë këshillën në xhep dhe s'e flakin tutje. Mokrafti ishte diçka si më i madhi ndër të mëdhenjtë në Njuhark që jo vetëm e mbajti në xhep këshillën e Batlerit, por edhe e lëndoi atë. Kur u mor vesh kjo, të gjithë menduan që Normani e çau udhën. Po pikërisht në ato ditë ndodhi e kundërta. I vdiq i ati.

Fred Batleri i kishte lënë trashëgim gjashtë muaj qira të papaguar, një dhomë me dy shtretër portativë nga ata të ushtrisë së konfederatës që me siguri kishin bërë gjithë fushatat e luftës civile, si dhe dëshirën për ta futur në dhe me ceremoni fetare. Normani kishte rruhur buzët e megjithatë kishte lënë kostumin peng për të paguar shërbesën fetare. Ai ndiqte korteun dhe nuk kuptonte pse kishte pasur këtë dëshirë i ati. Ishte e çuditshme që një njeri si Fred Batleri, që tallej orë e çast me fenë, të kishte pasur kërkesa të tilla në castin e fundit. Vonë, shumë vjet më vonë, ai e kishte kuptuar pse kishte ndodhur kështu. Fred Batleri ishte tallur me fenë pa e njohur kotësinë e saj shkencërisht. Kjo e kishte bërë të përkulej në prag të vdekjes. Ai s'kishte vdekur i gënijer, po i paditur. Të vdesësh i paditur, është e tmerrshme. Është njësoj sikur të kesh jetuar kot.

Këto dhe zilja që shkundte xhakoni për t'i hapur parajsën Fred Batlerit nuk e lanë Normanin të përfitonte nga një bursë që jepte «Shoqëria e shpëtimit», një organizatë fetare vullnetare. Normani do ta kujtonte për shumë kohë këtë «budallallëk» dhe s'do t'ia falte vetes. Të paktën katër herë në vit tetëqind vullnetarë nga «shoqëria e shpë-

timit» i bien kryq e tërthor Njuharkut me ato banderolat e verdha në duar. Batleri i shihte nga dritarja dhe tundte kokën. Mesjetë e plotë...

Pas vdekjes së të atit ai provoi urinë, vuajtjen, të ftohën dhe përbuzjen. Vetëm në këtë kohë ai zuri të mendonte në e vliente të jetohej kjo jetë. Më përpara, mirë a keq, i ati i mbyllte nevojat e rëndomta të familjes. Kur kishte bukë në shtëpi, duhan dhe bizele, jeta nuk dukej edhe aq e tmerrshme. Po Normani kishte diçka të veçantë që e dallonte nga shokët e vet të mjerimit. Ndaj gjithë mungesave të jetës ai vinte aso kohe apatinë e vet, një lloj çinteresimi gati prej të marri për çdo gjë që e rrethonte. Vetëm shkenca i duhej. Lexonte stoikët (librat i merrte andej-këtej dhe i ndynte me gishtërinjtë tërë yndyrë nga pjatat që lante nëpër restorantet e mëdha për të përballuar shpenzimet e tij dhe të universitetit). Megjithatë dukej që Batleri kishte bërë një marrëveshje të heshtur me stoikët, i pranonte gjersa të mbaronte universitetin. Po më tutje? Më tutje ishte mugëtirë... Më tutje ai mendonte për bukën, duhanin, bizelet... Mendonte për zilen që trokiste në krye të çdo muaji, për qiranë... Këto do t'i hiqte qafe më tutje...

Diplomën ia hodhën poshtë. Ishte një sirenë alarmi diploma e Norman Batlerit. Aty nuk kritikohesh ndonjë metodë e veçantë kurimi dhe kërkimi, po në përgjithësi filozofia që udhëhiqte kërkimet. Po a kishte një filozofi të vetën kërkimi në universitetin mjeksor të Njuharkut? Ç'ishte ky Batleri, patolog, psikiatër, kirurg, antropolog? Aty ia gjetën thembrën Akilit. Ai nuk duhej t'i largohej kirurgjisë në punën diplomë. «Caqet janë të ndara, mister Batler, kush i ngatërron ato, bie kokëposhtë! Pastaj ju sikur po lexoni shumë gjermanët. Ai Hegeli juaj...» Batleri kishte tundur kokën. Përveç stoikëve të lashtësisë ai nuk njihnte të tjerë. Dhe stoikët kishin luajtur si të thuash një rol utilitar, e kishin mësuar të duronte materializmin që mbronte në diplomë ai e kishte nuhatur, më shumë se nga librat dhe studimi. E kishte ndjerë në kadavrat që hapte, në njerëzit që u vdisnin në duar kirurgëve, në luftën që bënte Njuharku për të jetuar.

Batleri kishte mbetur keq. I kishte arritur thika në koskë. Ndodhte që me ditë të tëra të rrinte pa ngrënë. Paraqiti një punim të dytë brenda një kohe të shkurtër. Diploma nuk ishte një përjashtim nga tradita dhe u pëlqye. Kjo gati e fundosi përfundimisht Batlerin. Ai mund të mësohej të ecte mes atyre dy shinave të përjetshme paralele që quhen traditë dhe normë e kohës dhe kjo ishte e rrezikshme. Po atëhere ai kishte nevojë për diplomën, (bërryllat dhe gjunjët ishin gati t'i dilnin jashtë kostumit) dhe gati sa nuk bëri lëshime të tjera. «T'u bënte lëshime të tjerëve, dhe mendimet e guximshme t'i mbante për vete» kishte pranuar përkohësisht si moto Batleri. Një kontradiktë që në të ardhmen mund t'i kushtonte. Kjo ishte njësoj sikur të gjendeshin dy shkencëtarë brenda një Batleri.

Një revistë e fuqishme e Njuharkut u interesua për punimin e parë të Batlerit. Revista që kishte parasysh diçka më interesante se lavdia e shkencës, i dha Normanit 3600 dollarë për shtatëdhjetë e dy faqe të daktilografuara. Pra pesëdhjetë dollarë për një faqe. Dhe Batleri që kishte pranuar të lante shtatëqind pjata për dyzetepesë cent çdo mbrëmje, pranoi të shiste një faqe për pesëdhjetë dollarë. Kjo ngjarje, së bashku me jehonën dhe trazirat që shkaktoi në Njuhark, i dha të kuptonte Batlerit që mund të dilte ndonjëherë nga norma e kohës, po me shumë kujdes. U vërvit gjashtë muaj nëpër spitalet e Njuharkut dhe të qyteteve të tjera pa gjetur punë. «Norman Batler? Kemi dëgjuar për ju. Jo, mister, keni ardhur në kohë të keqe. Asnjë vend i lirë...»

Kur dilte nga dera, ai e dinte se e vështronin prapa kraheve. U kthye sërisht në zanatin e pjatalarësit. Pikërisht në këtë kohë, kur ishte më ngushtë, po ajo revistë që i kishte botuar punimin e diplomës, i kërkoi diçka të ngjashme. Batleri lante pjatat me shpresë se do ta harronin çfarë kishte botuar dhe se do t'i hapej ndonjë vend. Kur ja pranë revista... Dhe si pa e kuptuar dhe ai vetë se si nxori kokën pranë vetëdija e përgjumur e Batlerit, apo më mirë, ajo që vetë Normani nënidei ta bënte të heshte në të shpëtuar nga pjatat. E shkroi artikullin. Dorëzoi një pu-

nim shumë më të rreptë se të parin. Përveç bindjeve shkencore, aty kishte një dozë të fortë cinizmi që binte erë yndyrnash, supërash, karrotash dhe ndyrësira enësh. Punimin ia paguan mirë. Po më kot priti t'ia botonin. Dhe, kur ai kërkoi me ngulm botimin, e përzunë nga redaksia. Atë kohë as që mund t'i shkonte ndër mend pse kishte ndodhur kështu. Nuk mund të kuptonte që revista e ruante shkrimin e tij për ta përdorur kundër grupeve kundërshtarë. Po, sikur ato të merreshin vesh, shkrimi digjej... «Pse shqetësoheni, mister Batler? Ne ju paguam. Ç'ju duhet tjetër? Bindjet, opinioni kanë vlerë kur shndërrohen në para! Paratë i morët!»

E përzunë nga revista, po e ftuan ata që i kritikonte. Ky qe një grusht i ri për Normanin. Batleri, që qe pregatitur të vërsulej, mbeti i shtangur nga pritja e rektorit. Biseda nisi me një pyetje jo të zakonshme.

— Uluni Batler. Ju më kini sjellë aq ngatërresa, sa nuk tregohen. Ç'dreqin keni që nuk rrini urtë?

— Nuk ju kuptoj, sër...

— Rrini, pra Batler! A s'më thoni a keni qenë në ndonjë uzinë të madhe të Njuharkut?

— Kam qenë në atë të elektroteknikës, — tha i çuditur Normani.

— Nuk ju ka zënë syri aty ndonjë maqinë të re që s'e vënë në punë, ndonjë maqinë me rendiment shumë të lartë?

— Po, një metalprerëse, që bën punë sa për dhjetë maqina që punojnë sot. Dhe t'ju them të drejtën, sër, më çudiste që e mbanin mbuluar në një qoshe.

— Mendimet tuaja i ngjasin asaj maqine, Batler. Nuk u ka ardhur koha. E kuptoni?

— Kjo është antinjerëzore. Tjetër është mjekësia, tjetër industria. S'kuptoj asgjë sër.

— Për mua nuk kanë asnjë ndryshim. Mos doni të mohoni konkurrencën? Ajo ka formën e luftës biologjike në sferën tonë dhe trajtën e vërtetë në fusha të tjera. Ju jeni sociolog i keq, Batler!

— Megjithatë, sër, mendimet e mia nuk i kanë luftuar

si të parakohshme, po si të papërshtatshme për çdo kohë, materializmi...

— Nuk keni thënë gjë të re, Batler. Kjo muzikë dëgjo-
het prej shekujsh. Ajo që ju dha famë të keqe, që më
shumë kokëfortësia, me të cilën parashtronit mendimet.
Po kjo kuptohet, në moshën tuaj kështu isha edhe unë.
Tani i kujtoj ato kohëra dhe buzëqesh. Lamartini më duket
se ka thënë: «Nuk ka të ri që s'është republikan...» Me ko-
hë do të buzëqeshni edhe ju me mendimet tuaja. Kështu
si ju them unë.

— Nuk do të qesh. Atë që e shpreh sot, përpiqem ta
përfytyroj si do të tingëllojë pas dhjetë, njëzet vjetësh.

— Po sidoqoftë, i dashur, — i preu fjalën rektori — a
do të pranoni një vend si asistent në institutin tonë me
kusht që të shihni sa më shumë, po të flisni sa më pak?

— Do t'jua dija për nder, sër...

«Lëshime të vogla, për hir të idealeve të mëdha,» do
ta shfaqësonte më vonë veten Normani.

Të nesërmen e ditës që nisi punën në laborator, ai më-
soi se ata që financonin institutin e kërkimeve i kishin pa-
guar revistës dhjetë herë më shumë sa ç'kishte marrë Bat-
leri për shkrimin e dytë vetëm që të mos ia botonin. Me ç'du-
kej, ai po hynte në jetë, po e kuptonte atë pak nga pak.
Po gati si gjithmonë, në prak të vendimeve të mëdha, i doli
përpara sysh diçka tjetër që e bëri t'u kthente shpinën së-
rish bindjeve, mendimeve për jetën. Lexoi rastësisht një
monografi mbi gjendrat me sekrecion të brendshëm dhe
mbeti si i shushatur një javë të tërë. Ndoshta Batleri ishte i
dobët aso kohe. Lufta në laborator, i dukej më e lehtë se
jashtë mureve të tij. E, meqë donte megjithatë të luftonte
për diçka, u mbyll brenda mureve dhe i ktheu krahët botës.
Për të parë botën, njeriun nuk e pengon as muri më i tra-
ngjante edhe me Batlerin. Muret bëheshin të tejdukshme
sa herë i zgjohej ndërgjegjja si i kishte ndodhur në rastin
e Xheni Paterit... Në këtë kohë sado që ishte bërë i fam-
shëm, për pak e pa veten në kuzhinën e çifutit Rozenbah.
Po edhe ajo kohë iku. Më vonë, kur e pyesnin Batlerin si

kishte arritur atë shkallë përsosmërie në shkencë, ai ngrinte supet dhe thoshte: «Kam vuajtur në rini për bukën e gojës. Doni të shkatërroni një shkencëtar? Shtrojani udhën me degë ari. Mjerë ai që ka sukses në fillim!».

I çuditshmi Batler! Sikur ishte i kënaqur nga ato vite zie.

* * *

Shkencëtari hodhi bluzën e bardhë krahëve dhe shkoi në klinikë. Batleri mbante këtu dhjetë shtretër për raste sëmundjesh të rënda të gjendrave me sekrecion. Ai nuk shtronte njeri, nëse sëmundja nuk i paraqiste ndonjë interes atij vetë. Kjo thuhej edhe në kontratën që kishte nënshkruar me financierët e vet. Të hollat që derdhnin pacientët i kalonin shoqërisë aksioniste. Klinika ishte njëzet hapa larg vilës. Atë e lidhte me vilën një tunel i vërtetë, i gjelbër. Batleri shkante disa herë në ditë në klinikë vetëm për të kaluar nëpër atë tunel.

I doli përpara Larseni faqekuq, mjeku danez që merrrej drejtpërdrejt me klinikën. Ishte një burrë rreth të dyzetave, me trup të fortë dhe shëndet të mirë. Kishte një pamje prej vajze në fytyrë dhe një natyrë shumë të çiltër. Prej afro një viti punonte në klinikë. Batleri e kishte marrë nga vapori «Konektik» ku ai kishte punuar si kirurg.

— Mister Batler, — tha Larseni dhe buzëqeshi si një cupë kolegji — Dini nuk është i kënaqur nga ne.

— Pse?

Asistenti bëri me kokë nga mulati që kishte humbur i tëri në krevat.

— Dini kërkon shtratin e tij të vogël!

Profesori vuri buzën në gaz. Afroi një fron dhe u ul pranë Dinit.

— Jam penduar që të shtrova, Din — tha ai.

Shkurtabiqi përpëliti sytë me frikë.

— S'ke pse trembesh, s'flas për sëmundje, po, që kur të shtrova ty, nuk kam pirë asnjë kafe si duhet.

Mulati buzëqeshi. Po ashtu edhe Larseni. Po buzëqe-

shja iu shua sakaq. Pati një parandjenjë të keqe, s'e kishte parë kurrë profesorin të bënte shaka.

— Shëro mua, mister Batler, dhe unë bëj kafe mira, — belbëzoi Dini. Tjetri ia dha gazit me gjithë shpirt. Larseni u mbështet pas murit. Mos kishte shkalluar Batleri?

Ai u kthye nga asistenti dhe i bëri me shenjë të afrohej. Larseni ndenji në këmbë pranë tij. Ata e zbuluan Dinin dhe filluan të flisnin latinisht. Mulati u tremb.

Batleri e goditi me gisht në stomak.

— Për njëzet ditë do të të ngre në këmbë — i tha me shaka. Pastaj vështroi asistentin.

— Salla është gati, mister Batler. Sot në shërbim janë mis Karola dhe misis Peg. Vetëm për anestezinë...

— Do të na ndihmojë mister Veberi...

Larseni pohoi me kokë. Po as ai, as Batleri nuk vunë re tmerrin që e zu Dinin.

Batleri vështroi orën.

— Do edhe njëzet minuta të vejë dymbëdhjetë, Larsen.

U ngrit dhe doli jashtë. Nuk i vuri re as mis Korolën, as misis Pegin që po vinin me shtratin me rrota. Ato e përshëndetën dhe ai nuk ua ktheu. Vetëm kur qëndruan të habitura, ai u ndal, u kthye prapa dhe luajti dorën. Ato u panë sy më sy. Pastaj e futën karrocetën në dhomën e Dinit.

Askush nuk po e kuptonte atë ditë Norman Batlerin.

Batleri hyri në laborator. I vajtën sytë te tavlla e duhanit. Ishte përg me bishta purosh. E mori dhe e zbrazi. Pastaj qëndroi përpara mikroskopit të madh. E vështroi një çast si i habitur, si diçka të huaj. «Njeriu ka krijuar këtë mjet për t'u futur në të fshehtat më intime të botës. Pse nuk ka një vegël të tillë që të shohë edhe në shpirtrat e njerëzve? A mund të bëhej një instrument i tillë? Jo, as që do t'ia hyjmë ndonjëherë kësaj pune. Ky do të ishte një mjet vetëdemaskimi, njerëzit s'janë aq të marrë sa të demaskojnë veten, t'i nxjerrin të palarat në shesh...»

Batlerit i erdhi ndër mend se një e treta e patentës së mikroskopit ishte pronë e tij.

Një maqinë hyri në oborrin e vilës. Batleri u afrua te dritarja. Pa Maks Veberin që doli me të shpejtë nga ve-

tura dhe mori për nga klinika. Profesori vështroi orën. Dymbëdhjetë pa gjashtë minuta.

Kur hyri Batleri, salla e operacionit qe gati. Veberi dhe dy infermierët kishin vënë maskat në fytyrë. Maska e anestezisë mbulonte edhe Dinin. Aparati i transfuzionit përbri shtratit përhapte një atmosferë sigurie në gjithë sallën.

Batleri i bëri një shenjë të lehtë me kokë Veberit.

— Filloni, Veber — tha ai me zë të lehtë.

Maksi mori shishen e eterit dhe iu afrua Dinit.

— Mister Batler! — foli Dini përmes maskës.

— Hë?

— A jeni aty, mister Batler?

— Këtu jam!

Dini nuk foli më.

Trokitën në derë. Batleri nuk bëri më zë. Trokitën edhe një herë. Ai u kthye nga porta pa folur. «Mos nuk e kishin ndezur sinjalin që tregonte operacionin? Dera u hap dhe u duk Larseni që shtyhej me një të panjohur.

— Ju thashë që janë në operacion... — mundahej ta mbante tjetrin Larseni.

— Çfarë doni? — pyeti me të rreptë Batleri.

— Jam Tedi Rolvingu. Kam ardhur të marr në dorëzim klinikën. Ja dokumentat...

Ai zuri të kërkonte në një çantë të madhe që stononte me trupin e tij të vogël. Ishte një njeri me pamje nervoze, kryelartë, me një hundë të kthyer gjithë pretendime e gjithë sherr. Megjithatë kishte edhe diçka për të qeshur tek ai. Të kujtonte ata fisnikët kokëfortë e sqimëtarë të tetëqindës spanjolle.

— Kini mirësinë të më prisni sa të mbaroj operacionin, mister Rolving — tha Batleri gjakftohtë. — Atëhere do të jem në dispozicionin tuaj.

— Këtu thuhet të më dorëzoni klinikën menjëherë — nguli këmbë Rolvingu. — Anulojeni operacionin!

Batleri vështroi Veberin. Ai kishte kthyer kokën nga dritaret. I hipi gjaku në kokë. Iu afrua Rolvingut me grushtet e shtrënguar.

— Dilni jashtë! — tha ai gjakftohtë.

— Si? Si guxoni?

Atë çast Ted Rolvingu mund të dublonte më së miri një perandor të fyer.

Batleri e zuri nga jaka e xhaketës dhe e zvarriti jashtë sallës. Pastaj mbylli derën.

— Filloni, mister Veber — tha ai.

Maksi nisi të derdhte pikat e eterit mbi maskën e Dinit. Normani vetëm në anestezi nuk e pranonte shkencën e përparuar. I dukej se, duke i hedhur në dorë ato pika eteri, e kishte më shumë nën kontroll të sëmurin.

Maksi vështronte me bisht të syrit profesorin. E pat lakmi për atë të folur të qetë dhe për gjithë qëndrimin ndaj Rolvingut. Karakteret e forta njihen në çastet e mëdha. Pra Batleri qenka i tillë. Po në përgjithësi ai...

Këtu Maks Veberi u ngatërrua dhe u bë lëmsh. Djalli e merrte vesh natyrën e Batlerit...

Profesori e mbante kokën të përkulur mbi gjoks. Shih-te këmbët e mbuluara të Dinit. Në gjysmë të shtratit formohej një si piramidë e vogël. Aty arrinin këmbët e Dinit.

Batleri u mallëngjye. Një burrë fëmijë!

Iu kujtua si e kishte marrë nga cirku shëtitës. Arinj, qen, dy gorilla të vjetra dhe Dini me lak në fyt... Gorillat dhe Dini. Gorillat me lak dhe Dini me lak. Publiku qeshte dhe duartrokiste. I hidhte përdhe monedha njëcentëshe. Gorillat dhe Dini haheshin kush t'i merrte më përpara me buzë nga toka. Dini ankohej se ia dilnin gorillat. Për këtë punë duhen turinj të gjatë. Dini ankohej nga gorillat. Ato zvarriteshin dhe s'e çanin kokën që i rrëmbenin kafshatën... Për atë punë duheshin turinj të zgjatur... Natyra i ka ndarë rolet me kohë...

Batleri u kthye me rrëmbim nga Veberi.

— Ç'bëni kështu? Mos luajtët? — thirri ai dhe iu vërsul t'ia merrte shishen e eterit nga duart.

Nuk arriti ta kapte siç duhet. Shishja ra përdhe dhe u thye. Në sallë u përhap një erë që të merrte mendtë.

Misis Pegi u përkul dhe fshiu me një çarçaf të bardhë pllakat e lagura me eter. Pastaj e hodhi diku çarçafin.

Dini ishte gjallë, po frymëmarrja e tij qe shumë e rrregullt. Shigjetat lëviznin andej-këtej nëpër aparatet sikur të kishte nisur një stuhi magnetike.

— Edhe për pak do ta vrisnit! — iu hakërrua Batleri.
— Ku e keni mendjen, Veber?

— Më falni, profesor, po nuk e kuptoj as unë si ndodhi. Nuk di si të them... Numërova keq. Është për t'u çuditur...

Batleri u përkul mbi Dinin. Mulati tani bënte gjumë të thellë. Frymëmarrja i qe rregulluar pothuaj krejt.

Batleri ngriti kokën. Nënqeshte Maksin, apo i dukej Batlerit? Ku ishte tani vendi për të qeshur!

Batleri fërkoj ballin. I ndoti dorezat me djersë, kërkoi të tjera, bisturi i dridhej në dorë. Buzëqeshte Maksin?

Thirri Larsenin.

— Hapeni ju, Larsen, — i tha — gjersa të qetësohem.

* * *

Pas operimit, erdhi prapë në gjendjen e zakonshme. Ai u qetësua mbasi e hoqi atë tumorr që e kishte parashkuar pikë për pikë. Kjo e gjallëroi. Shkenca sundonte mbi Norman Batlerin.

Maksin përkundrazi dukej i mërzhitur. Lante duart në lavaman dhe nuk bënte zë. Dinin e kishin hequr nga salla. Larseni rrinte krahëvarur dhe priste Veberin të mbaronte.

Batlerit iu kujtua sa frikë e kishte mulati Maksin dhe u ngjeth. Tani që asistenti rrinte fytyrëngrysur, vetëm tani, u sigurua që ai kishte nënqeshur. Dhe ç'të nënqeshur, o perëndi!

I erdhën ndër mend hollësi të tjera. Dini ia kishte shitur trupin institutit «Norton»... Mos kishte dashur të fitonte kohë Veberi?

— Batleri doli jashtë. Erdhi Larseni.

— Rolingu na kërcënoi prapë, profesor.

— Iku, apo është jashtë?

— Iku! Ç'do të bëjmë, po të vijë prapë?

— Ai e ka vetëm me mua, Larsen. Besoj e ke kuptuar si po venë punët. Ti mund të punosh prapë këtu.

— Po ikët ju, do të kërkoj tjetër vend...

— Është vështirë të gjesh punë në këto kohë që kanë ardhur.

— Di ndonjë klinikë të mirë në rrethe, Larsen? — e pyeti Batleri papritmas. — Duhet hequr Dini që këtu.

— Posi, në Holli Berton. Kryemjekun e kam mik. E marr unë përsipër këtë, profesor.

— Të falem nderit! Ikë të punosh tani. Ka kaluar koha edhe për të ngrënë.

Ai për vete nuk ndjente uri. U ul në poltronën e vet. E kishte parë Maksin të largohej me maqinë dhe kishte ndjerë një farë lehtësimi.

Ngriti dorezën e videofonit dhe pyeti për Anabellën.

Kamerierja i tha se kishte dalë. Mos dëshironte gjë mister Batleri?

— Jo, asgjë!

I shkuan sytë në atë qoshen e laboratorit ku kishte parë ca ditë përpara njollën e zezë. Ishte prapë aty. Po iu duk sikur ajo kishte lëvizur, sikur ishte ngritur më lart.

Fërkoj ballin me dorë, pastaj zgjati krahun të merrte receptorin. Dësh të thërriste kamerieren ta hiqte atë njollë nga muri, po ndërroi mendim dhe e la receptorin në vend. Duheshin shkallë, duhej furçë, bojë... sidomos bojë! Njollat zhduken me bojë... Një thes me telashe. Batleri s'donte ngatërresa në ato çaste.

U ngrit dhe doli. Iu afrua mekanikisht garazhit. Kërkoj çelësat në xhiep, po nuk i gjeti. Tundi kokën dhe shkoi në këmbë. Po ku shkonte? Iu kujtua «Klubi shkencor». Nuk kishte vajtur atje që nga shëtitja e fundit vjetore. Shtatë muaj plot! «Klubi shkencor» nuk ishte aspak një rreth kokësh të dëgjuara. Shumicën aty e përbënin tregëtarët dhe lojtarët e pokerit. Në fillim ai kishte pasur një rregullorë të rreptë, po më vonë kushtetuta e tij ndërroi si gjithë kushtetutat në botë dhe u hapi dyert të gjithëve. Kokët serioze të shkencës në Njuhark kujtoheshin për klubin kur u vinte ftesa e kaltër e shëtitjes vjetore. Atë

ditë ato ngjisnin me Batlerin, të huaj e timidë, mudohe-
shin të sillleshin si të tjerët. Megjithatë secili paguante një-
zet dollarë kuotë antarësie në vit dhe i paguante me dë-
shirë. Ishte një institucion që s'të mërziste «Klubi shken-
cor», as mbaheshin fjalime, as të kërkonin referate. Këto
klubi i siguronte nga larg. Njuharkezët dremisin kur zë e
flet një bashkëqytetar i tyre. Po ata do të ishin gati të
dëgjonin dy orë rresht portierin e hotelit «Lahora» të Kej-
ptaunit.

Batleri ecte i qetë. Kishte vënë duart prapa dhe so-
diste vitrinat me një vështrim të ftohtë. E përshëndetën
disa herë rrugës.

Cilët mund të ishin? Kush e njihte atë në Njuhark?
Ah, po, studentët!

Gjersa të kujtohej ai, ata ishin larguar.

Rrugët zunë të mbusheshin me njerëz. Ishte koha që
dilej shëtitje. Batleri mbeti përpara një vitrine duke pri-
tur të hapej udha.

— Hej, djall! — dëgjoi një zë dhe përnjëherësh ndjeu
që dikush e zuri nga krahu. Ai pa një marinar që herë vë-
shtronte vitrinën, herë atë vetë.

— Ngjisni si binjakë me atë atje, mister...

Ai i tregoi Batlerit një reklamë në vitrinë.

— Preferoni shpendët tona që janë mbajtur me me-
todat e profesorit Batler — lexoi reklamën marinari. —
Mos jeni ju ky profesori i famshëm që rrit gjela deti?

Marinari u afrua për një studim më të përpiktë të
fytyrës së Batlerit.

— Jo — i tha ai. — S'ka si bëhet. Ju mund të jeni
mundës, po jo shkencëtar — dhe ia dha gazit.

Tjetri e vështrroi vitrinën edhe një copë herë pasi iku
marinari, shtrëngoi dhëmbët me inat. Kush i lejonte të bë-
nin kështu? E shtyu derën e dyqanit plot me blerës dhe iu
afrua një shitësi.

— Dua të zotin e dyqanit — i tha.

— Mistër Stokardin? — Shitësi qeshi me të madhe.
— Atë mund ta takoni kudo me përjashtim të këtij lokali.
Ai s'vjen kurrë këtu, mistër.

— Jam profesori Batler, kam...

— Profesori Batler? Norman Batleri? Prisni një minutë.

Shitësi iku si vetëtima. Pas pak në dyqanin e madh buçiti altoparlanti: «Klientë të shquar! Kemi fatin të kemi tani në mes tonë të shkëlqyerin Norman Batler. Ai preferon vetëm prodhimet tona. Është ai misteri që i ngjet reklamës...»

Batleri ngriu. Ai vështroi një vend nga mund të ikte. Po andej nga hyri nuk mund të dilte. Në Njuhark nuk dellet andej nga hyhet. Batleri gabonte kur mendonte që vetëm artistët kanë popullaritet. Iu derdhën përsipër dhe e ngjeshën pas banakut. Donin të dinin për shpendët, për njeriun përbindsh, për mrekullitë që bënte. Ata e tërhiqnin drejt vetes, shitësi në anë të kundërt. Ai shpresonte se profesori mund të bënte një deklaratë pas banakut për prodhimet e dyqanit.

Batleri harroi fyerjen me ato portretet e tij nëpër vitrina dhe bëri çmos sa doli jashtë.

Kishte zënë të errej. Ai vazhdonte të bridhte kot. Në një farë vendi iu duk se pa Perkinsin e institutit të rrezatimeve.

— Hello, Perkins!

Ndoshta nuk ishte ai. Po edhe sikur të ishte, ç'mund të bisedonte me të? Perkinsi do t'i ankohej për të shoqen. Muzikë e parashikuar nga Batleri.

E harroi «Klubin shkencor» dhe hyri në një bar pa ditur as vetë se si. Kamerieri i tregoi një tryezë të lirë. Batleri pa se të gjithë ata që ishin brenda silleshin si në shtëpi të vet. Duhet të ishin myshterinj të përhershëm. Këndonte një vajzë në mes të hollit. Këndonte dhe lëvizte ngadalë duke u përpjekur ta shoqëronte këngën me plastikën e trupit. Epshe? Përbuzje? Klithmë dëshpërimi? Jo, lëvizjet e saj kishin diçka tjetër, shprehnin braktisje, lëshim...

«Kështu këndonin edhe para luftës, mendoj Batleri. Kur këndojnë kështu, prit shpërthimet...»

Ai nuk kishte parasysh asnjë shpërthim të veçantë, po shpërthimet në përgjithësi. Me një gjuhë tjetër ato mund të quheshin «pakënaqësitë njerëzore të kësaj bote».

Në banak po pinte një prift i kishës metodike. Batleri iu duk prift nga rendigota e zezë e mbërthyer te qafa. Ai qe dehur e herë pas here kthehej nga tryezat dhe lëshonte anatema.

— Ç'është njeriu? Krimb është. Dhe kthehej e kërkonte sërish uiski. Batleri as që e vrau mendjen të dinte në lejohej të pinte prifti në bar. Ai mbante vesh padashur ç'flisnin në tryezën pranë.

— Nesër hapet miniera.

— Mbaroi greva?

— Ç' thua! S'kanë ndër mend të dorëzohen. Kemi mbledhur grevëthyes. Ama t'i shihni! Kriminelë të vërtetë! S'u bën dot ballë njeri.

— Shtesa prej pesë centësh në orë s'i kushton gjë kompanisë.

— I kushton tjetra, të mësuarit e punëtorëve me kërkesa. Po t'ua plotësojmë sot, do të kërkojnë nesër më shumë!

— S'e paskeni në dorë sindikatën?

— Jo, e vetmja që s'bindet në Njuhark. Duhet rrëzuar ca kokë të kuqe.

Batleri u kthye andej. Ishin tre ata që bisedonin. Ai që rrëzonte kokët qe dy para njeri...

U kthye prapë në pozicionin e parë. Në mendjen e tij kalonin miniera, greva, sindikata, të kuqtë, kokët që bien poshtë. Kokët donte t'i rrëzonte ai plakushi sa një grusht. «Pse, tha me vete Batleri duke bërë një llogari të shpejtë me mend, pse do të rrëzosh kokë, o mik? Ti shumë, shumë pesë vjet jetë ke!»

Ata të tre ishin njerëz me rëndësi. Kamerieri u rrinte te koka. Kur erdhi pranë Batlerit, ky i fundit mbeti si dru.

— Koktej «Hardi»! — Porositi më në fund.

Koktej «Hardi» dëgjoi po atë çast që porositnin gjithandej.

Ai me rendigotë të zezë zuri njërin për krahu.

— Vëlla! Ç'është njeriu? — i tha duke ju mbështetur gati në gjoks.

— Ikë pyet atin e shenjtë. Ai e di — iu përgjegj tjetri, duke u shkëputur.

— Atëhere e di unë vetë — u kolovit ai. — Është një krimb. — Batleri u ngjeth.

— Po, po! Një krimb. Njeriu i vërtetë ishte ai që e pamë para pak kohësh në rrugën trembëdhjetë. Përbindshi. Atë e ka krijuar...

— Garrule, sana te ipsum! — u dëgjua një zë nga fundi i sallës.

«Llafazan, mbylle gojën!» e përktheu atë Batleri. Ai u mundua të shihte kush i hodhi ato fjalë, po nuk arriti. Në tryezën pranë shpërtheu një e qeshur e fortë. Qeshte plakushi.

— Intelektualët thatë? Ha, ha, ha! E kush i vë në hesap ata? Frikën duhet t'ua kemi punëtorëve. Intelektualët janë si pleshta. Kërcejnë njëmijë herë më shumë në krahasim me madhësinë e tyre, ama, për t'i shtypur, mjafton një thua. Intelektualët thatë? Ha, ha, ha!

Batleri desh të ngrihej, po i erdhi në çast koktej «Hardi» dhe qëndroi. E vuri gotën në buzë. Kishte një shije manatoke. E rrëkëlleu të gjithë. Në rini ai pinte vov dhe uiski. Më vonë nuk pinte asgjë fare, ose më mirë «ujë të bekuar nga kroi i pastër i shën Bernandit», siç tallej ai.

Batleri kërkoi një gotë të dytë. Këtë ia sollën menjëherë. E rrëkëlleu edhe atë.

Llambadari i madh në mes të hollit herë ndahej në mijëra kandela xixëlluese, herë mblidhej si një oktapodh i ndritshëm. Koktej i kishte rënë në kokë. U mundua ta mblidhte veten. Ia doli disi. Në këtë kohë këngëtarja po rrinte te banaku me gotë në dorë. Ajo ia kishte ngulur sytë Batlerit. E ia gotën dhe iu afrua pa ia hequr sytë. Duke u përpjekur ta mblidhte veten, Batleri e humbi edhe më keq kur ajo iu ul pranë.

— Ju jeni si unë, i dashur. — i pëshpëriti ajo dhe i zuri dorën.

Batleri u tkurr.

— Si unë, i dashur, si unë...

Ajo ia fërkoj dorën fort dhe i afroi fytyrën pranë. Një rreze e llambadarit i ndriçonte dhëmbët e bardhë. Sytë i mbante gjysmë të mbyllur. Joshës dhe melankolikë...

— A nuk arratisemi që këtu, i dashur?
— Po, po! — tha Batleri gati me ngazëllim.
Ajo i futi krahun dhe e ndihmoi të ngrihej.

— Helenë! — i thirri prifti nga banaku. — Ai do të të mbytë.

Ata të dy dolën jashtë. Njeriu me rendigotë i ndoqi duke u kolovitur.

Ai desh t'u kalonte përpara, por s'arriti. U mbajt pas murit për të mos rënë.

— Nuk ke maqinë, i dashur?

— Maqinë? Kam. Në vilë...

— Ah, të gjithë kështu thonë, — rrudhi fytyrën vajza — në vilë.

— Ku shkojmë? — pyeti Batleri.

— Tek unë, i dashur, në vilë.

— Ah, te ju...

Ajri i freskët sikur ia nxori të pirët. Ai ecte dhe vështronte me çudi atë që kishte në krah. Donte të largohej, po ajo e mbante fort dhe i buzëqeshte. Mund t'i largohej çfarëdo shtrëngimi, po jo asaj buzëqeshjeje. Ai kishte nevojë për të. «Ja që paska edhe buzëqeshje, edhe njerëz që të mbajnë për krahun, që të thonë fjalë të ëmbla...»

Po ngjysin një palë shkallë të errëta. Dy-tri herë Batleri shkeli mbi kuti konservash të hedhura. Ato u rrokullisën me rropamë nëpër shkallë dhe sikur e zgjuan.

— Ku shkojmë?

Ajo nuk u përgjegj, por e shtrëngoi edhe më fort pas vetes.

— Moj bijë... — pëshpëriti Batleri.

Kushedi ç'desh të thoshte.

Ai u gjet papandehur vetëm me të në një dhomë të varfër dhe të ndyrë. Kishte vetëm një shtrat dhe një do-llap të vjetër. Në mur ishte një pasqyrë e rrënuar, e mbushur me copa fotografish nga gazetatat. Në dysheme kishte bishta purosh, kuti konservash boshe dhe sakete najloni nga ato me supë gjysmë të gatshme.

Vajza kishte hequr fustanin dhe kishte mbetur vetëm

në këmishë. Nën rrezën e këmishës i dukej gjysma e gjive të dobët, gati si gji fëmije. Ajo u ul në shtrat dhe e tërhoqi pas vetes. Batleri ndjeu se e puthi fort. Edhe ai e puthi. Po pastaj papritmas u bë esëll dhe u ngrit në këmbë.

— Jo! — thirri. — Jo!

— A? Ashtu?

Vajza gogësiu.

Kështu ajo nuk dukej aspak e bukur.

— Jo — tha Batleri. — Kështu jo.

Ajo mbloodhi këmbët dhe e vështroi si e çakërdisur.

— S'bën — tha Batleri gati me tmerr dhe u mat të dilte.

— Mirë. Si të doni! Vetëm paguani. Unë humba kohën me ju.

— Mirë! — i tha ai.

Zuri të kërkonte nëpër xhepa. I ktheu mbarë dhe prapë. Asnjë cent për be. Ai s'mbante kurrë të holla me vete.

— Shtireni sikur s'keni? E dini që duhet të paguaj edhe ato që pitë në bar? Shtatë gota plot!

Batleri kishte pirë vetëm tre.

Ai u skuq.

— Ja që s'kam — tha. — Më thoni shumën dhe emrin tuaj dhe jua dërgoj nesër.

Vajza shpërtheu.

— Shiko bukuroshi, dashka të lajmëroj policinë! Nxirrni paratë. Plot dhjetë dollarë! Mos bëni naze. Ma humbët këtë natë. Ç'qenkeni ju? Oh, perëndi, çfarë guaku!

— Ja që s'kam, moj bijë...

— Bijë? Ha, ha, ha! Edhe për pak do plekseshim bashkë! Dëgjo, babush! Paratë!

Batleri ngriti supet. Kaq e singërtë qe kjo lëvizje, sa vajza u kthye pikërisht në çastin që do t'i vërsulej.

— Jeni pa punë?

— Ashtu, ashtu...

Batleri s'e zgjati. Po kjo ishte në fakt një pjesë e së vërtetës. Vajza nxori nga gjiri një gjysmë dollari.

— Merreni! Kaq kam edhe unë për nesër. Nesër ditë

e re, fat i ri. Merreni! Apo i bëki naze? Mos doni njëqind dollarë. Ha, ha, ha! O perëndi, ç'matuf!

Batleri i ktheu krahët. Gjer te dera ai nuk ia ndau sytë asaj dhome të mjerë. I përcëlloi në shpirt. Pa nëse e kishte orën me vete. E hoqi dhe u kthye.

— Hë, vendosët të merrni gjysmën e dollarit? Bravo! Mos e kundërshtoni kurrë atë që ju japin.

Batleri la orën mbi karrige.

Vajza brofi nga shtrati.

— Çfarë? orë floriri? Atëhere ndryshon puna. Ju qenkeni i pasur. Prandaj s'mbani të holla. Ju ecni me emër, me çeqe!

Ai i ktheu krahët rishtazi. Pas shpinës së tij ushtoi e qeshura e vajzës. Mbeti pa ditur ç'të bënte.

— Hiqni edhe xhaketën, edhe pantallonat, edhe të mbathurat! — ulëriti vajza. — Kështu ndihmohen të uriturit. Dëgjoni? Shpejt, shpejt, i poshtër, derr, impotent i mykur!

Batleri kapërceu prakun dhe u vërsul poshtë. Qe bërë esëll fare, po kokën e ndjente të turbullt dhe të rëndë, sikur të qe vërtitur me orë në karuselet e cirkut.

«Ç'qe gjithë kjo? pyeste veten ai në rrugë. Ç'qe gjithë kjo? Ky refren e ndoqi për shumë kohë.

* * *

Anabella po e priste jashtë. Ajo qe mbështetur pas kangjellave dhe kishte kryqëzuar duart në gjoks. Batleri e dinte që kështu e shprehte ajo shqetësimin.

— Oh, Norman!...

— Asgjë, Anabell.... Pse je frikësuar kështu? Nuk duhet të dal unë ndonjëherë? Mos më kanë fshirë nga kjo botë?

— Kështu pa lajmëruar... Ti nuk humb kështu....

Batleri i futi krahun.

— Sa para kemi në shtëpi? — pyeti ai papritmas.

— Dymijë e pesëqind, mbase tremijë dollarë — u përgjegj vajza e çuditur.

— Ashtu? Besoja të kishim më tepër...

— Po ja, kam blerë...

— Mirë, mirë! Nuk na dilkan për të vajtur diku. Në Fjordet mbase edhe në Holandë. Të kujtohet këtu e dhjetë vjet?

— E mbaj mend si sot. Në Leiden. E zonja e pensionit me skufje të bardhë... Prit, si e quanin?...

Anabella u drodh. Ndjeu një peshë në gjoks. Iu duk sikur ky qe fundi i Norman Batlerit. Nuk dihet pse desh që të mos ia gjente emrin së zonjës së pensionit.

— Zonja Falstaf! E shikon që e gjeta? Do të doja të shkoja edhe një herë atje, Anabell. Po ja që s'kemi para. Ato që kam vënë për ty në bankë s'dua t'i prek. Pandehja se jemi të pasur.

— I heqim nga banka, i dashur Norman.

Befas atij iu kujtua vajza e barit.

— Jemi të pasur, Anabell...

E mbesa e vështroi me çudi. U tremb për shëndetin e tij.

— Nuk je mirë, xhaxha?

— Jo, jam gjithë shëndet. Sidomos sonte. Dhe dua të punoj. Një jetë të tërë kam pa punuar... Oh, ç'më ka hipur të punoj, Anabell!

Ai hapi krahët dhe u shtriq si ai që ka bërë një gjumë të mirë dhe mezi pret t'i përvishet punës.

Po ky qe një gëzim i shkurtër. Në klinikë tani sundonte Rologu.

Prite kur t'i sillnin një Rolog tjetër për laboratorin.

Anabella u zgjat dhe e uthi në faqe. Batleri u drodh. Ashtu e kishte puthur edhe vajza e barit.

— Natën e mirë! — tha dhe u fut në laborator.

Po, me të hyrë aty, gjithë dëshira për punë iu shkri, iu lektis dhe ai zuri të sillej nëpër laborator, i lëshuar dhe pa pikë vullneti për punë. Dhe ç'mund të punonte në fund të fundit?

Refreni i udhës zuri t'i ushtonte përsëri në mendje dhe bashkë me të vajza e barit. «Ç'qe gjithë kjo?»

U ul në poltronë. «Në një ndër këto ditë duhet të vete të shoh Dorotin», mendoi. Doroti qe një e njohur e vje-

tër e tij. Po ai nuk e kuptoi pse i shkoi mendja te Doroti atë çast. Vajza e barit dhe Doroti? Mos ishte kjo lidhja e mendimeve? Sytë i shkuan te njolla në mur. Tani iu duk diçka më shumë se një njollë, qe diçka e ngritur, diçka në relief.

U ngrit dhe mori një tub qelqi. E kruajti njollën me të. Diçka u shemb poshtë, si një copë suvaje e trashë dhe e zezë.

Batleri lëshoi një britmë të lehtë. Një kërmill!

O perëndi, një kërmill! Shiko si tulitet dhe struk veshët. Një kërmill që mblidhet në vetëvete... Që tërhiqet zvarrë... Që s'ka fuqi të kundërshtojë për asgjë... Një kërmill... «Norman, ç'ke bërë tjetër ti?» E mbuluan djersë të ftohta. Për një çast harroi çfarë i kishte dhënë shkencës dhe njerëzimit dhe e pllakosi dëshpërimi. Për të parën herë e ndau Batlerin shkencëtar nga Batleri njeri. Lëviz? Jo, tërhiqet zvarrë... Batleri kishte pasur raste që s'qe zvarritur. Në rini, në luftë, në rastin e Xheni Paterit. Tjetër herë kishte punuar kokulur. Jashtë bëhej luftë. Ai s'kish-te pyetur ç'bëhej jashtë, s'kishte dashur të dinte...

Vështroi kërmillin. Ai nuk donte andralla dhe telashe. Kishte ulur veshët. Gati kështu i kishte dëgjuar Batleri Veberin dhe Xhon Stivensin. Me veshë të ulur. Nuk kish-te pranuar. Po a mjafton? Nuk mjafton të mos e pranosh të keqen. Duhet të ngrihesh kundër saj.

Ndjeu neveri. Ai që kishte hapur kaq plagë, kaq ka-davra...

INTERLUD

Ajo fotografi tronditi qytetin. E botuan gjithë gazetatat. Një plazh i shkretë, çajkat që kërkonin ujërat. Në sfond hotelet bosh dhe rëra... Në rërë një gjurmë... Një gjurmë njeriu në rërë, si e ngrirë, si fosile... Kthehej dhe vazhdonte në det. Sikur qëndronte edhe mbi ujë. Kështu gjatë gjithë bregut, e stërmadhe, e Ulltarshme, e valëzuar nga era si nga ndonjë goditje sizmike...

KAPITULLI VI

Bill Redi kishte zënë vend në një qoshe dhe priste t'i shërbenin. Thithte llullën dhe vështronte përreth pa interes. E mbante veten mirë pas gjithë asaj që ndodhi. Po atë mëngjez kishin shkatërruar gazetën. Dhe ai qe i pari që pa dyert e shqyera, xhamat e karriget e copëtuara. Çdo gjë që mund të thyhej dhe të përplasej e kishin thyer dhe përplasur.

«The star of Newhark» kishte marrë udhët dhe trotuaret. Njëzetmijë kopje do të shpërndareshin atë mëngjez. Tani s'kishin nevojë për shpërndarës. Ata që donin mund ta merrnin nga udha. Të tjerët shkelnin mbi to.

Billi qe ulur në prak të derës dhe kishte ndezur llullën. Nuk çuditej për asgjë. Qe mësuar me skena të tilla. Madje gjatë kishte shkruar kjo punë. Herë të tjera i turreshin gazetës që në javën e parë të lindjes.

Tingëlloi zilja e telefonit. Zëri erdhi përmes receptorit që varej si një krah të vdekuri mbi shpinën e një karrigeje të përmbysur. Çudi, punonte ende....

— Alo! Bill Redi? Ju flet Kllajfi. Po... dora vetë. Ju kam siguruar pesëdhjetë abonime të reja. Gazeta po bëhet interesante. Punëtorët po e kërkojnë. Rriteni atë djall tirazhi! Më dëgjoni? Mirë! Rriteni tirazhin, thashë. Do t'ju sjell një shkrim. Të fortë... Gëzohem që më nxisni. Do t'ju sjell këto ditë.

Bill Redit s'i kishte bërë zemra të thoshte që e kishin shkatërruar gazetën.

Kishte vazhduar të thithte llullën aty në prak të derës. Kështu ndodhte gjithmonë. Në fillim i suleshin gazetës, pastaj partisë! Kishte pritur gjatë aty në prak, se mos vinte Albanoja apo shokët e tjerë. As që i kishte vajtur ndër mend t'i merrte në telefon. Në vend të tyre kishin ardhur shpërndarësit e gazetave. Vetëm kur ikën ata kokulur, kishte ndjerë një sëmbim të fortë në zemër. Kishte ndjerë edhe si një erë baruti. Muret ishin të nxira, orenditë po ashtu. Një minë me sahat! Dhe duhet të kishte qenë mjaft e fuqishme. Kishte hedhur jashtë edhe kanatet e dritareve. Shkatërrimin e prisnin, po jo nga minat. Vetëm gazetatat nuk i shkatërronin me mina, po me duar. Gazeta duhet shkatërruar me triumf. Kush i kishte tërbuar kaq shumë sa të hiqnin dorë edhe nga triumfi? Bill Redi kishte vazhduar të thithte llullën. Ai e dinte mirë nga se ishin tërbuar. «Thundra punon nën dhe!» Shkrimi i fundit i gazetës. Aluzion për gjigantët...

Billi qe ngritur. Nuk i pëlqente t'u jepte sqarime poliçeve. Ata duhet të kishin ardhur me kohë. Kur grabitej ndonjë vilë, ndodheshin në vendin e krimit për gjashtëdhjetë sekonda.

Iu kujtua që Albanon mund ta takonte te «Pirati». «Ose në gazetë, ose te «Pirati», i kishte thënë Albanoja».

Lokali ziente. «Pirati» ishte bari më zhurmëmadh në Njuhark. Kishte më shumë se treçerek shekulli që jetonte për bukuri në mes të rrëmujës dhe të pështjellimit të portit. Megjithatë ai nuk ishte një pijetore vetëm e marinarë-

ve. Ishte diçka më shumë. Lokalet e mëdha të Njuharkut luftonin njëri-tjetrin duke rendur fort pas së resë, ndërsa «Pirati» i konkuronte duke u mbajtur fort pas së vjetrës. Voza në vend të tryezave prej nikeli, kriklla bronci në vend të kristalit, shandane në vend të llambadarëve të mëdhenj. Në banak as ekspres, as orendi të shkëlqyera. Sundonte bakri dhe bronci. Thoshin se ai u jep një shije të athët pijeve, megjithatë e pinin me qejf. Shija e athët pëlqehet në Njuhark, kur atë e shërben vetëm një lokal.

Sa hyje në lokal, të binte në sy kuadri i madh dhe i vjetëruar i vaporet «Admiral Shelton». Vaporit kishte dyzet e ca vjet që ishte mbytur në fjordet norvegjeze. Në kuadër oxhaku i tij i madh nxirrte aq shumë tym, sa të mendoje se do t'i pëlçisnin kaldajat. Kuadri që i ndyrë, megjithatë asnjëri nuk e vinte në dyshim se që siguruar për tridhjetëmijë dollarë, ndonëse s'kishte as firmën e piktorit. Vaporit çante në një det që që një përzierje tymi, njollash rumi dhe të spërkaturash vere. I ngjante pak a shumë avullores së Fultonit dhe kishte shpëtuar kot nga muzetë. Në këq vetëm një njeri, një oficer marine me dylbinë e gjatë të shtrirë përpara. Përmes saj oficeri nuk shihte as flotën spanjolle, as fregata angleze. Ai sikur përpiqej vetëm të mos humbte nga sytë Tom Herderin, që rrinte pas banakut. I ati ia kishte lënë lokalin me testament. Po të përpiqej t'ia ndërronte faqen, e humbte të drejtën e pronës. Këtë konditë i kishte vënë i ati. Dhe dylbia e «Admiral Sheltonit» sikur gjurmonte Tom Herderin.

I ati kishte qenë profet. E kishte parashikuar që njuharkezët do t'i velte shkëlqimi i salloneve luksoze dhe do të kërkonin diçka jashtë modës. Duke qenë jashtë modës, «Pirati» e bënte modën vetë.

Billi po mërzitej. Ende nuk po i shërbenin. Në të djathtë bënte shumë zhurmë një skuadër basketbolli. Me fjalë gjer atëhere skuadra kishte mundur me tre shifra «Tigrat e verdhë», «Jaguarin e kaltër», «Gjatoshët e Oklendit» dhe plot ekipe të tjera që njiheshin si më të fortit në Njuhark. Herë pas here ndonjëri prej tyre psherëtinte dhe i binte tryezës me grusht: «Oh, sikur ta kishim edhe

Polin!» «Kush është ky Poli? Ç'më duhet mua Poli? Kam hallin e gazetës dhe plot halle të tjera...»

Më në fund ia sollën koktejin. Tek shkundte llullën, i ranë miqësisht në sup. Mendoj për basketbollistët, por, kur pa dy të tjerë përpara, nuk tregoi asnjë shenjë kënaqësie.

— Hello, Bill!

Nuk ua ktheu përshëndetjen, madje i vështroi shtrembër.

— Karriget janë të zëna — u tha. — Pres dikë.

— Ngrihemi kur të vijmë.

— Atëhere po ngrihem unë — tha Billi.

— Jo, qëndro. Ti më pëlqen.

Njëri nga ata të dy e zuri për krahu.

Bill Redi e pa me të keq. Ai që kishte përpara qe i dehur.

Qëndroi. U druhej skandalit dhe gazetave. Gazetat do ta përshkruanin si një grindje në mes të të kuqve.

Njëri nga ata të dy mbante në buzë një puro të keqe nga ato që bëjnë dhjetë cent dyzinën, tjetri një llullë të madhe të zbukuruar me një kokë të vdekuri. I pari qe Bill Morrisoni, i dyti Bill Nostringu. Bashkë me atë që gjetën në tryezë ata bëheshin tre Billër.

— E dimë! Nuk je i kënaqur që na takove!

Tjetri ngrii supet.

— Për besë ka çiltërsinë e Franklinit! — vazhdoi Bill Nostringu. — Megjithatë ne po e pimë nga një koktej këtu. E di që edhe mua m'u ngjitën prapa? Kështu është kjo botë... Dikujt do t'i ngjitesh... — E kishte fjalën për Morrisonin. Një kohë atë e quanin edhe «Billi numër tre».

— Ne jse, ta harrojmë këtë. Le të flasim për zjarret në Çimahua, zotërinj!

Çimahua ishte një lagje e pasur në Njuhark.

— Negrot? — pyeti Billi numër tre.

Bill Nostringu qeshi. Nga llulla u shkund duhani i ndezur dhe ra mbi kapakun e vozës që u shërbente si tryezë.

— Kjo duhet të ishte një vozë baruti — tha ai i vrejtur.

— Negrot? — pyeti sërish Morrisoni që kishte ndër mend Çimahun.

— Anarkia! — s'iu durua pa folur Bill Redit.

— Anarkia nëna e rregullit! — u hodh i kënaqur Nostringu.

— Muzikë e vjetër dhe e mërzitshme — ia pat Bill Redi. Tjetri i ra me pëllëmbë kapakut të vozës dhe u drodh. Nuk ishte vetëm një tik nervoz ky i tij, po një zinxhir tikesh. Kur i nisnin ato, Nostringu i ngjante një roboti. E kishte trashëguar nga industria këtë, nga puna në konvejer, në fabrikat e maqinave qepëse. Kishte pesë vjet që nuk punonte më, po pesë vjet nuk hahen dot me njëzet e pesë. . .

— Tom, tre «Simon»!

Ky koktej qe në modë te «Pirati». Një përzierje rumi, vere dhe kushedi çfarë gjëje tjetër që ngatërronte Tom Herderi pas banakut.

— Flakët vunë rregull andej, zotërinj. Kur erdhën pompistët, qenë bërë shkrumb dymbëdhjetë vila çifutësh dhe gjysmë duzine supermerkatosh. Kështu zotërinj!

Nisi reaksioni zinxhir i tikeve. Koktej iu derdh në mjekër.

— Po, dymbëdhjetë vila çifutësh, zotërinj.

Ai nuk kishte ndonjë mëri për çifutët e vërtetë. Po me këtë emër, i kishte pagëzuar manjatët e Njuharkut.

— Ç'thua, Morrison?

— Zjarri sjell zjarrin, mik. Ti i di mendimet e mia...

— Bill Redit?

Ai e kishte kyçur gojën. Priste Albanon. Shyqyr që ata të dy s'kishin marrë gjë vesh për shkatërrimin e gazetës. Po t'i thoshin që minën e vendosi Nostringu, nuk do të çuditej aspak. Qe nga ata tipat e dobët, po kockë mëdhenj të veriut. Shpinën e mbante disi të përkulur dhe kolle shpesh. Shpina e përkulur dhe kolla tregonin që kishte punuar në miniera dhe mbase kishte marrë silikozën. Ata që nuk marrin sëmundje profesionale në Njuhark, vdesin nga dhjami...

— Na plase me këtë kollën tënde — tha Nostringu.

— Po t'i kishe hedhur në erë minierat, nuk do të kolleshe kështu...

— Ah, sikur ta kishim Polin në këtë ndeshje! — zënë rishtas prapa shpinës basketbollistët.

— S'kemi pse ta zgjatim, Nostring. — Ne nuk merremi vesh kurrë. As me ty, as me këtë «fratin e urtë»...

«Fрати» ishte Bill Morrisoni.

— Lëre «Fratin»! Ne të dy jemi fare pranë. Si anarkia, si revolucioni, me dhunë punojnë. «Fрати» le të lutet... Pacifisti i shkretë! Tom, tre «Simon» të tjerë — tha Nostringu duke u kthyer nga banaku.

— Të kam dëgjuar kaq herë dhe po aq të jam përgjegjur. Anarkia mbështetet në dhunën pa qëllim, kurse ne na prin ideologjia e klasës.

Tjetri tundi kokën. E shkundi prapë llullën pas vozës.

— Kjo duhet të ishte fuçi baruti — tha. — Edhe globi i tillë është, fuçi baruti. Vetëm se do fitil...

— Mjaft! — ndërhyri Morrisoni. — Njerëzit kanë lindur të merren vesh.

— Ky Tomi do vrrarë! — tha tjetri duke parë nga banaku. — Edhe ju po ashtu...

— Mjaft! Je dehur. Ne mund të merremi vesh. Profshin marrëveshjet! Le t'i bëjmë lëshime njëri-tjetrit. S'kemi ndryshim. Tre Billër...

— Vetëm emrat kemi njësoj — tha me zë të fortë Bill Redi. — Asgjë tjetër!

Morrisoni bëri sikur nuk dëgjoji. Nostringun e kishte zënë plotësisht pija.

— Të parat do t'i hedh në erë maqinat qepëse — gulçoi duke pasur ndër mend fabrikat e tyre.

Tom Herderi e solli koktejin në gota të vogla bronci. Ato kishin të gdhendur në reliev nga një top mesjete.

— Këto më venë pas qejfit mua — tha Bill Nostringu duke vështruar topat. — Prandaj vij këtu.

— Atëhere?.. Do të bëjmë paqe?

— Për anarkinë! — thirri Nostringu.

— Për revolucionin! — ia pat Bill Redi.

Ata ngritën krikllat pa i takuar.

Në bar hynë skulptori Martin Parker dhe piktori Sa-

muel. I pari u mbështet pas banakut të drunjtë, ndërsa piktori zuri të vështronte rreth e rrotull. Atij i mbetën sytë te Bill Nostringu. Iu afrua me hap të madh dhe i propozoi të pozonte për dy dollarë seancën.

— Në djall të vesh! — iu përgjegj tjetri ashpër.

Skulptori hapi krahët.

— Jo skulpturë... Një tablo, një kompozim pesëdhjetë këmbësh. Do ta emërtoja «Shndërrimi». Ja, parafytyroni kokën tuaj mistike mes avujsh, gjithshka sikur ngjitet lart, avullohet. Gjithshka, toka, qielli, koka juaj. Një hapësirë pa përmasa, ku proporcionet humbasin. Lufta mes lëndës dhe idesë absolute. Ju mund ta bëni këtë. Çfarë portreti, o perëndi! Çfarë portreti!

— Në djall të vesh! — klithi për të dytën herë Nostringu.

— Atëhere pesë dollarë! Për Polluksin kaq merrte Xhoni...

Nostringu nxori një pako me bankënota dhe ia vuri nën hundë.

— Aha! Paskam të bëj me patricë!... Aq më mirë! Plebejtë i paguan për të pozuar, patricët pozojnë dhe të pagujnë!

— Në djall të vesh! — i përsëriti me tërë zërin Nostringu, saqë u ngriu gjakun disave përreth.

Piktori Samuel i afrua Nils O'Konorit.

— O perëndi, ç'portret! — psherëtiu piktori dhe i bëri shenjë Tom Herderit të afrohej.

Ata të tre vazhdonin të pinin.

— Bill! — tha Morrisoni. — Më tmerrove me ata dollarë...

— Dje kishin tjetër zot...

— S'ke frikë se të kallëzojnë, Bill?

— S'besoj të ketë të marrë që duan të zgjohen ndonjë mëngjez pa kokë.

— Ti je kapoja i anarkisë në Njuhark, prandaj humb kohë me ty — vazhdoi Billi numër tre. — Po të merreshim vesh bashkë, mund të rregullonim shumë gjëra.

Bill Redi nuk fliste. Si s'po vinte ky Albanoja? Sikur

të ngrihej? Kapoja i anarkisë nuk ia ndante sytë Martin Parkerit që po bisedonte me të zotin e «Piratin».

— Ata të dy seç kurdisin — tha ai.

— Ti po bën lodrën e Thundrës, Bill — nuk iu durua pa folur Bill Redit. — Thundra po përgatitet për një ofensivë të përgjithshme. Ti po ia jep shkakun me të dyja duart. Po të mos ishte kështu gjer tani, do të të rripnin, Bill.

— Ata të dy atje me Tom Herderin...

— Dëgjo, Bill, të thashë që ti po bën lodrën e Thundrës...

Njeriu ka një shpirt fëmije nën krifën e luanit. Ne duhet t'ia heqim atë për hir të dashurisë njerëzore.

— Pusho ti, Morrison! Pacifistët do t'i gllabërojnë të parët thundra.

Bill Redi pushoi. Humb frymën kot së koti.

Ata të dy u ngritën dhe u erdhën pranë.

— Oho! — tha piktori Samuel. — Fishekzarret në Cihnahuo... Komplimenta, mister Nostring. Tani do t'i vija tjetër emër kompozimit tuaj. Do ta quaja «Neroni». Ju pëlqen? Për fishekzarët...

— Ejani, Samuel — tha Parkeri i mërëzitur.

— Ato që pëshpëriten për mua janë gënjeshtër — foli i vrenjtur Nostringu.

— Anarkia s'prish punë — tha skulptori duke u larguar.

Erdhi i zoti i barit dhe vuri tre krikla të tjera mbi fuçi.

— Nga ata që ikën — tha ai.

— Koktej «Simon» për gjithë djajtë! — tha Morrisoni dhe ngriti gotën. Edhe Nostringu po ashtu. Billi tjetër e shtyu tutje.

— Ata të dy seç kishin — tha Bill Nostringu.

— Piktori donte që ta shisja «Piratin», vinte nga senatori Stivens.

— Po qe kështu, quaje të humbur «Piratin», o mik. E njoh mirë Xho Stivensin unë. Kam punuar me të — tha Bill Nostringu.

— Më mirë i vë flakën se ta shes...

— Okej! Kështu më pëlqen, Tom...

Bill Redit po i vinte plasja. U mat të ngrihej, po i erdhi diçka në mendje dhe qëndroi.

— Ke dëgjuar për ishullin e Kanarinave, Bill? Di gjë se ç'bëhet andej? — pyeti ai me shpresë se mos i nxirrte gjë anarkistit.

— Nuk e di. Nuk merrem me zogj të butë, unë. Më pëlqejnë skifterët...

Billi numër tre nuk ia hiqte sytë krikllës së paprekur të Bill Redit.

— Vendosmëria jote për të mos pirë një krikël nga armiku më duket qesharake — tha. — Po a i përket Thundrës piktori Samuel? Lere pastaj atë Martin Parkerin që s'ka një dysh në xhep.

Morrisoni ia dhë gazit me të madhe.

— I shkreti ti! Asgjë nuk kupton, ose s'do të kuptosh. Në atë fraksionin tënd nuk do të të jepja asnjë votë dhe jo të të bëja kryetar. Do të ta them? U kënaqa kur u shkëpute nga ne. Filistin gjer në nyje të këmbëve! Më bën të vjell. Kështu vazhdo, mblidhi naivët dhe zemërlepajt ku të jenë dhe ku të mos jenë. Na i hiq prej këmbësh! Rrite sa të mundësh «Ushtrinë e shpëtimit», kujdesu për shpirtin, bëji lavazhe... Për trupin të kujdesen të tjerët ta mbajnë në majmëri. Sa merr nga Erih Mihelsoni? Folë, sa merr përveç bekimeve? Po do t'i qërojmë hesapet me ju. Nostringun e gjykuam një herë... Na shkau nga duart. Po tani është fundi...

Bill Redi qe nxehur keq. Në ndonjë vend tjetër ai do t'u kishte kërcyer në fyt të dyve. I kishte ardhur shpirti në majë të hundës nga ata.

— Mënduat se na fshiu Thundra? — vazhdoi ai. — Kështu menduat para ca vitesh. Po ja që doli ndryshe. Por, edhe po na fshiu ne, do të dalin të tjerë. Ata do t'i ndreqin llogaritë edhe me ju.

— Mirë Nostringu, po ne ç'dëm ju sjellim? Sa më shumë opinione, aq më shumë demokraci...

— Aq më shumë jetë për Thundrën — psherëtiu Bill Redi.

Nostringu kishte mbështetur kokën pas vozës.

Bill Redi heshti. Një djalë dhe një vajzë qëndronin

përpara tyre. Këmbëzbathur dhe të veshur keq. Nën bluzën e grisur, vajzës i dukej një gji i dobët dhe i mavijosur. Koka e djalit qe një përzierje flokësh, mustaqesh dhe mjekre të zezë. Me gjithë varfërinë ata ishin jashtëzakonisht të ftohtë dhe përbuzës.

Djali rrëmbeu gotën që kishte lënë Bill Redi dhe e piu gjer në gjysmë pa ia ndarë sytë vajzës. Pjesën që mbeti ia zgjati asaj.

— Kush jeni ju? — pyeti Bill Redi i tronditur.

— Askush!

— C'bëni këtu?

— Nuk e dimë! — u përgjegj djaloshi duke ngritur supet. — Ndoshta mund të na e thoni ju — vazhdoi ai.

— Tom, or djall! Edhe pesë koktej — thirri Nostringu i entuziazmuar nga ata të dy. Ata të dy binin erë anarki.

Nuk i prekën gotat.

— Pimë vetëm atë që marrim vetë — shpjegoi djaloshi. — Atë që na e japin e përbuzim.

Nostringu klithi nga kënaqësia. Ndërkaq zbatharaku e puthi fort vajzën.

— Mund ta puthni edhe ju — tha ai. — Dashuria është për të gjithë...

Vajza u duk krejt e gatshme. Ajo madje u kthye nga Bill Nostringu. Po ky s'dihet përse nuk ia vari. Atëhere ajo pa nga basketbollistët. Ata heshtnin. Vështronin gati me frikë.

— Këtu ka natyrë — tha vajza. — Ndjehesh si në mes të pyllit...

— Mungojnë vetëm egërsirat — vazhdoi djali. Gjithë këto (me dorë përfshiu barin) gjithë këto qenkan kafshë të buta. Megjithatë mirë, për sot jetuam mjaft...

— Ju jeni anarkistët më të pastër që kam njohur — tha Bill Nostringu.

— Ju jeni të sëmuret e Thundrës! Ja ç'jeni ju! — kërcëu Bill Redi.

— Ku do ta shkoni natën sonte? — i pyeti Morrisoni.

— Nata dhe dita janë njëlloj. Ka vetëm një çast. Po e

kape atë, je i lumtur... Çfarëdo çasti, mjafton që të mos jetë diçka e rëndomtë...

— Qeveria do t'ju zbojë nga parqet. Po shumëzohen si çimkat — tha Morrisoni. — As në stola nuk gjen vend nga ju.

S'dihet përse nuk i pëlqenin atë të dy.

Billi Redit i qe lidhur diçka si lëmsh në fyt nga mallëngjimi.

— Ju jeni të sëmurë — u tha. — Të sëmurë!

— E sëmurë është shoqëria — ndërhyri vajza. Ajo foli aq pa interes, aq e lëshuar shpirtërisht, sa e ngriu Bill Redit.

— Shërojeni atëhere! — bërtiti ai duke marrë zjarr përnjëherësh. — Përndryshe ajo do t'ju vdesë. Thundra nxjerr përditë nga një armë të re kundër nesh, kundër jush. Ja ç'po pregatit tani...

Nxori një gazetë nga xhepi dhe ua vuri nën hundë.

— Plazhi perëndimor i Njuharkut, gjurma e përbindshme në rërë...

Djaloshi ia dha gazit.

— Këtë e bëra unë — tha — në gjithë plazhin. Me një dërrasë të gdhendur. E hëngrët edhe ju? Monstri! Njeriu përbindsh! Njeriu i Marsit! Unë vetë e bëra! Desha t'i nxjerr ca punë një farë tim ati...

— Kush është yt atë? Kush je ti? — pyeti me një frymë Bill Redit.

— Freak 1)! — thirri djali dhe e tërhoqi shoqen.

Dolën të dy nga bari.

— I biri i Xhon Stivensit, senatorit! — thanë basketbollistët. — Na ruajtë zoti!

— Si? — pyeti i habitur Bill Redit.

— Dora vetë! S'ka shumë që ka rënë kështu...

Nostringu u ngrit. Mbi fuçi qëndronte gazeta e hapur, gjurma në plazhin e perëndimit.

— Ja arma e re e Thundrës — tha me tallje Bill Nostringu. — Përbindshi na qenka tallja e zbatarakëve! M'i lumtë!

1) Tallja e natyrës.

U largua me përbuzje të hapur nga të tjerët.

U ngrit dhe Morrisoni, pasi i hodhi një vështrim shfaqësues atij që mbeti aty. Vrapoi të arrinte Nostringun.

Me gjithë pështjellimin që kishte në kokë, Bill Redi nuk arriti të sprapste një mendim: «Si thoshte partia? Kur vjen çasti për të vendosur, të moderuarit anojnë nga e djathta ekstreme!»

Pse ta sprapste? Kjo ishte e vërtetë!

— U gëzua që ikën ata të dy. Si nuk po vinte ky Albanoja? Në gazetë tani do të luanin fëmijët. Ndoshta edhe policët. Do të kërkonin një dëshmi me shkrim dhe do të gajaseshin së qeshuri me të nëpër zyra. Ky Albanoja... Albanoja dhe partia. Greva e afërt... Dhjetë cent në orë më shumë ishin pak. Po kështu edhe kushtet më të mira për punë në doket. Po duhej luftuar për aq sa mund të fitoje. Ndryshe mund të diskreditoje partinë e posaformuar. Radhën tjetër sindikatat i lanë në baltë. Në vend të grevës një pjesë e dokerëve zunë të mbanin mbi shpinë arkat me uiski. Atë ditë u hapën shumë arka. Kjo ishte meritë e sindikatave.

Nuk do ta harronte kurrë atë ditë. Thundra kishte korrur një fitore të madhe.

Bill Redin e zuri kolla. Kolla e tij ushtoi si zëri në një shpellë bosh.

Albanoja po vonohej. Basketbollistët nuk po e hiqnin nga goja Polin e tyre gjigant.

Billit i lindi një ide e vagëlluar. U kthye nga ata me gotën në dorë.

— Rrofshin basketbollistët! — tha.

— Rrofshin!

— Rroftë edhe Poli gjigant!

Heshtën. Heshtja e tyre ishte si një tabu.

— E njihni Polin? — pyeti njëri.

— Jo, po dëgjova që e përmendnit shpesh.

— Atë e rrëmbyen.

— Pse?

Ngritje supesh.

— Pse e quanit gjigant?

— Ishte më i larti. Dilte dy kokë mbi ne.

— Dora i arrinte mbi dërrasën e tabelës...

— Bënte kosha pa kërcim...

— I merrte shportat me sende nga kati i parë i apartamentit...

— E teprove, Llouston!

Ata ngrinin kokën me radhë nga fuçia ku i kishin mbështetur dhe lëshonin nga një fjalë. Pastaj përkuleshin prapë dhe mbështetnin kokët mbi fuçi. Ashtu i ngjanin një lule ortense të madhe dhe të çrregullt.

— Kush e rrëmbeu? — bëri një përçapje të fundit Bill Redi.

— Perënditë! — iu përgjegj një zë i dehur nga ortensa e madhe dhe e çrregullt. — Zeusi dhe Posejdoni....

Albanoja erdhi kur Billit po i mbaronte durimi. U mundua t'ia lexonte përfundimin në fytyrë. Do bëhej greva?

— Jo vetëm greva, po edhe një demonstratë e madhe — tha Albanoja duke u ulur. Megjithatë ai nuk po tregoj hej aspak i kënaqur.

«Seç ka. Nuk duhet ta lajmëroj një herë për gazetën. Më vonë... tha Billi. Ky nuk ditka gjë për gazetën. Si duhet t'ia them? Gjithë jetën lajme të hidhura kemi mbaritur... A është e mundur të mos ketë vajtur në gazetë? Sot kishte radhën e shpërndarjes...» mendonte Albanoja.

— A pat kundërshtime për grevën?

— E zakonshmja, Bill. Grevën do ta bëjmë pa sindikatën. Kjo është më e rëndësishme. Pra sivjet dokerët do ta fillojnë të parët. Ama duhet të ruhemi nga provokatorët... Në sindikatë zotërojnë renegatët.

Albanoja pa gjithë ato gota bosh mbi fuçi dhe i hodhi një vështrim gjithë shqetësim Billit.

— Nostringu dhe Bill Morrisoni m'u ulën pothuaj me zor këtu, Albano. Janë po ata që ishin, ndoshta edhe më të dëmshëm.

— Kuptohet — tha Albanoja.

Billi i tregoi shakanë e zbattharakut. I tha edhe fjalët e tij.

— Babai i tij ishte Xhon Stivensi. Apo jo? Dhe atij desh t'ia bënte atë rreng? Këtu ka diçka, Bill? Pse t'ia

bënte pikërisht këtë gjë? A nuk sheh ndonjë lidhje mes Stivensit dhe njeriut gjigant?

— Për besë ti arësyeton bukur, Albano!

U ngritën. Billi u kthye nga basketbollistët. Lule ortensa tani qe prishur.

— Salut! — u tha.

— Salut, padron!

«Padron!» mërmëriti Billi me vete dhe i shkuan mornica nëpër trup».

— Të marrim tramin, Bill. Ndryshe do të vonohemi. Mbledhja është në nëntë e gjysmë.

— Arrijmë — tha Billi i menduar.

— Ç'ke kështu, Bill?

— Kanë shkatërruar gazetën, Albano — s'iu durua Billit.

— E di, Bill!

— Ah, e ditke!

Nëpër udhë vërshonin njerëzit si mizat. Qeshnin, flisnin me zë të lartë dhe dukeshin të lumtur. Në këto çaste mund të nxirreshin fotografi shumë optimiste për këtë udhë të Njuharkut si për një Eldorado ¹⁾ të dytë.

— Këta nuk kanë halle, — psherëtiu Billi — janë ajka e mikroborgjezisë. A e dinë këta që në botë ka uri dhe mjerim?

— Marrëzira, Bill! Edhe ti vetë e di që po flet marrëzira. Ata nuk janë të gjithë ashtu si thua ti. Shumë prej tyre s'kanë as dhjetë cent në xhep. Apo i shikon nga rrobat dhe fytyra? Rrobat i marrin me kredi. Pastaj s'është ndonjë gjë e madhe të kesh një palë rroba të mira. Dhe sa për fytyrat... Njuharkezët i bëjnë ballë mjerimit me optimizëm. Mos më kundërshto! E di ç'do të thuash. Gjithë këtë optimizëm duhet ta harxhonin jo për ta përballuar, por për ta luftuar mjerimin. Kjo është faqja jonë e gënjeshtërt. Për të huajtë ne jemi vendi më i begatshëm në botë. Mbase dhe jemi... Kur dëgjon që ka edhe më keq...

— Si do t'ia bëjmë tani pa gazetë, Albano?

1) Sinonim i qytetit ideal

— Si kemi bërë herë të tjera. Do ta ngrejmë prapë. Po nuk na lanë, do ta nxjerrim fshehtas.

Qëndruan në një stacion dhe hipën në një tram.

Zuri të binte një shi i imët. Ai kishte erën e smokut dhe të blözës. Nëpër qiell ngatërroheshin vetëtimat si këmbët e një polipi.

KAPITULLI VII

Maksi frenoi. Nga vetura dolën pothuaj përnjëherësh Xhon Stivensi dhe peshkopi Erih. Senatori që veshur si për udhë të largët, me peliçe aviatorësh me gëzof dhe çizme të gjata. Çizmet e tregonin edhe më të ngjallur se ç'ishte. Ai rrihte çizmet me një kamzhik dhe vështronte oqeanin. Në perëndim mezi dukej plazhi i Njuharkut.

— Kot nuk erdhëm nga udha e plazhit — tha Maksi.

— Mbase do të kenë bërë të tjera gjurma.

Senatori rrihte çizmet pa pushim me kamxhikun me kokë gjarpëri. Nuk ua ndante sytë ujërave. Më shumë se dymijë vjet përpara një tjetër sundues po kështu vërtiste kamxhikun me kokë gjarpëri. Po ai godiste ujërat ¹⁾...

Edhe senatori do t'u binte ujërave, si një njeri që s'duron pengesë përpara, që s'duron të presë. Po të mos ishte oqeani, maqina do të çante pa ndalim. Tjetër zemërim s'kishte Xhon Stivensi kur rrihte çizmet me kamxhik.

Maksi shtoi edhe diçka tjetër rreth gjurmëve në plazh.

— Ata që i kanë bërë janë nga soji i tim biri. Një gjë të tillë e dëgjua rastësisht njerëzit e mi te «Pirati».

— Më fal, Xhon, po nuk të shqetëson ai djalë?

— Jo, Erih, nuk më shqetëson. Le ta provojë edhe këtë jetë. Ne e kemi nisur edhe më keq.

1) Aluzion për mbretin Kserks.

Senatori ngriti grushtin ku shtrëngonte kokën e gjarpërit.

— Ralfi nuk e nisi kështu jetën, Xhon. Ai arriti këtu pasi provoi një kohë të gjatë të jetonte si gjithë të tjerët. Ka një ndryshim në këtë mes. Nesër ai mund të lërë në një anë atë frymë të fshehtë shenjtërie që e mbështjell sot dhe të hidhet kundër nesh, kundër teje...

— Jo, Erih, nuk do të ngjasë ajo. Unë i besoj trashëgimisë. Do të ta them më shkoqur? Ai sillet kështu pikërisht se nuk mund të ngrihet kundër nesh, kundër meje. Kjo botë nuk i pëlqen dhe... Po mos mendo që ai ka parasysh ndonjë botë tjetër... Aspak! Vetëm kjo botë nuk i pëlqen... Unë i besoj trashëgimisë. Tani po i besojnë edhe ata që e luftuan dyzet vjet rresht përtej oqeanit.

Maksi nuk bënte zë. Dëgjonte e vështronte Erihun.

«Është i bukur, djalli, mendonte ai për peshkopin. Megjithë atë moshë që ka, hiç nuk është prishur. Dikë më kujton... Ah, po, Zhylien Sorelin... Vetëm në paraqitje...»

Me të hequr petkun fetar, prelatët e Njuharkut mund t'i merrje për njerëz të modës, për turistë, për çfarëdo tjetër, po në asnjë mënyrë për priftërinj. Ky ishte avantazhi që kishin ata ndaj sivëllezërve të tyre në vende të tjera.

— Dhe për gjurmat mos u shqetëso, teutonikus. Erdhi koha ta themi botërisht fjalën tonë.

Maksi desh të thoshte diçka, po e ndërpreu Erih Mihelsoni.

— Lavdi zotit që u larguam një herë nga Njuharku — tha. — Ka dhjetë ditë që po zija myk në atë burg mëkatarësh.

— Kjo është një blasfemi për qytetin tonë, Erih. Vetëm në Njuhark nuk mund të zërë njeriu myk. Njuharku pjell çdo ditë nga një gjë të re. Dëgjuat për murgeshat revolucionare? Nuk dëgjuat. Mirë, jua them. Kanë formuar parti të vetën! Duan të venë në postin e presidentit një shoqen e tyre.

— Po a është e bukur, të paktën? — gogësiu Erihu.

Senatori ngriti supet. Maksit iu kujtua Berta Snou. Peshkopi ishte interesuar prapë për të.

— Këto nuk janë gjëra të mira — tha Maksi. — Nuk e di ku lexova që në Njuhark ka dymbëdhjetëmijë bashki-me, organizata dhe parti të ndryshme. Kjo të fut frikën. Kur e kujtoj ndonjëherë, më ngrihen leshrat e kokës.

— Ne bëjmë mirë që i mënjanojmë shkencëtarët nga politika, Maks. Kur s'kupton ti që je aq i mprehtë, nga do të kuptojnë të tjerët?

Veberi e vështroi me dyshim. Tallej Xhon Stivensi, apo e kishte me tërë mend?

— Më mirë të kemi dymbëdhjetëmijë parti të ndryshme kundër, teutonikus, se sa një të vetme! Dymbëdhjetëmijë parti, janë dymbëdhjetëmijë mendime të ndryshme që nuk do të puqen kurrë me njëri-tjetrin. Unë do të uroj që ato të bëheshin pesëdhjetëmijë.

Veberi u drodh. Siguria e atij njeriu e trembte dhe e bënte të përulur.

— Do të presim edhe shumë? — pyeti peshkopi.

— Duhet të jetë në udhë. Për tri minuta është këtu.

— Mos na hanë ata përbindshit tuaj, Maks?

— Erih! — iu kthye senatori peshkopit. — Tani që ke hequr petkun e kishës, as ti nuk ke imunitet nga shpirti i keq.

Veberi shikoi orën.

— Tani duhet të vijë — tha.

Përtej oqeani shkumbëzonte. Dallgët përplaseshin në bregun me rërë dhe përfshinin një hapësirë të pamasë. Ato erdhën gjer pranë këmbëve të Erihut dhe e lagën. Peshkopi nxori një britmë fëmije të llastuar dhe u hodh t'i shpëtonte dallgës. Xhon Stivensi u ra çizmeve me kamxhik dhe zuri të fishkëllente si Kauboj. Tutje në qiellin krejt të pastër dukeshin dhe zhdukeshin një tufë pulëbardhash të Paqësorit, të gjata, të hirta...

— Këto nuk sjellin kohë të mirë — tha senatori pa u ndarë sytë shpendëve.

«As vizita jote,» se si i shkoi nëpër mend Maksit. E dinte që Xhon Stivensi nuk po vinte si turist në ishull. Ai donte të merrte një vendim në lidhje me vazhdimin apo ndërprerjen e eksperimenteve. Për tridhjetë e gjashtë muaj në ishull ishin harxhuar dyzetmilion dollarë. E krahasuar

institut për institut «Kananina» vinte fill pas qendrës kozmike në Hauski, që ia kalonte nga shpenzimet. Po nuk ishin të hollat që e shqetësonin senatorin. Ishte koha e gjatë dhe suksesi i pamjaftueshëm që kishte arritur Veberi. Metoda e tij nuk mund të përdorej për këdo, po mbi individë që kishin të dhëna të veçanta fizike, t'i kishin kaluar të dy metrat. Ai ndoshta mund t'i rriste ata edhe tridhjetë centimetra. Kurse hormonet e Batlerit premtonin një rritje shumë më të madhe dhe më të shpejtë. Veberit nuk i vinte keq që nuk kishte pasur suksesin e pritur, i vinte vetëm plasje që s'e kishte në dorë sekretin e Batlerit. Atë zbulim ai e donte për vendin e vet. A nuk kishte lindur atje ideja e mbinjeriut? Kjo kishte qenë në shekuj një ide e turbullt, e pavendosur mirë. Maksi e zbriti në tokë atë, e bëri tokësore duke i zhveshur fantazinë dhe shenjtërinë e kotë. Në këtë shekull praktikizmi dhe teknike, mbinjeriu për Maksin nuk qe as mbreti filozof i Makiavelit, as përrëndia e re e Niçes. Qe thjesht një reaktor fuqie dhe mendjeje në përmasa të reja, shumë më të mëdha se normalja. Që kur ishte student gjimnazi dhe qe dashuruar pas nibelungëve, nuk i hiqej nga mendja një frazë nga Zarathustra: ¹⁾ «Unë ju them se ç'është mbinjeriu. Njeriu është diçka që duhet tejkaluar. Çfarë keni bërë ju për ta tejkaluar atë?»

Veberi zuri të mendonte që në atë kohë për ta tejkaluar njeriun. Nuk është e qartë se si e kuptonte që atëherë këtë tejkalim. Në çfarë sferash? Në natyrë? Në psikologji? Në mënyrën e jetesës? Veberi praktik mendoi të fillonte nga trupi. Ndryshimet e tjera do të vinin për pasojë... Dhe kjo si rrjedhim i magjisë që i shkaktonin nibelungët flokëverdhe që trondisnin pyjet me fuqinë e tyre shkatërruese. «Çfarë keni bërë ju për të tejkaluar njeriun?» Kjo pyetje u bë qëllim i gjithë jetës së Veberit. Zuri të ëndërronte për njeriun gjigant qëkur dridhej përpara autoritetit të pedagogëve dhe qe i detyruar të hiqte shapken dhjetë herë në ditë për t'i përshëndetur. Atë kohë as

1) Vepër e filozofit reaksionar gjerman, Niçe.

ai nuk dinte si duhej të ishte ky njeri gjigant dhe ç'do të pille ai. Vetëm një gjë e kishte të qartë: arësyen që e shtynte ta krijonte atë. Dhe kjo ishte e thjeshtë. Veberi kërkonte fuqinë. Fuqia e trupit do të sillte shpërthimin e fuqisë mendore. Një shpërthim të paparë. Dhe kështu atdheu i tij, do të bëhej atdheu i gjigantëve të trupit dhe të trurit. Do të sundonte botën! Më vonë tallej me Niçen. E quante patologji filozofinë e tij. Lundronte në qiej, s'kishte qenë i zoti ta bënte tokësore filozofinë e tij. Ndërsa Veberi... «Të çmendurit shpesh shërbejnë për të ndriçuar të zgjuarit,» thoshte Veberi kur i kujtohej Niçja. Me fjalë të tjera, marrëzia e Niçes shërbente për të ndriçuar Veberin. Kërkimet e tij të para qenë një përzierje e filozofisë me teoritë mjekësore. Këtu ai u ndesh në kontradikta që e vunë shpesh me shpatulla në mur. Megjithatë ai ndoqi udhën e vet me një vendosmëri të pakrahasueshme. Le të mos pranonte mjekësia që një mendje e jashtëzakonshme rritet në një trup të jashtëzakonshëm! Maks Veberi kishte mendimet e veta për të dhe do të vinte koha që do ta provonte. Ndërroi shumë herë stilin dhe metodat e punës. Ndihma e Kurt Veberit nuk i mungoi asnjëherë, megjithëse mes tyre ekzistonte një hendek i vogël. I ati donte vetëm fuqinë e trupit, Maksi edhe të mendjes. Erdhi një kohë që ai filloi të rendte pas individëve të jashtëzakonshëm, nëpër katër anët e globit. Iu ngjit edhe Himalajeve. Njeriu i borës duhej të ishte një qenie tepër e fuqishme gjersa kishte arritur t'i bënte ballë asaj natyre të ashpër. Njeriu i borës ia hëngri konservat për dy javë rresht Veberit, dhe si për ironi ia kthente gjithmonë përmbys ato të boshatisurat. Nuk dihej si vinte gjithmonë kur ai nuk gjendej në çadër. Vetëm një herë e pa nga shpina. Njeriu i borës ecte ngadalë, duke ngritur me mundim trupin e tij të rëndë. Këmbët e zbathura i zhyste thellë në borë dhe, për t'i nxjerrë, përkulej herë në një anë, herë në një tjetër. Nga pas ai i ngjante edhe ariut, edhe gorillës së tropikëve. Po, jo, ishte njeriu i borës! Në të ecurën e tij kishte zgjuarësi dhe ndoshta një farë dëshpërimi. Ai s'arriti ta kapërcente atë prak që e hodhën pas shpine si vëllezërit e tij të Neandertalit.... Me që mbeti pas atij praku, ai duhej

të ishte një armik i tmerrshëm i gjithë racës njerëzore.
Mjerë kush i binte në duar!

Vazhdonin të zhdukeshin konservat, po ai nuk e pa më njeriun e borës, megjithëse e ruajti me net e me ditë. Kaq e rëndë u bë pritja, saqë ai zuri të mos i besonte më as vetes. Çfarë kishte parë, njeriun e borës apo ndonjë kafshë të Himalajeve?

Kur nisi lufta, hyri në ushtri vetëm që të kishte mundësinë t'i fillonte eksperimentet me njerëz. Që kur ishte krijuar njerëzimi, mjekësia nuk mbante mend një bollëk të tillë njerëzish kafshë për eksperimente. Kampet ishin plot. Aty i provoi Veberi gazrat për herë të parë.

U dëgjua zhurma e helikopterit. Pas pak ai doli nga retë. Veberi nxori nga xhepi radio-dhënësen dhe e urdhëroi pilotin të zbriste.

— Kanarina 3! Ju urdhëroj të zbrisni!

— Ju dëgjoj! Zbatoj urdhërin! — i erdhi përgjegjja.

Helikopteri nuk vonoi të zbriste. Ulja e tij të kujtonte një kërcim gomari me këmbët e para. Pastaj pushim në bisht.

Hipën të tre. Helikopteri u ngrit në ajër.

— Kjo është luftë për ekzistencë, Xho. Edhe më naisa e ke paraqitur ti.

— Nuk ju kuptoj, mister Xhon...

— Kur po kthehej sot nga banka, e sulmuan hajdutët. Kishte tërhequr kursimet e tij. Ia rrëmbyen. Po si u soll ai? Si ndonjë qyqar? Aspak. I dërrmoi kokën të parit dhe për pak la pa frymë të dytin. Po ata ishin tre veta dhe e hodhën përdhe. A sillet një naiv kështu?

— Kjo është luftë për ekzistencë, Xho. Edhe më naivi e di që duhet të mbrojnë dollarët, po të dojë të hajë...

— Megjithatë unë jam i bindur që Batleri ka ndryshuar këto kohët e fundit. Përpara gjashtë muajve mund t'ia shisje zhambonin për mish thellëzash.

— Ç'ishin ata vjedhës, Xho?

— Ishin vjedhës të tillë që m'i sollën mua të hollat, mik i dashur.

— I fortë je, Xho... — tha Erihu.

— Batleri ka ndryshuar — u hodh Veberi. — Do të

thosha që ka ndryshuar shumë. Ka filluar të bredhë. E kanë parë udhëve, në lokalet e natës. Tani nuk do të çuditesha, po të më thoshit që u martua me një artiste cirku.

— Mrekulli, teutonikus! Tani që i duhen para më shumë, tani do ta lëmë pa asnjë cent, All right! Batleri një kohë ishte Katon, tani u shndërrua në Trimalion. ¹⁾

— Unë nuk kam se ç'bëj më në «Trinidad» — vazhdoi Veberi. — Për hormonet e rritjes nuk më lë të hap gojë më. Po edhe në biseda të tjera më vë përpara. Turret me një logjikë që më çudit. Tani ai i ngjan një kafshe parahistorike që, me t'u zgjuar nga gjumi shekullor, tërbohet duke parë që bota nuk është ashtu siç e ka lënë ajo. Dje i flisja për fonde kërkimesh. Jo pa qëllim... Ai qeshte. «Shkencës së vërtetë nuk i caktohen fonde, por vetëm lëmosha, Veber. Fondet harxhohen gjetiu... Mendoni, mistër Veber, që Aristoteli merrte tetëmijë tallante ari në vit. Vetëm për kërkime... Ky është një turp për kohën tonë...»

— Po ngrihet era! — tha Xhon Stivensi duke vështruar poshtë.

Fjalët e tij kishin kuptim të dyfishtë.

— Atij i duhet gjetur një mbretëreshë Saba që t'i tregojë kafshët si Sollomonit — vazhdoi senatori pas pak me humor.

— Berta Snou... — tha peshkopi gjysmë i përgjumur.

Helikopteri bëri një rrëzim të rrufeshëm në një boshtllëk ajri, po e mori veten sakaq. Erih Mihelsoni përpoqi kokën pas mbështetëses dhe rënkoj si fëmijë. Senatori qeshi me lot. S'u mbajt as Maksi.

— Po thuaj arritëm — tha ai. — Vështroni përtej! Senatori as që e ngriti kokën. Vetëm peshkopi u zgjat andej. Ishulli i «Kanarinave» i ngjante një pike të zezë tej në horizont.

— Çudi! — tha peshkopi. — Në një copë udhë nuk pashë asnjë anije këtej.

— Dhe as që do të shohësh! Rreth ishullit vërtitet

1) Trimalion dhe Katon-personazhe të shkrimtarit romak Petron. I pari jepet pas teprimesh, i dyti jeton thjeshtë.

rryma detare Taki-Rot 1). Anijet ajo i gëlltit si senduqet, Erih. Nuk e kemi zgjedhur kot këtë vend.

Tani ishulli dukej si në pëllëmbë të dorës. Kishte formën e një trapezi të rregullt. Mund të ishte nja dyzet e dy milje i gjatë dhe tetë i gjerë. Në perëndim dukej një pyll i dendur dhe në anën tjetër përballë tij një masiv i zhveshur shkëmbor. Pjesa tjetër qe e sheshtë si një pistë gjigante raketodromi.

Zbritën. Helika e sipërme vërtitej ende kur u hap dera dhe brenda u futën dy veta të armatosur me automatikë të shkurtër marine. Në kokë kishin berreta australiane si dhe një uniformë që të kujtonte Legjionin e huaj në Afrikë.

Meqë nuk u kënaqën me shpjegimin e Maksit, i kërkuan lejën e zbritjes peshkopit. Vetëm kur e panë atë në rregull, e lanë të dilte nga avioni.

— Ku do na shpini, Xho? Unë s'pashë as laboratore, as oxhak fabrikash. Vetëm një shesh të mallëkuar shoh, që i ngjan çuditërisht Balbekut. 2)

— Hëpërhë hipni në maqinë, Erih — buzëqeshi senatori.

Peshkopi e mori vesh se do të drejtoheshin për në pyll. Vendi i kërkimeve duhet të ishte i fshehur nën ato pishat kanadeze dhe mështeknat e bardha.

Përmes pyllit qe një rrugë mjaft e gjerë, po shumë e errët. Kurorat e drurëve të lartë ishin bashkuar sipër dhe e kishin kthyer udhën në tunel.

Dolën në një vend pak a shumë të pastruar nga drutë. Udhën e ndërpriste aty një mur nja tetë metra i lartë. Muri ishte prej betoni dhe shumë i lëmuar. Në të nuk mund të kacavirej as macja më e shkathët e xhunglës.

Një pjesë e murit u hap automatikisht me t'u afruar maqina dhe po ashtu u mbyll. Gjer në korridorin e brendshëm ndërtesa i ngjante më shumë një burgu tepër të si-

1) Emër i trilluar.

2) Platformë shumë e madhe natyrale në Arabi. Përmendet edhe në librat fetarë.

gurt se sa një vendi për kërkime shkencore. Hekuri i trashë dhe betoni i armuar ishin elementët e vetëm që zotëronin aty. Me të kaluar korridorin, pamja ndryshoi. Hynë në një aneks. Veberi hapi një kapak të vogël në mur. Erihu pa përmes asaj vrime një sallë të mbushur plot me bombola, tuba dhe ventilatorë. Ajo i kujtoi Erihut një distileri alkooli apo një repart ku prodhohet amoniak.

Faqja e majtë e aneksit ishte e mbuluar me një perde kadifeje të zezë. Veberi e largoi atë. Pas perdes në gjithë faqen e murit kishte hekura të trashë sa krahu. Përtej hekurave dukej një palestër e madhe gjimnastike e pajisur më së miri. Nëpër anët e mureve maqina elektrike për gjimnastikën e detyrueshme, pastaj litarë të trashë, tra ekuilibri, shkallë suedeze prej hekuri, unaza me doreza të mëdha metali. Në mes një ring boksi që në vend të litarëve kishte në katër qoshet kablllo të trashë. Nga tavani zbrisnin poshtë litarë të tjerë që mbanin thasë lëkure me rërë e topa të mëdhenj për goditje me doreza boksi e plot gjëra të tjera për stërvitje.

— Kjo është sallë stërvitjeje — i shpjegoi Maks Veberi peshkopit. — Sistemi im i pregatitjes së gjigantëve mbështetet dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë për qind në stërvitjen fizike.

Senatori ngriti supet.

Maksit nuk i shpëtoi ai gjest.

— Çfarëdo metode që të përdorim, është e nevojshme të kombinohet me stërvitjen dhe gjimnastikën patjetër, mistër Xhon — tha me zë të vendosur ai. Edhe po të përdorim hormonet e Norman Batlerit. Pa stërvitje ata do të ishin gjigantë të lemerishëm të ngjashëm me kallamat e sheqerit. Prandaj mos i qani të hollat që u derdhën këtu, mistër Xhon.

E kaluan palestrën, pastaj edhe sallën e ngrënies. Aty nuk kishte ndonjë gjë të veçantë veç tryezave shumë të larta dhe stolave të mëdhenj. Pastërtia ishte shembullore.

— Këtej — tha Veberi dhe shtypi një sustë.

Ishte salla e fjetjes, një sallë afro njëzet metra e gjatë si një kapanon ushtarësh. Dhjetë krevatë rreth tre metra të gjatë vinin radhë pas radhe. Mbi krye të çdo krevati qe varur një portret.

— Ç'dallon te këto portrete, Erih?

— S'di si të them — u zu ngushtë kryepeshkopi. — Më duket që këta përbindsha vetëm një shprehje kanë në fytyrë, atë të urisë! O perëndi, më duket sikur do të më shqyejnë!

— Po, atë shprehje kanë. Dhe ta dish që janë fotografiuar pas një dreke mbretërore.

— Po ç'duhet këto fotografi mbi shtretër, Xhon?

Senatori bëri me shenjë nga Maks Veberi.

— Atyre ua kam zbritur inteligjencën në maksimum — u përgjegj Maksi. — Fotografitë i ndihmojnë për të mos ngatërruar shtretërit.

Peshkopi rrudhi buzët. Ndjeu një farë neverie të pavetëdijshme.

— Kështu do ta katandisni racën njerëzore, Xho?

— Një pjesë të racës njerëzore, hirësi — u tall senatori. — Ata që do të na duhen për punë dhe për të mposhtur të tjerët.

— E dija që ke më shumë se dhjetë veta këtu, Maks. Nuk e pashë portretin e Polifemit.

— Kam edhe tre të tjerë. Polifemi është me ta. Hë-përhë nuk ua kam prekur inteligjencën. Të shohim.

— Dy nga ata që pe në dhomën e fjetjes kanë qenë të dënuar me vdekje. Erih, dhe, po të mos ia sillja këtu Maksit, do të kishin përfunduar në karrigen elektrike. Më tërhoqën vëmendjen trupat e tyre të mëdhenj, mosha e re dhe ia solla. Maksi gjuan shtatlartët nën tetëmbëdhjetë vjeç! Po metoda që përdor ai...

— Ah, i sollët këtu nga karrigja elektrike, Xho?

— Posi!

— Po kjo është...

— Në kundërshtim me ligjet! Këtë do të thuash? E para e punës ata të dy pranuan vetë dhe Maksi i ruan mirë

deklaratat e tyre. Nuk i dihet... E dyta spitalet tona po bëjnë kërdrinë me eksperimente në kundërshtim me ligjet. Të dënuarit me vdekje, të sëmurët rëndë, pleqtë dhe ndonjëherë ata që s'kanë asgjë po zëvendësojnë me sukses kaviet dhe qentë. Po t'i heqësh anën sentimentale që e bën të fshijë sytë një ledi, kjo është krejt normale.

— Po, po, Xho, në fund të fundit kujt do t'i shërbejnë ato eksperimente? Njerëzimit. Duhet sakrifikuar disa për hir të shumicës.

— Unë e shikoj krejt në mënyrë praktike këtë çështje — ndërhyri Maksi. — Iks person ka për të vdekur që ka për të vdekur. Pse të mos i shërbejë shkencës?

— Kështu duhet të jetë — tha peshkopi.

Senatori u zgërdhi.

— Jeni mbreti i praktikëve, teutonikus. Ne njihemi si populli më praktik në botë, po ti na e kalon në diçka. Ti e pasuron praktikitetin tonë me gjakftohtësinë, me të cilën vepron.

— Mister Xhon! — tha Veberi me krenari. — Në shkencën tënde, në idealin tënd ose të jesh xhelat i pamëshirshëm, ose viktimë! Dhe jam i bindur që as ju nuk do të zgjidhni alternativën e fundit.

Senatori ia nguli sytë, pastaj pohoi me kokë.

— Tani përbindshat, Maks! — ndërhyri peshkopi.

— Ejani këtej — tha tjetri.

U bëri me shenjë nga një dritare që binte në oborr. Në oborin e gjerë vërtiteshin dhjetë gjigantët e Veberit. Silleshin në diell, secili shikonte punën e vet pa e pasur mendjen te prania e tjetrit. Po ndodhte që ndonjëri i afrohej pak më shumë sa duhej tjetrit dhe fillonte zënka menjëherë. Erihu pa dy-tri shkëmbime grushtash që do ta kishin lënë të ngordhur në vend një dem, disa goditje të tërbuara me shqelma në bark, pastaj u dëgjua sirena dhe përleshja pushoi. E njëjta gjë u përsërit edhe disa herë me radhë.

— Sirena vendos një farë ekuilibri — shpjegoi Maksi. — Ua kam krijuar refleks. Zënka këtu nuk pushon asnjë-

herë, po të mos jetë sirena. Këtu edhe në sallën e ngrënies. Nuk vutë re që tryeza e gjatë dhe stolat qenë të mbërthyer në çimento me bullona të trashë? Këtu hanë «mamuthët», siç i kemi pagëzuar ne ata të dhjetë. U shkon ky emër...

— Mos bëjnë pjesë edhe këto zënka në sistemin e stër-vitjes? — pyeti peshkopi.

— Tërthorazi!

— Tani tre të tjerët. Xhoni më ka thënë që janë edhe më të mëdhenj.

— Njëri negër, tjetri indian, Milluoki. Rrjedh nga një fis i vjetër lëkurëkuqsh.

— Po pse s'ua ke prekur zgjuarësinë atyre, Maks?

— Ata të tre hëpërhë i kam çobejtë e kësaj kopeje hirësi. Pastaj më shërbejnë si kontrast me të tjerët në kërkimet.

— Kam një surprizë për ju — foli Maks Veberi.

Ai i udhëhoqi nëpër një sallon tjetër, pastaj hapi një kapak në mur. Një zhurmë shurdhuese u përhap. Klithma, të shara, goditje mbi hekura.

Peshkopi dhe senatori u afruan te vrima. Një dhomë e madhe e ndarë në mes me hekura të trashë. Pas hekurave Polifemi, Milluoki dhe zezaku Ralf. Ata tundnin hekurat dhe bërtisnin me të madhe. Gjithë e ndarra ushtonte si nga ndonjë batare topash.

Peshkopi u drodh dhe bëri shenjën e kryqit.

— Ai është Milluoki, kriminel dinak. Mund të ta përdredhë qafën për njëzet cent ose edhe pa para fare. Ralfi është gjaknxehtë dhe i papërmbajtur. Nganjëherë bie në melankoli dhe qan. Gjer përpara se të na ikte atë mbrëmje, Polifemi është më i qëndrueshmi nga të tre. Atij i dhashë atë që kërkonte, fuqinë! Po nuk i kam dhënë diçka tjetër, vendin ku ta ushtrojë atë. Nga ata të tre vetëm Polifemi erdhi vullnetarisht. Ai ka qenë lojtar basketbolli — shpjegoi Maks Veberi. — Po tani edhe ai ka ndryshuar dhe, po të mos i hap udhë, nuk di ç'do

të bëhet me të, ndoshta do të më duhet t'ia prek edhe atij inteligjencën.

— Po ç'kanë që bërtasin, xhanëm? — tha peshkopi Erih duke zënë veshët.

— Kanë njëzet a katër orë pa ngrënë, hirësi! Shtakoni ç'do të ndodhë tani.

Veberi shtypi një buton. Peshkopi dhe Senatori nuk vunë re nga erdhje në mes të dhomës një tryezë e ngarkuar me lloj-lloj gjellësh. Me të dalë tryeza, klithmat dhe ankimet u bënë më të forta. Ata të tre pas hekura-ve s'e arrinin dot tryezën.

— Shpëtona, o zot! — u lut sinqerisht peshkopi.

— Kanë uri të tmerrshme — tha Veberi. — Pikë për pikë si tregon Odisea për Polifemin...

Ata të tre kishin zënë të tundnin hekurat me tërbim.

I tundnin të tre përnjëherësh, me një forcë që nuk mund të merret me mend. Vazhduan kështu disa minuta, pastaj në një mundim të fundit e shkulën nga vendi gjithë perden me hekura dhe e hodhën përdhe.

— Shpëtona, o zot! — u lut për të dytën herë peshkopi. Ata të tre iu derdhën ushqimeve dhe filluan të hanin si të babëzitur.

— Ja, këtë desha t'ju tregoj, — tha Maksi — forcën e tyre të tmerrshme. Me këta të tre unë do të provoj të zën e inteligjencës së kufizuar — vazhdoi Maksi. — Po kësaj ende s'ia kam arritur plotësisht.

— Peshkopi i bëri disa vërejtje Maksit.

— Baza e punës sime, — u përgjgj ai — është bombardimi i organizmit me sa më shumë gaz karbonik. Kur shtohet sadopak përqëndrimi i këtij gazi në organizëm, përforcohet procesi i frymëmarrjes. Fillon një zhvillim i vrullshëm i kafazit të kraharorit dhe i gjithë organizmit. Po në këtë çështje hyn edhe diçka tjetër, një veçori e kundërt e gazit karbonik. Dihet që ai hyn në përbërjen e kalciumit. Kur në ajër rritet përqëndrimi i ga-

zit karbonik, në kockat e skeletit grumbullohet intensi-
visht kalciumi. Kjo është metoda ime. Ato impiante që
patë kur hymë, japin pa ndërprerje gaz karbonik. Po kjo
metodë do kohë të gjatë dhe tre metrave lartësi nuk mund
t'u arrihet, besoj, hë për hë. Duhet kaluar disa breza gji-
gantësh. E kam fjalën për trashëgiminë si rrjedhim i rip-
rodhimit të tyre, që të arrihet ajo lartësi. Ndërsa me Bat-
lerin ndryshon puna. Hormonet e tij i arrijnë tre metrat
për dy vjet.

Erih Mihelsoni vështroi edhe një herë nga vrima. Ata
të tre i kishin përparë ushqimet dhe tani po pushonin në
dyshe me. Asnjëri nuk e dinte se po i vështtronin.

— Po flasin njëri me tjetrin, Maks? Ç'thonë për ty?
Ç'bëjnë ata?

— Nuk flasin kundër meje, se e dinë që ka kudo mi-
kromanjetofonë të fshehur. Po të llapin, i pi e zeza.

— Na e sill Polifemin — tha senatori.

Maks Veberi mori telefonin dhe dha disa urdhëra me
të shpejtë.

— E gjithë kjo nuk di si më duket — tha peshkopi.
— Si një ëndërr e keqe...

— Do të mësohesh, Erih! Kështu si ty tani u dukej
pushka indianëve përpara treqind vjetve. Ashtu na dukej
edhe ne kërpudha e bejbit ¹⁾. Po ç'ke kështu, nuk je mirë?

— S'kam gjë — tha peshkopi.

E sollën Polifemin. E shoqëronin katër veta të ve-
shur me tuta prej gome dhe me kaska hekuri me xham
përpara. Në duar mbanin bastunë me korrent. Gjiganti u
ruhej atyre dhe i vështronte vjedhurazi. Një e goditur
me to të shembte përdhe për dhjetë minuta.

— Si je, Pol? — e pyeti Veberi.

Gjiganti nuk u përgjegj.

Veberi rrudhi buzët.

1) Aluzion për bombën «A».

— Miqtë e mi kanë ardhur të të shohin...

Tjetri mbante sytë përdhe (Veberi ia kishte çliruar syrin e majtë nga dhjami që i varej, kështu që tani nuk dukej aq i tmerrshëm).

— A nuk na thua, pse deshe të ikësh? — ndërhyri Xhon Stivensi.

Poli ngriti kokën. I pa të gjithë me radhë, pastaj nuk dihet pse ia nguli sytë peshkopit. Ky nuk e duroi dot vështrimin dhe i largoi sytë. Qe zbehur në fytyrë dhe zemra i rrihte me forcë.

— Pol! — i bërtiti Maksi.

Gjiganti u trand. Rojet patën frikë dhe ngritën bastunët. Poli i vari duart poshtë plotësisht i bindur.

— Së shpejti do ta tregosh fuqinë tënde, Pol, do ta gëzosh atë...

Maks Veberi u inatos.

— Barkas, kafshë! — thirri ai.

Gjiganti ra barkas. Njëra dorë i arriti pak centimetra larg këmbëve të peshkopit.

Erih Mihelsoni u drodh dhe bëri praptas.

— Hiqeni! — u tha Maksi rojeve.

— Kjo s'është gjë e mirë, Xho... Kjo që keni nisur...

Senatori nuk ia vari peshkopit.

— Dëgjo, Xho...

Tjetri u kthye nga Erihu me vrull.

— Kjo s'është asgjë — tha. — Kjo është vetëm fillimi. Sa të vëmë në vijë atë matufin, pa të shikosh, një-mijë gjigantë, dhjetëmijë, njëqindmijë, një milion! Ne na duhet fuqia e tyre, dëgjon? Fuqia të them! Ai e zuri për krahu Erihun dhe e tundi fort.

«E zuri dhe këtë mania e gjigantizmit, mendoj Maksi. Aq më mirë!»

— Dhe ç'janë këto që na përrallis, uratë? Të zuri frika? Priftërinjtë nuk i ngasim...

Peshkopi qe tultur në fund të sediles dhe s'bente

zë. Qe zverdhur në fytyrë dhe i vinte për të vjellë. Ishte trembur për vdekje. Nuk shihte as pemët që ndërrohe-
shin nga ecja e veturës, as ndërtesat, as rrugën. Përpara
syve kishte një gjigant biblik që lajmëronte fundin e
botës ..

KAPITULLI VIII

Vështruan njëri-tjetrin. Batleri ngriti supet. Ted Rolvingu u kaloi pranë pa u folur, i hipi veturës dhe u zhduk. Nuk folën dhe as u përshëndetën. U takuan rastësisht në oborr.

— Të paktën sikur të punonte në laborator, xhaxha.

— Me siguri, që punon, Anabell... Si shkencëtar ka peshë, si njeri...

— Ai e ka mendjen të ndërrojë kravatat. Po çfarë kërkon ky Rolvingu?

— Nuk e di. Një kohë mbaj mend që gjurmonte limfën. Tani nuk e di.

— Më mirë të kishim në shtëpi një dyzinë policësh se këtë Rolvingun hundëpërpjetë.

— Çuditë si nuk po na zbojnë nga vila, Anabell. Po, sido që të jetë, duhet të largohemi këtej. Çudi! Stenli nuk po ndjehet i gjallë! Apo?..

— Ç'do të thuash, Norman?

Ai bëri buzën në gaz duke parë ankthin e saj.

— Mos u bëj e marrë — i tha. — Unë mendova se mund të m'i pengonin letrat e Stenlit. Jam regjur tani! E di që dyshoj edhe për grabitjen? Ndoshta, Anabell, do të kthehem të laj prapë pjatat nëpër restorante! Edhe pak ditë edhe mbetemi pa një cent. Harrova, tani ka lavapjatta automatike...

— Do të punoj unë, xhaxha... Megjithatë Stenli duhet të na njoftojë. Duhet të pyeste për ne...

— Mos do të martohesh me Stenlin, Anabell? — pyeti papandehur Batleri.

Anabella ia shkrepri një të qeshuri të fortë.

— Sikur ta shihje veten se me ç'fyturë po më pyet! Me atë të inkuizitorit të madh Darling.

«Stenlit nuk i duhet mbesa ime, mendoj Batleri. Megjithëse unë e dua Anabellën, ajo nuk bën për një shkencëtar. Pak a shumë i ngjan sime shoqeje.»

— Anabell, ti s'duhet t'i vardisesh Stenlit — i tha me një frymë.

Vajza qeshi me të madhe.

— Mos u tremb, Norman Batler! Unë nuk do ta heq Stenlin nga korifejtë e shkencës që bien erë myk.

— Anabell... Unë...

— Ta lëmë këtë bisedë, xhaxha! Ju që rrini mbyllur tërë kohën brenda katër mureve duhet ta çmonit më shumë se të tjerët jetën. Po fatkeqësisht ngjet e kundërta. Dhe unë e di përse ndodh kështu. Ju u çmësuar me jetën, e marrat atë. A nuk bindesh për këtë tani që ke fituar «lirinë»? Po mos kujto se jetojnë të gjithë kështu si ti...

«Për besë, tha Batleri me vete, kjo nuk është aspak mendlehtë!»

Norman, më fal! — tha Anabella duke u zbutur. — Ti je kaq i tronditur dhe mua së marrës më brendh gjuha pa pengesë si vejushave në Harlem.

— Asgjë, Anabell. Asgjë! Në Njuhark të gjithë thonë «asgjë». E di anekdotën e atyre që po linçonin një negër?

«Ç'po bëni?» i pyetën. «Asgjë!»; «Ç'po bëjnë ata?» i pyetën të tjerët. «Asgjë! Po linçojnë një negër» Kështu, Anabell...

E kishte prekur. Ajo u zu ngushtë dhe s'diti si ta ndreqte fajin. U afrua dhe e puthi në faqe. Batleri bëri një gjest me dorë sikur të thoshte: «Lëre, iku ajo tani!»

— E di, Anabell, jam i lumtur që shpëtova nga Xhon

Stivensi. Është i tmerrshëm ai. Një fajdexhi, një vampir... Kur del nga duart e tij një bankënotë dollari, ka gjithnjë dhjetë cent më pak.

Batleri heshti.

— Çudi! — pëshpëriti pas pak. — Kam zënë të bisedoj si shumë për të holla. Të thashë, Anabell, ç'bëri Perkinsi? Ai Perkinsi i shkurtër i institutit të rrezatimeve? Nuk e mban mend? Ai me atë gruan e re...

— Aha, posi...

— Më dërgoi pesëqind dollarë. Ia ktheva, ama m'u bë qejfi sa nuk thuhet. Dhe të mendosh se e pata sharë njëherë...

— Ajo e tradhëton. Nga ajo m'u kuitua Perkinsi.

— Po të jemi të gjithë aq zemërbardhë sa Perkinsi i ngratë. s'ka çfarë të na bëjnë as njëqind Xhon Stivensa, Anabell.

Qëndronin ulur në një stol të lulishtes. Batleri vështronte diku në një qoshe të kopshtit. Lulet aty ishin harlisur nga shëndeti.

— Mbrëmë pashë në ëndërr gjigantin, Anabell. Një ekzemplar njerëzor nga ata që përmend Talmudi se kanë jetuar treqind vjet. Në fytyrë ishte si ai tjetri që më erdhi në dritare....

— Po a është e mundur të bëhet ajo që do Stivensi, Norman?

— Pse jo? Në botë sot nuk mund të ketë ndonjë të tillë. Vetëm atë që më erdhi. Këtu nuk e marr vesh nga ka dalë. Mos punojnë fshehur të tjerët? S'dihet! Historia tregon për shumë njerëz me trupa kollosi. Perandori romak Maksimiliani e përdorte byzylykun e së shoqes si unazë, kaq trupmadh ishte, ndërsa i ndjeri Patrik O'Brijen, skeleti i të cilit ruhet në muzeun britanik, ndizte çibukun me fenerët e udhëve të Londrës. E kam parë skeletin e tij. I kalonte të dy metrat e shtatëdhjetë centimetrat. Dhe s'kishte asnjë deformim. Raste të tilla ka plot. Veberi më tregoi fotografinë e një skeleti të zbuluar në Indi. Madhështor! I kalonte tre metrat! Gjersa kanë një bazë ku të mbështeten, mundësitë e shkencës janë shumë

të mëdha. Ka vite që më është mbushur mendja. — Nuk ka gjë që s'mund ta arrijë njeriu...

— Po, Norman, kështu besoj edhe unë. Vetëm se nuk i kuptoj propozimet që të kanë bërë Stivensi e Veberi. Rri dhe vras mendjen dhe ato më duken përherë e më shumë një absurditet, një marrëzi pa anë dhe fund. Një gjigant do t'i nevojitej shumë, bie fjala, perandorit Keops për të ndërtuar piramidat, po tani që teknika ka arritur aq lart, nuk e marr me mend në ç'punë mund të hyjë. Ose në luftë... Një njeri i tillë do t'ia kalonte Rikard Planta-genetit¹⁾ në përdorimin e heshtës dhe të shpatës e mund të përballonte një ushtri të tërë. Po ç'mund të bëjë sot kur mund ta përmbysësh me një plumb gjashtë milime-trash apo me një rreze Lazer fare të dobët. Nuk kuptoj, xhaxha...

— Kurse unë i kuptoj fare mirë, e dashur. Ata i kanë bërë llogaritë me kujdes. Mos pandeh se janë ëndërrues të çmendur! Përkundrazi! Nuk ka njerëz më praktikë se ata. Mos harro që bota do të ketë gjithnjë nevojë për forcën fizike të njeriut, sado që të zhvillohet teknika. Po kjo nuk është kryesorja për Xhon Stivensin me shokë...

Batleri u mendua një çast, pastaj vazhdoi:

— Pse, keq është, për shembull, të kesh një korpus policie me gjigantë të tillë? Cilën demonstratë nuk do ta sprapsnin ata? Në luftën e dytë, trupat e zgjedhura të sulmit i mbushnin gjithnjë me më shtatlartët dhe të fuqishmit. Një ushtar i tillë të duket si një mal përpara tytës. Ja efekti psikologjik... E kam provuar vetë këtë... Veberi shpreson edhe në diçka tjetër. Trupin gjigant do ta bëjë rritësin e një mendjeje gjeniale. Këtu nuk puqem unë me të. Inteligjenca s'ka të bëjë me madhësinë e trupit. Po Veberi ka mendimin e vet për këtë. Shpreson t'ia dalë...

— Me një fjalë Veberi vete kundër natyrës, — e

1) Mbret anglez me origjinë normane. Njihet më tepër me emrin Rikard Zemërluani.

ndërpreu Anabella. — Me sa dimë, që nga homosapiensi e këtej, trupi i njeriut ka ardhur duke u zvogëluar dhe është rritur truri. Vepra e Veberit do të ishte një përmbysje e asaj që ka bërë natyra për shekuj me radhë.

— Për besë po, Anabell! Pikërisht mendimin tënd më vuri përpara Maks Veberi kur më kërkoi sekretin e veçimit të hormoneve. Ai gjoja druhej nga ky regres i trupit të njeriut. Do të vinte një kohë sipas tij që nuk do të mund të mbante as kokën mbi supe... E gjithë kjo do të ishte si rrjedhim i pakësimit të mundimit trupor, i përpjekjes fizike... E di si më tha Veberi? «Unë nuk shkoj kundër natyrës, mistër Batler, vetë njeriu ka shkuar me shekuj kundër natyrës së tij, me shpikjet, me përpjekjet për rehati dhe komoditet. Njeriu nuk e kupton drejt në çfarë humnere po shkon..»

— Ç'përgjegje i dhe, Norman?

— Kryesisht u mbështeta tek ajo që tërë ky projekt është antinjerëzor. Këtu m'u përgjegj se në shkencën e madhe kjo është krejt naive.» I përmenda pastaj rrezikun e degjenerimit të të gjithë racës njerëzore. Do të kishim një ose dy breza gjigantësh të vërtetë, më tej përndia e di çfarë qeniesh të neveritshme do të dilnin. Xhon Stivensi ma hodhi këtu dhe padashur zbuloi veten. Ai qeshi me të madhe. «Pse, më tha, mos kujton se do t'i lëmë gjigantët të bëjnë dashuri? Nuk do t'i lëmë të riprodhohen. Do t'i krijojmë ne». «Po ata janë njerëz...» «Njerëz?» Xhon Stivensi qeshi dhe më tha një fjalë të ndyrë. Atë ditë senatori më quajti naiv për të dytën herë. Më pyeti cili është qëllimi i shkencës, ideali i saj dhe si përpiquej shkenca t'ia arrinte atij. Unë seç iu përgjegja i turbulluar dhe i tronditur. Më quajti naiv dhe u përgjegj vetë. «Shkencës nuk i hyn në punë ta bëjë tokën parajsë, siç mendoni pak a shumë ju, Batler. Njerëzimi përfiton rastësisht nga realizimet e shkencës. Qëllimi i shkencës është të zbulojë të fshehtat e universit përmes një elite kokësh të mëdha. Miliona e miliona njerëz lindin, punojnë dhe vdesin për të mbajtur këtë elitë. Ndryshe nga do t'i merrnit ato miliona ju, Batler, po të mos robe-

toheshin të tjerët për ju? Hapni sytë, Batler, dhe ndiqni atë fat që ju kanë lënë ndër këmbë. Edhe ju i përkisni elitës...»

Profesori qe tronditur. I dridheshin duart. Anabella i vuri pëllëmbët e saj mbi to për ta qetësuar.

— Njerëz si Veberi dhe Stiyensi e mbajnë veten në avangardë të shkencës dhe të jetës në përgjithësi. Po mua më pëlqen më shumë «prapambetja» ime se sa «përparimi» i tyre. Që kur bisedova me ta, rri e vras mendjen pak si tepër. Dhe nganjëherë më duket sikur s'janë krejt kot fjalët e tyre. Miliona njerëz zihen, kacafyten, bëjnë përpjekje vigane për të qëndruar mbi këtë tokë gjashtë, shtatëdhjetë vjet, pastaj i lënë shëndetin. Gjithë sakrificat e tyre shkon për të mbajtur elitën. Vetëm elita e di përse jeton! Maksi e Stivensi kështu thoshin. Dje paradreke më shungulloi në vesh tërë kohën zëri i Stenlit. «Hidhi një sy një herë Marksit, mister Norman, hidhi një sy njëherë Marksit...» Mbaj mend që më ka thënë shpesh kështu. Nuk mërzitej që e ndërprisja. Ma thoshte prapë. Dhe unë e hapa Marksit dje, «Kapitalin» e tij. Stenli i kishte mbushur anët e faqeve me atë shkrimin e tij të imtë. Të shohim ç'do të thotë Marksit...

Kur bisedonim në të rrallë, Stenli më thoshte që unë ngatërroj biologjinë me sociologjinë. Nuk ishim shpesh në një mendje me Stenlin. Mendimet e mia i shpreha edhe në takimin që pata me Stivensin. Ai më tha që me zbulimin tim unë do të ndihmoja për të forcuar sistemin tonë shoqëror, për ta mbajtur atë në këmbë. Si iu përgjegja? Pak a shumë kështu:

«Sistemin, thatë mister Xhon? Në shkollën fillore na mësonin për rendin primitiv, për rendin e pronarëve të skilevërve, pastaj për feudalizmin, më vonë për rendin borgjez. Kaq kam mësuar në shkollë. Po, t'ju them të drejtën, në atë kohë i kisha më të qarta tërë këto. Tani kam zënë të dëgjoj për kapitalizëm, për imperializëm, për komunizëm. Këto s'ma mbushin mendjen. Botën e drejtojnë ligjet biologjike. Për politikën nuk kam asnjë thërrime respekti. Kur flet për politikë, unë edhe Pla-

tonit tim i kapërcej faqet. «Të merresh me metafizikë, thotë një mendimtar i vjetër, është njëlloj sikur të de-hesh metodikisht». Kështu më duket mua edhe po të merresh me politikë. Pastaj, po qe se ky rend shoqëror kërkoi të lëvizë, përse ta ndaloni? Lëreni të shkojë! Rendet që janë zhdukur nuk e kanë marrë me vete njerëzimin.

Me sa di unë ai është shtuar shumë mirë në afro katër miliard frymë. Lëreni të shkojë ky rend! A mund t'i ndaloni pemët të çelin gjethe, kafshët të shumëzohen, njerëzit të mendojnë? Si m'u përgjegj ai? «Mund t'i ndalojmë, o naiv, dhe do t'i ndalojmë!» Ai më shau edhe diçka tjetër nëpër dhëmbë, diçka si «idiot me bateri» duke u përmbajtur me zor të mos ma përplaste haptazi në fytyrë. Dhe mirë do të ma bënte....

Batleri mori frymë thellë, pastaj vazhdoi: — Stenli më fliste disa herë për revolta dhe dhunë. Unë s'e kuptoja ose më mirë s'e merrja mundimin ta dëgjoja. Tani më vete mendja prapë te Stenli. Pse duhet dhuna për të kaluar nga një rend në një tjetër? Dhuna nuk është kurrë e mirë. Pse duhet dhuna, kur rendi do të ndryshojë vetvetiu? Këtë nuk e marr vesh, Anabell...

— Unë i kuptoj më thjesht këto gjëra — ndërhyri Anabella. — Në këtë rend shoqëror, për shembull janë të fuqishëm senatori Xhon me shokë. Po të përmbysët ky rend, fuqinë do ta rëmbejë dikush tjetër. Xhoni me shokë nuk do ta lëshojnë pa dhunë fuqinë e tyre. Kështu, xhaxha?

— Mbase!

Anabella u ngrit.

— Të të bëj një kafe? — pyeti. — Megjithëqë e di që nuk të shijon sa ajo e Dinit.

— Bëma, Anabell. Dini del këto ditë nga spitali. Nuk do t'ia harroj Larsenit këtë të mirë.

— Tani të vijmë te asistenti im — rifilloi Batleri kur i solli kafënë Anabella. — Nuk bëre për vete?

— Nuk ka qenë kurrë kaq i kujdesshëm me mua, tha me vete vajza. Ose po plaket, ose ka zënë të bëhet

sentimental... Nuk do të më pëlqente i tillë. E dua ndryshe Norman Batlerin».

— Të vijmë te Maks Veberi — vazhdo profesori. — Jam i bindur që ai erdhi tek unë me qëllime të tjera nga ato që paraqiti. Kemi folur për këtë. Tani unë e kuptoj sepse i gjeja dokumentat e mia të trazuara! Në s'ka qene Maks, kanë qenë të tjerë. O perëndi, ç'leshko kam qenë!

— Ai nuk më ka pëlqyer kurrë — tha Anabella.

— Ai do të shkonte shumë përpara me gjithë atë vullnet që ka. Po i ka hyrë një rrugë të shtrembër. Ai ka votëm mendje. Nuk ka shpirt fare. Me mua ka arësytuar më ashpër dhe më ftohtë se vetë Xhon Stivensi. Ai i fryn senatorit, ai është prapa çdo ngatërrese. Mëkat! M'u deshën kaq muaj për ta kuptuar këtë!

Batleri kishte ulur kokën dhe vështronte zajat e lulishtes. Të vinte keq ta shihje ashtu të pikëlluar.

— Mbaj mend një frazë nga ai, Anabell: «Njeriut i duhet kthyer fuqia e moteve të lashta kur ai përleshej me mamuthin fare lakuriq!» Po a e di ti, Veber (këtu Batleri e harroi fare Anabellën), që fuqia e njeriut të lashtë ishte dobësia e tij?»

Edhe Anabella mendonte për Maksin. Maksi dhe Stenli. Stenli është larg. Stenli dhe ajo dashuria e tij e çuditshme... Stenli që e vështron pas xhameve të laboratorit. Epruvetat i dridhen në duar. Ai luan kokën dhe buzëqesh. Një pyll flokësh të artë. S'ka si mos ta këtë dhe zemrën të tillë. Bjond është edhe Veberi. Ari tek ai ka një shkëlqim të akullt. Stenli është larg. Tropikët do ta kenë përzhitur dhe nxirë. Thonë se tropikët nxijnë lëkurën dhe zbardhin flokët. Mund ta duash Stenlin me çfarëdo flokësh. Stenli dhe Veberi... Maksi mendon se mund të flejë me mua një ose dy herë në javë pa u shqetësuar dhe pa u dhënë shumë pas meje... Jo, mistër Veber. ne kemi shije të ndryshme...»

— Nuk më ke folur asnjëherë si duhet për hormonet e rritjes, xhaxha! A është një sekret kaq i madh veçimi i tyre?

Batleri qeshi.

— Për vite me radhë — tha — unë kam ecur po në ato shtigje. Arrita të mësoja vetëm përpara një vit më parë si mund të veçohen ato hormone. Për një hollësi fare pa rëndësi harxhova gjithë ato vite. Dhe një ditë ia arrita krejt padashur. Pothuaj si Flemingu, ai i penicilinës shumë vjet përpara. Kjo më trishton, Anabell. Më dobëson, i lë vendin rehatisë. Jo, jo! Mos u ngut, nuk i besoj rastësisë unë. Po ç'të thuash kur copëtohesh tetë, nëntë vjet dhe e gjen në një çast kur e ke mendjen te një kotoletë e shijshme?

Heshti.

— Më janë lidhur duart, — tha ai pas pak, duke i hedhur një sy lulishtes. — Një kohë nuk i lija lulet kështu...

— Xheni nuk desh ta merrte rrogën sot, Norman.

— Pse? Nuk është e kënaqur? Nuk do të punojë më te ne?

— E kënaqur është, por...

Batleri kuptoi më në fund. Shërbëtorja e kishte marrë vesh si e kishin hallin.

— Megjithatë duhet t'ia japësh, Anabell — tha ai i mallëngjyer.

— Ia dhashë, Norman...

— Do të dalim nga kjo gjendje. Asnjëri nuk mund të më pengojë të heq dorë nga shkenca. Ku ka punë, Anabell? Një kohë botonin kërkesa në gazetë...

Vajza ktheu kokën mënjanë. Ç't'i thoshte? Vetëm në Njuhark kishte më shumë se gjysmë milion të papunë.

Në udhë u dëgjuan zëra dhe zhurmë. Nuk po qarkullonin maqinat, prandaj dalloheshin qartë zërat e njerëzve.

— Ç'është kështu, Anabell?

— Më duket si demonstratë...

U afruan te kangjellat. Një vargan i gjatë njerëzish po kalonte në rregull të plotë rrugën numër trembëdhjetë.

Batleri i lexoi me një frymë parullat që mbanin në duar. Secilës ai i dha një përgjegje me mend si ndonjë automat.

«Dhjetë cent shtesë në orë!»

— E ç'do të bëjnë më dhejtë cent? — tha Batleri.

«Poshtë konvejeri kapitalist!»

«Ne nuk jemi kafshë!»

Ndërkohë vargani i demonstruesve kishte arritur përpara vitrinave të mëdha të supermerkatit të veshmbathjes. Batleri shikonte nëpër xhama reflekset e njerëzve dhe të pankartave që mbanin në duar. Ai e la pas Anabellën dhe doli në udhë. «Për besë, mendoi Batleri, të paktën këta njerëz diç duan dhe dinë çfarë kërkojnë». Ai nisi të ecte pothuaj paralel me demonstruesit. Nuk e dëgjoji të mbesën që e thirri.

Nga mesi i turmës flutëruan gurë në drejtim të vitrinave. Xhamet u përplasën menjëherë nëpër trotuare me një zhurmë shurdhuese.

— Provokatorët!

Qe një thirrje që i ngriu të gjithë, që i bëri të qëndronin në vend dhe të vështronin njëri-tjetrin.

Një breshëri tjetër gurësh në drejtim të xhameve të tjera.

Gjithshka mbaroi, u vendos fati i demonstratës. Tani do të ndërhynte policia. Qe e pamundur të qetësoheshin njerëzit. Zunë të shtyheshin, të bërtisnin. Parullat dhe pankartat lëkundeshin si direkët në furtunë. Andej nga mesi nisi përleshja. U dëgjuan edhe të shtëna. Me ç'dukej andej nga mesi po i zhëpnnin topçinjtë e breshërisë së gurëve. Po sa ishin? Kush ishin ata?

Sheshi përpara varganit ishte boshatisur. Nuk dukej frymë njeriu. Gjysma e udhës ishte plot me njerëz që kishin humbur gjakftohësinë, gjysma tjetër krejt e zbrazur. Kjo e rëndonte edhe më shumë gjendjen. E kishin më vështirë të bënin përpara në atë pjesë rruge pa jetë, se sa në një vend me njëmijë pengesa. Po prapë më e keqja ishin ata që hidhnin gurë...

Nëpër udhën e shkretë u turr një kamion i madh, i zi dhe qëndroi disa hapa larg demonstruesve. Prej tij u hodh përdhe vetëm një njeri, një alamet njeriu, gjysmë lakuriq, me një goxha hekur në dorë. Polifemi...

Njerëzit ngrinë. U sprapsën një hap. Gjiganti fitoi qetësisht atë hap që lanë ata.

— Është po ai! — thirri Batleri. — Është po ai!

Turma bëri edhe një hap prapa. Gjiganti e gllabëroi edhe atë. Ai donte t'i lëshonin tokë.

Njerëzit u lëkundën kur panë në ajër hekurin e tij të madh. Pastaj nisi pështjellimi, zprapsja pa rregull, pa adresë. Diku binte një sirenë. Njerëzit iknin.

Mbeti vetëm Batleri. Batleri dhe gjiganti. Në ajër një hekur i madh dhe i shtrembër. Ai mund ta arrinte kur të donte Batlerin.

Gjiganti iu shmang atij, ashtu siç i shmanget luani gjahut të vogël. Ndoqi turmën që po ikte. As që denjoi t'u hidhte sytë viktimave të tij, njerëzve të shkelur, të rrëzuar. Dhjetë tankse nuk do të sillnin pështjellim më të madh. Nuk ka armë më të fuqishme se e panjohura. Dhe, kur ajo bashkohet me të papriturën...

Batleri kishte mbetur prapa. Ai shihte vetëm shpina njerëzish që iknin. Një falangë e prishur... Ngriti grushtet lart dhe thirri me sa fuqi pati. I erdhi plasje që përfundoi kështu protesta e atyre njerëzve. Ai i pat pëlqyer ata... Pa le të ishte edhe zoti vetë ai që i kishte vënë përpara. Duhet të qëndronin. Nuk e dëgjuan. Nuk e panë. Shpinat nuk shohin... Vetëm një grup prej tridhjetë-dyzet vetash mbeti kur u shpërndanë të tjerët. Ata nuk bënë më prapa. Nuk do të ishin prapsur as gjer aty, po i mori vala me vete.

Qëndroi edhe gjiganti. Një hop dhe pastaj u zhduk nga kishte ardhur. Maqina e zezë e mbushi gjithë bulevardin me sirenën e saj.

* * *

Ai grup që nuk kishte lëvizur qe Bill Redi me shoqe.
— Më mirë të na hidhej! — tha Albanoja. — Do të na copëtonte, po do ta vinim poshtë. Do t'ua hiqnim edhe frikën atyre që ikën.

- Nuk e përkul dot atë — tha njëri. — Ai është djall...
- Pusho ti, Xhekson!...
- Herën tjetër duhet t'i hidhemi ne, — tha Billi.
- Posi, posi...
- Pusho të thonë, Xhekson...
- Duhet të kishim ndenjtur të gjithë në ballë — tha Albanoja. — Po kujt i shkante mendja? Kishim hallin e provokatorëve. Ata rrinë në mes.
- Nuk duhet të qëndrojmë më këtu — tha Xho Millsi, një zezak plak. — Do të na zënë.
- Xheksoni nuk është mur — foli Billi duke zënë shokun për krahu.
- Ai ishte djall — tha Xheksoni.
- I futën krahun Xheksonit dhe e morën me vete.
- Shpërndahuni! — thirri Albanoja. — S'kemi ç'bëjmë më këtu.
- Bill Nostringu duhet të na e paguajë këtë — tha njëri duke u larguar.
- Sa veta bëheshin? — pyeti Albanoja.
- Një armatë! — tha Xheksoni.
- Pusho, të lutem! — pëshpëriti Billi dhe i shtrëngoi krahun.
- S'ishin më shumë se dymbëdhjetë veta rreth Nostringut — foli Xho Millsi. — Disa prej tyre i rrahën keq. Mbase edhe vetë Billin.
- U dëgjuan sirenat e maqinave të policisë.
- Shpejtoni! — thirri Albanoja. — Dhe sonte asnjë nga krerët të mos flejë në shtëpinë e vet.
- E pamë edhe përbindëshin — tha Xho Millsi duke u larguar. — Në fillim për pak sa nuk më bëri tërr syri. Po më vonë m'u ftoh gjaku dhe nuk më bëri tërr syri.
- Mirë, Xho. Ikë tani. Takimi në Kantinë. Ikë, Xho!
- Ama atë vështrimin e tij nuk do ta harroj kurrë — foli zezaku dhe iku me të shpejtë.
- Kurse mua m'u duk po aq i trembur sa ata që ikën — foli Billi duke gulçuar.
- I trembur apo i dëshpëruar, Bill?

— Ndoshta i dëshpëruar, Albano. Po a mund të dëshpërohet gjiganti, o mik?

— Nuk i dihet, është njeri — i tha Albanoja.

— Njeri! — psherëtiu Billi.

Kishin mbetur vetëm ata të tre. Të tjerët ishin shpërndarë.

Xheksoni i pengonte të ecnin më shpejt. Sirenat po dëgjoheshin më pranë. Nuk kuptonin ç'kishte Xheksoni.

Arritën qoshen e udhës dhe u mbështetën pas një ndërtese. Maqinat e policisë ndaluan dhe u mbushën me kalimtarë që s'kishin marrë pjesë fare në demonstratë. Pastaj u zhdukën.

— Në shesh kanë mbetur të plagosurit — tha Billi.

— I kanë mbledhur tani — u përgjegj tjetri. — Është e kotë. I kanë rrasur nëpër maqina.

— Më kot! Nuk i ndalon dot njerëzit, Albano. . .

— Nuk i ndalon dot — tha Albanoja. — Ata duhet të jenë të përgatitur që të ndalen. Ne s'kemi bërë gjë për këtë... Thonë që disfatat e vogla të vlejné. Të japin forcë për fitoret e mëdha..

— Sidoqoftë...

Xheksoni u përmend.

— Përveç nesh dhe dikush tjetër nuk u tund përpara atij, — tha. Dy të tjerët u vështruan sy më sy.

— Për besë mirë e ke, Xhekson! — foli Billi. — Po ç'ke kështu?

Ai qe një goxha burrë. E pashë që doli nga vila «Trinidad». Eci ca kohë me ne.

— I pashëm dhe me shprehje fisnike në fytyrë? — pyeti Billi.

— Ai më kujton një portret të Hygoit — foli Xheksoni.

— Paska qenë Batleri, atëhere — psherëtiu Billi. — Kështu e përshkruajnë Batlerin.

— Ai nuk pat frikë — u hodh Xheksoni.

— Pse do të kishte? Gjiganti është krijesë e tij — u përgjegj Billi.

— Këtë nuk e dimë ende — tha i menduar Albanoja.

Dikush iu afrua duke u lëkundur. Ata të tre panë Bill Morrisonin. Binte erë alkooli.

— Ju përshëndes, trima! — tha ai dhe u largua .

— E kam parë të pijë të «Kryqet e thyera» — tha Xheksoni.

— Ai mund të pijë me çdo lloj kryqi, Xhekson... — thanë dy të tjerët përnjëherësh.

— Të ndalojmë një taksi — foli Billi.

Ai fërkoj ballin me pëllëmbë. La një njollë gjaku në ballë.

— Je plagosur, Bill?

— Jo! — u përgjegj Billi i hutuar.

— Po ky gjak?

Gjaku rridhte nën xhaketën e Xheksonit.

— Mbaje të gjej një taksi — foli me të shpejtë Albanoja. — Si e humbëm kështu fare? «Duhet të falënderojmë Bill Nostringun në radhë të parë», mendoi ai duke u larguar.

* * *

Gjiganti ishte një e keqe më vete. Kështu e kundronte Billi. Një armë e re e Thundrës dhe asgjë më shumë. Sa herë që dilte një armë e re, dilte edhe kundër-arma. Ai nuk çonte peshë në strategjinë e punëtorëve kundër Thundrës dhe nuk ndërronte asgjë. Po ai duhej luftuar si çdo armë tjetër e Thundrës. Lere pastaj anën antinjerëzore të atij projekti...

Ata që çonin peshë ishin topçinjtë e gurëve dhe sidomos ata që u drejtonin krahun. Në nëntëmbëdhjetën ata e ndanë partinë në dyzet copa. Në njëzet e gjashtën e bashkuan me Thundrën. Gjatë inflacionit vunë dhjamë me spekulime. Në njëzet e shtatën e harruan revolucionin për hir të fuqisë dhe lavdisë botërore. Dëshën që çdo gjë të drejtohej nga kapitali në Njuhark. Më vonë në një kohë pak a shumë më të qetë, i morën me sulm sindikatat. Kush sundonte sindikatat, kishte në dorë punëtorët.

Ky ishte një cikël i mbyllur i një periudhe të gjatë, shtatëdhjetëvjeçare. Ai përsëritej në kondita të reja. Megjithatë kishte vitet e veta të heroizmit. Kjo e mbajti gjallë partinë. Sado që mundoheshin të tregoheshin të përparuar dhe modernë, në politikë armiqtë e klasës dhe provokatorët mbetën po ato topçinjtë e vjetër që ndiznin topat me mbushje nga gryka. Gjashtë muaj përpara ata i dhanë një goditje të re partisë. E përçanë. Po që e para herë që i bënë një shërbim të vërtetë asaj; doli nga ajo grupi i Bill Redit me shokë, shpresa e vërtetë e së ardhmes.

Billi ecte drejt të lagjes së irlandezëve. Kishte një mik dhe mendoi ta kalonte atje natën. Kjo ishte një lagje modeste, me shtëpi të ulta. Pak ndryshonte nga getot e çifutëve dhe zezakëve. Gjithë ndryshimi qëndronte në atë që s'ishte aq e përmendur sa ato. Do të vazhdonin të quheshin irlandezë, megjithëse kishin katër breza në Njuhark, ashtu siç do të vazhdonin të quheshin çifutë dhe zezakë ata që kishin po atë vjetërsi prej katër brezash.

Billit i tërhoqi vërejtjen një grua që thërriste të birin. Ai nuk po ia varte së ëmës.

— Eja — i thirri e ëma më në fund. — Eja se të rrëmbejnë gjigantët.

Bill Redi u step. Njeriun e kanë trembur nëpër shekuj me shtriga, me djaj. Tani dolën gjigantët...

* * *

Edhe një tjetër bridhte udhëve, Norman Batleri. Ai u gjet papritmas përpara shtëpisë së Dorotit. Në fakt ai kishte nevojë për dikë ato çaste, për dikë që mos t'i fliste as për shkencë, as për hallet që kishte. Në kartelën e tij dedektivët kishin shënuar që nuk shkonte pas femrave, po se nga zhdukej herë pas here. Kur «zhdukej», ai shkonte te Doroti.

Nga turbullimi ai ngjiti një kat më lart se apartamenti i Dorotit. I zbriti me inat shkallët dhe qëndroi përpara derës së saj.

— Doroti! — i tha ai, kur u hap dera. — Të lutem më ço me maqinë gjer në vilë.

— Mirë, Norman, po hyrë brenda një herë.

U ul në poltronë dhe kërkoi purot nëpër xhepa.

— Mos u lodh, — tha gruaja — kur vjen këtu nuk i ke kurrë me vete.

— Nuk i kam, Doroti...

Ajo buzëqeshi. Nuk e kishte arritur ende atë prak kur gruaja e lëshon veten. Ndoshta donte edhe mjaft kohë që të arrinte, po sidoqoftë që një grua që po i afrohej atij praku. Po ajo kishte diçka që mund ta tregonte të re dhe të dashur, kishte një delikatesë të pleksur me dhemshuri.

I solli një kuti me puro dhe u ul përballë tij.

Batleri heshtte dhe vështronte si ngjitej lart tymi i puros. Kur heshtnin, ata të dy e ndjenin veten ngushtë.

— Ndoshta, Doroti...

Ajo i bëri me dorë ta linte atë bisedë, pa e nxjerrë nga goja.

— Atëhere ai antikuori qenka më i fortë se unë, Doroti...

— Jo — tha Doroti. — Meqë nuk po vendos ende, nuk është më i fortë se ti, Norman. Po nuk u jetoka edhe vetëm...

— Ndoshta ne të dy, Doroti...

— Jo, Norman. Ti flet kështu kur je i mërzhitur.

Ajo u ngrit dhe hapi frigoriferin. Nuk kishte limonadë për Batlerin. Ai nuk pinte kafe në këtë orë.

Ajo u ul me nervozizëm në poltronë, ziente për brenda. Po nuk kishte asgjë kundër tij.

— Më mirë kështu siç jemi, Norman tha ajo pas pak më e zbutur. — Unë do të jem kjo që jam.

Ai u ngrit.

— Po shkoj, Doroti — tha.

— Prit, po të çoj me maqinë.

— Jo, Doroti. S'është nevoja — u përgjegj ai.

Ajo u ngrit në majë të gishtërinjve dhe e puthi në të dyja faqet.

Kjo ishte një histori prej disa vitesh. Përsëritej.
Batleri zbriti shkallët.
Sikur frynte një fillad i lehtë...

* * *

Maksi u lidh me Xhon Stivensin. Meqë bënte buzë në gaz, dukej qartë që senatori po e lavdëronte. Në fund të helikopterit qëndronte Poli. Në mes rojet me bastunë në duar...

Helikopteri kishte dhjetë minuta që ishte ngritur në ajër.

— Qe një mrekulli, Maks! — vazhdoi senatori. — E ndoqa të gjithë ngjarjen në ekran. I përlau leckamanët, i fshiu, i çoroditi.

Nëpër kufje vërshoi si përrua entuziazmi i Xhon Stivensit. Ai mezi përmbahej nga gëzimi.

— Të them të drejtën, nuk prisja kaq shumë — vazhdoi senatori. — Ah, dëgjo! Ecë nga unë sonte. Më kanë sjellë tru elefanti. Pas dhjetë minutash ia hip edhe unë gjirafës sime: Salut!

Veberi hoqi kufjet, pastaj iu afrua Polit.

— Të përshëndesin për atë që bëre — i tha.

Gjiganti nuk e solli kokën.

— Tani më thanë me radio — vazhdoi Maksi.

Prapë asnjë interesim nga Poli.

— Ti je mosmirënjohës, — tha Veberi ashpër. — Mosmirënjohës dhe i keq. Po unë mund të bëj me ty çfarë të dua.

Veberi nxori një puro nga xhepi i jelekut.

— Unë të dhashë atë që më kërkove, ndërsa ti ma shpërblen kështu. Deshe fuqi? Fuqi të dhashë. Dhe me të tepërt... Po duhet të na shërbesh edhe neve... Hëpërhë duhet të qëndrosh në ishull. Do të vijë koha të dalësh që këtej. Ti do të kesh jetën tënde. Askush nuk do të të ngacmojë. Ama duhet të bindesh...

Helikopteri u fut në një re të dendur. Brenda u ndezën automatikisht dritat. Veberi u ul në vend të vet.

Poli rrinte si i ngrirë, si një masiv pa jetë. Vetëm kur dolën nga reja, sollli kokën dhe pa poshtë. Oqeani iu duk i murmë, madje i zi, kreshtat e valëve si kreshta malesh... Majat e tyre sikur çiknin bortin e avionit. Marihuana...¹⁾

Megjithatë kishte çaste që e mblidhte veten. Në këto intervale qartësie ai sillte ndër mend copa nga jeta e tij, mundahej t'i bashkonte ato. Po të shumtën e rasteve ato mbeteshin arna të puthitura keq. Jeta e tij? Një pshe-rëtimë pa ndërprerje...

Nëna dhe kllouni i cirkut. Kllouni i cirkut ishte një tërheqje e veçantë për gratë. I vërtiste ato siç vërtiste kapelat në arenë... Ajo iku me kllounin e cirkut. Nuk është shaka të ndjesh poshtërimin e parë në jetë nga nëna. «Ata paskan pirë xhin dhe shampanjë... sa pis që e kanë bërë dhomën! Këto kuti konservash... Sa i kanë filluar... Mësallat gjithë njolla. Kur do t'i shohë babai... Ai i ndyn për vete...»

Mamuthët! Qiell! Çfarë i bëra vetes... Mjaft më, mister Veber, po më merret fryma! Më vjen për të vjellë. Stop! Urdhërat me kohë, mister Veber. Nuk ka më gaz.

Pastaj jetimorja. Jetimorja me prindër gjallë. Jetimorja dhe mister Siksti. Një lëkurë bualli. Të ripeshin duart duke e fërkuar në banjë. «Më fort, o kallam sheqeri, më fort! Ke hedhur kot së koti gjithë atë shtat. Ku ke ndër mend të arrish? Më fort, thashë! Këtë zhul e kam nga ju. Ju jeni plehu i Njuharkut. Nuk është imi ky zhul. Më fort! Stërviti duart! Do të të duhen posa të dalësh prej këtej. Ke mësuar si boshatisen xhepat? Po si përdridhet një fyt? Ruaj fytin tënd në radhë të parë! Jepi! Ashtu! Ju bëheni banditë që në muajin e tretë».

Pastaj banda e Gringos. Gringoja dhe kontrabanda e duhanit. Fishkëllejnjë plumbat dhe shuplakat e Gringos. Duhanin e pjell deti. Asgjë s'bie më nga qielli. Qi-

1) Drogë

ellin e ruajnë, detin nuk munden. Heshtje! Rrahje lopatash. Rrëshqet një thes në det. «Hej ti, kallam i zgjebosur!» Fishkëllejnë plumbat. Shuplakat e Gringos... Duhet krahe të fortë për t'i bërë ballë Gringos, përndryshe të vdes së rrahuri. Ule kokën, gjersa nuk i ke.

... Marihuana e vë përposh plotësisht. Intervalet ndërpriten.

KAPITULLI IX

Xhoni gjatë gjithë kohës vetëm kishte dëgjuar shpërthimet e mis Karolës. «O zot, mendonte ai, tri shpërthime të tilla në vit dhe duhet të zë ndonjë shtrat në çmendi». Megjithatë në cepat e buzëve ku shtrëngonte puron e trashë i endej një ironi e lehtë që e tërbonte më shumë të shoqen. Mis Karolës i ishte shkrepur të ankohej për Ralfin. Në një ligjëratë të gjatë prej nëne që kujtohet pas ballos se i ka lënë fëmijët të kyçur në shtëpi, ajo iu derdh senatorit dhe i kujtoi me ca fjalë të ashpra që ai vetëm kishte lindur fëmijë, po s'kishte qenë asnjëherë baba. Xhon Stivensi vetëm dëgjonte. Ai sikur donte që ta shante dikush sot për Ralfin, se në fund të fundit edhe ai ishte njeri dhe, kur vinte batica (vinte shumë rrallë, ama), e çëmbonte diçka përbrenda. S'kishte arritur të ndjente ngrohtësinë e prindit! Po këto ishin çaste të rralla, jeta e Xhon Stivensit ishte aq e plotë, aq e ngarkuar, sa në atë magazinë shpirtërore nuk kishte ku të vendosje dashuri për Ralfin. U mërzit më shumë kur i ra inati së shoqes. Ç'do të ndodhte tani? Ja, qëndronin përballë njëri-tjetrit dhe nuk kishin ç'të thoshin më, nuk u dilte asnjë fjalë. Të kesh jetuar njëzet vjet me një njeri dhe të mos kesh ç'të thuash më, kjo është më keq se sa të grindesh. Në njëzet vjet, ata që nuk dinë ta ruajnë, mund të harxhojnë edhe zjarrin më të madh të dashurisë. Vetëm duhet thë-

në që si Xhon Stivensi, si mis Karola, ishin treguar të ndershëm, nuk i kishin premtuar njëri-tjetrit një zjarr të tillë. Martesa e tyre që lidhur ashtu siç lidhen në sferat e larta: një kontratë përpara, një tufë lule dhe bekimi i priftit. Lulet dhe në fund bekimi... Megjithatë, po të mos ishte çështja e Ralfit, Xhon Stivensi mund të thoshte se kishte kaluar një jetë të lumtur. Varet si e kupton lumturinë. Për senatorin, lumturia në martesë ishte sinonim i fjalës «liri». Aq «liri» kishin pasur, saqë Stivensi habitej si e bënë atë fëmijë. Nuk kishte qenë njeri i ftohtë, po zjarrin e kishte harxhuar ku ia sillte rasti. Ai dashuronte ku ndodhej dhe kur kishte kohë. E shoqja nuk e kishte tradhëtuar. Kjo e habiste senatorin. Nuk mund ta kuptonte mis Karolën. Ajo shoqërohej vetëm me burra dhe kishte apo nuk kishte dy-tri mikeshë.

Si kishte mundur t'i qëndronte tundimit? Atij i ishte bërë zakon ta qunte «mal akulli». Mis Karola më vonë e kishte modernizuar këtë epitete dhe, ai i binte shpatullave, i thërriste «ajzberg», duke qenë plotësisht i bindur se po i bënte shumë nder. E lartë, e bëshme, e sigurt, e mbyllur në vetëvete, me sy të kaltër të ftohtë, me një fytyrë të rregullt shumë të bardhë, të rrethuar nga një kurorë e dendur flokësh të verdhë, ajo që tipi i vërtetë i nordikes. Gra të tilla takon dendur në Kopenhagen, në Oslo, në fjordet, po jo në Njuhark.

«Si i ka qëndruar tundimit?» pyeste veten senatori. **Përveç ftohtësisë** në natyrë ajo që fytyra e dytë e Xhon Stivensit. As ajo nuk kishte kohë. **Do të bridhte dhe** do të merrej me gjërat më të pazakonshme. Do të interesohej për rezultatet e kafshëve të egra në Afrikë dhe për kuvendet e misionarëve në Pirene, do të mbante korrespondencë me të dënuarit me vdekje dhe do të përzihet në jetën e basifondeve të Njuharkut, do të merrte nën mbrojtje atë që duhej dënuar dhe do të ndihmonte për të dënuar atë që duhej mbrojtur. Qe një natyrë kontraktore. Vlerësonte vetëm mbresat që lënë gjërat e rënda, tronditëse. Nuk dinte si ta harxhonte energjinë dhe pasurinë e saj. Gjithë ajo energji që kishte, e bash-

konte me senatorin. I ndante qëllimi. Xhon Stivensi rropatej për pushtet dhe para, mis Karola për mbresa, ngaqë nuk dinte një mënyrë më të mirë për të jetuar. I kishte nxjerrë ngatërresa të shoqit, po shpesh padashur e kishte ndihmuar. Të kesh një grua të tillë në Njuhark, është njësoj sikur të kesh një armatë të tërë agjentësh të zotë për fushatën elektorale. Mis Karola kishte qenë një reklamë e mrekullueshme elektorale për të shoqin. Ajo kishte pasur disa flirte të vogla andej-këtej, po kjo nuk quhet tradhëti në Njuhark, ku janë në modë dashnorët dhe dashnoret e deklaruara.

Xhon Stivensi ishte shqetësuar më kot se ajo mund t'i fuste hundët në punët e gjigantëve. Mis Karola nuk hynte kurrë në ato ndërmarrje me të cilat merrej Xhoni. Nuk kishte bukuri aty ku futej Xhoni, aty kishte vetëm para. Kështu mendonte ajo.

«Megjithatë ajo po plaket, mendoj senatori duke vështruar të shoqen. Është plakur madje... Prandaj i bie ndër mend edhe për Ralfin...»

Kishte ngulur vështrimin në veshin e saj të djathtë ku mbaronte e prera e operacionit të fundit plastik. Ai vërejti se mollëzat ishin ngritur ca më lart, i tërhiqte lëkura. Gjithë fytyra e mis Karolës kishte marrë diçka orientale nga ajo e tërhequr e vazhdueshme lëkure.

Ai u ngrit dhe nisi të sillej nëpër dhomë:

— As unë, as ti nuk jemi marrë shumë me Ralfin, e dashur — tha ai. — Pastaj, kushedi... Ndoshta mund të dalë diçka nga ai djalë... Më tronditin karakteret e pavarura. Pastaj —, këtu senatori e uli pak zërin — ai ka trashëguar diçka nga ne të dy.

Ajo nuk bëri zë. I kishte rënë edhe asaj zemërimi.

— Duhet bërë diçka për atë djalë. Të premtoj që do të mendoj për këtë — vazhdoi senatori.

— Mirë, Xho — tha ajo e zbutur plotësisht.

— Sikur të hamë darkë në «Konektik» sonte? Ç'program ke?

Hyri një nga kamerieret dhe ia preu përgjegjen në buzë.

— Ç'është? — pyeti mis Karola.

— Herri Endrijusi dhe Klei Bimeni po presin në sallon, mis...

— Oh, oh! — tha shumë i çuditur Xhon Stivensi. — Që kur njihesh me «Gandhin»? ¹⁾ Po me Klein e egër? Mund të qëndroj edhe unë këtu? — vazhdoi ai pa pritur përgjegje.

— Si të duash — tha gati me mospërfillje mis Karola.

Ai e pa qartë se ajo nuk kishte qejf që ai të qëndronte aty. Senatori bëri sikur nuk kuptoi. Sa vinte dhe po i shtojte kureshtja. Ç'kërkonin këtu ato dy kokë zezakësh?

— Ejani, mister Herri, ejani mister...

E shoqja e senatorit u kthye nga Herri.

— Klei Bimen, mis Stivens. E solla ta njoh me ju. Veç kësaj, ai shpreson që mister Stivensi mund ta ndihmojë për të gjetur një të njohurin e tij, që është zhdukur.

— Jeni shumë i dashur, Herri — tha mis Karola me zë të ëmbël. — E njihni Xhonë? Patjetër e njihni.

Senatori u shtrëngoi duart të dyve dhe i ftoi të uleshin. Herri Endrijusi ndjehej si në shtëpi të vet. U shtriq në kolltuk dhe s'priti t'i ofronin puron, po e mori vetë nga kutia. Dukej që kishte qenë edhe herë të tjera. Rrinte lirshëm. Megjithatë shpengimin e tij e mbështillte një respekt i thellë gati me përulje për vendin ku ndodhej. Qe një burrë rreth të pesëdhjetave, i thinjur, me një fytyrë të shëndoshë dhe të butë. Sytë e tij qeshnin orë e çast dhe, kur hapte gojën, i dukeshin një sërë dhëmbësh të bardhë.

— Herri Endrijusin e njoh — tha Xhon Stivensi me t'u ulur. — Ju nuk ju kam takuar ndonjëherë. Mos e keni gjë Sonin? Son Bimenin, boksierin? I ngjani shumë!

1) Burrë shteti dhe filozof indian. Predikues i rezistencës paqësore kundër englezëve.

— S'e kam gjë — tha Klei.

Senatori desh të shtonte diçka tjetër, po e shoqja e vështroi rreptë dhe ai heshti. Do të bënte më mirë sikur të ngrihej. Nuk e kuptonte?

— Ju dëgjova mbrëmë, mister Herri — tha mis Karola. — Të them të drejtën, më mallëngjyet. Në sallë qanin. Më ngashërvet edhe mua. Doni t'iu them si mbaroi ligjërata juaj? E mësova përmendsh? Ja: «Çfaj ka Herri Endrijusi për lëkurën e zezë? Çfaj ka babai i Herrit? Gjyshi? Stërgjyshi i Herrit? Mbi kokët tona qendron i njëjti zot i kryqëzuar. Ai na pranoi kështu siç jemi. Po të mos na donte, do të na kishte zhdukur».

— Pikë për pikë — thirri Endrijusi i lajkatuar.

— Të kishim edhe dy njerëz si ju, problemi racor nuk do të ishte më problem për ne — tha me tërë mend gruaja e senatorit. — Apo jo, mister Klei?

Zezaku tjetër ngriti supet.

— Klei ka pikëpamje të kundërta me të miat, mis — foli Herri. — Është edhe ca grindavec. — shtoi ai me shaka. — U grindëm gjithë udhën. Po në përgjithësi është shpirt njeriu.

— Të lutem lëri këto, Herri!

— Nuk po them gjë, i dashur, unë po të lëvdoj.

Mis Karola qeshi. Ajo e largoi kamerieren dhe ua mbushi vetë gotat me uiski.

Mbrëmë pas jush dëgjova Odetën ¹⁾ — tha ajo. — E dini që ju jeni një botë më vete. Bota juaj meriton të jetojë, është e thellë. Këngët tuaja më të egra ruajnë atë shenjtëri që ne e kemi zbuar nga budallallëku. Unë them me gjithë shpirt: Predikoni, mister Herri! Këndoni Odetë! Në këtë shekull ku nuk merret vesh ç'po ndodh, ju jeni njëllorj purge e qytetërimit. Do të vijë koha që ne do t'ju kuptojmë ju më në fund, o mik.

— Falem nderit, mis! — tha Herri Endrijusi i përmalluar.

1) Këngëtare zezake

Xhon Stivensi mend ia plasi gazit. Ai kafshonte puron për të mos qeshur. Sa seriozisht i merrte tekcat e mis Karolës Herri, ky baptist i shkretë! Herri Endrijusi e qunin «Gandhi» i Njuharkut». Në filozofi diçka përkonte ky emër, nga pamja e jashtme hiç fare... Në vend të jutës¹⁾ që i mbulonte trupin kockë e lëkurë Eremitit të Benares, Herri Endrijusi u tregonte ithtarëve të tij një kostum të prerë pas modës dhe një bark të mbajtur mirë.

I pëlqente kur e krahasonin me Gandhin dhe, për ta bërë përgjasimin më të saktë, ankohej që klima e Njuharkut nuk e linte të mbante vetëm një copë jutë rreth trupit. Herri Endrijusi nuk ishte hipokrit. Njeriu mendon dhe gjykon për botën nga rrethi ku jeton. Herrin e kishin shkëputur nga rrethi i tij, sado që ai mendonte që tani ishte brenda tij më shumë se kurrë. Ai ishte doktor në filozofi dhe punonte në kolegjin «Benedikt», një nga më të famshmit e Njuharkut, bënte pjesë në këshillën e të drejtave civile dhe kishte një pension jetik prej pesëmbëdhjetëmijë dollarësh në vit, veç rrogës si «Kokë me vlerë kombëtare». Herri Endrijusi ua ndante një pjesë të këtij pensioni organizatave zezake dhe të varfërve të qytetit.

— Të hollat që premtova i mblodha, mister Herri — tha mis Karola. — Mund t'i merrni menjëherë. E mbushni çekun kur të shkoni. Është në emrin tuaj. Të hollat vijnë nga korporata e mishit dhe e veglave optike. Tri-dhjetëmijë dollarë gjithsej. Kaq e kishim fjalën?

— Kaq, mis. Ju falem nderit!

Klei u zgjua vetëm kur u përmenden paratë. Gjer atëhere kishte qëndruar si ai që mezi pret të ngrihet. S'i kishin lënë asnjë rast të fliste me senatorin për qëllimin për të cilin kishte ardhur.

— Përse duhen këto para? — pyeti Klei.

— Nuk e dini? Herri do të ngrejë një teatër kuk-

1) Është fjala për veshjen prej jute të Gandhit.

Ilash që t'i bjerë anë e kënd vendit për të përhapur idetë e tij.

— Teatër kukllash për kukllat — foli lehtë Klei.

— Nuk ju kuptoj — tha e çuditur gruaja e senatorit.

— Ai që nuk kuptoj jam unë, mis — u përgjegj Klei me mirësjellje këtë radhë. — Kukllat janë për fëmijë... Por pritni... Mbase keni të drejtë... Zezaku nuk është rritur, është ende fëmijë. Ndoshta duhet nisur me kukllat. Ama të mos flasë Herri me gojën e tyre. Herri nxjerr vetëm qumësht nga goja.

— Ah, ah! — rënkoi mis Karola e skandalizuar.

— Ç'duhet të nxjerri në vend të qumështit? — nuk iu durua Xhon Stivensit. — Të shtëna me armë si «Panterat»?

— Jo, mister! Vetëm se kukllat e Herrit do të predikojnë durimin dhe rezistencën paqësore. Unë për vete do t'i mësoja ta kërkonin drejtësinë pa u lutur.

— Me një fjalë me forcë? — tha gati me zemërim Xhon Stivensi.

«Mjaft, Xho! Po bëhesh i mërzitshëm» thoshte syri i mis Karolës. Senatori heshti. «Ja një njeri i fortë, mendoi ai për Klein. Ky është një nga krerët. Nuk duhet ta harroj këtë njeri». Ai mendonte për kohën kur mund të fitonte partia e tij. Do ta mbante mend Klein dhe do t'i ofronte një vend. Një rrogë të mirë, një vilë, pushime në Evropë... Gjithmonë kishte menduar për një aristokraci zezakësh. Në betejën përfundimtare ajo do të ishte diga e parë ku do të përplasej furia e negërve.

Zezakët u ngritën.

— Prisni t'ju sjell çekun, mister Herri.

Ndezën edhe nga një purë në këmbë.

— Janë kontrabandë — buzëqeshi Xhon Stivensi. — Gjithë jetën më kanë pëlqyer gjërat e ndaluara. Prisni! — u kujtua senatori. Mister Klei! Ju sikur do të më pyesnit për dikë... Për dikë që është zhdukur...

— Po, mister, për një të afërt timin. Është zhdukur përpara dy vjetësh dhe gjithë përpjekjet tona për ta gjetur kanë shkuar kot. E quajnë Ralf Teneki. Ka

banuar në lagjen zezake dhe është marrë me shitje vje-
tersirash. Ka dy vjet që është zhdukur.

Xhon Stivensi u vrejt njëherë pastaj nxori bllokun
dhe mbajti shënim.

— Do të interesohem për të — tha.

Erdhi Mis Karola me çekun në dorë. Shkëlqente nga
gëzimi.

«O perëndi, sa e re që duket tani! Ndryshon edhe
nga një tekë. Do të jetojë për një javë të tërë me mendi-
min se kushedi ç'bëri! Grua e marrë! Si thotë Kiplingu?
«Si gruaja e kolonelit, si indiania O'Gredi, si gra janë
qjësorj. Grua e marrë! Përmallohet si një manikyriste».

* * *

Xhon Stivensi u takua prapë me Klei Bimenin. Qe
një ditë e keqe, një nga ato ditët që po bëheshin të
zakonshme në Njuhark. Shtinin nga tarraca e një shko-
lle. Sheshi «Xheferson» ishte i blokuar, ndërsa rruga
përpara ndërtesës nga qëllonin ishte krejt e shkretë.
Fishkëllenin plumbat. Mbi asfalt shtriheshin të vdekur
dhe të plagosur, por asnjeri nuk guxonte t'u shkonte në
ndihmë. Tre veta shtinin nga tarraca e shkollës. Plum-
bat e tyre zgjidhnin vetëm të bardhët. Kundër atyre të
treve kryqëzohej zjarri i gjithë policëve dhe snajperëve
të asaj ane të qytetit, megjithatë ata të tre mbaheshin
ende.

Senatori kaloi rastësisht andej. E ndalën. Ishte rre-
zik të kaloje përballë vendit ku shtinin. Nuk mund të
hiqnin dot të plagosurit. Prisinin një autobлиндë...

— S'jam mësuar të pres — tha senatori.

Xhon Stivensi çau përpara. Maqina e tij ishte e blin-
duar. Shumë-shumë mund ta gërvishnin. Kështu ndodhi.
Zunë të shtinin mbi të. Dhe ai, si për t'i futur në ngasje,
e zvogëloi edhe më shumë shpejtësinë. Po u afrohej aty-
re që dergjeshin përdhe, kur pa të shkëputej nga një
qoshe muri një zezak dhe të vraponte duke u bërë dredha

plumbave. Zezaku vrapoi disa metra paralel me maqinën. Senatori njohu Klei Bimenin. E ngadalësoi edhe më tepër ecjen që të mbronte Klein, pastaj frenoi përpara grumbullit të të vrarëve. Pesë veta. Të gjithë të bardhë. Më tutje edhe një grua. Ajo rënkonte dhe përplaste krahët mbi asfalt. Për të kishte rendur Klei.

Zezaku e tërhoqi gruan, hapi derën e maqinës dhe e futi brenda.

— Ç'po bëni? — pyeti Xhon Stivensi i habitur.

Vetëm atëhere e njohu Klei senatorin.

— Mendova se ishte maqina e policisë — tha. — Më falni. — Ai mbeti një çast, pa ditur çfarë të bënte. Pastaj e mori veten përnjëherësh dhe tha me zë të vendosur: — Kjo grua duhet dërguar menjëherë në spital.

— Mirë, hipni! — mori një vendim të ri Stivensi. Maqina bëri pak praptas dhe u kthye. Breshëria e plumbave u përsërit mbi mbulesë.

Senatori i hodhi një sy gruas, pastaj Klei Bimenit.

«Ja çfarë bëjnë zezakët, u thoshte ai vështrim. Ju nuk mund ta lani këtë as duke rrezikuar jetën për të ndihmuar një grua».

Kështu e kuptoi zezaku vështrimin e senatorit. Ai mbante në duar kokën e gruas që tani kishte humour ndjenjat. Gruan e kishin qëlluar në kokë dhe në gjoks.

— Me siguri «Panterat»? —

— Panterat besoj... Por...

— Ç'deshët të thoshit me atë «por»? —

— Ka edhe provokatorë — tha Klei. — Jemi takuar kaq herë me ta. Duhet dalluar gjërat.

— Njuharkezi nuk bën dallim — u përgjegj senatori. — Ai është mësuar të vështrojë ngjyrën e lëkurës...

— Sepse kështu e kanë mësuar — tha Klei. — Pastaj, po ta shohësh hollë-hollë punën, ajo që po bëjnë ata të tre nuk ndryshon aspak nga ç'kanë punuar të bardhët kundër nesh.

— Jo të gjithë të bardhët — qeshi Xhon Stivensi.

— Jo të gjithë të bardhët — pranoi Klei.

— Megjithatë sikur po i marrim nën mbrojtje ata që bënë këtë mynxyrë...

— Jo! — tha Klei. — Madje ata do t'i dënoja. Nuk fitohet gjë duke vrarë çdo të bardhë që takon rrugës. Ata e zhvillojnë luftën e tyre ashtu si racistët e bardhë. Lufta jonë nuk duhet të jetë luftë racash, mister Stivens. Nuk fitohet kështu.

— Kështu jo, si Herri Endrijusi jo... Po në ç'mënyrë? Jam shumë kureshtar ta di.

Klei nuk foli.

— Keni lajme nga Herri, mister Bimen?

— Jo! — tha Klei. — Nuk kam ndonjë miqësi të ngushtë me të. Jemi takuar tri-katër herë nëpër mblehje zezakësh.

— Doni të dini mendimin tim, Bimen? Unë ju përkrah plotësisht. Vetëm se ju nuk mund të dilni në dritë pa një dorë të fortë, një dorë të bardhë. Kërkojeni atë dorë.

«Ku kërkon të dalë?» mendoi Klei.

Nuk foli më. Klei mendonte për Endrijusin. E kishte parë parmbremë në televizor duke dhënë shfaqje me grupin e tij shëtitës. Si e kishte titullin ajo dramë për kuklla? «Moisiu»? Apo «Samsoni»? Klei i ngatërronte gjithnjë këta emra. A nuk ishte për t'u vajtuar fati i atij Herrit? Kush i mbledhej kur jepte shfaqje? Katër-pesë pleq dhe një turmë fëmijësh që mbllaçisnin çimçakëz. Përse nuk kthehej Endrijusi? Çfarë shpresonte? Kleit iu kujtua biseda që kishte pasur me të kur po dilnin nga vila e Xhon Stivensit. «Nuk t'u duk interesant ky takim, Bimen? Mua më la shumë mbresë. E dëgjuat ç'tha mis Karola? «Në këtë shekull nuk merret vesh ç'po ndodh, ju jeni një lloj purge e qytetërimit. Do të vijë koha që ne do t'ju kuptojmë më në fund, o mik.»

«Po del në dritë një brez i ri të bardhësh, brezi i të pasurve realistë. Duhet të mbështetemi tek ata. Kush do të na trajtonte në një tryezë si të barabartë njëzet vjet përpara? As që mund ta ëndërronim këtë, Bimen.»

— Spitali është në të majtë, mister Stivens...

Senatori frenoi përpara një ndërtese dykatëshe.

— Këtu po zbres dhe unë. Ju falemnderit, mister Stivens!

— Jo, qëndroni! Sot ka rrezik t'ju linçojnë. Nuk shikon që s'duket asnjë zezak nëpër udhë? Pastaj dua të bisedoj me ju.

E lanë të plagosurën dhe u kthyen. Senatori i zgjati një puro. Zezaku e ndezi pa i këputur majën. Tjetri buzëqeshi.

— Kështu më shijon më mirë, — tha Klei pa çarë kokën. Tani vetura bënte përpara me shpejtësi të madhe. Klei rrinte si mbi gjemba. Ç'djall e takoi me Xhon Stivensin?

Nuk këmbyen asnjë fjalë, gjersa arritën përpara kangjellave të hipodromit. Senatori i bëri me shenjë Kleit të zbriste.

— Ejani, pra — tha senatori.

Zunë një vend shumë të mirë në tribunën qendrore.

— Djall, o punë! — tha Xhon Stivensi. — Lashë dybitë në maqinë. Ju lutem, Bimen, Ja çelësat...

Klei nuk luajti nga vendi.

— Mister Bimen, ju lutem, jeni më i ri...

— E shikon atë zijosin atje? Atë kalin që vrapon nga mesi me qafën e shtrirë fort? Është «Kaligula». Kam vënë pesë dollarë për atë kalë dhe mos qoftë thënë, të humb — vazhdoi Xhon Stivensi.

Senatori ishte i përqëndruar aq fort pas vrapimit të «Kaligulës» dhe vazhdimit të garës, sikur të kishte një pasuri të tërë në rrezik.

— Luani ju në totalizator, mister Bimen?

— Jo! — tha Klei.

— Dhe bëni mirë, o mik, Totalizatorin e manovron një bandë maskarenjsh. Njëherë më vodhën njëzet dollarë sy ndër sy — tha senatori me zemërim.

Klei Bimenit i vërtitej një pyetje në majë të gjuhës. Ai nuk duroi më dhe pyeti në kishte mësuar gjë për Ralf Tenekin.

— Ende jo, i dashur — u përgjegj Xhon Stivensi.

Grupi i kuajve po bënte rrethin e dytë. «Kaligula» ishte ndër të parët. Ai u zhduk bashkë me një re pluhuri.

Xhon Stivensi i zgjati dylbitë Kleit.

— Më duket se mbeti në udhë — tha Klei.

Senatori ia hoqi me rrëmbim dylbitë.

— Për besë... — tha. — Po, jo! jo! E mori veten. Ecë, zijosh. ecë! — thirri me gjithë mushkëritë senatori.

«Kaligula» arriti i tretj në finish.

Senatori u hodh përpjetë nga gëzimi. Nisi të thërriste. të hidhte kapelën në erë. Ai e shkundi disa herë tort Klei Bimenin.

— Ç do të kënaqem nesër me ata matufët e mi — tha. — Po më ecën. — Gjithmonë po u fitoj bastet senatorëve matufë. Po pse rrini i ngrysur? Nuk ju tërheq kjo garë? Natyrisht kur nuk vë baste, s'ke ç'të shohësh — th. ai duke harruar çfarë e kishte këshilluar Klein pak përpara.

Klei nuk dinte ç'të thoshte. Një grup tjetër kuajsh u derdh përpara për një garë të re.

— Ju do të më thoshit diçka, mister Stivens — foli Klei i mërzitur.

— Ah, po! — u përgjegj senatori pa i hequr dylbitë nga sytë. — Ndoshta ne të dy mund të bashkëbunojmë, mister Bimen. Do të vënë kandidaturën time për president. Dhe do të fitojë patjetër. Që kur ju pashë për herë të parë, mendova. Çfarë posti mund t'ju ofroj, mister Bimen. Më duhen njerëz si ju. Mendoni për këtë.

Kleit i kërceu gjaku në fytyrë.

«Do të më blejë, mendoi. Do të më blejë...»

— Shiko, o mik — tha Xhon Stivensi me gëzim. — Shiko ç'mrekulli... — Ai i zgjati dylbitë zezakut dhe e tërhoqi pranë vetes.

Klei Bimenit iu errësuan sytë. Nuk pa asgjë. E turbulloi gjithë ai afrim i senatorit, ajo sjellje e tij e përzemërt dhe e çiltër.

«Mos ka të drejtë Herri? mendoj ai. Mos po del në dritë një brez i ri të pasurish realistë?»

KAPITULLI X

— Më është mbushur mendja top — po i thoshte Albanoja Billit — që filli i këtij lëmshi nis nga ishulli i «Kanarinave». Duhet të lidhemi patjetër me të.

— Kështu mendoj edhe unë. Po më duket gati e pamundur të lidhemi me ishullin. E shoh që do të ngarkohem unë me këtë detyrë.

— Ka ndonjë të re nga hungarezi?

— Asgjë veç parave që dërgon me thes si gjithnjë. E shoqja derdhi dje në arkën e partisë dhjetë mijë dollarë. As ajo s'dinte më shumë se ne për Çarlin.

— Heshtja e tij po bëhet e rëndë tani — tha Albanoja.

— Do të bëhem gjithnjë garant për Çarlin, Albano.

— Nuk thashë që dyshoj. Thashë që kjo po bëhet e rëndë tani.

— E rëndë — tha Billi.

— Vështro, Batleri...

Bill Redi qëndroi. Kishin arritur përpara vilës «Trinidad». Profesori rrinte në një bankë dhe trazonte gurikat me bastun.

— Ndoshta do të kishim bërë mirë të kishim hyrë që prapa.

— Jo, Bill. Vila ruhet. Edhe shumë mirë, madje. Vë bast që fytyrat tona i shohin tani në ekrane dhjetëra qëndra vëzhgimesh. E kam hallin gjetiu. Ndoshta nuk duhet të vinim kështu. Mund të rrezikojmë dhe nga ana tjetër të mos nxjerrim asgjë.

Billi nuk po ia vinte veshin. Ai vështronte Batlerin.

— Prit! — Albanoja e zuri për krahu Billin.

Përpara vilës qëndroi një kamion i mbufuar. Nga ai kërcyen përdhe spanjolët e Njuharkut. Armurat dhe hesh-

tat e tyre përpiqeshin me një zhurmë metalike pas pllakave të trotuarit. Gjoksoret prej çeliku shkëlqenin, po kryqi mes tyre mezi shquhej nën morinë e zinxhirave dhe zbukurimeve. Përkrenaret i kishin ngritur me çip përpjetë si për paradë. Nën to u dukeshin leshrat e zeza dhe të shpeshta, simbol i një race krenare dhe të pashtruar.

Dy nga spanjolët bllokuan trotuarin në dy skajet e tij. Ngulën cfurqet (betoni thërmohet nën cfurqet e Albës) dhe shtrinë mbi to arkuebustat. Kalimtarët u shpërndanë si nga ndonjë tufan. Nuk donin të kishin punë me ushtarët e Filipit të dytë. I kishin të freskëta kujtimet e vendeve të ulëta.

Zbriti Alba, me atë mjekrën e zezë me qime të rra-lla, me atë pamjen krenare. Ishte aq fisnik, sa qe gati të fyhej edhe nga cicërimi i zogjve. Zbritën magistri dhe inkuizitori i madh. Ata të dy i shoqëronte një aureolë flake dhe tymi të lehtë, siç i shoqëron drita shenjtorët e Rafaelit. Pastaj murgjër dhe kapuçinë, njerëz që ushqehen me elb të zier dhe peshojnë dyqind paund. Zbriti dhe kryqi i madh, i shenjtë. Ai duhet të kishte bërë një udhë të gjatë nga Palestina dhe besimtarët duhet ta kishin cfillitur duke i hequr nga një ashkël çudibërëse. Ai duhet të kishte qenë tepër i fortë që mbeti i gjallë nga flakët e vendeve të ulëta. Pastaj një deng i madh kashte u rrokullis nga kamioni, përshkoi trotuarin dhe u mbështet lehtë pas kangjellave të vilës. Kashta u derdh andej-këtej mbi pllakat prej betoni dhe e përzjeu më mirë kohën moderne me mesjetën. Murgjërit këmbëzbathur u derdhën nga vila. Fluturuan gurë, shishe dhe kuti konservash. Kur hynte Alba në Anversë e përshëndetnin duke mbyllur kanatat. Gjatë gjithë udhës kanata që mbylleshin. Trak! Trak! Trak! Ai do t'ua shkurtonte ata krahe që zgjateshin jashtë dritareve për të mbyllur kanatat!

Batlerit nuk kishte kush t'ia ulte ruletat dhe xhamat i bëheshin copë. Anversën e lajmëronin njëzet e katër orë përpara se të dukej Alba. Njuharkun jo.

Murgjërit mbështetën kryqin e madh pas kangjellave. Zunë të çirreshin dhe të thërrisnin më keq se njëmijë të çmendur.

- Batler!
- Magjistar!
- Monstër i Lejdenit! Antikrisht!
- Në kryq! Kërkon të prishë digën, përbindshi. 1)
- Ndizni zjarret, për njëmijë djaj!
- Vëllezër murgjër! Sikur e ndjej ujët gjer në fyt.

I ka prishur digat antikrishti. Po mbytemi, vëllezër!

Murgu zuri fytin me duar dhe nisi të vërtitej si fugë nëpër trotuar. Të tjerët bënë një hap prapa duke mermëritur gjithë arsenalin e shenjtë. Murgu u përplas mbi trotuar dhe zuri të rrihte këmbët pas betonit. Këmbët e tij ishin të bardha dhe pa kallo, megjithëse kishte bërë dymbëdhjetë pelegrinazhe në Palestinë.

— Shpirtërat pastrohen me zjarr dhe me hekur! — foli Alba krenar. — Bëj detyrën, inkuizitor i madh! Edhe në pastë tri kokë si Cerberi, i dua të tria në shalë të kalit.

— S'do ketë ç'të varë fisnikëria juaj. Zjarri nuk le trofe... — foli një nga spanjolët me drojtje.

Batleri ishte ngritur në këmbë dhe mbante ballin me dorë. Mbi faqe dhe mbi pëllëmbë i rridhnin currila gjaku.

Turma u drodh brenda. Tyta e Arkuebustës puthitej tani pas gjoksit të Bill Redit. Megjithatë spanjoli kishte vënë syrin në shenjështër...

— Të lajmërojmë policinë! — thirri Billi. — Ç'është kjo, Albano?

— Linçim! Ke armë me vete? Për besë Batleri po ma këput shpirtin!

— S'kam armë, — tha Bill Redi. — Të lajmërojmë policinë, Albano! — Shoku i bëri me gisht nga qoshja e rrugës. Dy policë trupmëdhenj ruanin qiellin qetë-qetë.

Spanjoli s'e hiqte syrin nga shenjeshtra. Gjoksi i Billit dhe tyta e Arkuebustës shtynin njëri-tjetrin.

Batlerin e kishin vënë mes katër heshtash dhe po e shtynin me të goditura drejt kryqit. Timurlengu ishte sjellë një kohë më nierëzisht me Bajazitin. Thua ta mendonte këtë Batleri? Buzëqeshja i kishte ngrirë në fytyrë.

1) Aluzion për digat në vendet e ulëta. Pak a shumë edhe sinonimi i kryengritësit në vendet e ulta.

Bill Redi i dha një të shtyrë të fortë cfurkut që mbante Arkuebustën dhe u derdh përpara. Arma u shkreh nga përplasja, plumbi përshkoi vitrinën e dyqanit përballë dhe u ngul mbi një manekin. Manekini u rrëzua në një pyll kapelash, korsesh dhe kombinezonesth. Njuharkezët u sulën të ngrinin manekinin.

Billi dhe Albanoja u sulën të shpëtonin Batlerin...

Alba fërkoj mjekrën. Po bëheshin tri kokë! Ai u bëri me shenjë spanjoleve të hutuar nga Billi dhe Albanoja. Heshtat dhe tytat e Arkuebustave u derdhën mbi ta. Megjithatë ata arritën të dilnin përpara Batlerit. Tani goditjet i merrnin ata dhe jo Batleri.

Inkuizitori i madh ngriti cepin e pelerinës. E zbatuan menjëherë urdhërin, e afruan kashtën në këmbët e kryqit.

— Tri shtriga në zjarr! — thirri inkuizitori i madh që rrinte te kryqi.

Billi fshiu gjakun nga sytë. Të ishte e vërtetë ajo që pa? Njohu «spanjolin» Bill Nostring!

Edhe ai e pa. Sytë e tyre u kryqëzuan.

— Edhe ti qenke spanjol, Bill?

Ra nga një e goditur me heshtë. Po e ngritën prapë. Drejt kryqit nuk duhet shkuar zvarrë kur do të vdesësh, vetëm kur lutesh.

Nostringu i shpërndau rojet me grushte dhe me shqelma.

— Prapa, zgjebarakë! Prapa, murgj të Pirenejve! Ai është Bill Redi!

Ia lëshuan udhën të hutuar, të mrekulluar. Ushtarët e Albës i besonin mrekullisë. Mrekullia i bënte ata të vdisnin pa frikë dhe të krijonin paraajsën. Mrekullisë i besonte dhe Alba, po jo tani. U bëri shenjë ta futnin edhe Nostringun në rreth.

— Katër shtriga në zjarr! — ulëriti ai që rrinte tek kryqi.

Murgjërit ngritën duart drejt qiellit. Batleri sikur pa të feksnin brilantet nëpër gishtat e asketëve. Pa dhe orën «Atlantik» me zinxhirë platini. Orët e tyre kishin mbetur pesë shekuj prapa.

— Abrakadabra ¹⁾! — thirri me sa fuqi kishte Bill Nostringu.

Albës iu drodh mjekra, ushtarët i lëshuan krahët poshtë, murgjërit u ngritën në majë të gishtërinjve për të qenë sa më afër qiellit.

— Akrakadabra!

Spanjollët u prapsën, dikush ra në gjunjë, të tjerët çapëluan sytë të tmerruar. Inkuizitori i madh u fsheh pas kryqit të vërtetë.

— Akrakadabra! — bubulloi zëri i Nostringut për të tretën herë. Ai kishte ngritur duart lart dhe mbante dy sfera të zeza metalike mbi kokët e inkuizitorëve. Dy sfera metalike të ndara copa-copa si kurriz breshke, abrakadabra e erës moderne!

— Prapa! — u dëgjua zëri nervoz i Albës. — Kanë prishur digat! Do të kthehemi pas baticës.

*
* * *

— E shihni që anarkia është e dobishme? — tha Nostringu.

Nuk i dhanë përgjegje. U kthyen nga Batleri.

— Profesor!

— S'kam gjë — tha ai me një fije zëri.

Currilat e gjakut tani i ishin tharë nëpër fytyrë e duar dhe u ngjanin degëzimeve të myshqeve detare. Nuk ishte i trembur, madje qe i ftohtë. Një apati e thellë e kishte pushtuar. Aq fort spikaste kjo, sa që ata të tre e ndjenë veten të fyer.

— Duhet të largohemi, — foli Albanoja, — tani hyn në valle policia. Ejani me ne, profesor!

Batleri tundi kokën.

— Do të rri këtu — tha. — Falem nderit!

Mezi e nxori fjalën e fundit.

1) Fjalë magjike. Në mesjetë besonin se kishte fuqi çudibërëse.

Billi dhe Albanoja u panë sy më sy. Nuk mund t'ia kthenin mendjen Batlerit.

— Lamtumirë, profesor!

Batleri u tundi kokën.

Nostringu në gjunjë po ndizte kashtën.

— Ç'bën, o i çmendur?

— Zjarr! Është që është kashta...

Albanoja ia shkeli me këmbë.

— Çuditeni që isha me ata që sulmuan Batlerin?

— Jo, të kemi parë edhe më keq!

— Ti, Bill, je i ashpër edhe kur të shpëtojnë jetën.

— Sidomos kur ta përmendin...

— Djalli ju marrtë! Unë u ndodha rastësisht me ta. Asnjërin nuk e njoh. Gjithë kjo nisi nga «Pirati». Po hidhja një gotë. Më ra era zjarr dhe vajta pas tyre. Po s'ma merr mendja se do digjnin njeri. Veç druri do të vlonte aty te kryqi...

— Është mirë të ndahemi. Kështu si jemi, mund të biem në kurth menjëherë.

— Qëndroni pas kthesës. Jua sjell unë taksinë — i tha Nostringu Albanos.

— Është gatuar keq — tha Albanoja kur u largua Nostringu. — Sa dobi do t'i sillte çështjes sonë energjia e tij...

— Nostringu nuk do të na sjellë kurrë dobi. Sjellja e sotme që më shumë anarki e pastër, se sa dëshirë për të na shpëtuar nga druri.

— Mos je pak radikal më shumë se sa duhet, Bill?

— Jo, do të bindesh edhe vetë.

— Ja policia!

Nga maqinat kërcyen të parët fotoreporterët, pastaj policët.

— Fotoreporterët gjithmonë të parët. Sulen si ujçit

...

— Ç'që gjithë kjo që ndodhi, Albano?

— S'di si të them. Një gjë është e sigurt, nuk qe diçka e rastit.

— Vë bast që Norman Batleri e ndjen veten më ngushtë tani përpara fotoreporterëve se sa kur e qëllonin me gurë. Ç'njeri! Sikur ta rrëmbenim ne, Albano?

Albanoja e vështroi me çudi.

— Dashke ta kthesh partinë në tupamaros? ¹⁾

— Nuk u shpreha drejt. Desha të them ta hiqnim që këtu, ta fshihnim nga këta... Ta bindnim të vinte me ne.

— E para e punës ne s'dimë kush janë «këta» dhe kush është Batleri. Për t'u sqaruar erdhëm gjer këtu. Nuk dimë as kush e lufton, as kush e mbron. Nuk dimë ç'lidhje ka Batleri me njeriun gjigant. Nuk duhet të nisesh nga qëndrimi i atyre dy policëve që vështronin qie-llin. Ndoshta kishin udhëzim të mos përziheshin. Pak herë ka ndodhur kjo?

Billi zuri kokën me dorë.

— Kam ngrënë gjithë ato grushte — tha.

Erdhi taksia. Hipën prapa.

— Ku duan të shkojnë zotërinjtë? — u zgërdhi Nos-tringu.

— Në djall! — u përgjegj Bill Redi që u zemërua nga e qeshura e tjetrit. Si nuk i bëhej vonë për asgjë atij?

— Atëhere çoi në djall zotërinjtë! — i thirri Nos-tringu shoferit përsëri duke qeshur.



Maksi i ngjiti shkallët me një frymë. Pa senatorin që pinte duhan i fundosur në kolltukun prej sfungjeri. Në qoshe i vajtën sytë te Martin Parkeri. Skulptori kishte vënë duart në bel dhe sodiste veprën e vet, statujën e Xhon Stivensit. Maksi u pre nga qetësia e këtij të fundit.

1) Është fjala për organizata ekstremiste të majta. Vepronë kryesisht në Amerikën Jugore.

— S'e ditkeni? — tha ai me një frymë.

— Çfarë, teutonikus? Ç'ke kështu? — pyeti me qetësi Xhoni.

— Batleri... — tha Maksimi duke gëlltitur fyerjen si gjithnjë. E sulmoi një turmë leckamanësh... U demaskua kështu botërisht. Ata do ta kenë trembur për vdekje. S'kemi më asnjë shpresë ta bëjmë për vetë...

— Të kam ditur më gjakftohtë, Maks... Do një uiski?

«Ah, djall! Njëpërkë! Kërmë e pëgërë! Mi Antilesh! Më plase, më thithe palcën e kockave. Gjer kur kështu?»

Veberi u shemb në poltronë. Senatori i mbushi gotën. Tjetri e rrëkëlëu me një frymë.

Senatori u ngrit dhe i bëri shenjë Veberit ta ndiqte.

Martin Parkeri nuk kishte ndërruar pozicion. Xhon Stivensi i ra kokës me gisht dhe shpërvoli buzët. «I kanë rrjedhur trutë», desh të thoshte ai.

Hynë në studio. Senatori shtypi një buton. U ndriçua një ndër ekranet. Për dhjetë minuta Maksimi pa aty gjithë skenat e sulmit kundër Batlerit. I erdhi plasje që qe treguar aq naiv. Si nuk i kishte shkuar nëpër mend se atë e kishte organizuar vetë Stivensi?

— Ai që ka ngritur granatat mbi kokët e të tjerëve është Bill Nostringu, mbreti i anarkisë në Njuhark. E shet veten për të kuq, po tani po i ndjek pikë për pikë udhëzimet që i kanë dhënë.

— Lëvizni, krimba! — thërriste Bill Nostringu. — Ecnit t'ju dërgoj të gjithë te krijuesi Hë, pra, u stepët?»

— Ky sikur kërkon t'i nxisë dhe jo t'i frenojë — pëshpëriti Veberi duke u dredhur lehtë — Sikur kërkon të hidhet në erë bashkë me turmën. Ama mirë ua ka gjetur. Krimba! Ç'do të jenë këta?

— Borgjezë me jetë të siguruar. Ai që është fshehur pas kryqit është portjer në «Astoria»... Të tjerët nuk i njoh.

«Lëvizni, krimba!» bubulloi rishtazi zëri i Nostringut.

Bill Redi

Krimbat i tkurrën unazat e shpinës. Te unazoret kjo përcaktonte çastin kur do të lëviznin përpara, po më pas unazat u sheshuan dhe ndodhi e kundërta. Krimbat bënë prapa, e lanë vilën dhe se nga u zhdukën.

— Njërën nga ata të dy se ku e kam parë, — tha senatori, — po nuk më kujtohet.

Ai shtypi një buton tjetër dhe i përsëriti kuadrot e fundit. E kishte fjalën për Albanon dhe Bill Redin.

Tingëlloi videofoni.

— Mister Xhon?

— Po!

— Policia kriminale. Ata të dy për të cilët pyetët janë Bill Redi dhe Albanoja. Mbiemrin e të fundit nuk e njohim. Ndër rrethet punëtore e quajnë shkurt Albano. Të dy janë kokat e partisë së organizuar rishitas. Kjo parti është fanatike e marksizmit dhe s'ka lidhje me të majtët e tjerë. Nëse doni më shumë...

— Mjafton. Ju falem nderit!

Senatori e mbylli videofonin.

— Po ç'deshën ata në vilë? Hë, përgjegjuni, Maks? Erdhën rastësisht? Jo, për Polluksin! Këtë nuk e ha Xhon Stivensi, se i është regjur lëkura si e buallit! Të kuqtë po interesohen për Batlerin... Po mua ende nuk m'i ka ngrënë kush përpara bananet...

— Nuk mund ta kuptoj atë që i ndodhi sot Batlerit, mister Xhon. Ngado që ta vërtis, nuk e kuptoj dot.

Senatori shkundi llullën dhe u kthye nga Veberi.

— Ai duhet ta kuptojë se ndodhet në rrezik. Shokët e Bill Redit duhen çorientuar. Ata nuk duhet ta dinë që Batleri s'do të bashkëpunojë me ne dhe që s'është ai krijuesi i gjigantëve. Batleri kështu mbetet i izoluar dhe pa asnjë mbështetje. Trakti që shpërndanë Bill Redi me shokë tregon që kam të drejtë kur flas kështu.

— Trakti?

— Posi! Kanë mbetur na gazetë tani dhe përpigën me forma të tjera. Aty shkruhet për gjigantët si për

përbindsha parahistorike dhe akuzojnë qeverinë që do ta degjenerojë racën njerëzore për qëllime fitimi. Për Batlerin asnjë fjalë. Trakti doli gjashtë orë pas ngjarjes në «Trinidad». Nuk dinë ç'qëndrim të mbajnë ndaj tij, prandaj nuk shkruajnë gjë. Ngjarja e mëngjezit i ka trullosur.

— Paskan shpërndarë trakte... — tha Veberi me një farë çudie.

— Posi, pesëdhjetëmijë copë. Ndoshta edhe më shumë. Dhe i kanë shpërndarë sa çel e mbyll sytë.

— Ata janë një fuqi e vërtetë, mister Xhon. Fuqinë e tyre unë e shoh në çdo hap në Njuhark. Ajo i ngjet lumit që vërshon nën akuj. Po kur të shkrihen akujt...

— Mos e bëj kaq tragjike, Maks. Ata mund të kenë numrin, ne kemi cilësinë. Cilësia e mund sasinë. Ne kemi një mbështetje të fortë te njuharkezi i mesmë. Qindra mijëra dyqane të Njuharkut janë mbështetja jonë e patundur. Sa të ecin mbarë ato me reklamet me kripton përsipër, flije mendjen. Pastaj ne kemi në dorë fuqinë. Po nuk ditëm ta mbajmë fort. Ie të na e marrin! Në krye të disa dekadave ka gjithnjë një pikë kritike, një moment shpërthimi. Ja kështu si tani. Po e hodhëm atë, e sigurojmë edhe një dekadë. Unë nuk u besoj ndryshimeve, as shoqërizimit të pronës. Edhe po të ndodhë kjo, shoqëria do të kthehet prapë aty ku ishte përpara. Kështu e kuptoj unë, kështu e besoj. Kjo më ngushëllon dhe më jep fuqi. Pastaj më pëlqen lufta, Veber, ndeshja... Lufta dhe ndeshja janë zhvillim. Unë i përmbahem ciklizmit. Po mos prit fillozofira nga unë. Unë i shoh shumë thjesht këto gjëra, gati si një shitje në ankand. Kështu dhe kështu...

Shkundi llullën dhe e mbushi rishtaz me duhan.

Veberi kishte mbetur si në gjemba. S'e kishte dëgjuar kurrë senatorin të fliste aq gjatë. Kjo tregonte që ai ishte i shqetësuar.

— Në Njuhark drejtojnë një turmë pelikanësh — tha

papritmas Xhon Stivensi. — Gjer tani ata janë mësuar të zgjasin sqepin dhe të gëlltisin senduiçe! Mohikanët ishin më modernë se këta. Dhe kryepelikani, presidenti ynë i nderuar, më thoshte dje se duhet të dalë patjetër ai president që të mund të çajë qetësisht përmes dallgëve popullore anija e kombit. Pikë për pikë fjalët e tij!

Veberi nuk dinte ç'të thoshte. Zemërimi i senatorit kishte arritur kulmin.

— Do të përfytem me pelikanët në zgjedhjet e afërme, Veber. Do t'i vë përpara. Fushatën e filloj që sot, prandaj s'është sekret.

«Xhon Stivensi president! mendoj Maksi. Ç'e mirë do të vijë nga kjo?»

Hyri kryeshërbëtori.

— Ora është tetë, mistër Stivens! — tha ai.

— Mirë, mirë.

Kryeshërbëtori doli.

— Bëhu gati, Maks.

Tjetri i hodhi një vështrim pyetës.

— Do t'i vemi Norman Batlerit.

Maksi nuk bëri zë. Në tetë e gjysmë kishte lënë një takim me të atin. I ati e kishte kërkuar në këtë orë.

— Ngrehu, Maks. Duhet të shkojmë patjetër.

— Nuk mund të vij, mistër Stivens. Kam lënë një takim në tetë e gjysmë.

— Po më çudit! Punën kryesore përpara, të tjerat pas ballos — u tall ai. — Ecë, tundu. Dhe përpara Batlerit mos qëndro as shenjtor, as i çuditur për atë që i ngjau. Kjo është një vizitë mirësjelljeje dhe asgjë më shumë. Do t'i matim pulsin.

Ishte e kotë ta kundërshtojë Xhon Stivensin. Maksi u ngrit. Senatori iu afrua kalendarit elektronik dhe lëvizi një levë.

— Nesër kontrata me kantierët e ndërtimit të anijeve.

— Nesër në orën 16.00 debati mbi buxhetin. Fjalimi i senatorit Kroll në orën 17.00.

— Nesër nënshkrimi i huasë për Venezuelën. Në orën 17.00.

— Ta hajë dreqi! I kanë lënë në një kohë, — tha senatori.

— Nesër banketi për çiftin Elis. Në Star Billokug. Në orën 22.00.

— Bota martohen, ne na çaj në kokën...

— Pasnesër arrin transatlantiku «Batarava». Brenda është Stenli Pris.

Senatori ngriti levën. Maqina pushoi.

— Dëgjove, teutonikus? Pasnesër arrin Stenli Pris, asistenti dhe miku i zemrës i Batlerit. Transatlantiku do të arrijë nga ora trembëdhjetë në port. Duhet të takohesh me mua patjetër nesër në mëngjes.

E luajti edhe një herë levën e kalendarit për të parë programin e mëngjezit. Pas dhjetës kishte gjysmë orë të lirë.

— Më dhjetë e pesë në shtëpi — tha.

— Mirë! — u përgjegj Veberi.

Dolën nga studioja. Në dhomën ngjitur qeshnin me të madhe Martin Parkeri dhe gruaja e Xhon Stivensit. Sidomos kjo e fundit s'përmbahej fare.

— Arti do të vdiste, po të mos ishin gratë — filozofoi senatori. — Gratë i mbajnë artistët.

Veberi nuk foli. Ai pranonte vetëm gjysmën e mendimit të Xhon Stivensit, gjysmën e fundit...

* * *

Maksi u zu ngushtë përpara syve të fraulein Evës që tregonin një çudi të jashtëzakonshme. Si është e mun-

dur që të vinte me kaq vonësë ai që tërë jetën kishte
qenë i përpiktë si një orë «Omega»?

— Po më pret babai?

— Besoj të jetë zemëruar shumë, herr Veber.

Maksi bëri një shenjë padurimi me dorë dhe ngjiti
shkallët dy nga dy. E shtyu derën e të atit dhe u çudit
pa masë nga gjithë ata njerëz. «Tërë grupi «Kaizer»,
belbëzoi Maksi. Ç'dreqin duan?».

I shikoi të gjithë me radhë sikur t'i kalonte në re-
vistë. Ai pranë të atit ishte tregëtari i sallameve, Volf
Tanebergu. Ndenjur ai qe një njeri i qetë, që s'tregonte
ndonjë gjë të veçantë. Në këmbë kuptohej menjëherë që
kishte rrahur detrat. Ecte duke u lëkundur. Pas tij qën-
dronte Ernst Lothari me kokën e shogët dhe nofullat si
të kaut. Ai shiste benzinë dhe prodhime nafte, po në
vend të erës së karburantit kundërmonte livando. Të
tretin nuk e njohu. Qe një burrë rreth të tridhjetave, me
një fytyrë të pastër dhe sy të kaltër që i shkrepëtinin.
Jaka e këmishës së tij të verbonte nga bardhësia. Hans
Vinteri, një gërdallë kockëdalë gogësinte dhe nxirrte herë
pas here shaminë nga xhepi. Si gjithnjë edhe kësaj here,
syzet i kishin shkarë në cep të hundës dhe ai i ngrinte
me dorë. Nuk dihej ç'punë bënte. Maksi mendoi me një
farë pështirosjeje: «Sa e neveritshme do të ishte për një
grua ta ndante shtratin me Hans Vinterin». Pastaj me
radhë vinin ish-piloti Fuks, për të cilin ishin thurur le-
gjenda gjatë luftës, doktori Vencel, që kishte bërë emër
si ortoped në Njuhark, si edhe Adolf Hamershtajni, që
s'e hiqte kurrë monoklin nga syri i majtë.

Ata sikur u gjallëruan, kur hyri Veberi.

— Erdhi Maksi, herr Veber... — foli Volf Tanebergu.
Paralitiku as që i hapi sytë. Fytyra e tij qe si një
maskë e ngrirë dhe s'tregonte asgjë.

Maksi i zuri dorën të atit.

— Më fal, — i tha — po qeshë i zënë me diçka shu-

më të rëndësishme. Isha te Batleri. Atë e rrahën sot në mëngjez.

— E meritonte me kohë drurin — tha Kurt Veberi dhe hapi sytë. — Drunë e duan të gjithë shkencëtarët. Edhe ti, Maks.

I biri vuri buzën në gaz, pastaj u ul në një qoshe. E ndjeu se të gjithë po e vështronin. Sytë e tyre ishin sytë e grupit «Kaizer».

— Flisni, herr Shvarcenberg! — urdhëroi paralitiku.

Maksi e shihte për herë të parë këtë njeri. I bëri përshtypje koka e tij katërkëndëshe dhe gjallëria e fytyrës.

— Herr Shvarcbergu vjen nga faterlandi ¹⁾ — sqaroi Kurt Veberi.

— Ne po ju prisnim ju, herr Vever, — iu drejtua ai Maksit.

— Ju dëgjoj, zotëri...

— Në faterland dinë çdo gjë rreth njeriut gjigant dhe ideve tuaja. Dinë se ç'projekte keni për të ardhmen. Fakti që bijtë tanë mendojnë edhe në anë të dheut si t'i shërbejnë faterlandit tonë tregon se ne jemi një komb që na dërmoi fati kot së koti. Askush nuk e ka vitalitetin tonë.

Maksi vështroi të atin. Paralitiku dëgjonte me sy mbyllur.

— Ju lëshuat një ide të ndritur, herr Veber. Nuk e kam fjalën për shkencën, por për qëllimin që i keni vënë vetes që zbulimi i Norman Batlerit t'i takojë vetëm atdheut tonë. Ne pritëm kaq kohë, po ende ju s'keni arritur të bëni gjë. Tani ju lutemi të na e lini ne në dorë këtë punë. Kemi ardhur për të rrëmbyer profesorin Batler...

— Ah! — rënkoi Maks.

1) Atdheu (gjerm.)

— Batlerin duhet ta rrëmbejmë me çdo kusht — vazhdoi Shvarcenbergu. Ai ngriti dorën e hapur, pastaj e mbylli grushtin si ai që merr diçka me përdhunë.

«E zgjati putrën. Kjo është një kope ujqërish që ka ndërruar vend përkohësisht. Shvarcenbergu ka ardhur nga Areali¹⁾ kryesor. Njuharku është limer i përkohshëm. Kush është kryeujku? Shvarcenbergu? mendonte Maksi.

Shvarcenbergu nxori një letër nga xhepi.

— Ky është plani i vilës «Trinidad». Kjo është udha numër trembëdhjetë. Këto në verilindje janë magazina «Norton».

Vila ndahet...

«Hundë të vërteta... Nuk fryjnë, megjithatë e ndjejnë erën e njeriut. Ja kur t'i hidhen. Mjerë Batleri! Nuk u ka shpëtuar asgjë nga hollësitë e vilës. Cili është zbulues? Shvarcenbergu?»

— Mos u ngutni, herr Veber. E dimë si ruhet vila. Janë parashikuar të gjitha. Rojet nuk na prishin punë, ndërsa ekranet... Në dhjetë pa pesë do të ketë avari në nënstacionin elektrik. Kështu që edhe ekranet...

Maksi se si vështroi të atin dhe u drodh. Kurt Veberi nuk i kishte hapur sytë fare. Dukej sikur ai po i bënte inspektimin përfundimtar planit të Shvancerbergut.

«Kush është kryeujku?» — pyeti veten sërish Maks Veberi?

— Po u zbuluam, u fikëm, — tha me zë.

Kurt Veberi i hapi sytë. I vështroi të gjithë me rradhë. Sytë e tij lëviznin si dy sfera cirku. Nuk kishte kufi lëvizja e tyre.

— Jo, herr Veber. Nuk kemi vërejtje.

Kurt Veberi luajti rrotat e poltronës, qëndroi përpara secilit dhe i shtrëngoi dorën.

1) Zonë natyrore jetike për lloje të caktuara kafshësh.

«Kryeuju ku është im atë», mendoi Veberi.

Paralitik u kthye nga dy portretët në mur.

— Ata po qeshin — tha.

Maksi u mallëngjye. Patriotizmi dhe krenaria për të atin iu bënë një gjë e vetme. Rrëmbimi i Batlerit tani iu duk me vend dhe jo i vështirë.

KAPITULLI XI

— Më fort, Pol — tha Çarli Tot. — Pa stërvitje nuk mbahet gjithë ky trup.

— Po në pleqëri? Ç'do të bëhet në pleqëri me trupin tim? Atëhere nuk do të mund të bëj gjimnastikë — tha Poli duke zbritur nga paralelet.

Traineri vuri gishtin në buzë. Nuk lejoheshin këto lloj bisedash. Bisedat me zë të ulët tërhiqnin vëmendjen e rojeve që qëndronin anës palestrës me bastunët elektrikë në duar, tërhiqnin edhe vëmendjen e mikroaparateve të fshehura në mur. Asgjë nuk shpëtonte në ishull pa e marrë vesh Veberi.

Gjiganti u mbështet pas paraleles.

— Vazhdoni! — i thirri kryegardiani Çarlit.

Një ndër metodat e Maks Veberit ishte që mos t'u linte kohë të lirë gjigantëve. Koha e lirë i ndihmonte për të menduar.

Traineri e vështroi shtrembër kryegardianin.

Gjiganti u ul përdhe dhe zuri të vështronte Milluokin dhe Ralfin. Milluokini e urrente, me Ralfin nuk merrej vesh. Milluoki ishte një kafshë dinake, Ralfi një njeri gjaknxehtë. Si i pari, dhe i dyti ishin krenarë për

fuqinë e tyre dhe kërkonin t'ia kalonin Polit. Ishin krenarë që kishin dikë nën vete, gjigantët me inteligjencë të cinguar. Me ta silleshin si me një kope derrash të egër.

Ralfi e ngriti mbi krye shtangën dhjetëkuintalëshe, pastaj e uli përdhe. Milluoki kërcëlloi dhëmbët, pastaj iu afrua shtangës. E ngriti në gjoks, pak mbi kokë dhe mbeti ashtu. S'qe i zoti ta ngjiste më lart. E lëshoi shtangën duke e shtyrë pak përpara me duar. Ralfi kërceu në kohë. Shtanga do t'i kishte këputur këmbët. Ajo u rrokullis tutje me shpejtësi dhe shkallmoi shkallën suedeze.

— E bëri me qëllim! — thirri Poli dhe iu turr Milluokit.

— Hej, ju!

Çarli u mundua ta ndalonte, po Poli tani ishte pranë Milluokit. Ky i iku grushtit të parë, po i dyti e shembi përdhe. Ai u ngrit sakaq dhe vështroi përreth si kafshë e plagosur. Iu turr paraleles së hekurt dhe ia shkuli njërin krah. Do ta kishte lënë të vdekur Polin, sikur të mos i qe hedhur që prapa Ralfi. E vunë poshtë Milluokin. Po s'patën kohë t'i binin më. Mbi kokët e tyre ranë bastunët me korrent...

— Filloni stërvitjen! — ulëriti kryegardiani.

— Kafshë... Jemi kafshë... Kafshë! — thirri me sa fuqi pati Poli.

Çarli i rrahu supin.

— Eja, Pol...

— Ne jemi kafshë, mistër Çarl... kafshë!

Atij i shpërthyen lotët.

— Eja, Pol...

Një gjigant që qan është më i dobët se një fëmijë. Çarli Tot e tërhoqi me lehtësi Polin.

— Mistër Veberi do t'i mësojë të gjitha këto — ulëriti kryegardiani. — Do të përgjegjeni edhe ju, Tot!

Traineri desh t'i fshinte sytë Polit. Po dora e tij

mezi arriti te qafa e gjigantit. Ai zgjati llërën e dorës dhe fshiu sytë vetë.

— Ashtu, Pol! Ashtu!

Poli hipi në paralele. U ngrit në vertikale. Zbriti një kip të fortë dhe prapë vertikale.

— Ashtu, Pol! Ashtu!

Palestra u trondit prapë, ashtu siç qe tronditur kur kishte hedhur Milluoki shtangën. Poli shtrihej sa gjatë gjerë në parketin e palestrës.

— Damned folly! — thirri Çarli dhe u hodh nga ai.

Poli kishte mbyllur sytë dhe s'lëvizte. Çarli pande-hu se kishte vdekur. U afrua t'i dëgjonte zemrën. Pa ia vënë veshin mirë në gjoks e ndjeu që i rrihte si një mulli i fuqishëm. Ai desh të largohej, po atë çast Poli i mblodhi krahët dhe e shtrëngoi si një morsë e fuqishme.

— Pol...

Dera u hap sakaq.

— Pande-ha se qe kryegardiani — tha Poli — Do ta kisha mbytur...

— Mos, Pol... Mbaji mend ata dhjetë të marrët për-tej... — tha padashur Çarli dhe u pendua që foli. Fjalët e tij ishin regjistruar.

Poli u ngrit. Ralfi i lëvizi krahët dhe e fërkoj në shpatulla. Mendoi mos kishte thyer ndonjë kockë.

— Dreka! — thirri kryegardiani.

Poli i buzëqeshi Ralfit.

— Eja të bluajmë kockat — i tha.

Çarli Tot tundi kokën. Nuk e ndjente veten më mirë nga ata të dy. Po të paktën ai kishte një qëllim. Këtu nuk hynin dollarët... Iu kujtua që Veberi i kishte thënë se do t'i jepnin një lejë njëzetekatërorëshe sa të shihte të shoqen. Gjashtëmbëdhjetë muaj pa e parë...

1) Marrëzi e mallëkuar!

Këtë çast ai po e priste që kur shkeli në ishull dhe mori vesh se ç'bëhej aty. Kishte qenë e pamundur të nxirrte gjë jashtë. Ç'mendonin shokët për të?

Pa shpinën e Polit që po largohej. I këputi shpirtin gjiganti i dërmuar. «Tokë, o tokë! tha ai me vete. Si e mban Maks Veberin?»

* * *

Poli e flaku tutje librin. E kishin mërzhitur gjithë ato aventura që e detyronin të lexonte. Megjithatë duhej t'i lexonte patjetër, se e pyesnin për to.

Vetëm aventura... Asnjëri nuk e mposht dot Xhejms Bondin, megjithëse ka një trup të zakonshëm... Përkrah tij qëndron gjithnjë një vajzë e bukur. Polin e tmerronte kjo. Tani s'kishte asnjë mendim për dashurinë, atë e kishte ndjerë vetëm përpara. Po edhe përpara turbull. Një dashuri sysh... Aq më shumë tani, trupi i tij nuk reagoonte aspak. Veberi kujdesej për këtë duke u dhënë disa tableta me frenues të fuqishëm.

Poli e kishte kuptuar këtë të vërtetë. E kishte kuptuar që kur ishte përpjekur të ikte. Nuk ia kishte arritur asaj që kishte lakmuar, përkundrazi fuqia e tij që një vegël në duart e të tjerëve. Gjer përpara ikjes ishin më të lirë në ishull dhe shoqëroheshin disa herë me personelin. Çdo gjë ndryshoi pas ikjes së Polit.

Veberi vendosi një regjim të hekurt. Ralfi duronte tre muaj kokulur dhe në ditën e nëntëdhjetë e tretë kishte një shpërthim të tmerrshëm. E rregullonin paq dhe fitonin tre muaj të tjerë qetësie. Pastaj vinte prapë dita e nëntëdhjetë e tretë...

Milluoki ishte gjithë buzëqeshje. Ajo sikur nuk i buronte nga fytyra, po përmes atyre dhëmbëve të rrallë si gurë kilometrazhi. Donte të ishte i gjithëpushtetshëm

në ishull, donte të kishte edhe personelin nën vete. Veberit i vinte neveri prej tij. Ai e ndëshkonte Polin më shumë nga të gjithë, po shpresat më të mëdha te Poli i kishte.

Indiani e duronte edhe neveritjen me buzëqeshje. Dhe përpiquej ta mbante mend. Mendja e tij ishte një depo ku ishin grumbulluar gjithë poshtërimet dhe haqet që kishte për të marrë. Nuk falte askënd, por ndërkohë duhej pritur... Ishte më i fuqishëm se Ralfi dhe disa herë e kishte nxjerrë nga ringu gjysmë të vdekur... Po të donte Veberi, mund të bëhej i pasur vetëm me një-mijë metra film nga këto skena. Me Polin nuk hahej. Poli e bënte të ngrinte duart. Milluoki kishte dashur ta bënte Ralfin me vete kundër Polit. Nuk ia kishte arrihur. Ralfi merrej me meloditë e Karaibeve dhe me shpërthimet e veta. Nuk interesohej të bënte as miq, as armiq.

Polit iu kujtua dita kur u njoh me Veberin. Nuk e harronte atë ditë, e kishte puthur Renatën për herë të parë. Donte ta shihte prapë Renatën, po nuk kishte dëshirë ta puthte. Një kohë fërgëllonte nga kënaqësia vetëm kur i prekte dorën. Atë kohë ai posa kishte dalë nga burgu dhe ishte rezervë e skuadrës «Star». Nuk e mbante kot atë emër skuadra. Lojtarët i kishte me të vërtetë yje. Polin e pa rastësisht treneri i saj dhe i tërhoqi vëmendjen trupi i tij i gjatë. Por ai ishte tepër i paformuar. Traineri zuri ta prekte nëpër trup, siç preket një kalë për shitje. I pa musklaturën, gjoksin, dhëmbët. Mendoj që ndoshta mund të dilte diçka nga ai. Dëshmia më e gjallë për këtë qenë arnat në gjunjët e Polit. Ai do të përpiquej t'u shpëtonte arnave, do të stërvitej sa dhjetëfishi i të tjerëve. «Dyzet orë stërvitje në javë, i tha Polit treneri i skuadrës «Star». Drekën dhe mëngjezin nga klubi. Asgjë më shumë. Pranon? Po arrite të luash mirë, bëjmë kontratë tjetër. Pra, drekën dhe mëngjezin...»

— Njerëzit hanë edhe darkë — kishte folur Poli

dhe qe penduar. Po sikur t'i zemërohej treneri? Edhe pa darkë propozimi i tij qe punë e madhe për Polin.

Ai shembje përdhe nga lodhja ditët e para dhe nuk besonte kurrë se mund të vraponte si të tjerët. Në drekë përpiquej të hante diçka më shumë edhe për darkën. Flinte në palestër në një të ndarë ku zhvisheshin sportistët. Traineri kishte një natyrë të ndyrë, sillej poshtërsisht me të rinjtë. Nuk e kishte për asgjë t'i pështynte në fytyrë apo t'u binte turinjve. Me të vjetrit ishte më ndryshe. Skuadrën nuk e stërviste ai, po ndihmësi i tij. Po të mos ishte ai, një shpirt njeriu, Poli do të kishte ikur menjëherë, megjithëse s'ishte shaka të haje dy herë në ditë dhe të mbaje tuta të reja.

Në fillim basketbollistët e tallnin. Po më pas ai u hyri në zemër dhe secili ia mbushte xhepat me proshutë e djathë. Edhe ata qenë të detyruar të hanin në restorantin e klubit. I gjetën edhe një palë rroba në gjendje të mirë. I binin pak të shkurtëra, po ama nuk kishin arna. Ato rroba u bënë shkak të njihej me Renatën dhe të rrihej nga treneri. Kishte mësuar të luante mjaft mirë. Shkëlqeu sidomos kundër «Djajve të Njuharkut». Qe zot i vërtetë në tabelë atë ditë. Ata që e ndiqnin me çudi lojën e tij, harronin ç'mrekulli mund të bëjë uria. Atë ditë u njoh me Renatën... Atë ditë e rrahu Leston Trebkastli. Rrobat e reja të Polit e kishin vënë në dyshim... Me siguri që ai po i tradhëtonte! Cilës skuadër i kishte dhënë fjalën? «Më tradhëtove, o kallam i ndyrë? Cilës skuadër i je shitur? Kështu ma shpërbleve bukën? Po ngordhje urie kur të mora. Na, vagabond...»

Polin e kishte mjegulluar kënaqësia në fillim, pra, ia kishin nevojën, u duhej. Pastaj shputa fytyrës... Gjer kur do ta rrihnin? Mistër Siksti, Gringoja, policët, Leston Trebkastli... Gjer kur do ta rrihnin?

Një i huaj e kishte vështruar gjithë këtë skenë nga dera e palestrës. Ky ishte Maks Veberi. Kishte ditë që e ndiqte Polin. Ai po matej t'i fliste, kur iu derdh përsipër Leston Trebkastli duke thirrur si i çmendur: «Mas-

kara! Kërkon ta marrësh tani që e bëra me krahë? Jo, mistër! Zogun e rrita unë! Avullohuni, avullohuni, ju them... Përndryshe...»

Veberi i kishte kthyer jakën e xhaketës. «Më falni! Dhjetë herë ju kërkoj ndjesë... Ju mora për ndonjë trainer rival. Ju keni një paraqitje sportisti.»

Poli e kishte ndjekur me admirim sjelljen e Maks Veberit. Ai duhet të ishte shumë i fuqishëm që sillej ashtu me Leston Trebkastlin. Veberi ishte përkulur mbi Polin.

— Hë, boy? Të fyen? Posi, posi. Të fyen kushdo me këtë trup kallami që ke ti...

Poli qe ngritur në këmbë dhe e kishte vështruar me çudi.

«Pse, musklaturë është kjo? kishte vazhduar Maksi. Këta janë muskuj sfungjeri. Vetëm unë mund të të bëj të fortë. Eja tek unë...»

Se nga kishte dalë Renata, sekretarja e klubit. «Poli! Sa bukur që luajte mbrëmë? Po ç'është ky gjak në hundë?» Ajo kishte pandehur se atë punë e kishte bërë Veberi dhe e kishte goditur me shuplakë fytyrës. «Renata!» Poli kishte kërcyer në këmbë. Çudi, gjer atëhere s'kishte folur kurrë me atë vajzë. «Faleni, mistër...»

Veberi i zbehur kishte ngritur dorën dhe kishte shtrirë flokët e prishur. Pastaj kishte buzëqeshur. «Ë dini «Piratin?»».

— E di!

— Pasdreke në pesë e gjysmë ju pres aty. Kam një punë me leverdi të madhe për ju.

— Më falni... Punë kontrabande nuk dua. Kam bërë katërmbëdhjetë muaj burg... — foli i qetë.

Kështu qe njohur ai me Maks Veberin. Atë ditë kishte puthur Renatën...

Kujtimi i Renatës e trishtonte, i shkaktonte një boshllëk përbrenda. I dukej se diçka po i hiqnin nga gjoksi, po ia shkulnin. Renata! Më mirë mos ta kishte njohur. Po Veberin? Veberi... mallëkim! Renata do të lemeritej, po ta shihte. Do të lemeritej si të tjerët. Ajo

do t'i trëmbej si djallit, si diçkaje që na fut datën vetëm po ta kujtojmë.

«Të iki! Të iki! Të iki!»

U kthye përmbys mbi shtrat dhe shtrëngoi jastëkun me duar. Ku mund të shkonte? Të ikte? Po duhej jetuar diku, mes njerëzish... Ndoshta mund të gjente rastin të ikte, po a nuk do të iknin njerëzit nga ai?

Nga bregu u dëgjua një piskamë e fortë. Mamuthët... Poli u ngjeth. Veberi mund ta bënte si ata me një të luajtur të gishtit. Ata s'dinin asgjë nga kjo botë. Ata vetëm bindeshin. Ata s'dinin as të vrisnin veten, s'dinin të shpëtonin... Mos donte të vriste veten Poli?

«Jo, mërmëriti ai. Do t'ia përdredh qafën një herë Veberit me shokë. Po ç'paska qenë ky Veberi! O perëndi, në ç'duar rashë!...»

Ai kurrë s'kishte dashur ta kthenin në një gjigant të çoroditur. Kur arriti dy e dyzet, nuk desh të zgjatej më. Me atë trup dhe atë forcë që kishte fituar ndjehej mjaft i sigurt sa për të hedhur jashtë ringut dy boksierë me emër përnjëherësh. Ai nuk donte, po donte Veberi, ai xhelat i pamëshirshëm.

Mamuthët përsëri... Poli u drodh prapë. Një kohë ai i vinte përpara si egërsirat, i rrihte me kërbaç, po të mos e dëgjonin. Poli u ndihmonte rojeve. Kështu që gjer ditën që kishte ikur për herë të parë. Dy vjet e gjysmë në ishull, ai kishte harruar si ishte jeta larg atyre valëve të oqeanit. Forca që kishte fituar e kënaqte në një mënyrë të vetën. Po ku do ta përdorte atë? Kundër kujt? Në ishull nuk i përdornin shuplakat. E vishnin mirë dhe i jepnin të hante ç'të donte. I kishin premtuar ta hidhnin në jetën e madhe, në Njuhark. E keqja e vërtetë filloi posa pa Njuharkun, banorët e tij. Ishte i tmerrshëm ndryshimi me ta. Njerëzit largoheshin nga ai të tmerruar. Kjo e mbyti Polin dhe përnjëherësh e zgjoi. Ç'kishte bërë kështu ai? Si ishte katandisur?

Në ishull kishin hapur një gurore mermeri. Atë e prisnin në bloqe të mëdha. Bloqet i shtynin mamuthët gjer në breg.

Gurorja ishte e Xhon Stivensit. Mamuthët ishin skllëvër mumidas. Më keq se skllëvër... Ndërtonin një piramidë me mermer të zi... Keopsi ishte më modest. Ai qe i kënaqur edhe me gurët e thjeshtë të pllajës së Gazës apo guroreve të Golanit, Xhon Stivensi jo.

KAPITULLI XII

Batleri kundronte diskun e shkëlqyer të diellit si një gjë që të sjell mbarësi. Maja e rrufepritisit të hotelit «Astoria» ndriste si smerald. Batleri kishte mbetur me kokën lart. Nuk dinte si t'i gëzohej asaj pamjeje. Ajo qe vogëlimë jete, nga ato për të cilat njeriu ka nevojë. Mbase nuk qe edhe ndonjë vogëlimë... Si mendonte Batleri? Ai qe dielli i madh dhe i shkëlqyer. Ai qe gjithshka për këtë tokë.

Uli kokën dhe pa që po kalonte Larseni. Larseni buzëqeshi. «E mora vesh, i dashur, tha me vete Batleri». Batleri ia ktheu buzëqeshjen. Ai u kënaq që ndihmësi i tij ia kishte kryer porosinë. Vështroi prapë lart. Masa e shtizës në «Astoria» shkëlqente si përpara. Një diell i mbarë ky», mendoi Batleri.

Po pastaj u vrejti përnjëherësh. Ky diell i mbarë nuk mund t'i pengonte ata të dy që po i afroreshin vilës, nuk mund t'i pengonte të vinin dhe ta nxirrnin jashtë që aty. Ata kishin çanta të mëdha nën sqetulla dhe kapela republikë në kokë. (Kështu i përfytyronte Batleri nëpunësit e hipotekës dhe zyrës së përbarimit).

Ata të dy e kaluan derën e vilës. Batleri mori frymë thellë. E kaloi edhe këtë radhë...

U zemërua me veten. «Në fund të fundit le të vijnë, tha. Nuk do të shembet bota. Do të gjej edhe unë një strehë...»

I vajti mendja te Doroti, po e largoi menjëherë atë mendim.

Priste ta zbonin nga vila. Kishte dashur t'i dilte punës përpara dhe u kishte telefonuar disa sipërmarrësve që lëshonin apartamente me qira. Dy dhoma të thjeshta me anekse...

Të gjithë pranonin t'i lëshonin Batlerit për dyzet dollarë në muaj një apartament të tillë. Madje dhe u vinte keq për të. «Po s'është kafshatë për ju, mister Batler. Juve ju duhet diçka më komode, diçka...»

Pas një orë binte telefoni.

— Mister Batler?

— Po.

— Do të na falni. Nuk kemi apartament të lirë.

— Po ju...

— Ja që u gabuam. Na vjen keq. Drejtojuni sipërmarrësve të tjerë.

Dhe Batleri një ditë të tërë s'kishte bërë tjetër veç kërkonte adresat e tyre dhe i binte telefonit. Ai qe habitur pa masë. Sipërmarrësit e banesave ishin një ushtri e tërë në Njuhark. Lidhi dhjetë marrëveshje për një apartament të thjeshtë dhe dhjetë herë u përsërit po përgjegjja e parë. «Do të na falni. Nuk paskemi apartament të lirë. Na vjen keq që u gabuam».

Batleri nuk ishte budalla. Tani atij kishte zënë t'i binte edhe ajo leskra e naivit që e karakterizonte kohë më parë. Që në provën e dytë ai e kuptoi se në këtë mes kishte gisht dikush tjetër. Megjithatë vazhdoi të lidhte marrëveshje sikur donte të zbavitej. Nga ana tjetër donte të dinte gjer ku arrinte krahu i «atyre».

Nga vila donin ta zbonin, të zinte vend gjetiu nuk po e linin. Ç'donin ata? Ta hidhnin në rrugë? Të flinte nëpër parqe? Po ia mbyllnin të gjitha shtigjet me një qëllim të caktuar. Donin ta thyenin!

Dilte rrugës dhe e dinte se ata që i vinin prapa me jakat e pardesyve të ngritura, nuk ecnin rastësisht pas tij. Ata as që mundoheshin ta fshihnin këtë.

Eatleri kishte pak të njohur, po, edhe kur e takonte

ndonjë prej tyre, bënte sikur s'e shihte. Nuk donte t'u nxiirte andralla të tjerëve. Dje në mëngjez ai s'kishte mundur të largonte një skenë të papëlqyer. Kishte takuar udhës një studentin e vet. Kishte bërë sikur nuk e kishte parë. Në të vërtetë nuk kishte pasur kurrë ndonjë simpati për të. Ai ishte Van Llou, një flokëkuq dy para njeri, që çdo gjë mund të bëhej, vetëm kirurg jo. Kështu mendonte Batleri për të. Me Van Lloun e kishte shprehur kaq herë këtë. «Van Llou! Ju jeni për cirk. Ju nuk do të bëni kurrë as shkencë të vogël, as shkencë të madhe». Po pikërisht ky Van Llou... i kishte propozuar ta merrte në shtëpinë e vet. «O Perëndi! Van Llou! Hutaqi... Dy para njeri... Ja si gabohemi ne... Pandehja se më urrente për vdekje. Më priste keq gjuha një kohë...» Batleri i kishte shpjeguar me dy fjalë sa ngatërresa mund t'i sillte kjo familjes së tij. Se si i kishte shkrepur ta shihte gjer ku do të qëndronte Van Llou.

«Nuk kam frikë! i qe përgjegjur Van Llou. Asnjë nga ne studentët nuk ka frikë. E kemi marrë vesh ç'po ndodh. Në fakultet është formuar një komitet për mbrojtjen e profesorit Batler. Nesër do të na kesh të tërë para vilës. Ah, harrova!.. Atë që ju zëvendësoi, Smithin, e nxorëm me shqelma nga fakulteti. Smith Bristonin ju them... Po ç'duan nga ju, profesor? E dimë që po ju mendojnë, po nuk e dimë shkaku».

Pastaj kishte ndodhur e papritura. Njëri nga ata me jakën e ngritur të pardesysë, e kishte goditur Van Lloun me bërryl.

— Kafshë zooparku! Ke zënë gjithë rrugën!

Van Llou seç i qe përgjegjur. Kishte ndodhur zënka dhe policia... Van Llou u gjend me të panjohurin në makinë. Pas kësaj vinin gati gjithmonë gjashtë muaj burg dhe njëmijë dollarë gjobë.

Qe takuar me Perkinsin. Kishte dashur t'i vidhej, po nuk i qe duruar. Po pëlciste...

— Eh, eh! — i kishte bërë Perkinsi duke kërcyer si sqap plak. — Nuk di nga t'ia mbash? Nënshtrouhu!

S'ka rrugë tjetër. Nuk i dilet ndryshe. Kush nuk ka halle sot? Thuamë, kush? E more vesh që po ndahem me Xhenin? Ç nuk po shkruajnë gazetat... Ndoshta më jep një këshillë... Është ajo që do të ndahet... Divorc dhe njëqindmijë dollarë dëmshpërblim... Kaq të holla unë s'di as ti numëroj... Nuk e kam tradhëtuar asnjëherë Xhenin... A mund të dëshmosh për këtë?

— Jo! — i qe përgjegjur Batleri me inat. — Nuk mund të dëshmoj. Nuk di ç'bën ti. Dhe sa për dëmshpërblimin... s'ka të drejtë ta marrë. Ti nuk i ke bërë gjë asaj.

— S'i kam bërë — qe përgjegjur Perkinsi pa e kuptuar thumbin e Batlerit.

Me Maks Ollbrajtin kishte biseduar më gjatë. Ai ishte drejtor i shërbimit imunologjik në Njuhark dhe për të Batleri kishte konsideratë.

— Gjigantë kërkojnë nga ti, Norman? Krijoi sa më parë! Ç'pret? Duam, s'duam, do të bëjmë si thonë ata. S'deshëm të bëjmë as A, as H¹⁾. Po ja që i bëmë, na detyruan. Krijoi gjigantët, Norman. Dhe nuk do të të vrasë ndërgjegjja. Ata do të mbeten stoqe si A dhe H... Nuk shikon që kanë kaluar kaq kohë dhe nuk po përdoren? Shpëto nga telashet dhe hidhi ca dollarë xhepit. Xhepat tanë janë fishkur tani si barku i merlucit të tharë në diell. Pse e vret mendjen.

— Sepse më duhet të luaj me fatin e njerëzve, me jetën e tyre. A dhe B janë hekurishte. Gjigantët janë njerëz. Lamtumirë, Ollbrajt!

— Prit, Norman, mos u rrëmbe. Ta marrim shtruar. Ta quajmë ide çështjen e gjigantëve. Idetë gjithmonë duhen provuar në qëndrojnë apo jo. Pastaj atë që duhet zbuluar s'e ndalon dot. Lindi një ide? S'ke si ta ndalosh atë. Me qindra do t'i vihen asaj pune. Të rroftë ty që do të ngordhësh pa një dhjetësh...

Mos ki frikë. Do të mbeten stoqe, si A dhe H, për-lai dollarët!»

1) Bomba atomike dhe me hidrogjen

Maks Ollbrajti rrotullohej në poltronë. Ai i ngjante më shumë një kasapi të rrugës së njëmbëdhjetë se sa një shkencëtari. Gati pëlciste nga shëndeti.

Megjithatë Batleri e duroi gjer në fund. Të paktën me Maksin mund të fliste hapur. Ai nuk ishte hipokrit. Sa herë kishte biseduar me të, Batleri e kishte çmuar se nuk fshihej as nën maskën e humanizmit, as të lavdisë profesionale. Maks Ollbrajti ta thoshte troç atë që ndjente. «Kështu, i dashur. Vetëm se zgjat ca kohë... Ti do t'i bësh gjigantët. Ne kemi bërë gjithnjë ç'kanë dashur ata...»

Lindon Mak Grau e kishte zhvilluar edhe më tej idenë e Maks Ollbrajtit.

— Ti do t'i bësh gjigantët, i dashur. Ty të shtyn diçka drejt tyre, misteri i shkencës! Të gjithë na hedh gjer në greminë ai. Ne jemi shkencëtarë, hedhim të fshehtat e shkencës në jetë. Kjo është detyra jonë. Si shpërthejnë ato, u takon të tjerëve ta mendojnë. Të fshehtat e shkencës na mendojnë gjithë jetën ne, Batler. Kot e ke, ti do t'i bësh gjigantët, edhe sikur ta dish që do të të hanë kokën, i dashur... Përndryshe... Përndryshe nuk do të ishe shkencëtar i madh. Do të ndërmerjetësoj unë të pajtohesh me sipërmarrësit?

— Nuk dua! — i qe përgjegjur Batleri.

Po pse pyeste kaq shumë ai? Mos po tronditej betoni në themelet e Norman Batlerit?

I fundit i foli Arçibald Karteri:

— Më vjen turp kur ju dëgjoj, profesor Batler. A mos ju lëviz diçka përbrenda që mund t'ju bëjë të anoni nga ata? Ç'tmerr po i pregatitni njerëzimit! Ç'mallëkim? A mos jemi nga fundi? Fundin me ç'kuptoj nuk do ta sjellë as shuarja e diellit, as përplasja e planetëve mbi ne. Fundin do ta sjellim ne vetë!

Ai ishte njeri shëndetlig dhe nevrrik. Dridhej kur fliste dhe bashkë me të sikur dridheshin gjithë epruvetat, ganxhat dhe qelqet e laboratorit. Nga fundi ai u nxeheq sa zemërimi i tij u kthye në tallje të hapur.

— Mirë profesor Batler, po si do të jenë ata gjig-

gantët tuaj? Do të vuajnë nga glaukoma? Me siguri që jo! Nuk më vjen keq që më rrodhën trutë njëzet vjet këtu për glaukomën. Bëji gjigantët, Batler, ata nuk do të vuajnë nga glaukoma.

Pastaj shpërthimi që i njerëzishëm dhe njëkohësisht i rëndë.

— Më falni, profesor. Gjersa nuk i keni bërë ende gjigandët, më lini të punoj. Ka akoma glaukomë nëpër botë. E kuptoni vetë...

«Ose unë jam i çmendur, ose këta nuk më kuptojnë, kishte thënë ai me vete. Ç'mendojnë se jam unë?»

— Dëgjo, Arçibald...

— Këtu kam ca viruse (Arçibaldit i qe dredhur epruveta në duar), unë pothuaj e kam gjetur mjetin për t'i asgjësuar ato. Gjeje edhe ti për viruset e tua, Batler. Ç'pret? Njeriu e ka kurdoherë përgjegjen e drejtë për brenda vetëvetes, po tjetër është se nuk do ta dëgjojë...

— Ju jeni çmendur! — kishte thirrur Batleri. — Të gjithë jeni çmendur! — Dhe i kishte përplasur derën.

Tingëlloi videofoni. Batleri e la të binte edhe dy herë të tjera, pastaj ngriti receptorin. Në ekran sakaq u duk fytyra e Perkinsit. Ai ishte rruar taze dhe figura i dukej aq mirë, sa në ekran dalloheshin edhe rrembat e gjakut nën lëkurën e hollë të faqeve.

— Hello, Batler! Unë dhe Xheni nuk do të ndahemi.

— Në djall të vesh bashkë me të! — tha Batleri dhe përplasi fort receptorin.

Videofoni tingëlloi përsëri.

— Unë dhe Xheni nuk do të ndahemi, i dashur...

Batleri se si u përmallua.

— Epo mirë, Perkins! Urime!

— Nuk kisha kujt t'ia thosha këtë, Norman. Doja t'ia tosha dikujt.

— Mirë bëre, Perkins...

Mallëgjimi zuri të rritej në gjoksin e Batlerit.

— Është e tmerrshme të ndahesh, Norman... Të jesh vetëm...

Batleri e mbylli videofonin.

Perkinsi vuante nga vetmia. Anabella vuante nga vetmia. Të gjithë. Të gjithë. Po vetmia kishte një emër tjetër tani për Norman Batlerin, ajo quhej «çinteresim i shoqërisë». E ngriti edhe një herë receptorin dhe formoi numrin e Perkinsit. Në ekran u shfaq fytyra e Xhenit. Një herë e kishte parë, megjithatë e njohu.

— Ne jemi si fëmijët, Xheni — tha ai i ngashërver. — Kemi nevojë të na rrijë dikush pranë. Mos e bëni të vuajë Perkinsin e gjorë, gjersa... gjersa u martuat.

— Po kush jeni ju? — çapëleu sytë me habi Xheni. Ajo kishte një kokë të bukur që t'ia rrëmbeje e ta dorëzoje në galerinë e arteve.

— Jam Norman Batleri...

— Jeni shumë i dashur, mister Batler. Dhe nuk ju mendoja kështu... A nuk vini tek unë? Jam vetëm dhe po mërzitem. Vemi në parkun qendror...

Batleri nuk u përgjegj dhe e uli receptorin ngadalë.

U fundos thellë në kolltuk dhe për të parën herë ia qau hallin Perkinsit plak. Hallet e Perkinsit ishin edhe të vetat. Ja ç'qenka vetmia! Vetmia të lidhka me Xhenin... Ai donte dikë pranë...

Batleri e kuptonte kaq mirë tani. Një kohë ai i kishte quajtur pengesa njerëzit përreth. Po të mos kishte qëndruar larg njerëzve, s'do ta kishte kaq pisk tani.

«Pse kështu, Norman? pyeti veten ai. Pse kështu?» Përgjegjja që e gjatë dhe e ndërlikuar. Ajo lidhej me gjithë rininë, me gjithë jetën e Batlerit. Ai që dhënë si i çmendur pas punës dhe kishte dashur të fitojë me gjeninë e tij në pak vjet, atë që i kishte mohuar shoqërisë për më shumë se një çerek shekulli. Po më pas muret e laboratorit e kishin fashitur pak nga pak Normanin ambicioz dhe kryengritës, e kishin bërë për vete, e kishin shtruar, i kishin diktuar ligjet e veta. Kishte pasur edhe shpërthime... Shpërthimi për Xheni Paterin... Një shpërthim i fuqishëm kundër mureve, kundër gjithë mureve... Pastaj kishte shpërthyer gjatë luftës... Këtu ai sikur që afruar me njerëzit.

Ai nuk u kishte shkaktuar fatkeqësi njerëzve. Po Batleri e gjykonte veten nën një dritë të re. Tani nuk mjaftonte vetëm të mos ishte i dëmshëm për të tjerët. Duhej të ishte i dobishëm. Këtë kishte kërkuar më shumë ai kur kishte biseduar me Ollbrajtin, Maks Graun dhe Karterin. Ata s'e kishin kuptuar dhe as ai vetë nuk kishte ditur ç't'u kërkonte. Karteri ndoshta do t'i kishte gjetur një rrugëdalje. Po me të ishte ndarë më keq se me gjithë të tjerët. Batleri erdhi në përfundimin se duhej t'i shpallte botërisht mendimet e veta. Nuk ishte puna për të mbrojtur veten, por për të ndaluar një vepër çnjerëzore. Duhej të kërkonte ndihmën e të tjerëve, të forcave përparimtare në Njuhark, të lidhej me ta. Të niste një shpërthim të ri, si për Xheni Paterin, si gjatë luftës. Po, po! Kështu do të bënte. Do të fliste me Karterin, me studentët, me këdo që do të ishte gati të përkrahte shpërthimin e tij. Vendimi që mori e gjallëroi. Dhe kjo ndodhi në prak të vizitës që i bënë Stivensi e Veberi. Në atë bisedë ai qe më i fortë se ata të dy, më i qetë. Sikur ishin ndërruar rolet.

Xhon Stivensi premtoi se do t'i zinte fajtorët e sulmit brenda njëzet e katër orëve dhe do t'i shpinte me hekura në burg. Le të shkonte t'i shihte të nesërmen Batleri po të donte.

«Drejtësia le të bëjë ç'i takon», i qe përgjegjur me lakonizëm shkencëtari. Pastaj ata kishin biseduar për libra, për silvikulturë, për zgjuarësinë e bletëve dhe delfinëve dhe asnjë fjalë për njeriun gjigant. Kishin hequr dorë ata nga ai projekt? «Kurrën e kurrës», kishte menduar Batleri duke i përcjellë jashtë. Duke mos folur, ata sikur i qëndronin një tabuje. Heshtja e bënte realizimin më të sigurt.

— Ju mund të filloni nga puna, mister Batler — i kishte thënë Xhon Stivensi duke dalë. — Po mbetemi prapa. Merruni me se të doni, vetëm punoni. Ne nuk do të ngulim këmbë në ato që kërkonim nga ju. Po jam i bindur (këtu senatori ngriti dorën me fuqi lart) që ju vetë do t'i hyni asaj pune. Maksi më tregoi sa

përpara kanë ecur kolegët tuaj në Evropë. Edhe pak edhe ata do të dinë më shumë se ju mbi gjendrat me sekrecion dhe mbi hipofizën në veçanti. Apo jo, Maks?

— Ashtu është, mister Xhon!

— Disa nga ata më trondisin në themele...

— Kush? — nuk i qe duruar Batlerit. — Lui Misheli, Thomson Granti, Korado Bertoldi dhe sidomos Boris Shumakovi. Jo! — i kishte thënë Batleri. — Nuk dua të punoj më. Ajo me të cilën do të merrem këtej e tutje do të jetë një punë krejt private. Unë mund të bëj çdo punë.

Megjithatë emri i Boris Shumakovit e kishte tronditur Batlerin. Po ashtu edhe emrat e shkencëtarëve evropianë. Përse punonin ata? Për gjigantët?

Kjo e shtyri Batlerin të nxitohej. Nuk kishte kohë për arësytetime të kota. Duhej të dilte sa më parë në shesh e vërteta tronditëse.

Nuk ishte vetëm Batleri rrezik për njerëzimin, por plot të tjerë. Mund të ishte Lui Misheli, mund të ishte krijuesi i gjigantit që shpërndau demonstratën, mund të ishte kushdo, po të mos e pengonin. Shkencëtari që ka dymbëdhjetë palë sy për kërkimet e veta, shpeshherë është krejt qorr për dëmin që i sjell shoqërisë. E kishte provuar vetë Batleri këtë.

KAPITULLI XIII

Senatori po dëgjonte dikë me receptor në vesh. Ai i bëri me shenjë Maksit që të mos fliste. Veberi u ul pranë Martin Parkerit që për çudi qe esëll atë ditë. Skulptori dukej i mërzhitur. Ai nxirrte rrathë tymi nga goja dhe vështronte llambadarin e madh të stilit barok që varej në tavan.

Zërat e mbytur pushuan në receptor. Senatori e la

në vend. Ai u ngrit në këmbë dhe i bëri me shenjë Maksit që ta ndiqte. U kujtua për skulptorin dhe u kthye nga ai.

— U morëm vesh, Martin. Dua një tjetër si ajo aty. Po kaq të bukur, po kaq madhështore. Vetëm katër-pesë herë më të madhe. Do ta përdor për zgjedhjet, siç të thashë. Ç'mendim ke, teutonikus? Do ta vendos statujën time në ballë të rrugës trembëdhjetë. Një skulpturë tetëmetërshe prej bronci. Mrekulli, hë? Nuk u ka rënë në mendje të tjerëve kjo. Kështu nuk e ka hapur asnjë kandidat fushatën elektorale.

Martin Parkeri nuk u përgjegj. Ai vështronte statujën e Xhon Stivensit. Qe e vetmja punë që i pëlqente me gjithë shpirt. Aq i pëlqente, sa pendohej që e kishte shitur. Maksi, që e dinte këtë, besonte se ai vinte te Xhon Stivensi vetëm për të parë veprën e vet.

— Ejani, Maks!

— Kam shumë gjëra për t'ju thënë, mister Stivens — foli Veberi kur iu afruan studios.

— Mirë, mirë! Po më përpara të hapim pak ato «dritaret». Për ato më folën në telefon. Ah, harrova! Të kam përfshirë në shtabin tim që do të drejtojë fushatën elektorale. Duhet të të pjellë mendja, Veber...

Senatori u fut menjëherë në studio dhe shkeli butonin e një ekrani. U hap «dritarja» dhe përpara syve u doli vila «Trinidad». Përballë kangjellave kishin qëndruar disa vetura të zeza. Një tjetër dukej më tutje.

— Dikush po i bën një vizitë mikut tonë — tha senatori me qesëndi.

Veberi u drodh. Në atë kohë ujqit kishin ndër mend të grabisnin Batlerin. Po tani? Tani çdo gjë vajti kokëposhtë, senatori e ditka... Maksi u drodh për të dytën herë. Xhon Stivensi nuk do t'ia falte kurrë! Ai kishte për ta marrë vesh patjetër kush ishin vizitorët e vilës «Trinidad».

Disa fytyra me maska dolën nga vila.

Xhon Stivensi qeshi dhe i shkaktoi një të rrëqethur të re Maksit.

— E sheh dot Batlerin mes tyre, teutonikus?

— Jo, sër!

— Ha, ha, ha! Kanë ardhur ta rrëmbejnë! Po nuk m'i ka ngrënë akoma njeri bananet në duar mua. Ha, ha, ha! Batleri tani është në vend të sigurt. Dësh të ngrinte krye. të formonte një farë komiteti kundër shpërdorimit të shkencës. E hoqa nga qarkullimi pa e hapur sqepin. Dëgjon? Po këta miq, Veber? Tanët, apo të huaj? Të majtë apo të djathtë? Të zinj, apo të bardhë? Shpejt do ta marrim vesh, teutonikus, mos u bëj merak!

Njerëzit me maska hipën në maqinat e zeza dhe u nisën. U kuptua nga përplasja e dyerve që ishin shumë të pakënaqur.

Xhon Stivensi rrëmbeu radiotelefonin.

— Ndiqini! — thirri ai.

Ata panë se si u turr edhe maqina tjetër që kishte qëndruar mënjanë. Mes veturave filloi një duel i çmendur udhëve të Njuharkut. Trafiku u pezullua disa herë. Shpëtuan pa u përplasur për një qime.

Maks Veberi vështronte me ankth. Do t'i zinin? Do t'i njihnin? Ky do të ishte fundi për të. Mirë t'i bëhej! Kishte vajtur pas mendjes së ca hajvanëve. Po i ati?

Dy veturat e zeza kaluan si shigjetë përpara një kamioni të madh mallrash. Me ç'dukej ata që kishin dashur të rrëmbejnë Batlerin e kishin vënë re që po i ndiqnin. Vetura e tretë nuk arriti ta kalonte kamionin. Parafanga e majtë i ndeshi fort pas kamionit dhe ajo u përmbys sa çel e mbyll sytë. Kuadrot në ekran mbetën po ato për shumë kohë. Maqina që kishte aparatën marrës dukej që vinte pas asaj që u përmbys. E ngritën maqinën. Xhamet ishin bërë shoshë, po njerëzit brenda vetëm gërvishje kishin. U vunë përsëri në udhë. Po dy veturat e zeza ndërkohë ishin zhdukur. Xhon Stivensi shau diçka nëpër dhëmbë, se u kujtua vonë të lajmëronte qendrën e helikopterëve.

Kishin kaluar gjashtë minuta. Duheshin edhe dy minuta sa të ngriheshin helikopterët në ajër, dy minuta të tjera sa të arrinin në atë zonë.

— Më duket na shpëtuan kësaj radhe — tha me keqardhje. — Po nuk ka gjë. Do t'i fut që do t'i fut në dorë!

Maqina me xhame të copëtuaara çante si shigjetë përpara. Dy a tri herë qe duke u përmbysur.

— Do ta puthin tokën prapë, idiotët! — shau senatori. — Ecin si të dehur.

U dukën helikopterët.

Senatori vështroi orën. Të ikurit kishin dymbëdhjetë minuta avancë ndaj helikopterëve.

— Më njoftoni ç'do të ngjasë! — urdhëroi Xhoni në radio-telefon, pastaj u kthye nga Maksi. Këtij të fundit sikur i kishte ardhur ca fryma. Megjithatë s'ishte i bindur që do të shpëtonin.

— Ta lëmë atë punë, Maks. Ti sikur deshe të më thuash diçka...

— Po! Sot kam takuar Erih Mihelsonin dhe djaln tuaj, Ralfin.

— Aha, ç'thotë shpirti i shenjtë? Më duket se po lëpihet pas Rishar Balduinit. E di që edhe ai ka shumë shanse për të fituar, Veber? Ai do të marrë gjithë votat e lëkurëzinjve dhe mamlukëve të tjerë. Është aq filistin, saqë s'e ka për gjë të puthet me gjithë llumin e Njuharkut. E ke parë nëpër revista se si përqafon por-torikanët dhe dingot e Meksikës? Po me lëkurëzinjtë? Një perëndi e merr vesh si ua duron erën... Të ftoi Erihu?

— Posi! Me një njeri të posaçëm madje. Unë dëgjoja një leksion të vërtetë mbi shpirtin dhe trupin që më çuditi fort. Një kohë Erihu ishte i një mendjeje me ne në të gjitha pikat. Kaq i papritur më erdhi qëndrimi i tij, saqë nuk dita ç't'i përgjegjesha. Mendova se mos kishte ndonjë acarim interesash mes jush, mister Xhon, që unë nuk e dija. Peshkopi ma vërtiti andej-këtej bisedën, po mendja i punonte te zgjedhjet e ardhshme. Pra-noi që ju keni shumë popullaritet, mister Stivens. Po ai nuk e fshehu aspak që anonte nga Rishar Balduini. Ju ju cilësoi si «dorë e fortë», ndërsa për Balduinin tha që

është «njeriu e së nesërmes». «Dhe ai që është njeriu i së nesërmes, është aq më shumë i së sotmes, Maks, — më tha. — «Ajo që çon peshë në politikë është të dish të parashikosh. Më vjen keq, po Xhonit i mungon kjo. Praktikizmi nuk e lë të ndërtojë të ardhmen disa vjet përpara». — Kështu u shpreh peshkopi, mister Stivens dhe...

— Dhe të çuditi, apo jo?

— Po, shumë. Besoja që keni shije të njëjta...

— Si është e mundur? Unë dendem me uiski, ndërsa Erihu pi vetëm një mineral — u tall Xhon Stivensi.

— E kam me seriozitet — tha i vretur Maksi.

— Dëgjo, atëhere — tha senatori. — Nuk është i ri qëndrimi i Erihut. Kam këtu nja dyzet metra shirit të regjistruar me zërin e Erihut. Ka biseda me gra, me Rishar Balduinin, me Bill Morrisonin. Shiriti nuk gënjen, po edhe pa shirit unë e kam njohur Erihun. Mund të them që kam shkuar mirë me të. Dhe, po të mos vija kandidaturën për president, do të shkonim prapë mirë. Ai mund të pajtohet me këtë fuqi, se e di që nuk do të përfitojë asgjë nga rritja e fuqisë sime. Nga ndonjë tjetër mund të përfitojë, nga Balduini, për shembull...

— Nuk ju kuptoj mirë, mister Xhon...

— Po të bëhem president, nuk kam ndër mend ta bëj Erihun as kryepeshkop, as kardinal... E ka shumë edhe atë ofiq që mban. Pikërisht për këto gjëra dua të zgjidhem unë, Maks, t'u vë fshesën gabimeve në administratë dhe në politikë. Në një kohë si kjo jona, nuk mund të qeverisësh me miq dhe farefis, po me kokë që kanë tru. Unë nuk jam Balduini, megjithëse Erihu t'u mburr për zotësinë parashikuese të tij. Vitet e ardhshme janë vite lufte, lufte të rreptë. Ajo nuk fitohet me kokë si të Erihut me shokët. Po të zgjidhet Balduini (unë nuk do të ngurroj të përdor çdo mjet për ta penguar), në Njuhark do të qeverisë një dyzinë presidentësh. Balduini me shokë nuk do të prapsen përpara asnjë vështirësie. Mund të nxjerrin në shesh edhe sekretet më të mëdha, mund të vrasin, të presin. Erihu do t'i bekojë,

siç do të më bekonte edhe mua. Mos u çudit nëse ata përdorin edhe kartën e fundit...

Senatori hodhi ca uiski në gotën e vet. E piu me një frymë.

— Karta e fundit është çështja e gjigantëve... Po e pamë pisk në zgjedhje, do ta zbulojmë sekretin. Do të dalë në dritë se Polifemi që shtypi demonstratën nuk është një përjashtim i natyrës që ne e kemi rekrutuar në polici, siç kemi dhënë shpjegime në senat, po krijimi ynë. Në një kohë tjetër as që do të pyesja. Ne do t'i nxjerrim dikur ata, po tani përpara zgjedhjeve... Të mbushet mendja që mund të arrijnë gjer këtu?

— S'di ç'të them. Më duket absurditet të ngrihen kundër një gjëje kaq të madhe vetëm për pozitë.

— Do të ngrihen vetëm përkohësisht, Veber. Kur të kenë zënë rrënjë mirë në kapitol, do të thërresin, Veberin, Batlerin dhe të tjerët, t'i sajojnë ata gjigantët. Dhe mua do të më duhet ta mbaj prapë miqësinë me ta. Peshkopi do të jetë Xhon Stivens dhe unë Erih Mihelson, vetëm... vetëm pa ujë mineral. Nuk po shprehem qartë? Këtu ka dy lloj interesash. Ato të politikës së përgjithshme na mbledhin mes dy shinash, interesat personale na çojnë në udhë të ndryshme. Pra ata mund të lozin edhe letrën e fundit. Dy-tre njerëz e dinë me saktësi çështjen e gjigantëve. Kjo është gjë e mirë, se, po hapën sqepin, unë do të di kë të falënderoj.

— Kush mund të flasë nga ata?

— Të gjithë ata që e dinë. Në radhë të parë Erihu... Ka më shumë se dy javë që s'ka vënë këmbë këtu. Po a nuk të thirri po për këtë punë? Ai ishte i bindur që të gjitha do të m'i transmetoje mua. Këtë donte. «Hiq aore, Xho, po deshe të mos digjesh!» Këtë paralajmërim deshën të më bënin duke të thirrur ty.

— Ndoshta duhet të tregoheni pak më elastik me peshkopin?

— Jo, Maks. Erihu është nga ata që po t'u japën veturën, të marrin shtëpinë, po t'u japësh shtëpinë, të

marrin gruan... Pastaj nuk është vetëm Erihu. Do një puro? — tha ai duke u kthyer të marrë kutinë.

— Jo, ju falem nderit.

Xhon Stivensi shtypi butonin e televizorit. Në ekran asgjë me rëndësi. Ai pyeti nëse doli gjë nga ndjekja.

— Asgjë! — iu përgjegjën.

— Djalli ju marrtë! — bubulloi senatori.

— Përpara disa vitesh të gjithë ishin të bindur, siç jemi edhe tani, që, po të vinit ju kandidaturën për president, do të fitonit patjetër. Ju nuk e bëtë këtë, se ato kohëra kishin telashe dhe kokëçarje të mëdha. Si ndërruat mendje tani? Mos nuhatni një epokë të artë për vendin tonë?

— Aspak! Madje kaq keq sa tani nuk kemi qenë kurrë ndonjëherë. Po tani më thërret detyra. Unë e njoh Balduinin dhe gjithë pelikanët e mundshëm që mund të zënë vend në qeveri. Ata do ta shpejtonin katastrofën. Unë do ta mënjanoja atë, ose më saktë, do ta vonoja për disa dhjetëvjeçarë. Megjithatë, sido që të ndodhë, në Njuhark nuk do të arrihet kurrë shoqërizimi i plotë i pronës. Për këtë jam i bindur.

Maksit i shkoi mendja te Batleri. Ai duhet të pyeste ku ndodhej ai. Keq të pyeste, keq të mos pyeste... Senatori mund të dyshonte.

— Çpo mendon, Maks?

— Për Erihun... Sikur të këtë vendosur të flasë?.. «Atëhere... ushtoi në mendjen e senatorit fjala e Maksit. Ajo që si një grishje për veprim. Mendoj për Berta Snoun. Vizitat e Erihut... «Taunusi» i zi e peshkopit që frenon gati çdo mbremje përpara portës së Berta Snout. Çudi me këto gratë... Sa shpejt ndërrojnë partner... Përpara shtëpisë së Berta Snout rruga i ngjjet një ferri të vërtetë nga qarkullimi i maqinave. «Taunusi» i zi i Erih Mihelsonit mund të përplasët me ndonjë kamion të rëndë. «Ki mendjen, Erih!...» mendoj senatori.

Xhon Stivensi i buzëqeshi Maksit.

— E di, teutonikus? Ndodh që njeriu frymëzohet nga diçka krejt papritur...

— Nuk ju marr vesh — tha Maksi.

— Lëre! Nuk ke çfarë të marrësh vesh.

Ai bëri me dorë që ta linin atë bisedë.

— Të flasim më mirë për Stenlin — tha. — Vjen nesër. Nga transatlantiku më njoftojnë që është mirë me shëndet dhe duket çakërçejf. Vetëm se nuk i afrohet njeriu. As edhe grave...

— Harrova t'ju flas për Ralfin — tha Maksi.

— Prit! Pastaj... Ai ka kohë për marrëzira.

Senatori i shpjegoi me hollësi ç'duhej bërë me Stenlin.

— Do të ishte më mirë ta futnim në maqinë kur të kalojë nga vila «Trinidad» — vazhdoi senatori. — Do të shkojë patjetër andej. Po nuk shkoi, e mbërthejnë kudo që të shkojë.

— Do të shkojë në vilë — foli Maksi. — Atij nuk i durohet sa të takojë Batlerin dhe Anabellën...

— Ah! Ah! Ndonjë roman?

— Pothuaj i përfunduar...

— Aq më mirë! Do të na hyjë në punë kjo rrethanë, Maks.

«Fatkeqësisht!» tha tjetri me vete.

— Ku duhet ta shpie Stenlin? Apo doni ta bashkoni me Batlerin atje ku ndodhet tani?

— Do t'ju njoftoj me radio — i bëri bisht përgjegjes senatori.

Maks Veberi kafshoi buzët. Nuk i hiqej dot asnjë leskër atij Xhon Stivensit.

— Më folë për Ralfin, tani — tha ai.

— Kërkon të bëhet gjigant — tha shkurt Maksi.

Senatori qeshi me të madhe.

— Mos i kanë rrjedhur trutë, teutonikus? Ralfi gjigant! Më gajase, më vdiqe...

Po i doli para sysh trupi i dobët i të birit dhe u trishtua. E pushtoi një farë dhemshurie për të.

Depresioni te Xhon Stivensi nuk mund të zgjaste shumë dhe ai e mori veten përnjëherësh.

— I varfëri dëshiron të bëhet i pasur, budallai i

zgjuar dhe i dobëti gjigant. Njerëzit kërkojnë gjithmonë atë që s'e kanë, Maks. Po atij tim biri po i rrjedhin trutë. Mblidhja në një qelq, ai me siguri ka farën e gjenisë...

— Nuk është për të qeshur — ndërhyri Veberi me një farë ashpërsie.

— Ti nuk e ke kuptuar atë, Maks, — tha senatori — po unë e kuptoj fort mirë. Ai është tallur me ty dhe me mua.

— Sido që të jetë, ai nuk është në rregull — tha Maksi. — Eksperimenti ka arritur në pikën kritike, mister Stivens, duhet ndërprerë. Përndryshe mund të pendoheni një ditë! Nuk duhet ta lini të bëjë sipas kokës. E sa për teorinë tuaj të trashëgimisë... nuk i besoj asnjë thërrime!

— Ku e takove?

— Në rrugën «Toronto», përpara një ndërtesë të braktisur. Më duket se aty e kanë çerdhen.

Senatori vrejti vetullat.

— A mund ta gjejme aty, Maks?

— Mbase e gjejmë.

Senatori doli nga studioja. Martin Parkeri po zihej në një cep të sallonit me rrobaqepësin e Xhon Stivensit. Ky i fundit i kishte veshur një xhakëtë pa mëngë trupores së senatorit dhe nuk donte ta linte skulptorin t'ia hiqte.

— Më lini rehat, mister! Ç'më duhet mua se e keni bërë ju këtë skulpturë? Unë këtu i provoj vazhdimisht rrobat që i qep mister Xhonit. Dhe ai është i kënaqur nga unë.

— Hai van! Kjo është një vepër arti! Ka kushtuar mijëra dollarë — thërriste Martin Parkeri i kuq në fytyrë si hekuri i shkrirë. — Mijëra dollarë, o çifut i ndyrë!

Ata nuk e kishin parë as senatorin, as Maksin. Vazhduan të grindeshin. Rrobaqepësi betohej që senatori e kishte blerë këtë statujë vetëm për qëllime praktike. S'kishte kohë ai të bënte prova e stërprova sa herë bënte rroba.

Skulptori e hoqi xhaketën me rrëmbim dhe e flaku tutje. Ajo ra te këmbët e Maksit. Skulptori pa Stivensin që po buzëqeshte.

— Ky çifuti po më çmend — tha. — A është e vërtetë, senator?

— Një rrugë e dy punë! — u përgjegj tjetri. — Edhe vepër arti, edhe manekin për provë. Të them të drejtën, më ka shpëtuar nga shumë andralla.

— Ah, ashtu!... Manekin... Kështu jam katandisur... Manekin... — qeshi skulptori si të kishte pësuar krizë. Ngriti sytë dhe kërkoi ndihmë nga Maksi. Maksi vështronte parketin e dyshemesë.

— Ah, ashtu!.. Manekin... Mbeta vetëm. Unë dhe manekini. Megjithatë unë e bëra...

Heshti.

— Shkojmë, Maks — tha senatori. — Ra dëshpërimi i krijimit në art, u fashit. — vazhdoi ai me ironi.

Parkeri atë çast do të dëshironte shumë ta bënte copa-copa atë skulpturë. Po nuk e bëri. Kishte frikë nga Xhon Stivensi apo e s'donte të prishte krijimin e tij?

— U zemërua Martini, mister Stivens — tha Veberi duke parë si po i zbriste shkallët skulptori.

— U bëre edhe ti tragjik? Unë i çmoj këto shpërthime. Arti do të kishte vdekur pa to. Po eja të nisemi. Parkeri do të më bëjë edhe një tjetër skulpturë.

— Pandehni që jam ari pylli? — pyeti vrazhdë senatori, ndërsa po udhëtonin me maqinë. — E kuptoj artin. Dhe e dua. Ajo skulpturë më pëlqen, jam unë aty. Do të rrojë edhe pas vdekejs, siç rrojnë Qezari dhe Bruti. Po ç'të keqe ka që më shërben edhe për tjetër gjë? Ah, këta artistët! Nuk duan të zbresin në tokë! Jo, që jo!

— Qëndro këtu! — e urdhëroi Maksi shoferin.

Zbritën. Përpara tyre ngrihej një ndërtesë dhjetëkatëshe. Jashtë të linte përshtypjen e një pallati të zakonshëm të pesëdhjetë viteve përpara. Atë ndërtesë do ta shembnin.

Brenda kishte rrëmujë dhe ndyrësi. Ai vend mund të ishte çdo gjë, po jo një banesë për njerëz. Duhet të

shkoje kokulur për të mos ndeshur merimangat që vareshin nga tavanet si litarë cirku. Një kuti konserve e porsafilluar dhe një lugë e rrëzuar përdhe. Mbi parmakët e shkallëve vareshin një palë pantallona të vjetra. Pluhuri i trashë në këmbët e shkallëve i tradhëtonte banorët e asaj ndërtese. Dukeshin gjurmët nga këmbët e zbathura.

Senatori zuri hundët. Jo, kështu nuk e kishte nisur ai jetën dhe nuk donte që ta niste as edhe sikur ta vrisnin.

Në të majtë vinte një zë fyelli. Tingujve të tij u mbante iso një kor, që alternonte ca britma që të kujtonin foshnjërinë e botës.

— He! Auj! He!

— He! Auj! He!

Hynë në një dhomë të madhe pa tavan, pa dyer dhe pa dritare. Në mes të dhomës ishin ulur lakuriq në ayshe me në një rreth të madh dhjetë-dymbëdhjetë veta, djem dhe vajza. Ata tundeshin sa në një anë në një tjetër, të mbajtur për shpatullash. Tundeshin dhe këndonin në ritmin e fyellit.

Senatori u mundua të dallonte të birin. Nuk e njohe dot. Ndërkohë rrethi tundej dhe asnjë prej pjesëmarrësve, nuk e ngriti kokën për të vështruar dy të huajt.

Senatori i hodhi një vështrim pyetës Maksit.

— Ç bëjnë këta? — pëshpëriti.

— Kërkojnë të njohin trupin e tyre. Mendojnë që njeriu i zakonshëm, i veshur me petk dhe me funksione shoqërore nuk mund të njohë trupin e vet. Vetëm lakuriq mund ta njohësh trupin. Unë i kam ndjekur punët e tyre dhe mund t'ju them shumë gjëra, mistër Stivens. Këta mendojnë që trupi është një mjet shprehës, siç është fjala apo diçka tjetër. Ja, këto lëkundje në rreth përfaqësojnë trupin si mjet shoqërizimi. Vetëm kontakti i mishit krijon shoqërizim, miqësi për këta njerëz.

— Dua Ralf Stivensin, jam i ati — i tha Xhoni një vajze.

Vajza ngriti supet.

— Ne nuk kemi prindër jashtë nesh — tha. — Gjinninë tonë e kemi këtu.

Ajo shkoi dhe u ul në vendin e mëparshëm. Vuri fyellin në buzë, po nuk i ra.

— Të ngrihet ai që quhej Ralf Stivens! — thirri papritmas.

Një trup i përmbysur lëvizi andej nga fundi dhe desh të ngrihej.

«Të paktën e mbaka mend emrin», mendoi senatori.

U ngrit pothuaj në gjunjë, po nuk e pa të atin, u shtri praptas.

— Ralf!

Asnjë përgjegje.

— Dëgjo, Ralf!

Po Ralfi heshte.

Maksi dhe senatori u sprapsën dhe dolën jashtë. Xhon Stivensi ishte i shqetësuar, megjithatë i lëvrinte edhe një shprehje tjetër në fytyrë, që Maksi e kuptoi se ç'qe, vetëm pasi foli senatori.

— Dhe ç'ndodhi në fund, Maks? E pe ç'ndodhi? E pe kush sundonte mbi të gjithë? Një Stivens... Ralfi!..

Vetëm tani e kuptoi Maksi atë shprehje që i lëvrinte në fytyrë Xhon Stivensit.

— Gjaku në fund të fundit përcakton. Si thoni ju?

— Das Blut? ¹⁾

Maksi pohoi me kokë. Ai po vriste mendjen çfarë race konkuistadorësh ²⁾ i përkiste Stivensi.

— Atëhere unë nuk kuptoj asgjë — psherëtiu Veberi. — Përse djallin sillet kështu gjersa ka atë gjak sunduesi që thoni ju?

— Kur erdhi ai në botë, fronet e arta ishin të zëna — filozofoi senatori. — Janë të zëna edhe tani që u rrit. Një nga ato frone mbaj edhe unë. Duhet të kalojë shumë kohë që të lirohet një për Ralfin. Shkurt, është kriza

1) gjaku (glerm)

2) pushtuesish

e brezave që vijnë, e etërve dhe bijve... Nuk është krizë bindjesh...

Në shoqërinë e Ralfit djem të të pasurve janë vetëm dy-tre — tha Maksi. — Të tjerë tjanë plebej.

— S'merret vesh ç'farë çorbe bëhet kur nis diçka — tha Xhoni. — Duhet kohë që të diferencohen bindjet e njerëzve. Në qoftë se ka bindje...

Veberi kishte rënë në mendime. E besonte vetëm pjesërisht senatorin. Për të kriza e Ralfit që më e thellë se një krizë brezash. Xhon Stivensi i që hapur shumë atë ditë.

Xhoni fliste hapur vetëm kur punët i kishte shumë në vijë.

— Mos më folë për të, Maks. (E kishte paraqysh të birin). Më jep një adresë. Do ta mbyll në ndonjë sanatorium psikiatrik. Atje të paktën nuk do ta hanë murrat...

— Po a është me ndërgjegje të plotë, me inteli-gjencë...

— Mjaft!

Nuk folën për mjaft kohë. Veberi ndjente fyellin që vazhdonte të binte.

«Le të shpresojmë të shpëtojnë pa u kapur të paktën», mendoi Maksi.

Senator fishkëllente një melodi. Maksi vështronte udhën që përpinte maqina me vërtik. Kishte rënë në mendime të thella. Asnjëherë më shumë se në ato çaste nuk e kishte ndjerë rrezikun e lojës së dyfishtë.

KAPITULLI XIV

— Dyshoj që Batlerin e kanë grabitur, mister Larsen, — tha Billi i mërzitur. — Sikur ma ndjente zemra. Kur e patë ju për herë të fundit?

— Parmbrëmë, në kalim. Dhe për çudi m'u duk shumë i gëzuar. Pastaj nuk e pashë më. Sot erdhi shërbëtori i profesorit dhe më dorëzoi letrën. Qante. Nuk dinte ku ndodhej Batleri. Nuk ka fjetur mbrëmë në shtëpi. S'është as e mbesa, Anabella.

— Po sikur të jetë fshehur? Apo të ketë ikur vetë?

— Ndokush duhej ta dinte, mister Bill...

— S'dihet! — tha Billi i menduar.

Ai vërtiste në duar letrën, apo promemorjen e Batlerit dhe nuk dinte çfarë të bënte.

— Ju me siguri doni të dini ç'është kjo letër dhe si erdha te ju. Kjo letër më bën të dyshoj që profesorin e kanë rrëmbyer. Ai duket e parashikonte këtë. «Në qoftë se unë s'do të jem nesër e prapa në shtëpi, këtë letër jepja Larsenit». Kështu i kishte thënë Dinit.

— Kjo më shumë të shtyn të besosh që ka shpëtuar, mister Larsen — tha Billi me një farë shprese.

— Letra që keni në dorë, nuk ju drejtohet juve personalisht, mister Bill, po të gjithëve, apo më mirë gjithë atyre që mund ta ndihmojnë Batlerin. Unë brodha sot në të katër anët e qytetit, po asnjë redaksi nuk pranoi ta botonte atë. Doni të dini si erdha te ju? Në fund të udhës trembëdhjetë është një salamier i dëgjuar për proshutën e mirë, njëfarë Hans Fjordonsen. Ai ma dha adresën tuaj.

— E njoh Hansin — tha Billi. — Tani më falni t'i hedh një sy letrës.

Larseni priti gjersa e mbaroi tjetri letrën.

— Doli ajo që parashikonim — tha Billi dhe pshe-rëtiu. — Batleri nuk është krijuesi i atyre gjigantëve që i kallën datën qytetit. Për to ka punuar dhe punon dikush tjetër. Batlerin kërkojnë ta futin në atë valle. Ai kërkon që të dalë në shesh e vërteta. Ne do të përpiqemi për këtë, mister Larsen, megjithëse na e kanë shkatërruar gazetën dhe s'na lënë të botojmë tjetër. Po do ta rregullojmë. Ne mund ta shtypim në njëqindmijë

kopje si trakt. Po, gjersa Batleri nuk mund të dalë dhe të pohojë në publik vetë, mund të shpërthejnë një fushatë të tërbuar kundër nesh, sikur shpifim. Megjithatë do ta bëjmë atë që kërkon profesori. Kjo letër ka shumë rëndësi për ne. Dhe mua më vjen shumë mirë që Batleri nuk ka gisht në këtë çështje të ndyrë.

— Në qoftë se nuk ka ikur, atij i kanoset një rrezik i madh. Unë nuk e kam biseduar me shokët këtë që do t'ju them, po Batleri do të bënte mirë të ikte, të fshihej diku, të emigronte. Nuk e di a e ndjen ai rrezikun që i kanoset. Po tani mbase është vonë...

— Nuk di ç'të them — foli Larseni.

— Ne do të bëjmë çmos për ta ndihmuar Batlerin, — tha Billi. — Kjo përputhet me programin dhe planet e partisë sonë. Ne ishim në krah të tij edhe kur e sulmuan para pak ditësh.

— Nuk e dija që ishit ju — tha Larseni.

— Do t'ju lutesha të më flisnit me hollësi për Batlerin, për punët në vilë dhe banorët e saj — tha Billi.

— Me kënaqësi.

Larseni foli gjerë e gjatë. Billi e ndërpreu vetëm dy herë. Herën e parë kur përmendi Stenlin dhe të dytën kur zuri në gojë Veberin. Stenlin e njihte, e kishte dëgjuar shpesh nëpër konferenca dhe i kishte bërë përshtypje të mirë.

— Mbaj mend njëherë një debat — tha Billi. — Grupi ynë ende nuk kishte dalë më vete. Qe një debat i hapur i partisë. Po fliste Klarku... Kur ja, shoh që ngrihet një djalë leshverdhë andej nga fundi dhe e ndërpret. I mbaj mend mirë fjalët e tij, se nuk ishin të rëndomta: «Ju përkrahi kalimin fazor në socializëm, mister Klark, kalimin paqësor shkallë-shkallë... Po e dini si është kjo shkalla juaj? Ka vetëm këmbën e parë dhe të fundit. Kapitali ia ka hequr të tjerat. Po të tentoni të ngjiteni, do të bini në humnerë». Më pas ai e la alegorinë dhe doli haptas. Klarku e pati pisk atë ditë.

— «Kush është ky? — pyeta unë.

— Një shkencëtar, — më thanë — e quajnë Stenli

Pris». Po njeri i çuditshëm. Nuk e di a bën pjesë në parti.

— Po a nuk është njësoj kur ka të njëjtat bindje, mistër Bill?

— Nuk është njësoj, — tha Billi. — Partia nuk shërben vetëm për të grumbulluar njerëz me të njëjtat bindje, por për t'i organizuar ata, për t'i hedhur në luftë. Nejse... Në letrën e Batlerit përmendet Maks Veberi. Çfarë njeriu është ky?

— Vështirë ta kuptosh — shpjegoi Larseni. — Po një gjë është e sigurt, që pas tij fshihet çdo gjë. — Ngatërresat në vilë ndodhën menjëherë pas ardhjes së tij.

— Letra e hapur apo promemorja e Batlerit ka një të metë të pafalshme, trajton vetëm anën shkencore të problemit. Nuk e lidh atë me dhjetëra probleme të tjera shumë të rëndësishme që rrjedhin nga ajo.

— Është e vërtetë! — tha Larseni.

— Skemi ç'bëjmë, do ta shpërndajmë edhe kështu. Po do të jetë një punë e mangët, nëse nuk do të bëjmë një shtojcë të mirë sqaruese.

Billit iu ftoh entuziazmi i parë. Kjo letër që mban-te në duar nuk iu duk aq e rëndësishme sa në fillim.

— Sidoqoftë diçka do të dalë — psherëtiu Billi. — Më duhet të di, mistër Larsen, sa mund të mbështetemi ne te ju për këtë problem.

— Për çështjen e Norman Batlerit vihem në dispozicionin tuaj pa asnjë rezervë.

Ai nxori një blok dhe grisi një copë letër.

— Ja adresa ime. Bulevardi i pestë, rruga e bankave. Mund të mbështeteni plotësisht tek unë për Batlerin.

— Po për çështje të tjera? — se si i shpëtoi Billit.

— Ju kuptoj — u përgjegj Larseni. — Familja ime ka gjashtë breza mësuesish. Të gjithë qenë demokratë dhe nuk u pajtuan as njëherë me qeverinë. Unë dola shkencëtar. Po edhe si shkencëtar s'besoj se mund të heq dorë nga demokracia — shtoi Larseni me humor. — Mos mendoni që jam krejt i humbur. Se shkencëtarët

kështu i rendisin, ndër të humburit. Të paktën unë di ta ndaj plazmën nga gjaku... Dua të them...

— Ju kuptoj! — tha Billi dhe buzëqeshi.

— Ndodh shpesh që njeriu arrin mjaft herët në një pozicion të caktuar politik, por e zbaton mjaft vonë. Nuk jam njeri pa shqetësime, mister Bill... Po, do të flasim prapë...

Tek po matej të dilte, Larseni u kthye edhe një herë.

— Letra e Batlerit ishte në disa kopje — tha. — Njërën ia çova me postë Bill Morrisonit...

— Ah, Morrisonit?

— Ç'patët? Nuk kam bërë mirë? Mos është një fraksion juaji?

— Më shumë se një fraksion — u përgjegj Billi.

Larseni bëri një shenjë pakënaqësie me dorë.

— Lëre mos e nga ç'paskam bërë...

— Mos u shqetëso — tha Billi. — S'ka për të ndodhur gjë.

I shtrëngoi dorën Larsenit.

— Mos ju ndiqte njeri kur erdhët tek unë? — tha kur po ndaneshin.

— S di ç'të them — u përgjegj Larseni si i zënë në faj. — Nuk ma preu mendja këtë...

* * *

Donte dhe dhjetë minuta të bëhej pushimi.

Repartit i madh pëlciste nga nxehtësia. Punëtorët punonin rreth furrave të porcelanit. Flakët që dilnin nga grykat e furrave lëpiheshin pas trupave ngjyrë bronci të punëtorëve, i ndriçonin dhe i skuqnin.

Bill Redi vështronte djersën, njerëzit, maqinat. Këtu me gjithë fjalën e fundit të teknikës, mbizotëronte djersa. Dhe ajo lavë djerse bënte që kjo fabrikë moderne porcelani të mos kishte ndryshim nga poçeritë e Athinës së vjetër dhe Frigjisë.

I mbyllën kapakët e furrave, vagonat me dhe të ngjeshur qëndruan përpara përzierëseve. Ishin vagonata të vegjël, pas lakomobilit ishte vetëm një vagon i madh, pesë herë më i madh se të tjerët. Atë e përdornin kur furra kërkonte mbushje të menjëhershme nga lëkundjet e brendshme të nxehtësisë. Bill Redi ia kishte ngulur sytë vagonit të madh. Se si e krahasoi me njeriun gjigant. Krahasimi ishte pa vend.

Fishkëlloi sirena e pushimit. Punëtorët u derdhën në vendet ku linin rrobat dhe dolën që andej me peshqirë në duar. Ai u drodh kur pa disa prej tyre të shtrydhnin peshqirët.

«Ju i shtrydhni ato, të tjerët ju shtrydhin ju. Prandaj ju rrjedh djersa...»

Billi u zemërua me veten. Me gjithë lodhjen dhe mërzinë ai filozofonte pa pushim.

Njihte nja dy veta në atë uzinë të re. I pa ata dhe u bëri me shenjë të afroheshin. Ata nuk bënë pjesë në parti, megjithatë ishin simpatizantë të saj.

— Dua të flas me punëtorët — tha Billi. — M'i mblidhni, po mundët. — Ai hipi mbi shtratin e vagonit të madh dhe priti. Pas pak përpara tij u mblodhën mjaft veta.

— Ç'kërkon ky? Do të flasë?

— Nuk i paskan ndaluar mitingjet brenda në re-part?

— Ju lutem pushoni! — thirri Billi me dorën e zgjatur përpara.

— Folë, ama shpejt! Folë, vetëm politikë mos na bëj. Na ka ardhur gjer këtu!

Ai që foli e preku qafën me dorë.

— Dua të flas për diçka tjetër me ju — tha Billi. — Keni dëgjuar ç'po përgatit Thundra?

— Ç'është kjo Thundër? Folë qartë s'dimë ne nga këto!

— Thundra është qeveria, janë pronarët dhe gjithë ata që i kemi mbi kokë dhe i majmim ne.

— Oll Rajt! — u ndje një zë nga mesi i punëtorëve.

— Në djall të venë të gjithë pronarët dhe bankierët. Bjeru dhe shaji sa të mundësh. Vetëm njërin mos guxo ta zesh në gojë, njërin!

Billi u zgjat në majë të gishtërinjve dhe pa atë që fliste. Ishte një burrë i fortë e i shëndoshë si ndonjë div.

— Cilin! — nuk iu durua Billit, megjithëse nuk i pëlqeu që ajo mbledhje e shkurtër mori këtë rrugë.

— Xhon Stivensin! Atë, të lash gojën tri herë me esencë alkooli, pa ta përmendësh. Ai na mblodhi këtu, ngriti uzinën dhe na dha bukë. Tre muaj përpara ne ishim njerëz të dëshpëruar që bridhnim udhëve të përndimit me dorën e shtrirë përpara. S'është çudi që edhe ju, mistër, të na keni hedhur ndonjë pens pa na vështruar fare në fytyrë. Kështu pra, për Xhon Stivensin asnjë fjalë, darling...¹⁾

Billi e mbajti veten. Epiteti i fundit ishte më shumë një kërcënim, se sa një shprehje miqësore.

— Folë shpejt! — i thirrën. — Nuk qëndrojmë pak më këmbë, tërë ditën...

— Unë do të flas pikërisht për Xhon Stivensin — foli Billi i qetë. — Keni dëgjuar ju për gjigantët, apo përbindshat si kanë zënë t'i quajnë? Keni dëgjuar që e kanë grabitur profesorin Norman Batler? Për gjigantet...

Mes punëtorëve plasi gazi. Zunë të qeshnin dhe të bisedonin me njëri-tjetrin me zë të lartë.

— Ç'thua kështu? Ne pandehëm se do të na flusje për zgjedhjet. Le që dhe me zgjedhjet na mërzitët! Le të zgjedhin kë të duan! Se mos do të na pyesin ne!

— Ç'përrallis kështu? Ç'janë këta gjigantë?

— Zbriteni që aty!

— Shikojani sytë! Ka pirë dy kova me xhin!

Billi priti të pushonin.

— Ju s'keni faj — tha dhe u mundua të buzëqeshte.
— Ju nuk dini ç'bën Thundra nën dhe, prandaj më quani të dehur. Ju nuk dini gjë për gjigantët, po dë-

1) I dashur (angl.)

gjoni një herë... — Ai desh të vazhdonte kur dikush thirri nga kreu i repartit:

— Zbrit që aty! Ndalohen mitingjet brenda në repart! Për mitingje delni jashtë!

— Do të dëgjojmë vetëm një komunikim të shkurtër, mister Herbert — iu përgjegj burri i shëndoshë që pak më parë kishte marrë në mbrojtje Xhon Stivensin.

— Mirë, po shpejt!

Ai që quhej Herbert u zhduk nga kreu i repartit.

Bill Redi foli plot dhjetë minuta. Pas çdo sekonde që kalonte ai bindej që po fliste kot. Askush nuk po e besonte. Megjithatë e kishin dëgjuar në heshtje. Ky ishte një farë suksesi. Kështu mendoj ai atë çast.

U hodhi një sy punëtorëve dhe priti reagimin e tyre. Ata zunë të largoheshin njëri pas tjetrit në heshtje, kokulur. «Të paktën i bëra të mendojnë, tha Billi me vete, shkunda...»

Rreth tij mbetën nja tridhjetë veta. Prej tyre u shkëput një punëtor i ngjallur që kishte marrë në mbrojtje Xhon Stivensin.

— Ti je i kuq! S'ke nevojë të pohosh, ngjyra jote shihet pesëqind jarde larg.

— Kështu dua edhe unë, — u përgjegj Bill Redi qetë — të më dallojnë mirë.

— Dëgjo, ti, — u hodh punëtori i ngjallur — çështja e përbindshave që një trillim i ndyrë dhe askush s'të beson. Jemi mësuar të dëgjojmë gënjeshtër dhe më të mëdha në praktik të zgjedhjeve. Për zgjedhjet e shpikët ju gjithë këtë histori? E ç'tregon kjo? Shkarjen tuaj! Ju ia keni hyrë fushatës elektorale po me ato metoda që përdorin partitë e së djathtës. Apo nuk është kështu?

Disa nga punëtorët e aprovuan, disa deshën të kundërshtonin, po ai nuk i la.

— Nuk ju kujtohen socialprogresistët? — pyeti ai. — Ç'thoshin partitë e së djathtës për ta? Hë, pra nxirreni të shkretën!

Ai vërtitej si fugë rreth vetes dhe kërkonte përgjegje nga Billi dhe nga shokët e tij.

— Jua them unë atëhere, mbasi nuk flisni, thanë që socialprogresistët kishin minuar Njuharkun, nxorën edhe një qoshe të metrosë të mbushur me mina. Dhjetë ditë rresht gazetat vetëm për këtë folën. Po ç'që ajo? Një bllof! Kështu edhe njeriu gjigant.

— Gabohesh! — u përgjegj Bill Redi. — Ne nuk duam ta përdorim atë çështje si kapital kundër Thundrës në zgjedhje. Ne duam të pengojmë këtë vepër ç'njerëzore me ndihmën tuaj. Po në qoftë se kjo na ndihmon edhe për zgjedhjet, aq më mirë...

— Zbrit! Nuk duam të të dëgjojmë më!

— Na u mërzitën partitë me ngjyrë. Ne duam një parti pa ngjyrë, që të qeverisë si duhet, të na shtojë pagën e të mos na dërdëlisë për revolucion. Të kuqtë na lanë në baltë kaq herë. Ku janë krerët e kuq? Argalisen nëpër vila në breg të Paqësorit...

— Ata nuk ishin të kuq, — kërcëlloi dhëmbët Bill Redi, ata ishin renegatë, ishin zgjyra jonë. U vumë drunë... Po kështu do t'u vëmë drunë edhe Thundrës, edhe Xhon Stivensit, të gjithëve...

— Çuditë që nuk po vjen policia — tha me zë të lartë ai që kishte marrë nën mbrojtje Xhon Stivensin.

Fishkëlloi sirena. Billi zbriti nga vagoni. Reparti zuri të mbushej me punëtorë. Ai i pa në fytyrë shumë prej tyre. Sytë e tyre tregonin frikë, dyshim.

Billi u drodh. Kjo ishte vepra e disa renegatëve që i kishin çorganizuar punëtorët. Në çastin e fundit ata e kishin ndërruar partinë me një vilë në Palm Bek!

Disa syresh i shtrënguan dorën në kalim. Shpejt dhe fshehtas. Që pa hyrë mirë në repart, pëllëmbet e tyre djersinin.

E pa edhe një herë atë punëtorin e ngjallur. Ai mbase çuditej që s'kishte ardhur ende policia dhe që askush nga uzina nuk e kishte penguar Bill Redin të fliste. Thundra po e linte me qëllim sa të ngrinte krye partia, madje ajo edhe sikur e inkurajonte të bënte diçka, për ta zhdukur përfundimisht. Sa kohë mund të përfitonin nga kjo Bill Redi me shokë? Partia ishte

jashtë ligjit dhe goditja e Thundrës do të vinte patjetër.
— Get more fire, Comrade! 1) — i pëshpëriti një punëtor në kalim.

More fire! More fire!

Billi u gjallërua. Zjarri nuk i mungonte partisë.

Ai po dilte nga reparti, kur disa copa porcelani iu thyen nëpër këmbë. Një copë tjetër e goditi në sup. Një e tretë u thye pas derës së hekurt. Zhurma e tyre nuk u ndje. Maqinat gumëzhinin.

E la pas uzinën e porcelanit dhe iu afrua një bankine betoni ndanë trotuarit. Zakonisht aty rrinin pasdrekëve të papunët dhe pensionistët.

Billi u ul. Ishte i lodhur.

Kishte pesë ditë që bridhte nëpër Njuhark dhe qytetet satelite rreth tij. Gjatë kësaj kohe ishte ushqyer keq, kishte fjetur ku e kishte zënë nata. Mbrëmë kishte pasur më shumë fat, qe shtrirë në një kamion të ngarkuar me kërpa.

Billi u shtriq dhe rrëmoi xhepat për një cigare. I ktheu mbarë e prapë dhe nuk gjeti asgjë. E hapi edhe blokun e shënimeve. Nganjëherë gjente brenda tij ndonjë cigare të bërë petë nga të ngjeshurit.

Mendoi për zgjedhjet dhe për njeriun gjigant. Nuk mund t'i trajtonte të ndara ato dy çështje. Kishte pasur më shumë sukses në Uajt Siti ku nuk e kishte permen-
dur fare gjigantët. Po ashtu edhe në fabrikën e maqinave qepëse në Xhorxhston.

Njerëzit ishin gjer në grykë me lloj-lloj propagande dhe në prak të zgjedhjeve nuk i besonin as vetes. «Ç'lodhesh, i dashur? i kishte thënë pardje një metalurg. Ç'harxhon gjithë atë karburant? E di në ç'gjendje kemi arritur ne? Ne të gjitha i besojmë dhe asgjë nuk besojmë. Ja, kështu jemi bërë ne. Mбай mend që përpara katër vjetve na mblodhi një i qeverisë dhe na foli për ju. «Të kuqtë duan ta ndajnë globin në dy pjesë»,

1) Hidh më shumë zjarr, shok! (Angl).

tha ai. Në zëmë të pëshpërisnim. Ndahet globi? Pse, ç'është, arrë koko? Apo top bejsbolli. Me se do ta ndajnë? Me tritol apo me bomba H.? Ç'përfitim do të kenë ata nga ndarja? E praniam edhe sqarimin e tij më vonë, duan ta ndajnë në dy pjesë, në të varfër dhe në të pasur, në shfrytëzues dhe të shfrytëzuar. Po kjo s'është e vërtetë. Te ne i varfëri është përkohësisht i tillë, ai ecën drejt pasurisë. Sillni ndër mend Xhojsin, Protorin, Ben Kozinskin. Përpara katër vjetve ishin vetëm shofera taksish dhe kamerierë.»

Billi psherëtiu duke kujtuar metalurgun. Kështu ishin të gjithë punëtorët? Tundi kokën sikur t'i jepte zemer vetes. Disa herë renegatët e kishin kthyer kokëposhtë politikën e partisë. Partia e porsakrijuar ishte ende e dobët. Tetëdhjetëmijë anëtarë në Njuhark dhe afërsisht po kaq në mbarë vendin. Përpara miliona njerëzve të çoroditur, të keqinformuar dhe të lodhur nga politika, ajo i ngjante një fëmije të njomë. Po fakti që ajo zhvillohej dhe po rritej e mbushte Bill Redin me besim të madh. Ta mbaje partinë kështu të pastër dhe të pacënuar, ishte njësoj sikur ta kishe fitoren e fundit në dorë.

Billi vështroi djathtas. Bankina e gjatë kishte zënë tek-tuk të mbushej. Njëri prej të ulurve ktheu xhepin përmbys dhe mblodhi duhanin e shkundur. Pastaj gris një copë gazetë. Aty dukeshin dy sy të qeshur dhe gjysma e dorës së njërit që po fliste përpara mikrofonit, Xhon Stivensi në rolin e tribunit popullor... Bill Redit iu çua hunda për duhan dhe u ngrit. Nuk kishte asnjë pens në xhep për të blerë cigare. I kishte mbaruar që në drekë. E ndoqi edhe një copë herë me sy cigaren e trashë të mbështjellë me gazetë. Tani fytyra e tribunit Xhon Stivens po digjej dhe hiri i tij po fluturonte në qiell...

Billi zuri të ecte më shpejt. Në ora pesë pasdreke kishte mbledhje. Tri pika ishin në rend të ditës: zgjedhjet, demonstrata e përgjithshme në Njuhark dhe çështja e gjigantëve. Demonstratën donin ta organizonin për këtë të fundit. Zhdukja e Norman Batlerit e kishte ndërlikuar

edhe më shumë këtë çështje, po nga ana tjetër mund t'u jepte dorë për të ngritur popullin në këmbë. Nëse mund të quhej humbje zhdokja e Norman Batlerit, dukja e Çarli Totit ishte patjetër një fitore. Kishte ardhur të shihte gruan me lejë. Megjithëse e shoqëronin dy veta, ai kishte gjetur rastin t'i vinte në dorë një letër së shoqes tek e përqafonte. Letra ishte për Bill Redin. Ata ishin njohur në burg. Traineri kishte rënë viktimë e një mashtrimi. Se kush kishte falsifikuar bileta boksi për njëqindmijë dollarë dhe ia kishte hedhur atij. Ndenjën gjashtë muaj bashkë, pastaj Çarli u lirua. Në atë kohë nuk ia ktheu dot bindjet politike Çarlit, (gjithë filozofia shoqërore e Çarl Totit mbështetej në fitimin dhe konkurrencën) po i frymëzoi atij një respekt të pakufishëm. Jo rrallë Çarli i thoshte gjysmë me shaka, gjysmë serioz: «Po të ishin të gjithë sipërmarrësit si ti, Bill, bota do të ishte e lumtur».

Bill Redi qeshte nga kjo kontradiktë që Çarli Tot s'e kuptonte. Gjithë jeta e tij kishte qenë një kontradiktë, të cilën ai s'kishte mundur ta nuhaste dot, siç nuk kishte mundur ta nuhaste një pjesë e madhe e njuharkezëve të mirë. Jashtë takoheshin rrallë, një herë në gjashtë muaj, apo në një vit, nëse mund të quhet takim i rrallë ky në një qytet pesëmbëdhjetëmilionësh, megjithatë një gotë birrë në këmbë, apo një uiski i pirë shpejt e shpejt tregonin që s'e kishin harruar njëri-tjetrin.

— Hello, Bill!

— Hello, Çarli!

— Ç'bëhet me revolucionin? Kur keni ndër mend ta digjni Njuharkun?

— Së shpejti, Çarli! Po ty do të të lajmërojmë që të mos përzhitesh si pulat e rostiçerive. Po ç'kemi nga turritë e dërmuar? Rrjedhin dollarët?

— Pak, Bill!

— Salut, Çarli!

— Salut, Bill!

Po ata nuk ecën shumë kohë në drejtime të ndryshme. Çarli kërkoi të hynte në parti. Dhe hyri. Në atë

kohë ai punonte si masazhiator në një spital ortopedik. E kishte lënë stërvitjen e boksierëve pikërisht kur do ta ngatërronin në një skandal tjetër. Në boks lufta e vërtetë nuk bëhej në ring, po jashtë tij. Në atë spital e njohu Veberi. Futi një njeri dhe i propozoi një punë tjetër. Ajo kishte shumë fshehtësi dhe shumë dollarë. Çarli punonte vetëm gjashtëmbëdhjetë orë në javë për tridhjetë dollarë. Me këtë pagë mezi mbahej gjallë me të shoqen.

Një mëngjez erdhi si furtunë në zyrat e gazetës. I gjeti të gjithë aty.

— Më propozojnë një punë të leverdishme — tha.

— Pranoje, pse e zgjat? — i kishte thënë Xho Millsi, zezaku plak.

— Të leverdisshme dhe të dyshimtë...

— Ah, të dyshimtë!

— Kështu, Albano. Do të ushtroj profesionin e trenerit të gjimnastikës, atë profesion që ushtroja në rini. Por për tre vjet rresht nuk duhet të komunikoj me asnjëri, as me time shoqe. Dymijë e pesëqind dollarë në muaj. Kontratë e çuditshme.

— Rrogë mbreti! — kapsalliti sytë Xho Millsi.

— Prit, Xho! Ka diçka nën rrogoz këtu...

Albanoja kishte rënë në mendime. Pse duhej gjithë kjo fshehtësi kur do të ushtronte një profesion si ai i trenerit të gjimnastikës?

Mendimi i të gjithëve që se dikush po përgatiste në fshehtësi të madhe ndonjë skuadër të re bejsbolli, basketi apo të ndonjë sporti tjetër profesionist. Po dymijë e pesëqind dollarë ishin pak si tepër për një profesion të tillë. Kjo e ndërlikonte punën.

— Gjithë këto para m'i paguajnë meqë do të jem i izoluar dhe larg familjes, — kishte thënë Çarli — kështu ma shpjeguan.

— Ka mundësi që kjo të jetë një punë e pandershme dhe gremisesh me të, Çarli. Ose ndonjë eksperiment i Thundrës. Mund të jetë kështu! Mund të të çojnë në ndonjë qëndër kërkimesh dhe të të përdorin si trainer për personelin.

— Në të dy rastet unë mendoj që Çarli duhet të pranojë, sidomos në rastin e dytë. Duhet të dimë çfarë bën Thundra. Fliten gjëra të tmerrshme.

Tre muajt e parë i kaluan me kurajë. Po më pas rrinin me veshët ngritur se mos dëgjonin gjë për Çarlin. E vetmja dëshmi se ai jetonte ish-in dollarët që dërgonte në shtëpi muaj për muaj. Ato nuk vinin kurrë nga një adresë e vetme. Po të gjykoje nga adresat e mandat post-tës Çarli Tot i binte kryq e tërthor gjithë vendit. Asnjëri nuk kishte besuar që për një kohë kaq të gjatë nuk do të dëgjonin asgjë për të. Disa edhe i humbën shpresat. Ndërsa Billi dhe Albanoja u bindën që ai bënte pjesë në ndonjë kamp kërkimesh. «Pa dale! Pse të mos jetë në ishullin «Kanmarina»? kishte thënë Albanoja një ditë. Ai mund t'u shërbejë për stërvitjen e gjigantëve!» Këtë e kishte thënë kur kishin parë Polin dhe çështja e gjigantëve kishte nisur të binte erë.

Dhe ja, papritmas ardhja e Çarlit dhe letra e tij...

Çarli përshkruante me hollësi ishullin dhe njerezit. Tregonte si ruhej ishulli dhe kush ishte zot aty. Fliste mbi gjigantët dhe mbi qëllimet e Thundrës. I porosiste të ruheshin nga Xhon Stivensi. Batlerin e kishin dërguar në ishull. Çarli bënte thirrje që t'i jepej fund asaj veprë çnjerëzore, të mblidheshin gjithë forcat e shëndosha të Njuharkut.

Billi pa që po e gjurmonin. Ndjekësin e kishte parë që kur doli nga uzina e porcelanit. Në fillim nuk e pandehu të tillë. Tani u bind. «Ndoshta kërkon të më vrasë, tha Billi me vete. Po ç'pret? E kishte më lehtë ta bënte pak përpara. Tani ka njerëz...» Nuk e shtynte frika të mendonte kështu, po ajo ditë që kishte lindur dhe po perëndonte me vrasje. Në Harlem kishte pasur gjithë ato të shtëna, dy zezakë të vrarë dhe një fëmijë i plagosur rëndë. Në rrugën «Kongresi» i kishin shkrehur një karikatore të tërë maqinës së policisë. Smith Pedersoni i policisë kriminale kishte mbetur top në vend me gjithë ndihmësin e tij. Në sheshin «Kolombo» kishte shpërthyer një minë në agjensinë e aviacionit «Pan Am». Shtatë tu-

ristë belgë qenë plagosur rëndë. Lista vazhdonte, po kaq dinte Billi.

Ai që po e gjurmonte kishte futur duart në xhepa dhe pinte duhan. Nuk e vështronte fare Bill Redin, megjithëse i ndiqte gjithë lëvizjet e tij përmes xhamave të vitrinës së një supermerkatoje këpucësh.

«S'ka ndër mend të më vrasë, mendoj Billi. Ky kërkon që ta çoj me këmbët e mia në çerdhen tonë».

Zuri të ecte. Ai e ndoqi. Billi vrapoi dhe u kap pas tramvajit elektrik që u nis atë çast. Ktheu kokën dhe pa shqetësimin e atij që po e gjurmonte. E ndoqi me sy për një kohë të shkurtër, dhe e dalloj duke rendur drejt një kabine telefoni. Billi nuk priti të arrinte në stacion, po kërceu përpara. Ishte teknika e vjetër e ikjes prej policëve. Varu përjashta tramit, lëshoji këmbët zvarrë, pastaj hiqi duart... Përplasja është e fortë, shuplakat të djegin për kiamet, po të paktën nuk thyen kokën.

Nxori kasketën, e ngjeshi në kokë dhe u fut në të parën pijetore që i doli përpara syve. Doli nga dera e pasme, këtë manevër e përsëriti disa herë nëpër lokalet e tjera. Tani atë nuk e ndiqte askush, po donte t'u shpëronte ekraneve gjurmuese të televizorëve të policisë që lajnë sheshet kryesore.

Një motoçikletë frenoi përpara këmbëve të tij.

— Hello, Bill!

Ishte Albanoja me Xho Millsin prapa.

Ata e mbështetën motorin në trotuar dhe iu afruan shokut.

— Ç'ke kështu, Bill? Je zverdhur...

Albanoja e zuri për krahu gjithë shqetësim.

Billi ngriti krahët.

— Ndoshta nga lodhja...

Billi i buzëqeshi Xho Millsit plak. Zezaku e vështronte me kaq dashuri dhe kujdes, saqë Billi u prek. Atë çast ai e meritonte me të vërtetë mbiemrin «gjyshi i partisë» që ia kishin ngjitur shumë kohë përpara. Ai ishte një aktivist i vjetër i partisë, po socializmi i «gjyshit të partisë» atë kohë binte erë ungjilli, erë

Tomas Mori. Gjithë jetën e kishin akuzuar se nuk mund të urrente atë që duhej urryer. «Ja që s'mund... E drejta është me ju, po unë, i tillë brumë jam... Unë nuk ju hyj në punë. Armikun duhet ta urresh që ta mundësh».

Ai e njihte dobësinë e vet. Ata që e dëgjonin largoheshin kokulur dhe mendonin për Xho Millsin në mënyrat më të ndryshme. Kush e trajtonte më butë, shihte prapa vetes fushat me pambuk, Xho Millsin, të atin, gjyshin e tij... shihte vetëm kurrizet e tyre të zeshkët në mes të bardhësisë së boçeve të pambukut. Vetëm kurrize të përkulur apokaliptikë, diej të shuar të Afrikës, diej të mërguar me forcë...

Ato nuk zhdukeshin menjëherë se ishin bërë një pjesë e qenies së zezakut. Dinjiteti i përdhosur do kohë të ngrihet në këmbë... Megjithatë Xho Millsi u ngrit. Në fillim ai i ngjante një prifti metodist që predikon ungjillin, pastaj një banori të «Qytetit të diellit»¹⁾ më vonë u bë ithtar i revolucionit pa dhunë. Edhe tani që pranonte dhunën, shkiste ndonjëherë Xho Millsi, ky «Gjysh i partisë».

Kështu mendonte atë çast Bill Redi. Ai kishte qënë një nga ata që e kishin trajtuar me butësi Xho Millsin dhe e kishin ndihmuar të ngrihej. Billi ia nguli sytë këllëfit të violinës që mbante zezaku në dorë dhe buzëqeshi lehtë. Aty brenda kishte një «Tomson» të vërtetë me shtatëdhjetë e dy fishekë.

Xho Millsi i vuri dorën në sup Billit dhe e afroi pranë.

— Mbahu tek unë, mor Bill, — i tha ai me të butë.

— S ka gjë — tha Billi.

— Menduam se nuk do të vije as sot, Bill — tha Albanoja. — Kemi aq punë, sa...

— Unë pothuaj dështova, o mik — foli Billi. — Nuk më eci siç duhet në dy tri vende, sidomos në uzinën e porcelanit. Shumica nuk ma vari dhe sa për zgje-

1) Vepër utopike.

dhjet... Atje Xhon Stivensi gëzon popullaritet të madh.

— Është i zoti, djalli — tha i menduar Albanoja. Ju kujtua që e kishte parë njëherë Xhon Stivensin me kominoshe në mes të punëtorëve. Sillej dhe fliste si një punëtor i lindur. Dinte ta vërtiste punën, qerratai. Ai orientohej shumë më mirë me situatën e sotme se të gjithë udhëheqësit e tjerë të Thundrës që s'hiqnin dorë asnjë çast nga aristokratllëku i tyre. Edhe Xhon Stivensi qe aristokrat, po ai nuk harronte se aristokracia e tij rridhte nga kaubojt e tokave të Perëndimit. Ky ndryshim e bënte Xhon Stivensin edhe më të rrezikshëm. Ai donte që kapitalizmi të mbijetonte nëpërmes zhvillimit të shoqërisë, ndërsa të tjerët përpiqeshin të pengonin zhvillimin për të ruajtur kapitalizmin.

— Koicidenca e zgjedhjeve me atë çështjen tjetër po na prish punë, Albano.

— Si t'ia bëjmë, pra? Logjikisht e dyta duhej të na ndihmonte për të parën. Po ja që nuk po ndodh kështu. Nëntëdhjetë përqind e popullsisë nuk ka një mendim të qartë për gjigantët, prandaj shumëkush na vështron me dyshim kur flasim për ta.

— Duhet të përgatitemi për goditjen finale të Thundrës, apo jo?

Albanoja dhe Xho Millsi pohuan me kokë.

— Por pati mjaft nga ata që u orvatën të më godisnin...

— Fred Kartin e shtruan në spital — tha Albanoja. — E goditën me një hekur kokës kur po dilte nga fakulteti i drejtësisë. Rihterit i thyen krahun. Të gjithë shokët e shpërndarë andej-këtej nuk kanë shpëtuar pa ndonjë cen. Vetëm Bertoni u kthye i paprekur. Fred Karti është dëshpëruar për vdekje. Nuk nxori gjë nga studentët. Kur mbaroi ai, ata thirrën! «Urra për njeriun gjigant!», «Urra për ndërrimin e botës!» Dhe të mendosh që ishte fakulteti i drejtësisë — vazhdoi Albanoja.

— Studentët janë si fëmijë të rritur, Albano —

ndërhyri Xho Millsi. — Në çastin e fundit do të anojnë nga ne. Kështu ka ndodhur gati gjithmonë.

— Kurse Bertoni pati sukses të plotë, Bill — rifuqoi Albanoja. — Ai ishte në uzinën elektrike «Vardlington». Një nga punëtorët e kishte parë gjigantin atë natë që u përpoq të ikte. Ai e ndihmoi shumë Bertonin. Punëtorët thyen xhamet dhe dolën në oborrin e uzinës duke bërë titur kundër Xhon Stivensit. Bertoni formoi aty një komitet prej pesë vetash që do të ndërlihdhë punën me ne.

— Mjaft, Albano — ndërhyri Xho Millsi. — Po tërheqim vëmendjen këtu në trotuar.

— Nuk po duket ende Larseni — tha Billi.

Larsenin e kishin thirrur, ngaqë e njihte Stenlin. Billi vetëm një herë e kishte parë. Nuk e mbante mend.

Billi vështrroi orën. Stenli duhej të zbriste në qytet brenda dy orëve.

— Kë presim tjetër veç Larsenit, Albano?

— Frenkin dhe Llojd Perin — u përgjegj Xho Millsi.

— Siç e di, ata kanë hequr dorë nga bombat që kur u futën në parti, Bill. Megjithatë sot mund të vijë era dinamit.

Xho Millsi e tërhoqi me rrëmbim Albanon. Maqina që kaloi si vetëtimë përpara tyre, për pak do ta kishte bërë copë.

Panë andej nga iku maqina. Një fytyrë vështronte nga xhami i pasmë i veturës.

— Tani nuk do të tallen më me ne — tha Xho Millsi, duke ndjekur me sy veturën që po largohej.

Billi që zverdhur në fytyrë.

— Nuk e di se ç'kam — tha Billi. — Nuk ndjehem mirë. Ai zuri të kollitej me dorën në gojë. I pushoi kolla dhe e largoi dorën. Në pëllëmbë kishte njolla gjaku.

Xho Millsi nxori një britmë dhe u derdh nga Billi.

— Të thërrasim një taksì, Albano!

— Jo! Dua të ulem diku nja dhjetë minuta. Të pi gjëkafshë. Më kalon. Më ka ndodhur edhe herë të tjera...

— Te «Pirati» atëhere, Bill. «Pirati» është këtu pranë.

— Po Larseni? E harrova krejt...

— Larsenin e pres unë. Shko ti me Xhonë — tha Albanoja.

— Mbaje atëhere violinën, Albano.

Zuri të frynte një erë e fortë krejt papritur. Një karusel vigan çmbështillej atje ku gjente vend të hapët përmes grataçieleve të larta. Era i ngriti pezull në ajër, letra, reklama, copa rrobesh. Kërcitën dyert dhe xhamet. Në kryqëzimin e rrugës u përplasën disa maqina. Pastaj çdo gjë pushoi përnjëherësh. Letrat e reklamat zunë të binin butë nga qielli sikur t'i hidhnin avionët për një ditë feste. Një nga ato u mbështet pas gjoksit të Xho Millit, u hap aty. Ishte trakti i tyre për njeriun gjigant.

— Era po na ndihmon, — buzëqeshi Billi.

Ai i futi krahun Xho Millsit dhe të dy u drejtuan nga «Pirati».

Sella e madhe ishte pothuaj bosh. Kjo orë ishte e vetmja kohë e vdekur për «Piratin».

Billi porositi një tas me kafe.

Në banak ishte vetë Hendersoni.

— Si ndjehesh, Bill? Hë, mor bir?

— Asgjë, Xho! Një proces i vjetër...

Hendersoni e solli vetë kafënë.

— Pëlçet gjë sot? — i pyeti ai duke u shkelur syrin!

Këto lloj pyetjesh ishin të modës në Njuhark.

Billi ia preu shkurt me një lëvizje të dorës.

— Kur të fitoni ju, mos harroni që ju kam ndihmuar — vazhdoi Hendersoni dhe u shkeli prapë syrin.

Hendersoni iu afrua banakut me hapa të mëdhenj dhe të ngadalshëm. I ngjante bizonit të bardhë të Perëndimit. Vetëm se Hendersoni nuk ishte objekt kult, nuk të ngjallte asnjë ndjenjë fetare siç u ngjallte bizoni i bardhë indianëve. Ai kishte zënë të pinte shumë dhe

ndodhte që të mos dilte në banak me ditë të tëra. Pastaj kishte një gojë të vrazhdë. Por ai i kishte ndihmuar me heshtje. Policia kurrë nuk kishte nxjerrë gjë nga Hendersoni për klientët e tij, qofshin politikanë, qofshin banditë. Sa për revolucionin...

Se kush tërhoqi një karrige dhe u ul në tryezën e tyre. Ishte Martin Parkeri.

— Ju kam kërkuar gjithandej, — tha skulptori. — Më mbani mend? Jemi takuar njëherë po këtu. Ishit me Bill Nostringun.

— Ç'dëshironi? — pyeti Bill Redi ftohtë.

— Më ndihmoni! — tha Parkeri. Po shkas...

Billi dhe Xho Millsi u panë sy ndër sy. Mos ishte i dehur kv Martin Parkeri?

— Shoku im është sëmurë — ndërhyri Xho Millsi. — Ju lutem mos e lodhni.

— Ashtu?.. Më falni... Po... Po unë duhet të flas me ju. Më lini një takim. Adresën tuaj...

— Nuk ka adresë që nuk e di Xhon Stivensi — tha me ironi Bill Redi. — Pyeteni atë.

Skulptori u ngrit në këmbë.

— Unë nuk jam provokator — tha. — Po nejtë... Në djall të vini të gjithë! Të gjithë njësoj jeni...

Vunë re Frenkin që hyri me këllëfin e violinës në dorë.

Ai u bëri me shenjë të ngriheshin.

— Na falni! — i tha Xho Millsi skulptorit.

Billi vuri re fytyrën e dëshpëruar të Martin Parkerit dhe u kthye nga ai.

— Do t'ju kërkoj unë ju, mistër Parker — tha. — Mos u bëni merak. Po sot nuk mundem. Jam i zënë dhe i sëmurë.

— Ashtu qoftë! — u përgjegj skulptori disi i ngushëlluar.

Duke dalë, ata e dëgjuan që kërkoi një koktej të fortë.

— Albanoja më urdhëroi të të dërgoj në shtëpi, Bill — tha Frenki.

— Hesht ti, Frenki!

Frenki heshti për një çast, pastaj tha me zë të ulët si të ishte duke përtypur fjalët.

— Fredi vdiq. Një komplikacion në tru nga ai hekuri... Vdiq i qetë... Nuk më besohej se nuk ishte më në jetë. «Fred! Fred!» thirra disa herë dhe s'desha t'i lija infermierët ta çonin në morg.

— Fredi... — pëshpëriti Xho Millsi.

Bill Redi hoqi kasketën. Në gojë ndjente shijen e gjakut...

KAPITULLI XV

Dera ishte e hapur, apartamenti i shkretë. Fraulein Eva nuk dukej askund.

Pas derës së Kurt Veberit qëndronte kolltuku me rrota bosh...

Maksi nuk e mbyti dot këtë britmë. Shtyu derën... Fater!

Kurt Veberi shtrihej i vdekur në mes të dhomës. Kokën e mbante nga dera. Vështrimin e kishte të akullt.

Nuk ia kishin mbyllur kapakët e syve.

Thirri edhe një herë, po nuk qe i zoti të binte në gjunjë pranë kufomës, as të bërtiste më. Ajo atmosferë akulli që sundonte aty e ngriu edhe atë.

Maksi u spraps. Ndjente sikur e kishin shqyer ata vetë, besnikët e tij, në një ditë urie. Vlera e një kryeujku qëndron në lëvizjet e putrave dhe të çaponjve edhe kur këto janë kthyer në dy rrota paralitiku, nuk janë më putra, nuk janë më çaponj...

1) Baba! (Gjerm.)

Klani i ujqve! Kryeujku i vdekur!...

Ata sikur nuk ishin mbledhur për të varrosur të vdekurin, po për të zgjedhur të riun. «Përse nuk thërrasin? mendoj Maksi. Përse nuk thonë: Kryeujku vdiq! Rroftë Kryeujku!?»

U ngrit Hansi i gjatë, një ujk artiku me qime të rralla, një gërdallë akullnajash.

Përqafimi i Hansit qe i përzemërt. Maksi ndjeu në faqe dhëmbët dhe noçkat e gjithë klanit.

Pastaj klani zuri të këndonte nën zë. Në fillim kjo ishte një puhizë bore. Ajo mezi zinte vend mbi qepallat e ngrira të Kurt Veberit, aq e hollë ishte. Pastaj u trash, sikur zunë të binin copa akujsh. Kjo ishte kënga e xhunglës së ngrirë, ku sunduesi i gjithëpushtetshëm duhej të ishte dhe do të ishte klani i ujqve.

— Eja shpejt, Maks! — erdhi nëpër fill zëri i Xhon Stivensit.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti ftohtë Maksi.

Ai përpiquej që të mos e shihte fytyrën e senatorit në ekranin e vogël.

— Vdiq Erihu!.. Përpara dhjetë minutash... E shtypi një kamion i rëndë ndërsa po shkante te Berta Snou. Më dëgjon? Po shkante te Berta Snou dhe e shtypën... Pse nuk përgjegjesh? S'të shoh dot fytyrën...

Maksi uli sytë. Në ekran dukej turbull fytyra e Xhon Stivensit. Ishte me pizhama në dhomën e gjumit. Se si i erdhi keq për Erihun... Përtej ishte Kurt Veberi i vdekur. Dhëmbja që ndjente për të atin u shtri edhe mbi peshkopin. «Një vdekje ndihmon tjetrën» mendoj Maksi.

— Ç'djallin ke që nuk flet, Maks? Shpejt! Vrapo!

Maksit nisi t'i dridhej receptori në dorë. «Nga e dinte Xhon Stivensi që Erihu po shkante te Berta Snou?»

Qe një shkëndijë qartësie që u shua sakaq në trurin e Veberit.

— Ruhuni se mos rrëzoheni, Maks — erdhi nëpër fill zëri tallës i senatorit.

Veberi pati një shkëndijë të dytë qartësie.

— M'u dhimbs Erihu. po e mbaj veten. Mbaçu edhe ti. Rri larg femrave, Maks!

— Ç'ke që s'flet? Për dhjetë minuta të jesh këtu, Maks!

E pa senatorin që u kthye dhe i foli dikujt rëndë, pastaj zëri dhe ekrani u shuan.

Pas shpinës po dëgjonte Fraulin Eva.

Sytë e saj e bënë leckë. Si nuk i kishte folur ai senatorit për të atin?

— Babai ishte i vdekur për të tjerët, fraulein — e ndjeu për detyrë të shpjegohej — rronte vetëm për ne.

Vendosi të tregohej burrë një herë në jetën e vet dhe të mos shkonte te senatori.

KAPITULLI XVI

Po ndodhte diçka e rrallë në atë rrugë anësore të bulevardit të pestë. Me mijëra njerëz ishin rreshtuar në dy anët e saj. Shumica ishin zezakë. Qëndronin ashtu si policët dhe garda kombëtare, nga Kapitoli gjer në aeroport, kur duan të ruajnë ndonjë personalitet me rëndësi. Vargu i tyre mbaronte për çudi në dyert e një shkolle...

Klei Bimeni lëvizte poshtë e lart gjatë rrugës dhe shkëmbente dy-tri fjalë me ata që kishte pranë. Ky grumbullim njerëzish, këto piketa të mëdha në dy anët e asaj rruge ishin vepër e tij. Kishte pranë Xho Millsin dhe Bill Redin. Që të dy kishin pjesën e vet në këtë ndërmarrje të guximshme.

Fytyrat e zezakëve ishin të shqetësuara, megjithatë dukej se asgjë nuk do të mund t'i tundte që andej. Ata qëndronin të heshtur, me duart e bashkuara si një gardh i hekurt.

Motrat Abrams do të shkonin në shkollë. Cështia e tyre kishte një javë që ziente në Njuhark. Motrat Abrams,

njëra nëntë, tjetra njëmbëdhjetë vjeçe, nuk i kishin pranuar në shkollën e të bardhëve. Ditën e parë i kishin zbuluar. Vajzat ishin kthyer prapë të nesërmen dhe i kishin rrahur keq. Së madhes i kishin çarë kokën me një shishe boje. Gazetat e përshkruanin me tërë hollësitë ç'u ngjau motrave Abrams. Gjenin edhe një farë romantike. Babai i tyre ishte djegur pesë vjet përpara që të shuante zjarrin në kolegjin kombëtar të arteve të bukura. Vajzat e atij që i kishin dhënë medaljen e «Lavdisë qytetare» për shpëtimin e një shkolle, nuk kishin të drejtë të ndiqnin shkollën!

Shtypi i Njuharkut është i çuditshëm. Sot ke përshlypjen se u trembet autoriteteve dhe qëndron përpara tyre si shërbëtori i ngrirë me livre, nesër mendon që është shtypi më rebel në botë. Po të heqësh mënjanë organet përparimtare, që s'kanë kurrë jetë të gjatë, për te kuptuar shtypin e Njuharkut, duhet të dish mirë si i lozin fijet ata që fshihen pas tij. Dhe kjo gjë bëhet gjithnjë më e qartë gjatë fushatës së zgjedhjeve. Për opozitën rasti Abrams qe një rast i bekuar.

Klei Bimenin e lajmëruan se një turmë të bardhësh po grumbullohej pranë shkollës. Turma shante dhe bërtiste, por gjer atë çast nuk ishte orvatur të thyente gardhin.

— Mos u përgjegjini — tha ai. — Ruhuni.

— Po në qoftë se na bien?

— Ktheuani edhe ju — tha Klei duke shtrënguar dhëmbët.

— Ashtu! — e përkrahu Xho Millsi.

— Ejani t'i marrim fëmijët — foli Klei.

— Jo — tha Billi. — Le t'i sjellë e ëma vetë. Kështu do të bëjë më shumë përshtypje.

Pas gardhit të duarve ishte mbledhur një mizëri e vërtetë kureshtarësh. Disa syresh shanin dhe bërtisnin me të madhe!

— Prisni! — tha papritmas Klei. — E shikoni atë që po vjen? Ai do të na nxjerrë andralla.

— Po ai është Herri Endrijusi — tha Xho Millsi.

— Dora vetë! — u përgjegj Klei. — Shpreson se mund ta dëgjojmë nga dy orë të mira.

— Duhet të jetë i çmendur që të mendojë kështu — tha Xho Millsi.

Sytë e shqetësuar të Herri Endrijusit u ndalën mbi Klein.

— Shpërndaji njerëzit, vëlla Bimën! — u lut gati me lot në sy Herri Endrijusi. — Do të na marrësh në qafë, vëlla...

Tjetri i ktheu krahët.

— Atëhere do t'i shpërndaj unë — tha Herri. Mua më janë bindur gjithmonë.

— Nuk do ta bësh këtë, Herri! — tha Klei dhe shtrëngoi nofullat.

Herri Endrijusi bëri një hap prapa. Ai ngriti dorën dhe shënoi Xho Millsin me gisht.

— E kuptoj — tha. — Ke rënë në grackën e të kuqve. Po ajo s'është udha jonë, vëlla. Zezakut nuk i duhet politika.

Vendin e mbuloi një heshtje si me urdhër, një heshtje e thellë, që zuri të hapej në gjithë rrugën.

Tutje dukej silueta e një gruaje me dy fëmijë për dore.

Heshtjen e prishën zërat kërcënues të policëve. Zezakët nisën të këndonin andej nga kreu, pastaj kënga e tyre u përhap në gjithë rrugën. Zuri të këndonte edhe Xho Millsi nën zë. Zëri i tij e mallëngjeu fort Bill Redin. Zezaku ia shtrëngonte fort krahun. Pushoi një çast dhe seç i pëshpëriti Billit.

— Nuk dëgjoj! — tha Billi.

— Zezakët kanë filluar ta ndjejnë veten njerëz — foli Xho Millsi me ngashërim. — Po, shiko, Bill! Shikoj ata fëmijë. A nuk të therin në zemër?

Motrat Ambrams tani ishin krejt afër. I shtrëngonte fort për dore e ëma, një grua e shëndoshë. Ajo ecte me një hap të qetë, duke vështruar vetëm përpara, në drej-

tim të shkollës. E gjithë kjo ishte shumë prekëse. Dukej sikur nuk po çonin dy fëmijë në shkollë, po sikur zhvillohej një funeral.

Fëmijët iu afruan shkollës. Vajza më e madhe ngjiti shkallën e parë (sikur u ngjitën mijëra këmbë zezakësh në atë shkallë), pastaj shkallën e dytë, (mijëra këmbë zezakësh po aty...), pastaj shkallët me radhë dhe motrat Abrams u futën në shkollë. (Mijëra zezakë bashkë me to...)

Qëndruan pak brenda, po ajo kohë iu duk një shekull atyre që prisnin jashtë. Pastaj ato dolën. Buzëqeshnin... Turma nxori një psherëtimë çlirimi. Po gardhi i duarve nuk u prish, gjersa motrat Abrams u futën në shtëpi.

— Shkojmë, tani — tha Klei i kënaqur. — Do të pija një shishe verë tani edhe sikur të më kushtonte jetën. Kur pinë njerëzit më shumë, Xho? Kur janë të mërzitur, apo të gëzuar?

— Nuk e di, — tha Xho Millsi i menduar, — unë për vete mezi e përmbys një gotë.

— Shkojmë te «Pirati» — tha Bill Redi. — Paguaje unë.

Njerëzit po shpërndaheshin. Klein e përshëndetnin nga të katër anët. «Kur të përshëndetin njerëzit kështu, diçka ke fituar» — mendonte Bill Redi. Ai e njihte fare pak Klein. Kishte dëgjuar për të në rrethet e zezakëve dhe nga Xho Millsi. Një kohë ata të dy kishin qenë shoqë. Klei punonte si polombar në një shoqëri që nxirrte anijet e fundosura. Pastaj e la atë punë, po profesionin nuk e ndërroi. Filloi të xhironte filma nën ujë që patën një farë suksesi në Njuhark. Më vonë ai doli nga ujët dhe zuri të xhironte filma mbi tokë. Ku ishte më errët? Nën ujë apo në lagjet e zezakëve. Nga vërtiteshin më shumë peshkaqenët? Filmat dokumentarë, që nxirrte ai, ndoshta nuk shquheshin për shumë mjeshtëri artistike, po askush më mirë se Klei Bimen nuk dinte të filmonte jetën e vërtetë të zezakëve. Klei nuk përpiqej të gjente sensacione. Ai donte t'i tregonte botës kush ishte zezaku

dhe zezakut cila ishte bota. Veprën e Kleit e karakterizonte vërtetësia dhe drejtësia. Këto dy cilësi e shquanin atë edhe në radhët e udhëheqësve zezakë. Zezaku ishte mësuar të besonte në qiellin (atavizëm e lashtë e kohërave kur s'kishte kë të besonte tjetër).

Herri Endrijusi, apo «Gardhi i Njuharkut» siç e thërrisnin, kishte autoritet të madh në mes të zezakëve. Klein e ndihmoi mungesa e tij për të ndërmarrë mbrojtjen e motrave Abrams. Herri Endrijusi sapo ishte kthyer nga turneu i tij. I kishte gjetur zezakët në udhë. Nuk kishte pasur çfarë të bënte. Atëhere kishte vrapuar te Xhon Stivensi...

Njerëzit qenë shpërndarë gati krejt. Policët morën zemër dhe u turrën ndaj atyre pak vetave që nuk ishin larguar ende. E shtynë edhe Herri Endrijusin. Ai u përplas pas Bill Redit. Atë çast kishte një pamje prej guaku në fytyrë.

— Epo... — tha.

Rregulloi kostumin, pastaj e mblodhi veten.

— Lavdi zotit! Çdo gjë shkoi mbarë — foli ai. — Doli pikë për pikë siç më tha senatori Stivens.

— Dhe çfarë ju tha ai? — nuk iu durua Billit.

— Askush nuk do t'i pengojë motrat Abrams të shkojnë në shkollë.

— Çuditë! — foli prapë Billi. — U interesoka për çdo gjë ky Xhon Stivensi.

— Po, është njeri i kujdesshëm. Nuk e ka harruar as çështjen, për të cilën e pyete ti, Bimen. Po s'ka asnjë informatë ende.

— I kërkova të më ndihmonte për të mësuar fatin e një të njohuri tim. Po bëhen gati dy vjet që është zhdukur dhe nuk dihet asgjë për të — tha Klei si i zënë në faj.

— Kush është ky? — pyeti Xho Millsi.

— Ralf Teneki, një djalosh i ri.

— Si? Si thatë? — pyeti me rrëmbim Xho Millsi.

— Ralf Teneki...

— Njëzet e tre vjeç, trupmadh, ka punuar kamerier...

— Ai vetë — foli Klei. — Dini gjë për të? Flisni! Xho Millsi dhe Bill Redi u vështruan sy më sy.

— Ju lutem shumë!. . Flisni, nëse dini gjë për të.

— Ndodhet në ishullin e «Kanarinave» — tha Bill Redi. — Po, në atë ishull të fshehtë dhe askush nuk di për të më shumë se Xhon Stivensi. Po, po, senatori... Që është aq i kujdesshëm...

Klei ecte si i dehur, megjithëse s'kishte pirë asgjë. Ajo që i tregoi Bill Redi e kishte dërmuar. Nuk desh ta besonte në fillim, por përpara fakteve të Billit nuk kishte c'të thoshte. Kishte vështruar herë Billin, herë Xho Millsin. Zezaku plak kishte luajtur kokën në shenjë pohimi.

«Ralfi në ishull! Ralfi gjigant! Nëna e qau për së gjalli. Çfarë ankthi! O perëndi, çfarë ankthi! Një i njohur i tij gjigant... Një përbindsh në duart e armiqve. Nesër mund të të shembë përdhe edhe ty që të ka shtrënguar dorën. Njëkohë kishte një fytyrë fëmije, në një trup kollosi. Do t'ia kenë përdhosur atë fytyrë. Edhe shpirtin... Ndoshta mbahet, qëndron... Nuk epemi ne kaq lehtë...»

Posa ishin ndarë nga Bill Redi. Klei nuk ua kishte vënë veshin ankimeve dhe kundërshtimeve të Herri Endrijusit. Pastaj nuk i qe duruar më.

— Mjaft, Herri — i kishte thënë. — Ç'do më shumë? Rrugët tona ndahen këtu. Pastaj ne as që kemi ecur në një rrugë. Po deshe, dëgjoma fjalën, largohu nga Xhon Stivensi, largohu nga ata që nuk mund të jenë kurrën e kurrës njerëzit tuaj. Kështu Herri.

— Vetëm një udhë ka për zezakët, mor bir, — tha papritmas Xho Millsi — udha jonë. Mbaji mend motrat Abrams. A nuk të thamë që do t'ia dalim mbanë? Nejsë... Dhe sa për gjigantët... Do ta zgjidhim edhe atë punë...

Klei ecte me mendjen e hallakatur dhe me zemërimin në shpirt kundrejt Herrit. Shihte përpara sysh gar-

dhin e krahëve të shtrënguar dhe buzëqeshjen e motrave Abrams në prak të shkollës Kordelet e tyre të bardha mbi kokë... Kjo i jepte zemër dhe e gëzonte.

KAPITULLI XVII

— Uluni, mister Bill! Ç'do të pini? Nuk ma mori mendja që do të më kërkonit.

Bill Redi u ul. Martin Parkeri kishte një pamje të qetë në fytyrë. Me ç'dukej ai nuk po dehej më.

— Do të marr një kafe — tha Billi.

Një ditë më parë ai kishte vajtur në shtëpinë e skulptorit. Banonte në një pension të lirë në udhën e Admiraliatit. E zonja e pensionit kishte ngritur krahët. «Mister Parkeri vjen vetëm për të fjetur këtu. Dhe kur vjen... Gjithnjë pas mesit të natës. Këta artistët... Nganjëherë s'vjen me net të tëra... Ama nuk ka të sharë, nuk dehet dhe nuk pështyn nëpër shkallë si qiraxhinjtë e tjerë. Po ju kërkojeni në kafe «Kristal», aty vete gjithnjë.

— Më thanë që më keni kërkuar — tha skulptori.

Billi tundi kokën. Ai nuk dinte nga t'ia niste bisedës. Madje iu duk sikur kishte rendur kot pas Martin Parkerit. Ai ishte krejt i qetë, asnjë thërmijë nga gjithë ajo revoltë që kishte treguar ca ditë përpara. Mos kishte qenë vetëm një shpërthim artisti nga ato që ngrihen gjer në qiell dhe fashiten menjëherë?

— Po vij nga një ekspozitë skulpture — tha Billi.
— Mendova se do t'ju gjeja atje.

— Ah, ekspozita e Bankerit! Si ju duk? Ka shumë shpirt ai djalë...

Billi ngriti supet.

— Ju kishit për të më thënë diçka, mister Parker. Apo jo?

Skulptori e vështroi si i hutuar një çast, pastaj nisi të fliste. Ai i tregoi historinë e statujës së Xhon Stiven-sit. Pak nga pak zuri të merrte flakë. Bëri fjalë për «përdhosje» arti, për «banalizim», për «kthim në arti-zanat».

— Oh, Circe magjistare! Kur pashë xhakëtën e atij çifuti mbi veprën time...

Ai e përsëriti disa herë këtë shprehje. Kur fliste kështu, dukej si një fëmijë i llastuar.

— Vetëm këtë deshët të na tregoni?

— Pse? Pak është? — u indinjua Martin Parkeri.

— Nuk është pak, por unë mendova mos kishit diçka më shumë...

— Për besë... Atëhere desha t'ju lutem të më pranonit në parti! — tha skulptori.

— A jeni edhe tani i këtij mendimi?

Tjetri ngriti supet.

— Nuk di ç'të them...

— Nuk jeni! — tha ashpër Billi. — Për të marrë një vendim të tillë, nuk mjafton vetëm t'ju preku në sedër, siç ju preku Xhon Stivensi me rrobaqepësin e tij. Duhet t'ju prekin gjetiu, mister Parker, t'ju prekin thellë, gjer në kockë! Ose po të dilni nga interesat personale, të shihni si i prekin të tjerët gjer në kockë. Kështu hyhet në parti.

Nuk qe një zhgënjim ky për Billin. Ai nuk priste më shumë. Ai po kryente një detyrë.

— Ju jetoni në erë — vazhdoi Billi po me atë ton. — Megjithëse fitoni pak, shkoni me shpresën se do të pasuroheni një ditë dhe do të shpëtoni nga varfëria. Për hir të kësaj ju harroni çdo gjë. Ju hedhin një kockë, ju përkëdhelin dhe ju tundni bishtin. I veshin një xhakëtë skulpturës suaj dhe ju revoltoheni. Kështu jeni ju! Pa më thoni, përse e gdhendët në mermer Xhon Stivensin? Ta bënit të pavdekshëm? Nuk besoj që ju shkon mendja këtu. Ju paguan dhe ju e gdhendët. Po a ju shkoi nëpër mend kë do të përjetësonit? Ju paguan... Kjo kishte rëndësi...

Billi u ngrit në këmbë. Kishte harruar të pinte kafënë. Ajo qe ftohur aty mbi tryezë.

— A e dini kush është Xhon Stivensi? Pas disa kohësh do t'ju vijë turp për skulpturën që i bëtë!

Billi e uli zërin. Martin Parkeri ishte mbledhur sa një grusht.

— Mund të hysh në parti... Në atë të Nostringut apo Morrisonit. Nuk u mungon romantika as atyre. Në Njuhark pastaj ka plot parti të tjera...

— Nuk jam aq i humbur unë, mistër Bill — tha skulptori duke gulçuar. — Nuk jam aq i humbur...

Billi e piu filxhanin me kafe, të ftohtë. Iu duk se e kishte tepruar. I erdhi një ide dhe u ul në tryezë.

— A vini me mua, Parker? — e pyeti ai me të butë.

— Ku?

Skulptori kishte një pamje sikur të kishte pirë gjithë ditën.

— Të bredhim! — tha Billi dhe i hodhi një vështrim të butë.

— Posi! — tha Martin Parkeri duke u gjallëruar përnjëherësh.

KAPITULLI XVIII

— Duhet të më lënë të dal mistër Veber — tha Batleri me të fortë. Ai tha «të më lënë» mbasi qe i bindur që në këtë vend Veberi kishte një pozitë të dorës së dytë. Kush kryesonte këtu? Xhon Stivensi? Pa dyshim ai, sido që vinte rrallë.

Batleri e kishte parë vetëm dy herë. Ai e kishte pyetur për shëndetin, qe interesuar mos i mungonte gjë dhe, kur Batleri u bë gati të shtrohej në bisedë me të dhe të protestonte, Xhon Stivensi kishte dalë jashtë.

Vështroi Maks Veberin. Ai nuk i kishte dhënë ende përgjegje.

Gjatë këtyre ditëve që kishte qëndruar këtu, Batleri e kishte marrë Maksin për një barometër të gjendjes së vet dhe ishte gabuar rëndë. Kur vinte i qeshur dhe energjik, mendonte se duhet ta linin të dilte së shpejti, kur e shihte të zymtë, besonte se punët ishin keq. Kur e hoqën nga vila në fshehtësinë më të madhe, ai nuk besoi asnjë fjalë nga ato që i thanë për rrezikun që i kanosej. Ai u tha me të ashpër që mundahe-shin kot, Norman Batleri nuk do të jepte asnjë të dhënë në kundërshtim me ndërgjegjen e tij. Po, me të ardhur në banimin e ri, i doli ndryshe nga ajo që priste. As nuk e shtrënguan, as nuk e morën në pyetje. Për më tepër, ata që i shërbenin, tregonin një respekt dhe nderim të thellë. Kishin vetëm një të keqe, nuk i jepnin përgjegje kurrë aty për aty edhe sikur të bënte pyetjet më të rëndomtë. Për shembull, po të thoshte Batleri: «A mund të më sillni edhe pak çaj?», ata do të dilnin jashtë pa folur, pastaj do të ktheheshin pas pak dhe do t'i thoshin: «Po mund t'ju sjellim» ose «Jo, nuk mund t'ju sjellim».

Veberi e kishte justifikuar këtë si një masë të fortë sigurimi. «Po kundër kujt më ruani, Veber? kishte pyetur me cinizëm Batleri. «Kundër të gjithëve», i ishte përgjegjur po ashtu Maksi.

Maksi heshte. Batlerit iu duk i mërzhitur dhe i vvarë atë ditë. Në këtë çast ai mendonte për Maksin njëlloj si për çdo njeri që kryen një vepër, sepse e paguajnë, sepse do të ietojë dhe prapë gabohej rëndë.

Maksi kishte hyrë në dhomë treçerekë ore përpara dhe kishte nisur një ligjëratë të gjatë, të cilën Batleri e kishte dëgjuar pa interes. Maksi fliste për transplantimin e organeve dhe për problemin e «mospranimit të trupit të huaj nga organizmi». Foli dhe foli gjatë, pa arritur t'i ngjallte ndonjë interes të dukshëm Batlerit. Vetëm në një vend ngriti kokën profesori dhe pyeti me

ngulm: «Si thatë Veber, si thatë?» «Që të kenë sukses transplantimet duhet të kemi individë me tipare të një-llojta, të krijohen këta individë... Kuptohet që genetika e së ardhmes mund t'ia arrijë kësaj. Te individët e një-llojtë nuk bëhet fjalë më për teorinë e mospranimit. Individët e njëlllojtë janë një burim i pashtershëm pjesësh këmbimi për njëri-tjetrin. Kuptohet që këtu do të luajë rolin kryesor seleksionimi. Masa dërrmuese e individëve do të jetojë për elitën, për gjenitë».

Batlerit i kishin shkuar mornica nëpër trup. Pa botën ashtu siç e dëshironte Veberi. Një kope njerëzore, njëllloj nga trupi, nga shpirti dhe mendimet. Një grup gjaku, të njëjtat inde, të njëjtat kromozomë. Mbi kopenë elita...

Vetëm disa qindra, disa mijëra vetë... Elitës i sëmuret zemra... Heqin një individ nga kopeja njerëzore dhe zembrën e tij ia transplantojnë të sëmurit. Ky i fundit dëmton veshkën... Heqin një tjetër nga kopeja... Po i qërrohen sytë... Heqin një të tretë nga kopeja.

Batleri u ngrit me rrëmbim në këmbë. Iu turr Veberit, e kapi nga jaka e xhaketës dhe e shkundi fort.

— Jeni kriminel! Kriminel! — thirri ai.

E lëshoi dhe psherëtiu thellë. Kishte harruar ku ndodhej. Qe nxituar...

Djersë të ftohta i mbuluan ballin. Ç'do të bënte Veberi tani?

Ai rregulloi xhaketën dhe buzëqeshi.

— Nuk e prisja nga ju — tha. — Mendoja që mund të diskutonim çdo gjë bashkë.

Batleri kishte ulur sytë dhe priste çfarë do të ndodhte. Tani nuk dyshonte më që ideja e njeriut gjigand ishte e Maks Veberit. Çkërkonte ky njeri? Ku donte të arrinte kështu?

Batleri i ngriti sytë. Tjetri vështronte jashtë dritares sikur nuk kishte ndodhur asgjë. «Eshtë i sëmurë... I çmendur... Ose i tillë, ose praku i gjenialitetit. Kështu shprehet te disa ky prak, me marrëzi. Po vazhdoi

kështu, ose do të çmendet, ose do të çudisë botën. Përndëri të skëterrës! Gjithë kjo homofobi...¹⁾

— Nuk ju mbaj mëri, mistër Batler — foli Veberi pa hequr vështrimin nga dritarja. — Do të kërkoj t'ju lënë të shëtisni.

Të nesërmen ai e nisi prapë atë bisedë. Batleri e dëgjoi me vëmendje (kishte marrë vendim të mos reagoonte), po në një çast nuk iu durua.

— Ku do të preferonit të bënit pjesë ju, mistër Veber, në elitën apo ndër individët që sakrifikohen për të?

— Kjo nuk është një pyetje mirëdashëse, megjithatë po ju përgjegjem. Edhe unë, edhe ju do të donim të bënim pjesë në elitë, po do të kishte gjykatës të tmerrshëm elektronikë që mund të na seleksiononin me përdhunë. Nuk e di a keni respekt për Darwinin, po unë edhe vetëm për këtë term do ta respektoja. Në elitë do të bëjë pjesë vetëm koka e madhe, universalja.

— Ajo nuk mund të ruhet përjetësisht, Veber. Nëse do të pranoni që vdekja e vërtetë e njeriut vjen nga vdekja e trurit...

— Këtu kam një propozim tjetër, profesor. E di ç'do të thoni ju. E keni fjalën për një kokë të tillë që e mbart një trup, i cili mund të ketë pësuar me dhjetëra transplantime. Do të thoni që kokën e një gjeniali nuk mund ta transplantojmë në një trup të ri se do të lindte kontradikta në mes të trupit shumë të gjallë dhe kokës relativisht të plakur. Po unë kam një propozim tjetër, mistër Batler. Ta vëmë kokën të jetojë në solucione. Aty e kemi lehtë ta drejtojmë sipas nevojës biologjinë e saj.

Ky ishte kulmi! Batleri parafytyroi kokën e vet mbi poçe qelqi, rrethuar nga gypa plastmasi, që i sillnin jetë, rrethuar nga kufje, ekrane televizive, ordinatorë dhe kalkulatorë elektronikë, me të cilët jepte dhe merrte koka e tij.

— Do të lindnin mijëra probleme të tjera etike, do të lindte revolta e kokës pa trup dhe ajo do të pranonte

1) Homofobi — armiqësi, urrejtje për njeriun.

mijëra herë më mirë vdekjen, se sa atë jetë të gjymtuar. Jeton apo nuk jeton njeriu dhe për vete? Çfarë intereseash do të ketë ajo kokë që të mendojë dhe të punojë për shkencën, kur nuk mund të shijojë ato që ka qenë mësuar të shijojë shtatëdhjetë, tetëdhjetë vjet rresht? Kjo është absurde, Veber!

— Prandaj duhet seleksionimi, profesor. Do të mbeben vetëm ato kokë që kanë interesa shkencore në jetë. Pastaj mos harroni që interesat ndryshojnë. Në mesjetë njeriu dëshironte parajsën, disa vite më parë dëshironte tokën, ndërsa sot ne i kemi drejtuar sytë fuqimisht nga universi. Koka që jeton artificialisht do të ketë interesa të tilla dhe, po nuk i pat, po u revoltua, kjo do të jetë kryengritje e përkohshme. Nuk jam me ju, që ajo pranon më mirë të vdesë se sa të bëjë atë lloj jete. Për qenien e gjallë ekzistenca është gjithshka, qoftë gjysmake, qoftë dhjetë herë e cinguar. Kemi parë si përdridhet dhe kërkon të jetojë krimbi i tokës vetëm me tri-katër seksione? Mos e harroni këtë, mister Batler. Po do të ketë dhe kokë që do të revoltohen, gjer në fund. Do të jenë të pakta...

— Pse duhen gjithë këto, Veber, përse duhen? — pyeti gati duke iu marrë fryma Norman Batleri.

— Për të zbuluar misteret e jetës dhe të universit — u përgjegj Veberi pothuaj me të egër. Një gjë të tillë jua kam thënë edhe më përpara. Kështu si ka ecur shkencën gjer tani, nuk do t'ia dalim dot. Kemi ecur me shpejtësinë e breshkës së Filipineve.

Kishin heshtur një copë herë, pastaj Veberi kishte vazhduar: «Ato që kemi zbuluar gjer tani, nuk janë asgjë përpara atyre që duhet të zbulojmë. Më falni, mister Batler! Unë e kam për nder të quhem nxënësi juaj, megjithëse tani po luaj rolin e mësuesit. Të gjitha ato që kam thënë unë, ju i dini shumë më mirë. Po ju mungon guximi t'i shprehni hapur dhe si të thuash... me atë arrogancën e shkencës së saktë! Prandaj unë jam i revoltuar nga ju. Revoltohem edhe për hormonet... Jepjani shkencës, atë që i takon shkencës!

— Për hormonet asnjë fjalë!

— Si të doni.

Maksi u ul në poltronë. Pak nga pak ai e humbi gjallërinë e parë.

— Më thatë se do të më lini të dal... — foli Batleri.

Veberi nuk e kishte mendjen fare tek ai.

— Mundohen kot me mua — tha Batleri. — Le të më lënë të iki që këtej. Nuk do t'u shërbej. Duhet ta kuptojnë këtë.

— Ja që nuk po e kuptojnë — vuri buzën në gaz Veberi. — Për pak minuta do t'ju bëj një surprizë, profesor — vazhdoi ai. — Dhe jo shumë më vonë një surprizë të dytë.

Batleri shtrëngoi dhëmbët. Tani ai e pa qartë pozitën e vet. Maks i nuk po i përgjegjej për pyetjen që i bëri. Nuk do ta linin të delte kurrë pa e mjelur mirë. Dhe, në qoftë se gjer tani nuk i kishin përsëritur propozimet e vjetra, këtë e kishin bërë me qëllim të caktuar. Donin ta rposhtnin me anë të heshtjes së gjatë, me anë të plogështisë, mërzisë së padurueshme që i krijon papunësia një njeriu që është mësuar të qëndrojë gjashtëmbëdhjetë orë në ditë në laborator. Dera gjysmë e hapur e laboratorit dhe ajo dritë joshëse blu, ishin një tundim i pamëshirshëm, një torturë e ngadalshme që të sillte një vdekje të vonë.

Vështroi edhe një herë Veberin. Tani ishte po ai Maks Veberi i ditëve të para, i gjallë, i bukur dhe elegant. Iu duk gati si magjistar që e kishte në dorë të ndërronte gjendjen e vet shpirtërore nga çasti në çast. Ai njeri ishte i zoti për gjithshka.

Maksi vështroi orën. Ai u ngrit dhe hapi televizorin.

— Këtu ka diçka që mund t'ju interesojë, profesor — tha. — Mos e lini pa e parë.

Batleri nuk u përgjegj. Veberi u largua dhe atij iu duk sikur i hoqën një gur që i rëndonte shumë në gjoks.

— Për disa çaste — filloi spikerja e televizorit — do të shihni një emision mbi profesor Boris Shumakovin dhe mrekullitë e tij me hormonet e rritjes. Ky program...

Batleri kërceu në këmbë. Ai futi në televizor spinën e teleregjistruesit të ngadalshëm që ta përsëriste kur të donte programin. pastaj u ul në poltronë me zemrën që i buçiste si vullkan.

— ...Boris Shumakovi është i pari shkencëtar në botë që arriti të veçonte harmonet e rritjes — vazhdoi spikerja. — Me këto kërkime janë marrë edhe të tjerë si Lui Misheli, Thompson Giranti, Korodo Hasnovora. Zërat që qarkullonin për njuharkezin Norman Batler, sot cilësohen si të pathemelta...

Batleri lëvizi nga vendi. Ai ishte përqëndruar aq shumë, saqë nuk i kalonin pa parë as xixat që sajoheshin në ekran. Një tendosje të tillë nervore ai rrallë e kishte provuar.

Pastaj në ekran u duk Boris Shumakovi, një burrë rreth të dyzetave, bjond, me një pamje arrogante në fytyrë dhe me sy tepër të kaltër.

Atë çast hyri Maks Veberi në dhomë, po Batleri nuk luajti fare kokën, sado që e njohu nga të ecurit. Maksi u ul në një qoshe dhe e nguli shikimin në ekran. Profesori e kishte pas shpine. Po të kishte mundësi ta shih-te, do të çuditej, sepse ish-asistenti i tij nuk ndiqte Boris Shumakovin, po atë vetë.

Pas një historiku të shkurtër për studimet që ishin bërë për hipofizën, ku Shumakovi përmendi një mori shkencëtarësh dhe nuk zuri në gojë fare Norman Batlerin, ai filloi të ilustronte punën e vet. Shumakovi mburrej hap-tas dhe krenaria e tij aty në ekran po e dërmonte Batlerin. Ai zuri të lëvizte nëpër poltronë sikur kërkonte të futej diku. I dukej sikur e shihte Shumakovi dhe jo ai Shumakovin. Kjo ndjenjë erdhi dhe iu rrit sidomos kur argumentat e Shumakovit iu dukën serioze dhe Shumakovi vetë një shkencëtar i avangardës. Ai shpjegoi rëndësinë e madhe të veçimit të hormoneve të rritjes, po nuk tregoi rrugën që kishte ndjekur për të arritur gjer atje. Nuk kërkoi ndjesë për këtë, pa pikën e turpit tha që nuk do ta tregonte këtë rrugë, sepse ai shpresonte të nxirrte sa më shumë fitime nga kjo.

Redaktori i emisionit e pyeti se ku mund të përdorej zbulimi i tij i madh.

Batleri u ngjeth duke pritur përgjegjen e Shumakovit. Përgjegjja e tij vonoi disa sekonda. Ai buzëqeshi me një farë mendjemadhësie të dukshme, pastaj përmendi një varg sëmundjesh që mund të kuroheshin me ato hormone. Kur ai heshti, Batleri nxori një psherëtime qllirimi. Nuk po përmendte gjigantizmin, nuk ishte ai qëllimi i Shumakovit.

— Po hormonet e rritjes i kam gjurmuar për tjetër gjë rifilloi Shumakovi.

Batleri mbajti frymën.

— Me to unë arrita të krijoj njeriun e së ardhmes. Ja, ç'arrita të bëj unë me ato hormone brenda një viti e gjysmë...

Batleri qe zverdhur. Ai i kishte ngulur gishtat në mbështetësen e kolltukut dhe mezi mbahej.

Shumakovi doli prapë në ekran. Përbri tij një alamet kollosi, një gjigant me trup mjaft të bukur dhe të zhvilluar në harmoni të plotë. Gjiganti ishte vetëm me të mbathura dhe kishte kryqëzuar krahët. Vështrimi i tij ishte burrëror dhe i egër njëkohësisht. Ekranin e nxirrte si një model të përsosmërisë trupore antike. As Praksiteli, as Fidias nuk do të dëshironin model më të përkryer.

Pastaj u ndërrua përnjëherësh. U pa një rrugë qyteti që Batlerit iu duk një vend province bavareze nga disa shtëpi të stilit gotik, një veturë e ndezur, një «Parker mercedes».

Gjiganti doli me hapa të ngadalshëm katër-pesë metra përpara saj. Vetura zuri të ecte. Kollosi shtriu krahët, u përkul dhe s'e la të bënte më tutje. Shoferi u ngërdhesh dhe i dha tërë gazin maqinës me nervozizëm. Në të gjithë ekranin u shfaqën rrotat e veturës që xhironin në vend. Pastaj maqina zuri të bënte prapa e shtytur nga forca e muskujve të kollosit, në fillim ngadalë, pastaj më fort. Shoferi s'qe i zoti ta bënte maqinën as të ecte përpara, as edhe të qëndronte në vend. Kollosi nuk u kënaq me atë që bëri, por i dha një të shtyrë

të fundit dhe e hipi mbi trotuar. Maqina kërceu përpjetë, u thyen xhamet dhe shoferi përplasi fort kokën pas sediljes.

Batleri ishte çliruar nga ankthi. Gjatë kohës që kollosi shtynte veturën, Batleri harroi tërë anët negative të këtij problemi dhe vlerësoi vetëm forcën. Hormonet japin forcë! Njeriu do të ketë nevojë për forcë dhe dhjetë shekuj më pas. Forca do t'i duhet njeriut sa kohë që të ekzistojë. Atëhere pse të mos i jepet forcë njeriut?

Ato çaste Batleri mendonte vetëm për fuqinë dhe aspak për rrjedhimet e saj. Ai emision televiziv e mbërtheu aq fort, sa për disa çaste ai harroi që këtu e kishin sjellë pikërisht se kundërshtonte atë lloj force. Ato çaste jetonte vetëm Batleri profesionist, Batleri njeri kishte heshtur.

Ai nuk e ndoqi më tutje programin. U ngrit dhe zuri të vërtitej nëpër dhomë. Harroi të hiqte spinën nga televizori dhe, kur u kujtua ai, bashkë me programin e Boris Shumakovit në teleregjistruesin kishin hyrë edhe nja pesëdhjetë a më shumë kuadro nga Mis Kartli që po zhvishej dalëngadalë majë një podiumi në mes të një publiku të zgjedhur që duartrokiste dhe e inkurajonte me britma.

U vërtit edhe ca kohë nëpër dhomë pa menduar asgjë. Ishte aq i tronditur dhe i dërmuar, sa nuk qe i zotë të mendonte.

Qëndroi përpara Maksit. Sytë e tyre u kryqëzuan. «Bota punon, Norman Batler, edhe pse vegjetoni ju», thoshin sytë e Maksit.

Batleri nuk do të kishte mbetur ashtu si dru sikur të dinte që Boris Shumakovi ishte krijesë e Veberit dhe kollosi, indiani Milluoki...

* * *

«Dërmim i plotë, tha Maks Veberi me vete dhe buzëqeshi. Profesionisti ngriti krye dhe te njeriu me skru-

puj të fortë që quhet Norman Batler. Të shohim tani sa do të zgjasin skrupujt tuaj, Norman Batler...»

Ai po ecte ashtu i kënaqur dhe i gëzuar nëpër korridor dhe i çuditi fort rojet që e kishin parë të ngrysur si një ditë dhjetori këto kohët e fundit. Aq i kënaqur qe Veberi, saqë gëzimin që i solli ky sukses nuk ia shuajti dot as kujtimi i të atit që i rrinte i varur si kundërpeshë mbi kokë.

Qëndroi përpara derës numër tridhjetë e tre, një derë e veshur me pllaka hekuri, të lyera bukur në ngjyrë gri. Një herë zgjati dorën ta hapte për të hyrë brenda, pastaj ndërroi mendim. Nuk desh të hynte kështu i eksituar dhe i kënaqur nga sukcesi. Mendoi të bënte disa hapa nëpër korridor për të zotëruar veten. «Batleri do t'i vihet punës, mendoi ai. ai do edhe një goditje të vetme, po, po! Një goditje përfundimtare... Unë e kam në dorë edhe atë...»

Mbajti vesh përpara dhomës së Batlerit. Dëgjoi hapa.

Batleri vërtitej. Sa më shumë vërtitej ai, aq më i kënaqur ndjehej Veberi. Ai u kthye dhe shtypi një buton. U hap dera numër tridhjetë e tre. Në dhomë ishte vetëm një njeri, i kthyer me shpinë nga Veberi. Ai nuk ndërroi pozicion kur u hap dera, as kur dëgjoi hapa në dhomë; vështronte përtej xhamit një park të vogël, të rregulluar me një simet-ri të përsosur dhe çuditej me atë zotësi mahnitëse të kopshtarëve. Nuk e dinte që bimët dhe drurët aty ishin prej Vinil Karptoni sintetik.

Maksi doli përkrah atij, që vështronte parkun.

— Ky park që i përngjet kopshteve përralore të Harun El Rashidit është krijim i kolegëve tanë, mistër Pris — tha Veberi. — Drurët dhe lulet që duken aty si të vërtetë janë prej Vinil Karptoni... shkenca po u jep gjallëri edhe sendeve pa jetë. A nuk ju duket magjepsëse.

Stenli u kthye. Dukej sikur nuk kishte fjetur net me radhë.

Mbi ballë i kishte rënë një tufë qimesh të bardha. Po ato i shkonin.

Vështroi Veberin dhe pat shumë dëshirë që t'ia ngjishte me grusht turinjve. Duhet të ishte shumë i fortë

ky Veberi, që pas gjithë atyre skenave të ashpra që ishin zhvilluar mes tyre arrinte të buzëqeshte prapë.

— A nuk ju duket magjepsëse? — përsëriti pyetjen Veberi duke bërë me shenjë nga lulishtja.

Stenli iu përgjegj me po atë qetësi.

— Vetëm për një cast, pastaj fillon zhgënjimi. Sidomos, po ta vështrosh ditë me radhë, drurët mbeten po ata, lulet nuk rriten, nuk zverdhen, nuk bien. Një bukur e qendrueshme, së cilës i mungon zhvillimi...

Stenli u kthye nga parku. E krahasoi me jetën në Njuhark. Njuharku i kishte të përcaktuara fatet e veta, ai nuk mund të dilte jashtë atyre caqeve, ashtu siç nuk mund të dilte kjo lulishte. Qyteti rritej, ndryshonte, lindnin uzina gjigande dhe ndërtesa shumëkatëshe. Nuk kishte kufi për madhësinë e qytetit, por kishte kufi për madhësinë e njerëzve.

Thundra kishte një ligj të pashpallur: «Smithi do të ecë kaq jarde në jetë, do të mendojë kaq, do të jetojë kaq... Kështu Brauni, kështu Evansi, Litëll Eduardi, të gjithë. Të gjithë! Këta drurë prej Vinil Karptoni kishin të njëjtën jetë. Po ka të tjerë në Njuhark që nuk i pranojnë kufitë. Ata janë Njuharku...

— Vazhdoni, mister Pris — tha Maks Veberi.

Stenli u ul në kanape.

— Jo! — tha. — Më mirë ta lëmë këtë bisedë. Po të vazhdojmë, do të fillojmë të zihemi prapë. Ne kemi botëkuptime të ndryshme. Dhe unë sot nuk kam as dëshirë, as forcë të zihem me ju. Mes nesh nuk shtrohet çështja si mund të merremi vesh, po si mund t'ia hanë kokën njëri-tjetrit. Le të mos jemi hipokritë, mister Veber!

Veberi buzëqeshi.

— Paskeni vizione kanibalësh sot — tha ai dhe doli. Nëse Maks Veberi kishte gjithë ato avantazhe kundrejt Normal Batlerit, kundrejt Stenlit nuk kishte asnjë. Ai e kishte kuptuar menjëherë këtë dhe i ishte përshtatur siç duhej që në takimin e parë. Te Stenli nuk i hynin në punë armët që i provonte dhe përdorte mbi Batlerin.

Prandaj kur ulej të bisedonte me të shtihej sikur fliste me një koleg të barabartë, madje bënte sikur linte në një anë edhe faktin që Stenli ishte robi i tij. Në fillim Veberi kishte shpresuar shumë te Stenli ose më saktë te mosha e tij.

Shkencëtarët e brezit të Stenlit ose rendnin pa skrupuj pas zbulimeve, ose ishin kundërshtarë të pamëshirshëm të atyre eksperimenteve që mendonin se dëmtojnë njerëzimin. Stenli u përkiste këtyre të fundit. Veberi foli hapur me të, nuk mbajti asnjë rezervë. Stenli e dëgjoi plot një orë, pa e ndërprerë dhe pa lëvizur nga vendi.

Gjatë asaj ore, ankthi i Maks Veberit shtoej minutë pas minute, kurse Stenli kishte qenë më i qetë se kurrë. Përgjegjja e Stenlit kishte filluar me një pyetje.

— E dini mister Veber, që unë jam komunist?

Maksi kishte luajtur nga vendi sikur ta kishin goditur me shuplakë. Ai kishte pasur gjithnjë bindjet e veta politike, po nuk donte që shkencëtarët e tjerë të kishin bindjet e tyre.

Ai i tha edhe Stenlit atë që thuhej poshtë e lart nëpër sferat shkencore që «politika i lidh duart shkencëtarit, një shkencëtar politikan është si një mikroskop i rëndomtë, ndërsa shkencëtari i pavarur, një instrument dhjetëmijë herë më i fuqishëm.

— Kështu, mister Veber. Unë jam komunist — kishte vazhduar Stenli pa ua vënë veshin fjalëve të Veberit. — Dhe asniherë tjetër nuk kam qenë më i vendosur se tani në bindjet e mija. Për këtë më ndihmoni edhe ju, mister Veber, ju edhe ata që qëndrojnë mbi ju. Ju keni një të mirë, jeni praktikë. Nga ju njeriu mund ta mësojë dhe ta njohë shumë shpejt kapitalizmin, mund të njohë dhunën, urrejtjen. Ju nuk i fshihni këto se e ndjeni veten he për he të fortë. Po gënjeheni, Veber...

— E çlidhje kanë të gjitha këto me propozimin që ju është bërë, mister Pris? Përse nevojiten? — pyeti Veberi me një ironi të lehtë.

— Nevojiten që ju të zhdukni çdo iluzion në lidhje me mua. Të kuptoni që po humbni kohë kot.

— Vazhdoni, po ju dëgjoj! (Ironia sa vinte shtohet).

— Shkenca dhe politika për ju është një. Kjo është një meritë, po të marrësh parasysh që një pjesë e mirë e njerëzve tanë të shkencës nuk kuptojnë ç'bëhet për-reth. Ju i tërhiqni nga hunda sipas qejfit, sado të nder-shëm që të jenë. Dhe ata bëjnë bombën A, H, armët me Lazër dhe përbindshat. Po unë jam si ju, mistër Veber. As unë nuk e ndaj shkencën nga politika. Mua nuk do të më tërhiqni nga hunda.

Veberi heshtte. Kishte një qëllim heshtja e tij, kërkonte që Stenli të zbrazej deri në fund. Në të ar-dhmen ai nuk do të kishte ç'të thoshte dhe nuk do të ishte aq i fortë. Kur përsërit, nuk je aq i fortë...

— Nuk do të nxirrni gjë nga unë, siç nuk kenë nxjerrë nga profesori Batler. Na lini të dalim më mi-rë që këtej. Po harxhoni shumë për ne..

Veberi iku duke përplasur derën.

Dera u hap ngadalë e shtyrë nga një forcë meka-nike. Stenli e kuptoi këtë se lëvizja e derës që e njëtraj-tshme. Ai e mbajti mend këtë rrethanë dhe u mun-dua të merrte vesh nga hapej dera. Me dhjetëra herë kishte vrarë mendjen si të dilte që aty. As tani, me-gjithëse e kishte kuptuar që nuk kishte asnjë mundë-si për të ikur, nuk e hiqte atë mendim.

I sollën mëngjezin: Çaj, gjoks pule të ftohtë dhe fruta. Stenli mori një Grejp Fryit dhe e shtrydhi gati të tërë në tasin me çaj. Pastaj e afroi tasin prej por-celani te buzët. Nuk piu. Mbeti duke vështruar samu-rain në faqet e tasit. Ai kishte zhveshur shpatën dhe, megjithëse i kishte hipur një kali qesharak, mund të të jepte pa më të voglin ngurim goditjen e krillës¹⁾ më atë shpatë.

Ai e përfytyroi veten si samurai mbi kalë... Kur do t'a zhvishte shpatën?

Pastaj mendoi për Batlerin dhe Anabellën. Ishte

1) Sipas legjendave japoneze me një goditje të tillë samurai e ndante armikun me dysh nga qafa në ijë.

i bindur që edhe ata ishin aty. Kur pyeste Veberin për ta, ai nuk jepte përgjegje. Stenli nuk dyshonte në ndershmërinë e Normanit, po trembej se mos e gënjenin. Për një kohë Stenli jetoi në ankth të vërtetë, pastaj fitoi një farë qetësie. Ankthi i vinte nga siguria që tregonte Veberi, nga ajo fytyra e tij që shkëlqente. Përpara se t'i hapte televizorin Batlerit, Maksi e kishte bërë atë provë me Stenlin. Stenli kishte vrarë mendjen për një kohë të gjatë se kujt i ngjiste Boris Shumakovi i televizorit. Dhe e kishte gjetur. Atëherë i qe turrur Veberit.

— Jo keq — i kishte thënë. — Batlerit nuk do t'i shkojë ndër mend që Boris Shumakovi juaj luan në një theatër të dorës së tretë në Njuhark. Doni t'ju them edhe emrin? Në mos gabohem, e quajnë Patrik Kollins. Po ç'keni, mistër Veber? Dështuat? Mos u mërzitni, do të sajoni diçka më të goditur radhën e ardhshme... Ja çdo të thotë të kesh fat! Të njohësh Patrik Kollinsin në një qytet njëzetmilionësh! Më uroni, Veber!

Stenli qe hedhur në ofensivë. Fjalët i rridhnin si përrua.

Në rini Stenli kishte bredhur theatrot e parëndësishme të Njuharkut me shpresë se ndonjë ditë do ta pranonin për Otello apo Hamlet. Sikur ta kishte ditur këtë rrethanë Veberi...

Stenli nuk e kishte ngrënë, po mund ta hante Batleri. Apo nuk luante me gjithë fuqitë Patrik Kollinsi? Veberi për Batlerin e kishte pregatitur gjithë këtë. Stenli nuk do të kishte besuar, edhe po të mos e njihte Patrik Kollinsin. Ai sapo ishte kthyer që jashtë dhe e njihte mjaft mirë gjëndjen në fushën e kërkimeve endokrinologjike. ¹⁾ Po mund ta hante Batleri... Ai duhej lajmëruar. Po në ç'mënyrë?

1) Të gjendrave me sekrecion

KAPITULLI XIX

Njerëzit nxitonin drejt sheshit «Delauer». Maqinat i kishte bllokuar policia dhe ata ecnin në këmbë.

Qe një mëngjez i zyrtë dhe jo i zakonshëm. Po t'u heqësh maqinat rrugëve të Njuharkut, gjithë mëngjezet dhe mbrëmjet do të duken të jashtëzakonshme. Qoshet e trotuareve ishin pis. Maqinat e ujit kishin shplarë rrugët dhe gjithë ndyrësitë u ishin veshur trotuareve. Binte erë bloze dhe klori. Dukej sikur policia kishte shpërndarë një demonstratë me lëndë kimike. Kjo përzihej me erën e djersës së punëtorëve që kishin ardhur fill nga turni i tretë të dëgjonin Rishar Balduinin.

Reklamën e madhe të cigareve «Marlboro» e kishin harruar të ndezur. Natën ajo harxhonte energji sa për dymbëdhjetë apartamente. Ditën dukej diçka e shplarë, e përmbytur nga rrezet e diellit. Puroja që dilte si grykë topi nga paqeta gjigante, vazhdonte të nxirrte tym, sikur pak tym kishte në gjithë qytetin. Diku binte një fanfarë, një përzjerje marshesh që ndihen nëpër parada.

Në një qoshe, një invalid kishte hapur një gramafon dhe shpresonte të nxirrte ndonjë pens me ndihmën e zërit të mallëngjyer të Mahallia Xhekson. Rreth e për-qark sheshit vareshin me qindra banderola. Në çdonjerën prej tyre qe shkruar: «Balduin!» Ky emër shihej në bluzat dhe kapelat e shumë prej atyre që po grumbulloheshin në shesh. Në krye të tetë udhëve që të çonin në shesh, anëtarë të shoqërisë «Jezui u ngjall», u jepnin kalimtarëve një trëndafil të kuq dhe një të bardhë sikur të donin të nxirrnin prapë nga arkivat grindjet e dinastive në Angli.¹⁾ Edhe Billit e Albanos u dhanë nga dy trëndafilë. Ata posa kishin ngrënë mëngjezin në një restorant të dorës së dytë. E kishin ngrënë së bashku me

1) Lufta e dy trëndafilave në Angli.

Rishar Balduinin, ose më saktë nëpër pjtat ku kishin stampuar portretin e kandidatit për president. Billi e kishte fshirë mirë e mirë salcën nga fytyra e Balduinit, pastaj kishte kundruar një copë herë me nge. Balduini vetë...

Billi dhe Albanoja nuk dinin çtë bënin me trëndafilat dhe ia zgjatën një burri të shëndoshë që ecte për-krah tyre.

— Balduini është shpresa jonë — u tha ai atyre.

Nuk i dhanë përgjegje.

— Pse pa kapelë ju? Pse pa distiktivin e Balduinit, — vazhdoi i panjohuri duke u mbështetur te Billi që t'i lironte udhën një grumbulli të rinjsh, që bërtisnin për kandidatin.

— Nuk jemi me Balduinin ne — tha Billi.

— Po me cilin jeni? Me atë derrin Xho?

— S'jemi as me derrin Xho...

— Në djall të veni atëhere! — shfryu i panjohuri dhe u bashkua me të tjerët.

Vërshonin pa ndërprerje turma të reja njerëzish. Mes tyre mjaft punëtorë. Bill Redit i therte në zemër. Ç'kishin të përbashkët ata me Balduinin? Asgjë.

— Këta janë ajo pjesë e popullit që ne s'po dimë ende ta tërheqim me vete, Albano, — tha Billi.

— Do të dimë, — tha tjetri. — Ata janë tanët.

Kaloi një grup vajzash me bluza dhe pantallona të gjera. Në xhepin e pasmë të pantallonave të gjitha kishin të shkruar me germa të mëdha «Haendle With Care!»¹⁾ Billi i ra me bërryl Albanos. Qe një filozofi e tërë e shprehur me paturpësi.

Billin e shtynë dhe ai u kthye të shihte prapa. Takoi vështrimin e Bill Nostringut. Ai u habit. Nostringu mbannte kapelën dhe shenjzat dalluese të partizanëve të Rishar Balduinit.

— Albano...

— E pashë, Bill...

1) Ngrejeni, prekeni, monovroni me kujdes. (Shkruhet në ambalazhimin e qelqurinave).

Nostringu humbi në turmë, po në mendjen e Billit dhe Albanos mbetën fjalët e shkruara në shpinën e tij: «I love Balduin 1)»

Billi u ngrit në majë të gishtërinjve. Po vinte një veturë e madhe. Brenda ishte Balduini. Gazetarët e rrethuan menjëherë.

— Vetëm dy fjalë, mister Balduin. Cili është slogan 2) juaj?

— Fitore! — u përgjegj gjithë gaz Balduini.

— Do të bëni ndonjë deklaratë të re sot?

— Po! Diçka që do të trondisë Njuharkun dhe Xhonin tonë të dashur... Ah, No! No! No!..

Tri ndajfoljet mohore ishin si tri të shtëna. Rishar Balduini shkau brenda turmës si një kokërr rëre që e përpjnjë thellësitë. Papritur u dëgjuan disa krisma. U bë pështjellim i përgjithshëm.

Balduini u gjend i shtrirë, i goditur për vdekje. Fytyra e tij u shkel nga këmbët e njerëzve. Policët u vunë në kërkim. U desh mjaft kohë të zbulonin Bill Nostringun.

«I marrë tha me vete Bill Redi, Ti i hape rrugë Xhon Stivensit. Duhet t'i lije të përfyteshin sa më shumë. Apo ishte krahu i tij? Killer 3) i tij...»

Njerëzit i shtynë tutje, i shkelën. Kur u ngritën ata, tajfuni po zbriste në jug. Ai shfrynte mërinë mbi kokët e zezakëve, në vitrinat e dyqaneve të vogla, në shpinat e njerëzve me kominoshe. Djersa e atyre që kishin ardhur fill nga turni i tretë u përzje me gjak. Një arësye më shumë për Bill Redin që të kuptonte se ata kishin vajtur atje gabimisht.

Bill Redit i shkoi mendja te Morrisoni. Cili do të ishte fundi i Billit të tretë?

1) E dua Balduinin.

2) Slogan këtu në kuptimin e parullës.

3) Vrasës, dorë e zezë

KAPITULLI XX

Ai që i shërbente Stenlit qëndroi si i ngrirë në praktikë të derës.

— Gjymnastikën, mistër!

Stenli u ngrit.

Mori peshqirin dhe doli në korridor. Në dy anët e korridorit kishte plot dyer, po Stenli s'e kishte parë asnjërën prej tyre të hapur. I tërhoqi vërejtjen një shërbëtor tjetër nga kreu i korridorit. Ai u afrua pranë një dëre dhe shtypi diçka me gisht në qoshe të saj. Stenli e kuptoi që u hap dera vetëm nga një vazhdë drite që ndërpreu korridorin. Pastaj ajo u shua sakaq. «Komandim nga afër dhe nga larg», mendoi Stenli. Në cilat dyer do të ishin Batleri me Anabellën? Mos ishin në atë derë që u hap?

U fut në sallën e gjymnastikës. Çarli Tot po e priste bashkë me sekundantët e vet.

Stenli la peshqirin në një stol dhe u drejtua nga paralelet. Nuk foli, se e dinte që nuk do t'i përgjegjeshin. Megjithatë ky treneri i gjymnastikës... Se si e vështronte ai, se si i shtrëngonte duart kur e ndihmonte në ushtrimet...

Kërceu në paralele. Ndjente kënaqësi të vërtetë kur bënte ushtrime të vështira aty. Kishte ndenjur mbyllur gjithë atë kohë dhe ato lëkundjet në paralele ishin si të thuash përgjasimi i lirisë...

— Kip!

Stenli u ngrit në kip.

— Vertikale!

U ngrit në vertikale.

— Lëkundje me temp.

— Kur të dal që këtu, do të marr pjesë në gara — bëri shaka Stenli. — Do ta lë shkencën. Thonë që sportistët fitojnë shumë para...

Asnjëri nuk u përgjegj.

Stenli u ngrit edhe një herë në vertikale dhe provoi

të qëndronte me një dorë. Nuk ia arriti. Ai do të ishte rrëzuar, po të mos e kishte mbajtur Çarli. Stenlit nisi t'i rrihte zemra me forcë. Nuk i besoi vetes. Traineri i kishte futur në dorë një shuk letre.

— Për sot mjafton — tha Stenli gjithë merak se mos i binte letra. — Jam i lodhur sot.

Mori peshqirin dhe e hodhi në krah. Një cep të tij e mbajti në dorë për të maskuar letrën. E lexoi atë në shtrat, nën batanie, se druhej nga ndonjë objektiv i fshehtë.

«Mbahuni!, thoshte letra. Jashtë mendojnë për ju. Dinë çdo gjë për ishullin. Së shpejti do ta marrin edhe në film. Lidhuni me mua me letra. Me gojë asnjë fjalë. Ka mikroaparate shumë të ndjeshme. Letrat i lini nën stolin ngjyrë gri ku uleni për t'u çlodhur. Batleri është atje, në dhomën numër tridhjetë e pesë... Ai qëndron ende mirë...».

Stenli u përmallua si fëmijë. Normani të ishte një numër larg tij dhe ai të mos dinte asgjë!

E gëlltiti letrën dhe u ngrit. Fuqi të reja i kishin ardhur.

Ndërkohë Veberi vëzhgonte përmes ekranit trazimin e Norman Batlerit. Ai buzëqeshte. Dy orë përpara Batleri kishte kërkuar revistat dhe gazetatat e ditës.

Këtu qëndronte asi i fundit i Maks Veberit. Ai kishte përgatitur edicione të falsifikuara. Gjysma e shtypit që i sollën Batlerit fliste për Shumakovin dhe gjigantët e tij.

Norman Batleri lëvizte nëpër dhomë. Një puro e kishte në gojë, tjetra po digjej e posafilluar në taketuke. Normani qëndroi dhe vështroi tymin e puros që ngjitej lart, pa kuptuar aspak nga buronte ai. I dukej sikur dilte nga puroja që mbante në buzë. Ai qëndroi ashtu gjersa puroja u dogj pothuajse krejt dhe bishti i saj i trashë ra mbi mbulesën e tryezës. U dogj edhe ajo, puroja aty bëri një rreth. Batleri e pa rrethin dhe anët e tij të ndezura, pastaj pa rrathë më të mëdhenj njëri brenda

tjetrit, rrathë që lëshonin shkëndija dhe që hapeshin në eter, në përgjasim të valëve të radios.

Batlerit iu duk sikur ra zjarr i vërtetë në dhomë. Ai u preokupua aq shumë për atë vrimë të djegur në mbulesë, aq sa do të ishin preokupuar pompistët për ndonjë supermarket në flakë. E shoqti me mëngën e xhakëtës, me ngathtësinë qesharake të atij që s'i vinë ndorësh këto punë. Në këto çaste ai të kujtonte Çaplinin në filmat pa zë të njëzetepesës. Pastaj u shemb në kolltuk përnjëherësh, si pas një pune që i ka ngrënë gjithë fuqitë. Megjithatë mendja e tij punonte te gazeta «Njuhark Tajms»; kishte një shkrim shumë të fortë kundër qeverisë në faqen e parë. Artikulli qe shkruar nga Atli Braun, që kishte fituar Çmimin Nobël në fizikë. Në të dyja anët kishte dy foto të mëdha si dy engjëj roje, Boris Shumakovin dhe Batlerin. Batleri gati mbeti pa frymë kur pa firmën e Braunit poshtë artikullit. Ishte e vetmja kokë, përpara së cilës Batleri qëndronte me nderim. «Qeveria jonë e nderuar, shkruante Brauni, që ruan më së miri hajdutët e xhepave në burgjet federale, nuk qe e zonja të ruante nderin e Njuharkut dhe tërë vendit, Batlerin. Batlerin e rrëmbejnë nën hundët tona dhe ne presim të na e kthejnë dhe të na kërkojnë të falur që e trazuan. Pa Batlerin, Boris Shumakovi edhe për dy shekuj nuk do t'i veçonte dot hormonët e rritjes. Batleri po cicëron andej në Lindje për lavdinë e qeverisë sonë të fortë dhe si për inat i tregon Shumakovit edhe më shumë se ç'i kërkon. A është i poshtër Batleri? A duhet akuzuar ai për tradhëti të lartë? Kjo nuk duhet të na shqetësojë tani. Duhet të na shqetësojnë syleshët që merrren me fatet e kombit. Po të rronte Tueni, do të thoshte që ne do të na shkatërrojë hunda jonë. Hunda jonë po arrin katin e fundit të Empajr Bildingut.¹⁾ Përtej oqeanit Shumakovi ka zënë të fabrikojë gjigantë. Nuk janë vetëm nga trupi të tillë. Nuk përjashtohet një mendje po në këto proporcione. Ne do të

1) Grataciele në Nju-Jork

vazhdojmë të nxjerrim një Anshtajn në çdo gjysmë shekulli, ndërsa Shumakovi do të na bombardojë me qinara Anshtajnë të tillë. Pastaj ne kemi një farë lëmshi në gjoksin tonë që psikologët e quajnë ndërgjegje. Ky lëmsh, në shumicën e rasteve të ndihmon të ngatërrosh shkencëtarët me asketët më të devotshëm të perëndisë. Thonë që Batlerit i paskan propozuar të bëjë në Njuhark atë që po bën tani në Lindje për Shumakovin. Kur ishte këtu, Batleri i ngjante profetit Ilia, po, me të ikur, u bë shumë tokësor. E la ndërgjegjen në një anë dhe hapi xhepat... A nuk të shtyn kjo të mendosh se skrupujt e fortë duhen fshikulluar dymbëdhjetë herë në ditë me kërbaç? Po le të kthehemi edhe një herë te qeveria jonë e fortë! Si do t'i bëjë ballë ajo kësaj gjendjeje? Kur të tjerët nxirrnin një nëndetëse të re, ne turrehim të bënim një tjetër dy herë më të përsosur. Nxirrnin një bombë të re, ne na dilte gjumi dhe fabrikonim një tjetër dy herë më të fuqishme. Në raste të tjera i arrinim dhe i tejkalonim ata që na dilnin përpara. Po si do t'ia bëjmë me Boris Shumakovin? Mos mendojnë gjeneralët tanë të krijojnë gjigantë me nga tri kokë? Po qe kështu, duhet të përjetësohen në mermer.

Fantazia më e çmendur pranohet sot si krejt reale.

Pranohet gjithashtu se ata që na qeverisin nuk kanë pikë fantazie dhe përgjegjësie për fatet e kombit.

E hodhi gazetën mbi tryezë.

— Gabohesh, Atli — pëshpëriti Batleri. — Nuk më ka rrëmbyer Shumakovi siç të kanë gënjyer... Dhe ai ia arriti vetë asaj, vetë! Kurse unë...

Mezi e mbante tërbimin kundër vetëvetes. Tërbimi i tij përmbante pak gjak nga konkuistadorët spanjollë që populluan këto brigje, pak nga kërkuesit e arit të Klondajkut, pak nga njerëzit e sotëm që manovrojnë bursën në Njuhark.

Veberi i ndiqte pas ekranit gjithë lëvizjet e Batlerit, po nuk mund t'i ndiqte mendimet e tij. Ai nuk e dinte që Batleri atë çast kujtonte Openhejmerin ¹⁾ që nuk ki-

1) Shkencëtar atomist. Krijues i bombës A

shte dashur të bënte bombën me hidrogjen. Ç'nuk i punuan. Ai qëndroi. Po çfarë doli nga rezistenca e tij? Doli dikush tjetër dhe bombat H i radhitën nëpër arsenalet si vezët e strucit. Kështu kishte ndodhur gjithnjë. Gjithnjë do të dilte dikush për ta bërë atë që nuk e pranonte ndërgjegjja normale. Kështu kishte ndodhur me bakteriet, me raketat, me gazrat...

Batleri ndjeu në gojë shijen e ipritit¹⁾ dhe i erdhi për të vjellë.

Tingëlloi videofoni dhe Veberi hoqi sytë nga ekrani, me të cilin gjurmonte Batlerin. E dinte që ishte Xhon Stivensi, prandaj nuk u ngut të ngrinte receptorin. Veberi kishte vendosur t'i lante hesapet me Batlerin me ta zgjidhur gjuhën. Do të kujdesej që Norman Batleri të mos mund të fliste më dhe... «Dhe lamtumirë, Xho... Kujtojmë për të mirë... Merru me import, eksport, mbaj fjalime në Kongres, ëndërro për president dhe bëj grushte shteti andej-këtej, veç hiq dorë nga gjigantët. Lëre të rritet mbinjeriu në atdheun e vet, në racën e vet!»

Videofoni tingëlloi edhe një herë. Maksi ngriti receptorin.

— Ç'të reja kemi, Maks?

— Hëpërhë asgjë, mistër Xhon...

— Të jesh kaq miop? Nuk më besohet. Nejse, atëhere po t'i jap unë të rejat. Dritarja ime vështron në kopshtin tënd...

Maksi pa dhomën e Batlerit në ekranin e televizorit të senatorit. E pa përpara videofonit të tij.

Batleri vërtitej nëpër dhomë me gjallërinë e njeriut që ka marrë një vendim me rëndësi.

— Ç'thua, Maks?

Veberi ngriti supet. Në receptor buçiti e qeshura e Xhon Stivensit. Ai e mbylli telefonin pa shtuar më asnjë fjalë. Qe si një dush i ftohtë për Veberin. Në atë çast ai humbi çdo shpresë për t'ia hedhur Xhon Stivensit.

1) Gaz helmues.

KAPITULLI XXI

Ata nuk ishin të përbetuarit e plantacioneve dhe nuk mundoheshin të fshihnin fytyrat nën strehët e gjëra të panamave. Nuk po thurnin ndonjë atentat kundër padronit dhe nuk kishin ndër mend të digjinin «aziendan»¹⁾ e tij; megjithatë, mbi një fuçi dukeshin dy zare. Kujt do t'i binin ato?

Në vend të Abraham Linkolnit, në mur vështronte Marksi. Atmosfera që e rëndë. Njeriu që ishte dërguar të arrinte në ishullin e «Kanarinave» nuk ishte kthyer. Ai do të merrte filmin që kishte nxjerrë Çarli Tot. Çarli kishte treguar me hollësi në letrën e parë ku do ta fshihte filmin. Askush më shumë se ai film nuk mund të nxirrte në dritë se ç'bëhej në ishull.

Ted Kanigani duhej të ishte kthyer që pardje. Ishte nisur me një varkë të vogël me një velë për t'i shpëtuar radarit. Veli mezi dilte mbi trupin e Kaniganit.

Asnjëri nuk thoshte se ai kishte vdekur. Nuk guxonin as ta mendonin. Tedi... Rrinin në atë kantinë vere dhe mendonin për të.

Filmi duhej të vinte në Njuhark. Duhej të vinte me çdo kusht!

Kush do të ndiqte udhën e Kaniganit?

Rrymën e fuqishme që rrethonte ishullin mund ta përballoje vetëm me trap. Me asnjë mjet tjetër. Ky ishte mendimi i Albanos. Po kush e përpiu Ted Kaniganin, Thundra apo oqeani?

— Boys²⁾ më lini mua të shkoj, boys! — u lut me zë të thekur Xho Millsi.

Atij nuk ia vunë veshin.

— Do të nisem unë — tha Frenki.

— Unë!

1) Ndërmarrje

2) Boys — diema.

— Unë!

Tre-katër zëra të tjerë.

— Mund të shkoj vetëm unë — tha Llojd Peri. — Unë kam punuar në det.

Xho Millsi tundte zaret. Me mend u kishte vënë të gjithëve nga një numër. Gjashtën Bill Redit...

I lëshoi nga dora në një mënyrë të tillë si për të kaluar ato intervale pushimi gjithë tension. Zaret rrëshqitën nga vozat dhe ranë përdhe. Xho Millsi i ngriti pa i parë.

— E ke gabim, Llojd — kërceu Billi. — Detin e njoh edhe unë. Njëqind e pesëdhjetë milje janë. Pastaj, sido që të ndodhë, njësoj është për mua... Unë jam i vetëm.

Albanoja po mendohej. Billit i kishte vdekur ato ditë gruaja. «Apo mos fliste kështu se ishte i sëmurë?»

— Mos e ke fjalën edhe për sëmundjen, Bill?

— Jo, Albano. Ai proces mund të mbyllet ashtu si u hap.

— Billin duhet ta kuptoni — tha Albanoja. — Nuk është sentimental ai. Megjithatë nuk duhet ta shtronte kështu çështjen.

— Unë, Albano...

Tjetri i bëri me shenjë të pushonte.

— Le ta bëjmë me vota të fshehta — tha ai. — Jemi shtatë veta.

Billi qeshi.

— Do të ketë shtatë emra të ndryshëm — tha. — Secili do të shkruajë të vetin.

— Atëhere do ta caktoj unë! — foli rreptë Albanoja.

— Caktoje! — thanë me një gojë.

— Do të shkojë Llojd Peri!

— Të falem nderit! — tha Llojd Peri.

Dolën dy nga dy. Mbi voza mbeti diçka. Gjashta e Xho Millsit.

* * *

— Si ke qenë këto ditë, Bill?

— Diçka më mirë, Albano.

— Duhet t'i shtrohesh kurës. Nuk bën ta zvarrisësh këtë punë.

— Do t'i shtrohem — tha Billi. — Po u sëmura në një kohë delikate, kur duhet të isha më i fortë. E kam nga minierat e argjendit, nga oksidi i tij... Kam punuar në miniera, në Xhorxhbenk. Procesi më është hapur dhe mbyllur dy-tri herë.

— Do të mbyllet prapë, Bill.

— Do të mbyllet — tha tjetri.

— Më rri mendja te filmi — tha Billi.

— Do ta shtiem në dorë patjetër! — tha Albanoja.

— Harrova të të them se kam takuar atë skulptorin — tha pas pak Albanoja.

— Martin Parkerin?

— Po. Si të ra ndër mend ta shëtisësh nëpër Njuhark? E ke tmerruar. I kishte bërë përshtypje kaq të thellë, sa dridhej duke më treguar për mjerimin që kishte parë.

— Mos ia var shumë — tha Billi. — Artist... Merr flakë si kashta dhe shuhet po ashtu.

— Ndoshta s'ke të drejtë, Bill! Ai më tha që po punon diçka kundër Thundrës.

— Ama, për të hyrë në parti, s'bën më zë!

Duke ecur në trotuar, u tërhoqi vëmendjen një grumbull njerëzish. Në mes të tyre merrte dhe jepte një burrë me çantë dhe kapelë në kokë.

— Ai është Morrisoni — tha Billi duke e zënë për-krahu Albanon. — Sa paska ndryshuar!

— Pse nuk e ke dëgjuar? Morrisoni është bërë agjent i shoqërisë së sigurimeve «Harper». Ma tha vetë një ditë kur po prisnim trenin. Fiton më shumë se dyqind dollarë në muaj. «Harper» pati fitime të mëdha sidomos pas vdekjes së Rishar Balduinit. Rrjedhimisht edhe Morrisoni...

«Një Bill ndihmon tjetrin», mendoi Bill Redi.

— Morrisoni bëri shaka me mua dhe më tha se nuk do të na siguronte, edhe po të derdhnim pesëmbëdhjetë-mijë dollarë për shok.

«Kurse ty, Morrison, iu ktheva unë, mund të të sigurojmë edhe për pesë dollarë. Udhë që ke zënë tani nuk të çon në vdekje...»

Bill Redi tundi kokën. Tutje Morrisoni qeshte dhe shënonte shpejt e shpejt diçka në blok.

— E pashë edhe Billin e tretë, Albano...

— Nuk të kuptoj...

— Pashë fundin e tij. Pak a shumë kështu e kam menduar.

— Lufta i shoshit njerëzit. Po në djall të vejë! Eja të pimë diçka, Bill...

Bill Redi nuk pranoi.

— Mirë u pafshim, atëhere! — tha Albanoja. — Nesër mos harro të mbarosh pamfletin kundër derrit Xho!

— Eh! — psherëtiu thellë Albanoja. Ju dhimbs shoku që po largohej ashtu i kërrusur. Tribut të rëndë po i paguanin Thundrës...

Ai kërceu në trolejbuz. Ishte bosh. Vetëm një çift të rinjsh putheshin me zjarr në fund të tij. Ata kishin të drejtë të mos mendonin këtë çast për Thundrën, për tuberkulozin që merret në miniera dhe për përbindshat.

KAPITULLI XXII

Njeriu do të jetojë edhe me një këmbë, edhe me një sy edhe pa sy fare. Nganjëherë gjymtimet më të tmerrshme e shtyjnë të kërkojë të jetojë më fort se njerëzit e zakonshëm. Poli ishte gjymtuar pas mënyrës së vet, kishte humbur shëmbëllimin e njeriut të zakonshëm. Krenaria për veten iu kthye shpejt në urrejtje të vetëvetes. Vetëm se ai urrente Polin e dytë, atë që e kishin

frikë të gjithë dhe që në ishull e quanin Polifem. Kjo nuk ishte një luftë e thjeshtë, po një luftë për jetë dhe për vdekje dhe shpërthente atëhere kur sillte ndërmend që kishte dalë jashtë shoqërisë njerëzore nga budallallëku i tij. Kjo gjendje i zgjati disa kohë, pastaj erdh batica. Ai nuk mund të zgjidhte asgjë duke tundur hekurat e dhomës së vet, duke thirrur si i çmendur, duke mëshiruar gjer në marrëzi mamuthët e mjerë dhe duke u qarë hallin atyre. Nuk mund të nxirrte gjë as duke urryer veten e dytë, Polifemin. Ai kishte ende një armë në dorë, e cila mund ta ndihmonte, kishte dëshirën për jetë. Kishte dhe një armë të dytë të fortë sa të parën, arësyeën. Ajo po e mësonte ta vinte gjigandin Polifem nën urdhërin e Polit njeri. Po të ndodhte kjo, ndryshimi me njerëzit e tjerë s'do të ishte gjë. Ai i nënshtrohej trupit gjigand, po jo egërsisë së tij.

Nuk mund të shpëtonte nga gjendja e re, nagjistarrët e kishin harxhuar fuqinë e tyre shumë kohë përpara Homerit. Nuk do të gjendej asnjë Circe që të mund ta kthente në përmasat e njeriut të zakonshëm. Prandaj Poli përpiqej për të qënë njeri në përmasat e gjigandit.

Pastaj punët erdhën dhe u ndërlikuan. Për të qënë njeri duhet të jetosh si njeri, duhet të dalësh nga kthetërat e Maks Veberit. Duhet këputur ato për të shpëtuar... Dikur Poli mendonte se s'kishte asnjë udhë shpëtimi. Sikur të ikte, njerëzit do të largoheshin me tmerr nga ai si nga lebra, si nga murtaja. Tani nuk pyeste më për këtë. Do t'i rrinin larg në fillim pastaj do të mësoheshin me të. Njeriun nuk e bën trupi të urryer për të tjerët, e bën shpirti, karakteri i tij, mendja... Dikur do ta kuptonin Polin. Ata ishin të afërmit e tij (Për Polin që s'kishte farefis, të afërt ishin gjithë njerëzit e mirë.)

Maks Veberi kishte ndryshuar. Kjo e fuste në mendime të tjera gjigantit. Nga ai Veber që kishte qënë gati t'ia gjymtonte inteligjencën me një të shpuar gjilpërë, ishte kthyer në një njeri që s'po çante fort kokën për ç'ndodhte me gjigantët dhe gjithë vëmendjen e kishte kthyer nga Batleri. Poli nuk dinte që aty ishte Norman

Batleri, po dinte që diku pas atyre labirinteve të dyerve po mbanin një njeri me rëndësi. Dinte gjithashtu që s'e kishin sjellë për të mirë. Në «Kanarinat» nuk mund të sillnin asgjë për të mirë. Veberi u kishte premtuar se do t'i largonte nga ishulli. Me t'u larguar, ata mund të jetonin si të tjerët, po kuptohet, që do të vareshin nga Veberi, do t'i shërbenin diçkaje dhe dikujt... Kështu u kishte thënë Veberi. Ai qëndronte dhe ndërronte ndonjëherë dy-tri fjalë me Polin. I binte edhe shpatullave. Megjithatë Poli nuk harronte kush ishte Veberi. Ai mundohet të kuptonte pse sillej tani më butë.

Poli rrinte shtrirë në shtrat dhe përpiquej të shqyrtonte gjendjen e tij. S'kishte asnjë dyshim që Maks Veberi po e trajtonte në mënyrë të veçantë. Atij ia sillnin bukën tani në dhomë dhe nuk e ngatërronin me punët që i ngarkonin të tjerët. Rojet dhe zëvendësit e Veberit i flisnin me një farë respekti të përzier me frikë. Prej kohësh nuk e kishin fyer dhe goditur.

Në mur u ndez një dritë e gjelbër. E thërrisnin. Poli u ngrit dhe doli në korridor. Gjetei dy nga rojet.

— Të kërkon mistër Veberi — i thanë ata.

Të tre përshkuan labirintet e korridoreve pastaj iu afruan dhomës së Veberit. Hynë që të tre brenda. Veberi rrinte në kolltuk pas skrivanisë. Ai ngriti kokën, pastaj i bëri me shenjë Polit të ulej.

— Na lini vetëm — u tha rojeve.

Ata vështruan njëri-tjetrin.

— Nuk dëgjuat? — u bërtiti. Me Polin tani merrem vesh për bukuri.

Gjiganti ngriti supet dhe vështroi rojet. Ata dolën jashtë.

Maksi u ngrit dhe hapi televizorin.

— Sa kohë ke pa parë, Pol?

— Pothuaj dy vjet, mistër Veber...

Në ekran u dukën reklama stofrash, automobilësh, vila luksi, gra të bukura, djem që puthnin vajzat në mes të udhës... Pastaj udhët... Udhët plot njerëz, udhët me jetë, udhët që nuk mbaronin kurrë... Pastaj koncerte, një tren që humbte diku në një tunel, (lokomotiva e tij vazh-

donte koncertin), Martin Villiamsi që hidhte dikë nga ringu, yjet e basketbollit të zi që merrnin diku një kupë.

Poli nuk thirri, ulëriti.

Veberi e shohti televizorin.

— Të hoqa nga të gjitha këto — filloi ai — në një kohë kur ti vetëm ëndërroje, të hoqa për të t'i dhënë tani kur mund t'i shijosh me të vërtetë. I varfër dhe i pafuqishëm siç ishe do të sekretoje vetëm lëngje me gjuhën jashtë, si qentë e fiziologëve. Edhe unë do të ulërija, po do të ulërija nga gëzimi. Filozofia nuk çan kokën për atë që ka kaluar dhe mirë bën. Vlen vetëm e ardhmja. Kështu edhe për ty. E ardhmja! Dhe për pak unë do të të nxjerr nga ishulli dhe do t'i kesh me të tapërt ato për të cilat ulërite. Ulëri! Luani e vret demin në fillim me ulërimë. Kur i ngul putrën, ai është pothuaj një kufomë. Do të kesh gëzime, pasuri, gra dhe armiq të nënshtruar. Do t'i kesh vetëm tani, sepse unë të dhashë fuqi. Fuqisë i nënshtrohen njëlloj si miza e dheut, si njeriu. Të gjithë do të të binden, ndërsa ti do të më bindesh vetëm mua. Jam krijuesi yt, do të të bëj mbret të boksit, mbret të regbisë, mbret të çdo gjëje që vlen të mbretërohet në Njuhark. Do të jesh aq i famshëm në këtë vend që dashuron të jashtëzakonshmen, sa që të gjithë do të jenë një hiç përpara teje. Së fundi unë do të të vë edhe mbi shtetin dhe ti do të sundosh. Po pas shpinës tënde do të më kesh mua. Ti do të jesh fuqia, unë mendja. Mos u çudit. Në Njuhark vendos lavdia. Presidenti i tanishëm u zgjodh nga lavdia që fitoi në shpinë të kuajve. Senatorët e tjerë s'qenë aq të zgjuar sa të merren me hipizëm. Gjersa njerëzit iu nënshtruan atij ish-ponejt¹⁾ sa një grusht, do t'i nënshtrohen aq më shumë Polit gjigant.

Njerëzit do të tremben në fillim, më vonë do të nënshtrohen me dashje. Ata e kanë në gjak nënshttrimin, ndjejnë nevojë për t'iu përkulur fuqisë. Po ata janë hipokritë. I kanë vënë fuqisë emrin e zotit, Krishtit dhe

1) Kalorës garash.

Brahmës. Bien në gjunjë përpara Krishtit dhe Brahmës, lozin menç pas idhujve. Pas teje aq më shumë. Ti je një Krisht i gjallë, një Brahmë e gjallë.

Poli që mbledhur kruspull. Nuk që Veberi që trembej nga ai, ishte Poli që trembej nga Veberi.

Poli besoi se Maks Veberi që çmendur. Mund t'i kishte bërë edhe atij ndonjë nga ato injekcionet që u bënin mamuthëve.

— Nuk do të iki nga Njuharku — thirri Veberi me tërë mushkëritë. — Fuqinë do ta fitoj këtu. Përpara nesh do të dridhet bota. Ç'ke, ulëri, pra! Ulëri mbi turmën, mbi ata që s'të marrin vesh, mbi ata që duan ta ndërrojnë këtë botë. Ulëri, pastaj nguli putrën...

Maks Veberi i ra papritmas skrivanisë me grusht.

— Ulëri! — thirri ai.

Gjiganti shtrëngoi gjoksin me dorë. Desh të sprap-sej, të ikte. Ai përpara tij që çmendur... Të çmendurit i druhet edhe një gjigant...

— Merrni Milluokin, mistër Veber — tha Poli gjithë ankth. — Ai është më i përshtatshëm.

Veberi qeshi.

— Nuk jam i marrë — tha. — Ai i përket një race tjetër, ka ngjyrë tjetër. Njuharku e do zotin me ngjyrën e vet...

Maksi zuri të qeshte prapë. Qeshte dhe dridhej. E kapi për krahu Polin dhe doli me të në korridor.

— Ti je Samsoni — i pëshpëriti ai edhe një herë. — Je krijesa, pjella ime...

E la Polin prapa dhe vazhdoi të ecte gjatë korridorit. U hap një derë dhe që aty dolën Stenli dhe shoqëruesi i tij. Nuk e panë Veberin.

«Stenli vete të shtriqet, mendoi me tallje Veberi. Por ai shtangu në vend. Ç'po ndodhte?»

Stenli i kishte dhënë një të shtyrë shoqëruesit dhe e kishte hedhur përdhe. Pastaj ai nisi të vraponte. Qëndroi përpara një dere dhe shtypi sustën në anë të saj.

Maksi erdhi në vete dhe u turr përpara. Pa derën që po hapej ngadalë. Stenli e shtynte atë, po ajo lëvizte

në mënyrë të njëtrajtshme. Veberi arriti kur Stenli ndo-
dhej brenda. Përpara të dyve qëndronte si hije Norman
Batleri.

Stenli nuk u hodh në krahët e tij, po i foli me një
frymë: «Ju mashtrojnë, profesor. Boris Shumakovi nuk
ekziston. Programi që i trilluar, po ashtu edhe shkrimet
në revista. Veberi është kriminel. Ruhu nga...»

E goditën në kokë. Batleri goditi dikë. Veberi...
Prapë Batleri. Pastaj këtë të fundit e larguan. E futën
brenda. (Batleri ishte turrur jashtë). Mbyllën derën.

— Thirrmani Polin! — urdhëroi Veberi.

— Si thatë, mistër Veber?

— Polifemin, ju marrtë djalli!

Në dhomën numër nëntë ka ca hekura, Pol — tha
Veberi. — Rregulloje aty mistër Stenlin.

Poli e ngriti në duar asistentin e Batlerit. Veberi u
largua. Vazhdonte të qeshte. Nga fundi i korridorit
zuri të fishkëllente një marsh. Një motiv nga repartet
e sulmit...

Me këtë motiv arriti gjer në shtëpi. Po kështu i
kaloi nën hundë fraulein Evës, po duke fishkëllyer. Ajo
e ndoqi me sy, me duar të bashkuara në gjoks, e tron-
ditur. Fraulein Eva harroi t'i thoshte që lart po e pris-
nin. Veberi nuk pushoi as përpara klanit të ujqërve.
Çudia dhe zemërimi i tyre e futi edhe më shumë në
ngasje. Ai vazhdoi të fishkëllente sikur kishte sjellë pas
shpine një renë të shqyer diku në kanjonet e ngrira. A
nuk ishte ai kryeujku i zoti i tyre?

Kryeujku u shqetësua. Ai që kthyer duarbosh nga
gjahu. Nuk ndjente as erën e gjakut, as peshën e renës
mbi shpinë. Mbante mend mirë që kishte bredhur akull-
najë më akullnajë dhe u ishte sulur renave. Pas gjithë
asaj ngrice, tani i digjnin putrat...

Ku e kishte Batlerin?

Nuk e shqyen Veberin, e braktisën. Ky që një për-
jashtim në ligjet e bishës që tregonte se egërsirat po
mësonin nga njerëzit e civilizuar.

Kryeujku e ndjeu këtë për një çast dhe rënkoj nga

dhembja. Po përnjëherësh ai vështroi gjithë atë hapësirë të bardhë dhe lëshoi një psherëtimë kënaqësie. Ai ishte zot i gjithë këtij vendi, ishte çliruar nga detyrimi ndaj kopesë dhe do të gjuante vetëm për vete. Nuk ishte një egërsirë e plakur që e braktisin për të mos e patur barrë. Ishte gjithë shëndet dhe dhëmbë. Mjerë kush i dilte përpara!..

Aty pas derës, fraulein Eva mbante vesh me zemër të dredhur përpëlitjet e Maks Veberit në ethe...

INTERLUD

Më në fund plasi ajo që duhej të pëlciste. «Star of Njuhark», një gazetë që dikur mbështeste Balduinin, pranoi të botonte fotografi të marra në ishullin e «Kanarinave». Një faqe e tërë... Mamuthët në përleshje, Milluoki që hidhte shkrepa në det, Veberi me kërbac në dorë. Pastaj Veberi me Xhon Stivensin. Senatori qeshte vesh më vesh... Llojd Peri kishte pasur më shumë fat se Ted Kanigani.

Billi me shokë po ngrinin punëtorët. Sindikata e çelikut i vuri një kusht Xhon Stivensit, të inspektohej ishulli, përndryshe do të votonin kundër. Kështu bënë edhe të tjerët.

Në këtë kohë Batleri vërtitej nëpër dhomë dhe i binte derës. Ai nuk e dinte sa shumë kumbonte korridori, sepse brenda nuk hynte asnjë zhurmë. Rrinte dhe i binte derës. Atë ditë, qe tepër i ashpër me veten dhe mosbesues gjer në marrëzi.

Ndërkohë Martin Parkeri vendosi një statujë në krye të udhës trembëdhjetë. Ishte Xhon Stivensi. Ai kishte një pamje të përbindshme në fytyrë dhe një çomangë me gjëmba në duar. Skulptori ishte kujdesur që vepra të shihej nga të gjithë. Kishte vënë një shënim të shkurtër në fund të saj: «E minuar».

KAPITULLI XXIII

Stenli kishte përkulur kokën. Nuk mbahej ai, e mbanin hekurat. Ai mbahej vetëm kur vinte në vete. Atëhere vështronte Batlerin dhe Anabellën. I rridhte gjak nga goja. Pikë, pikë... Guta Cavit Lapidem... 1) Po shponte zemrën e Batlerit. E kishin urdhëruar të vështronte martirizimin e Stenlit. Kështu kishte thënë Veberi. Ai dukej i shqetësuar dhe u binte çizmeve me kamxhik. Herë pas here kamxhiku i tij ndërronte trajektore dhe binte mbi Stenlin. Veberi ndihmonte kështu Milluokin.

Batleri thërriste pa pushim. Atë nuk e kishin prekur me dorë, po nuk e linin të lëvizte.

— Veber! Ju jeni kriminel, jeni i mallëkuar...

Veberi mundohej ta bënte veshin e shurdhër.

— Sikur t'ju shtypnin ju kështu, Veber...

Maksi rrihte çizmet dhe i bënte me shenjë Milluokit të mos i kursente goditjet.

— Veber! Ka një vdekje, ka një pleqëri! Në pleqëri do të dridhesh...

Pastaj ai heshti papritmas. I mbloodhi përbrenda thirrjet dhe mallëkimet. Iu deshën për të qëndruar, për t'i bërë ballë Veberit.

Milluoki i hodhi një kovë me ujë Stenlit. Këtë punë ai e bëri si pa qejf, nga urdhëri i Veberit. Stenli me kokën poshtë ishte vepër e tij, nga kjo ai ndjente fuqinë e vet. Ai do ta kishte dërmuar, sikur mos t'ia drejtonte krahun Veberi. Ai nuk donte vdekje, donte mundime. Ai ia ngrinte kokën Anabellës të vështronte Stenlin dhe mundohej të provonte sa dhemb dashuria.

Batleri u drodh. Për pak sa nuk e prishi atë maskë olimpike. Futi thonjtë e duarve thellë në mishra dhe u përmbajt.

Milluoki ia përplasi kokën Stenlit pas hekurave ku e kishin lidhur. Kur erdhi në vete, kërkoi me sy Batlerin.

«Mistër Batler! Ja ç'paska nëpër botë! I keni ditur

1) Pika shpon gurin (latinisht).

ju këto? E ç'duhet ajo koka juaj olimpikë, ç'duhet dituritë, ç'duhet një kravatë e lidhur bukur, po të mos i dish këto? A nuk ju thosha një kohë? Po kështu nuk i dija as unë. Unë u afrohesha...»

Nuk fliste Stenli, fliste Norman Batleri. Ai i kishte përpara që të dy: Stenlin dhe Milluokin, njeriun e zakonshëm dhe gjigantin.

Pse i dukej Stenli më i madh, më i fuqishëm? Në atë përpëlitje mendimesh dhe ndjenjash, Batleri zbuloi si mund të bëhet njeriu gjigant...

U hap dera dhe brenda hyri si furtunë Xhon Stivensi me disa veta pas. Merrte frymë me zor. Stenli i humbur, Batleri i mbërthyer pas murit, Anabella që qante... të gjitha këto i shkrepëtinë brenda një sekonde.

— Qëndroni, mistër Batler! — mezi foli Stenli duke dalë nga kllapia.

— Po qëndroj, miku im...

Senatori u turr nga ata që mbanin Batlerin dhe i tërhoqi për mëngësh duke i sharë dhe bërtitur.

— U sollën keq, profesor?

Batleri ktheu fytyrën në një anë, pastaj u derdh nga Stenli dhe i mori kokën në gjoks.

— Zgjidheni, egërsira!

Xhon Stivensi qëndronte ballë për ballë Maks Veberit.

— Sadist! — i thirri. I rrëmbeu kamxhikun dhe e goditi fort. — Kush të urdhëroi ta bësh këtë? Sadist!

Veberi zuri faqen me dorë. Vija e kamxhikut i varej gjatë faqes si një bisht kobre. Iu kujtua Erihu dhe Rishar Balduini. Kush i vrau ata?

— Hiqmu nga sytë! — thirri prapë Xhon Stivensi.

— Mos më dil më përpara.

Senatori u bëri me shenjë të afroreshin atyre që ishin në dhomë.

— Shpejt! — tha. — Zhdukni çdo gjurmë. Nuk duhet të kuptohet ç'është bërë këtu.

Ata e vështruan si guakë. Disa menduan se e kishte fjalën për shenjat e torturës dhe deshën të fshinin gjakun.

— Jo vetëm atë, po çdo gjë që mund të tregojë për gjigantët. Ishulli mund të inspektohet. Prishni impiantin e gazrave, shtretërit e mamuthëve, dhomën e bukës. Të gjitha në det! Ishulli mund të inspektohet. Lëvizni, ju thonë!

Filloi një trazirë që s'e pa i pari të dytin. Zunë të shkatërronin me lehtësi të madhe atë që e kishin ndër-tuar me mundim.

Tani të gjithë e kishin kuptuar si qëndronte puna. Brenda dy orësh hodhën në det çdo gjë që mund të zbulonte të fshehtën e ishullit.

Poli e kishte parë çfarë kishte ndodhur në mes të Veberit dhe senatorit. Mos ishte fundi ky? Çfarë do të vinte pas tij? Liria?

Xhon Stivensi bridhte sa në një anë, në një tjetër. Prapa tij suleshin ata që e kishin shoqëruar në ishull. Jepte urdhëra, shante dhe fliste me vete.

E lajmëruan-se s'kishin ç'të hiqnin tjetër. Tani mbe-teshin vetëm provat e gjalla.

— Me ato kam punë unë — tha ai duke psherëtirë.

E tërhoqi në një anë zëvendësi i Veberit.

— Ç'do t'u themi kur të vijnë, mistër Stivens? Ata do të na pyesin ç'punë bëjmë ne këtu dhe përse duhen këto ndërtesa. Do ta kuptojnë menjëherë të vërtetën.

— Aspak! tha senatori.

— Nuk kuptoj, mistër Stivens...

— Pas pak do të kuptosh...

— A nuk mund ta pengoni inspektimin, mistër Stivens? — vazhdoi të pyeste zëvendësi i Veberit.

— Mundësia, po kjo s'ishte e arësyeshme. Do të bindeshin që fotot e botuara në «Star of Njuhark» janë të vërteta dhe unë nuk do të zgjidhesha. Dhe, po të mos zgjidhem sivjet, ka mundësi që as senator më të mos mbetem. Veberi u tregua leshko. Fotot i kanë nxjerrë nga ishulli. Të mbarojnë zgjedhjet, pastaj do të merrem me ata që na sollën këtë prapësi. Kemi tradhëtarë në mes tonë.

Senatori i bëri me shenjë njërit nga ata, me të cilët kishte ardhur.

— Banorët e rinj! — thirri ai.

U hap një derë dhe brenda hyri në radhë një varg njerëzish me pamje të shastisur dhe të lidhur me hekura.

— Për këta duhen dhomat me hekura — tha Xhon Stivensi.

— Nga ç'burg vijnë? — pyeti zëvendësi i Veberit.

— Nuk vijnë nga burgjet, vijnë nga çmendina!

Zëvendësi i Veberit hapi gojën i çuditur. Mprehtësia e senatorit e habiti. Ai ishte kujtuar të sillte memecë, njerëz që nuk do të ishin në gjendje të zbulonin të vërtetën.

Të çmendurit i hodhën nëpër dhoma. Mund të ishin nja tetëdhjetë gjithsej. I shoqëronin mjekë dhe infermierë... Pastaj prunë shtretërit dhe pajisjet. Sa çel e mbyll sytë, azili i gjigantëve u shndërrua në një çmendinë model.

— Nuk do të bjerë në sy largimi i të çmendurve? — pyeti zëvendësi i Veberit.

— Jo! I kam hequr nga një e nga dy nga njëzet e pesë çmendina të ndryshme — tha Xhon Stivensi. — Harri, — vazhdoi ai — shko dhe pregatit mamuthët për udhë! Jep urdhër edhe për motoskafët dhe helikopterin!

Çarli Tot i qe vënë prapa Veberit. E futi në dyshim buzëqeshja e tij kur u nda nga Xhon Stivensi. Veberi u fut në dhomën e vet. Ai hyri qetësisht aty, po, me të vënë këmbën brenda, ndryshoi përnjëherësh dhe zuri të kërkonte dollapet si i xhindosur.

— Po kërkoj një pastë dhëmbësh, Çarli...

Ai doli nga dhoma me hapa të shpejtë, përshkoi korridorin duke u përplasur me ata që venin e vinin. Asnjëri nuk ia lëshonte udhën.

U fut në dhomat me hekura. Posa i kishin futur të çmendurit brenda. Ata thërrisnin dhe rrihnin hekurat me zinxhirët e duarve.

— Napoleon! Napoleon! — i thirrën atij që kishte folur latinisht.

— Napoleon? Një m... Napoleon! Jam Kuint Saver Sesterci, edil i kampanisë!

Veberi u shkëput nga hekurat.

— Kisha një pastë dhëmbësh — i tha ai Çarlit me të butë. — Kisha edhe tritol. Tritol, mistër Tot...

Hyri në dhomë dhe zuri të vërtitej rreth xhamave. Zgjati dorën drejt tyre duke u ngritur në majë të gishtërinjve. Përpiqej të zinte mizat.

— Gjigantët e mi të dashur... Gjigantët e mi të dashur...

Zuri një grusht prej tyre dhe i afroi pranë fytyrës. I iku një mizë nga dora.

— Ndiqeni Polifemin! — thirri Veberi. — Iku Polifemi. Help! ¹⁾

— Domned Folly ²⁾... — tha Xhon Stivensi nga praku i derës. Ai e kishte ndjekur gjithë këtë skenë pa nxjerrë zë.

Se kush e kërkoi për diçka dhe senatori u largua duke i bërë me shenjë Çarlit që ta ndiqte pas.

— Tani të gjitha janë gati, mistër Stivens raportoi zëvendësi i Veberit.

— Më gjetët ndonjë emblemë të Balduinit?

— Posi! Nja dy kapela dhe një nga flamurët që vendoste në podiumin ku fliste.

— Bukuri, atëhere.

— A nuk është e rrezikshme kjo lodër? — pyeti njëri.

— E rrezikshme është, sikur të ketë kohë për t'u zbuluar e vërteta. Po zgjedhjet janë nesër. Është e pamundur të merret vesh që unë po ua punoj kështu kolegëve të mi. Kur të jem zgjedhur, le të kuptohet që gjigantët nuk ishin të Balduinit, po të mitë. Atëhere do të jem i zoti t'u mbyll gojën.

Senatori kërkoi Batlerin.

1) Ndihmë!

2) Marrëzi e mallëkuar... (Angl).

— Na lini vetëm! — urdhëroi ai kur erdhi shkençetari.

— Mundohuni të më dëgjoni me vëmendje, profesor — tha senatori me zë gati të vrazhdë. — Unë do t'ju nxjerr nga ishulli. Do të jeni i lirë së bashku me mbesën tuaj dhe Stenlin dhe mund ta ruani apo të bëni ç't'ju shkrepet me sekretin e hormoneve. Po, për të dalë që këtej, do të bëni një deklaratë të shkurtër.

— Çfarë deklarate?

— Do të thoni që fotot në ishullin e «Kananave» ishin montazhe dhe se ju kanë mbajtur në një vend të fshehtë nga Perëndimi. Do të thoni që nuk ju kam rrëmbyer unë, po Rishar Balduini.

— Të gënjej?

Senatori ngriti supet.

— Pasesër do të jem president — tha me arrogancë Xhon Stivensi. — Do të përpiqem t'ju shpëtoj nga gënjeshttra. Dhe... Dhe po t'ju shkojë nëpër mend të ma punoni, do t'ju zhduk në vend, mistër Batler... Mendoni për të ardhmen tuaj e të mbesës, të Stenlit. Ata sikur kanë filluar një roman...

Senatori thirri zëvendësin e Veberit. I la listën e emrave të atyre që do të qëndronin në ishull. Ishullin e linte nën urdhërat e tij.

— Po mistër Veberi? — pyeti Harri. — Ç'do të bëjmë me të?

— Vëri hekurat! — u përgjegj ftohtë senatori. — Atij i ka fluturuar mendja.

Hipën në helikopter Batleri, mamuthët, rojet e tyre, Poli dhe Ralfi me Milluokin, Anabella dhe Stenli i shtirë në një vig. Rojet përveç bastuneve, ishin të armatosur me automatikë «Tomson» dhe me granata.

Brenda asaj ore që zgjati fluturimi, sytë e senatorit u ndeshën vetëm një herë me Batlerin. Senatori qëndronte në kabinën e komandës dhe vështronte herë mbas here se ç'bëhej. E ndeshi vështrimin e Batlerit vetëm kur po zbrisnin. Nuk pati kohë të mendonte dhe ta kuptonte

atë. Helikopteri kishte qëndruar. Në fushë po priste një autobus dhe dy vetura.

— Zbrisni! — urdhëroi Xhon Stivensi.

* * *

Veberi ishte larguar fshehtas nga dhoma dhe po ashtu i qe afruar gurores ku nxirrnin mermer. Në dorë shtrëngonte tri-katër miza të ngordhura me bindjen që i kishte gjigantët në grusht. Zuri të ngjitej në bregun shkëmbor dhe të fishkëllente. U ngjit në majë. Heshti dhe i ktheu shpinën detit. Përfshiu me sy gjithë ishullin. Pastaj zhurma e helikopterit e bëri të ngrinte kokën lart. Po ikte Xhon Stivensi.

— Salut! — tha Veberi dhe tundi dorën sikur të përshëndeste dikë të afërt.

Pastaj sytë i mbetën në gurore. Sikur dëgjoi levat e mamuthëve që shqepnin bloqet e mermerit. Pastaj bloqet që lëviznin e rreshtoheshin në breg. Bloqet mbi kokët e mamuthëve po ngjiteshin lart...

Veberi llogariti kohën dhe i doli që jetonte njëqindmijë vjet përpara erës së re. U tremb nga mamuthët. Humbi ekuilibrin dhe ra poshtë në det pa e hapur grush-tin fare.

* * *

Xhon Stivensi vinte me maqinë, pas autobusit. Kish-te rrasur një kapelë republike në kokë dhe i kishte ulur mirë perdet e veturës. Vështronte herë rrugën, herë një ekran të vogël televiziv. Në rrugë kalonin maqina të zakonshme, ndërsa ekрани s'tregonte asgjë. Senatori hapi radiotelefonin dhe pyeti për demonstruesit.

— Nodohen në udhën trembëdhjetë — iu përgjegjën.

— Sa janë?

— Kush mund ta dijë? Ka dalë gjithë Njuharku në rrugë. Ekрани u ndriçua. Xhon Stivensi rrudhi buzët,

kur pa atë mizëri njerëzish që po ecnin. Bashkë me ta ecte edhe statuja e Parkerit.

— Do të ma paguash, i poshtër! — kërcëlloi dhëmbët senatori. — Unë të ngrita në këmbë. Kur erdhe tek unë, lëpiheshe si langua.

Autobusi mori kthesën. Pas tij doli në udhë edhe vetura e senatorit. Ngjitur me të po ecte një «Parker» i gjelbër ku po udhëtonin Batleri, Stenli, Anabella, dy njerëz të Xhon Stivensit dhe s'dihet se si ishte ndodhur aty edhe Çarli Tot.

Senatori i njoftoi me radio të ndalonin dhe ta lejonin Batlerin të dilte.

Turma e demonstruesve tani ishte fare pranë.

— Vetëm Batlerin! — ritheksoi Xhon Stivensi.

Shkencëtari doli nga maqina. Dolën edhe dy njerëzit e senatorit. Ata u futën armëve fishekë në gojë.

Batleri qëndroi një hop dhe pa nga Anabella. Vajza e shtyu njërin nga ata që deshën ta pengonin (Ky ishte Çarli Tot. Ai bëri sikur i kundërshtoi, por në të vërtetë e la të zbriste), pastaj u ngjesh pas Norman Batlerit.

— Ç'të bëjmë? — e pyetën me radio Xhon Stivensin.

— Në djall të veni! Lëreni tani që doli. Po hapni sytë!

Turmën e demonstruesve nuk e kishin as dyzet metra larg. Çarli Tot ngriti krahët përprjetë dhe thirri:

— Ja Norman Batleri!

Po nuk e dëgjuan nga zhurma. Atëhere Çarli vrapoi drejt demonstruesve dhe e përsëriti atë që kishte thënë pak përpara.

— Batleri?

— Profesori?

— O burra!

Fjala u përhap menjëherë radhë pas radhe.

— Pra Batleri...

Turma u ndal përpara tij. Ky që i pari ballafaqim i tillë në jetën e Norman Batlerit.

— Rroftë Batleri! — thirrën nga të katër anët.

— Rroftë!

E ngritën Batlerin mbi supe. Ngritën edhe një nga njerëzit e Xhon Stivensit. Ngritën edhe Çarlin Tot. I sollën kështu me brohoritje gjer përpara statujës së Xhon Stivensit që e kishin montuar mbi një kamion. Gjetën shpejt e shpejt një mikrofon dhe ia afruan te goja.

Çarli Tot ia mori nga duart mikrofonin. Mendoi t'ia sheshonte udhën Batlerit.

— Doni të dini kush e rrëmbeu Batlerin?

— Duam! — thirrën me mijëra zëra.

— Ja kush e rrëmbeu! — tha Çarli duke treguar me gisht statujën.

Njeriu i senatorit hapi sytë si ndonjë i çmendur. Ai mund të dyshonte për një gjë të tillë nga Batleri, por kurrë nga Çarli. Nxori revolen dhe qëlloi. Plumbi nuk e zuri Çarlin, por thërmoi barkun e mermertë të Xhon Stivensit. Plumbi i dytë i kaloi dy gisht mbi kokë. E kapën dhe i hoqën armën nga dora.

— Ky është njeri i Xhon Stivensit — shpjegoi Çarli. Pastaj ai u kthye nga shkencëtari.

— A janë të vërteta ato që thashë?

— Po! — tha Batleri pas një ngurrimi të lehtë.

— Kush ju rrëmbeu, pra? Kush fabrikon gjigantë? Thuajani emrin!

— Xhon Stivensi! — tha Batleri.

Një thirrje buçiti nga turma. Batleri mendoi se ky qe efekti i fjalëve të tij dhe nuk pa mamuthët dhe tre gjigantët që po sulleshin me çomangat në duar. Mjaft prej tyre mbanin distiktiva dhe emblema të Rishar Balduinit.

— Këta janë njerëzit e Stivensit. Mos u mashtroni nga shenjat — thirri Çarl Tot.

Fishkëllyen plumba. Çarli u fsheh pas statujës dhe vazhdoi të fliste.

Mamuthët iu sulën demonstruesve dhe zunë t'u binin me çomanga dhe me hekura.

Njerëzit u përgjegjën. Njëri nga mamuthët goditi për vdekje një plak. Atë e shkelën me këmbë. Përpara

mamuthëve u krijua një boshllëk, pastaj turma u vërsul e vendosur. Përballë tyre qe Frenki dhe Llojd Peri. Në anën tjetër udhëhiqte Albanoja me Bill Redin. Xho Millsi me shokë ishte diku nga mesi i turmës. Klei Bimëni në një anë tjetër.

Poli nuk kishte goditur ende asnjëri. Ralfi dhe Milluoki ishin lëshuar si bisha dhe kishin bërë kërdinë. Kundër tyre njerëzit zunë të hidhnin gurë e shishe. Poli vështronte pa ditur çfarë të bënte. Për një çast ai mbeti i rrethuar nga turma, pastaj u pa në shesh të hapët. Atë nuk e nganë, kur iu afruan, megjithëse së largu hëngri goxha gurë. Ai vështronte Milluokin dhe Ralfin. I pari ulte dhe ngrinte çomangën. Ralfi mundahej të shpërndante njerëzit me fjalë.

Klei Bimëni u gjend ballë për ballë me të.

— Ralf! Ti këtu? Kundër nesh?..

Turma e shtyu tutje Klein dhe ai e humbi Ralfin nga sytë. Gjiganti Ralf u mpi kur pa Klei Bimënin. Ai mbeti me çomangën në dorë.

— Pol! — thirri nga mikrofoni Çarl Tot. — Zgjohu, ndihmoje popullin. Po të flas unë, Çarl Tot...

Gjiganti u kthye nga turma e njerëzve. Pikërisht në atë çast Milluoki iu afrua tinëzisht dhe e qëlloi pas kokës me çomangë. Poli u shemb përdhe. Milluoki i ndoqi disa hapa njerëzit. U dëgjuan krisma. Milluoki dhe Albanoja u ndodhën ballë për ballë. Prapa ishte një falangë. Ajo po i ngjishte radhët.

Batleri kishte mbetur në karrocërinë e kamionit bashkë me Çarlin. Ai vështronte Milluokin që vërtiste çomangën. Milluokin dhe Ralfin... Në fillim turma qe e pur dhe pothuaj po thyhej. Po pastaj atë e kishin organizuar, i kishin dhënë zemër Billi dhe Albanoja.

Ralfi e hodhi përdhe çomangën dhe u spraps. Nuk bëri as dhjetë hapa dhe u rrëzua. E qëlluan nga autobusi njerëzit e Stivensit. Ra përmbys, pastaj zgjati krahët, sikur të donte të kapte një gur, një rrënjë peme, të shpëtonte nga mbytja...

Mbete Milluoki dhe masa e njerëzve përpara tij.

Batlerit i rrihte zemra fort. Ai kishte zbritur nga karrocERIA dhe ishte gjendur padashur në radhët e para. E vështroi Milluokin e tërbuar nga zemërimi dhe urrejtja dhe e pati frikë. Por i iku frika, kur vështroi sa njerëz kishte për krah. Batleri mendoi që veç e veç asnjëri prej tyre nuk vlente më shumë se ai vetë, por të bashkuar ata ishin shumë të fuqishëm.

Milluoki u spraps dy-tre hapa. Vështronte andej-këtej si bisha që pret ta shqyejnë langojtë. Turma e njerëzve e fitoi atë tokë që lëshoi ai.

Nga autobusi qëlluan prapë. U rrëzua dhe Milluoki. Xhon Stivensi po i hiqte vetë qafe krijesat e tij.

«Ai nuk mund të shkonte as përpara, as prapa, mendoi Batleri duke parë si po rrëzohej Milluoki. Një kohë as unë vetë nuk mund të shkoja as përpara, as prapa...»

Krismat u shtuan. Turma çante si furtunë përpara. Sheshi filloi të boshatisej. Mbetën Batleri, Xho Millsi dhe Bill Redi. Ky i fundit i zgjati dorën shkencëtarit.

— Jam Bill Redi — tha. — Jemi njohur, kur ju sulmuan spanjолët e Njuharkut.

— Po, ju mbaj mend — foli Batleri duke i shtrënguar dorën fort.

Nga larg vinte zhurma e gëzuar e atyre që kishin mposhtur gjigantët. Rrugët oshëtinin nga britmat.

— Tani mund të marrim frymë lirisht — psherëtiu shkencëtari.

Billi buzëqeshi. Kjo e tanishmja qe vetëm një betejë. Fitorja do të vinte patjetër, po lufta do të ishte e gjatë. Do të dilte një Xhon Stivens tjetër, gjigantë të tjerë...

Fund